




INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

01/2020

SHËNJESTRIMET E DËSHTUARA



PRISHTINË, MARS 2020

Autorët: Leotrim Gashi dhe Medina Kadriu

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Mars 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive.....	5
II. Metodologjia	8
III. Veprimet e KGJK-së dhe KPK-së në trajtimin e rasteve të shënjestruara.....	10
a) Raportet e Komisionit Evropian për rastet e shënjestëruara	11
b) Shkelja e kriterëve të PSV-ve nga Prokurori i Shtetit në shënjestrimin e rasteve	13
IV. Efikasiteti dhe rezultatet në trajtimin e rasteve të shënjestruara	14
a) Shkeljet ligjore dhe të politikave të KGJK-së në rastet e shënjestruara	18
b) Shkeljet ligjore të vendimeve dhe politikave të KGJK-së nga vet KGJK	18
V. Performanca e sistemit të drejtësisë në rastet e shënjestruara.....	20
VI. Aktgjykimet përfundimtare në rastet e shënjestruara	26
a) Politika e dënimeve në rastet e shënjestruara të përfunduara me aktgjykim përfundimtar	27
VII. Aktgjykimet e shkallës së parë në rastet e shënjestruara të kthyer në rigjykim.....	30
VIII. Aktgjykimet e shkallës së parë në rastet e shënjestruara	33
IX. Profili i personave të akuzuar në të gjitha rastet e shënjestruara	37
X. Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të shënjestruara.....	42
ANEX I: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara që gjenden për herë të parë në gjykim	45
ANEX II: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të kthyer në rigjykim	91
ANEX III: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të përfunduara në shkallë të parë, të cilat gjenden në procedurë ankimore	110
ANEX IV: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë	150
ANEX V: Veprimet e institucioneve të drejtësisë pas 1 janarit 2020.....	195
XI. Rekomandimet.....	197

Lista e shkurtesave

PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
LV	Lëndë të shënjestruara për liberalizimin e vizave
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KE	Komisioni Evropian
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

I. Përmbledhje ekzekutive

Në korrik të vitit 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës kishte miratuar “*Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional*”, me të cilat synohej që institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë të arrinin një koordinim dhe bashkëpunim reciprok me qëllim që të parandalonin, zbulonin, hetonin dhe gjykonin kryesit e veprave më të rënda penale, e që për qëllim final kishin sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar përmes veprave penale. Një vit pas KPK-së, Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, më 30 dhjetor 2015 kishte nxjerrë vendim me të cilin obligonte kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e çështjeve që të gjitha rastet që vijnë nga prokuroria dhe kanë shenjë “LV” [Liberalizim i Vizave], të trajtohen me prioritet absolut.

Për pesë (5) vite, nga muaji dhjetor 2014 deri më 31 dhjetor 2019, janë shënjestruar 57 raste në të cilat janë përfshirë 443 persona, ku 343 nga ta janë bërë pjesë e aktakuzave të prokurorisë. Nga ta 194 persona janë akuzuar për vepra korruptive, kurse 149 persona i takojnë natyrës së krimit të organizuar.

IKD gjen se mekanizmi për shënjestrimin e këtyre rasteve të krimeve të rënda për liberalizimin e vizave në vazhdimësi janë shkelur kriteret e përcaktuara në *Procedurat Standarde të Veprimit* me rastin e shënjestrimin të rasteve.

Shumë lëndë të shënjestruara nuk i plotësojnë kriteret e PSV-ve, ndërsa shumë lëndë, të cilat i plotësojnë kriteret për shënjestrim nuk janë shënjestruar. Përderisa, fokusi i Prokurorit të Shtetit është përqendruar në raste shënjestrimin e rasteve që nuk përkojnë me qëllimin e PSV-ve, ky institucion ka injoruar rastet, të cilat hyjnë në kuadër të veprave penale të rënda dhe ku dëmi i shkaktuar ndaj buxhetit të Republikës së Kosovës apo qytetarëve të saj kalon vlerën me dhjetëra apo qindra miliona euro dhe ku mundësia për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së tillë të fituar me veprimtari kriminale është shumë e madhe.

Karakteristikë është fakti se Prokurori i Shtetit edhe në gjashtë (6) aktakuzat e ngritura gjatë vitit 2019, në të cilat janë të përfshirë 34 persona, ka akuzuar për korrupsion vetëm një person të profilit të lartë dhe 10 persona të profilit të mesëm, ndërsa 24 persona të tjerë janë qytetarë dhe një (1) polic, të cilët janë akuzuar kryesisht për vepra penale që lidhën me shit-blerjen e narkotikëve.

Prej 57 rasteve të shënjestruara në tërësi, rezulton se janë ngritur 44 aktakuza, tetë (8) raste janë në hetime, në katër (4) raste kanë pushuar hetimet, ndërsa në një (1) rast janë pezulluar hetimet.

Ndërsa, gjatë tërë vitit 2019, është arritur që nga 30 rastet sa kanë qenë në proces gjatë këtij viti vetëm gjashtë (6) raste kanë arritur plotfuqishmërinë (“Ndërtimi”, “Kontrata”, “HIB”, “UP”, “Prokurori 2” dhe “Mati”), duke lënë kështu prapa edhe 24 raste në proces gjyqësor para gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të dytë.

Edhe përkundër faktit se shënjestrimi i rasteve kishte për qëllim trajtimin e këtyre rasteve me prioritet, nga monitorimi dhe hulumtimi i IKD-së rezulton se në mbi 90% të rasteve të shënjestruara gjykatësit shkelin afatet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale. Jo efikasiteti në trajtimin e këtyre lëndëve dëshmohet nga trajtimi i tyre prej dhjetorit 2014 deri në fund të muajit dhjetor 2019, në të cilën periudhë, rezulton se vetëm 43% e rasteve apo 19 lëndë kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar, ndërsa 57% apo 25 lëndë të tjera janë akoma në proces në shkallë të ndryshme gjyqësore.

Nga 25 rastet që janë në proces, 11 prej tyre janë duke u trajtuar në shkallë të parë, 9 të tjera kanë përfunduar në shkallë të parë por gjenden në procedurë ankimore, ndërsa pesë (5) lëndë të tjera janë kthyer në rigjykim.

Karakteristikë tjetër në trajtimin e këtyre rasteve përbën fakti se shumica e lëndëve të shënjestruara janë duke dështuar që të përfundojnë me aktgjykime dënuese. Nga 19 rastet e gjykuara me aktgjykim përfundimtar, ku janë përfshirë 58 persona të akuzuar, 40 persona apo 69% të tyre, janë liruar nga gjykatat, ndërsa 18 persona apo 31% të tyre, janë dënuar. Politika e dënimeve ndaj këtyre 18 personave nuk është adekuate dhe përmes saj nuk arrihet qëllimi i dënimit. 13 prej të akuzuarve janë dënuar me burgim efektiv, ndërsa pesë (5) të akuzuar janë dënuar me gjobë.

Politikë joadekuate të dënimeve, vërehet edhe në rastet e gjykuara në shkallë të parë, të cilat ende janë duke vazhduar në procedurë ankimore. Në këto raste, ku janë të përfshirë 81 persona të akuzuar, rezulton se gjykatësit kanë dënuar 50 persona apo 62% të tyre, ndërsa kanë liruar 25 persona apo 31% të tyre, ndërsa për gjashtë (6) persona është veçuar procedura. Prej 50 personave të dënuar në shkallë të parë, rezulton se 13 persona janë dënuar me burgim efektiv, 12 persona janë dënuar me gjobë, ndërsa ndaj 25 personave janë shqiptuar dënime me kusht.

Në këtë periudhë raportuese, me vendimet e Gjykatës së Apelit për kthimin në rigjykim të rasteve “Feronikeli dhe “Stenta”, janë prishur dy (2) vendime të shkallës së parë me të cilat si rrallë herë tre (3) persona të profilit të lartë, ishin dënuar me dënime me burgim. Përderisa në rastin “Feronikeli” ish-kryetari i Komunës së Lipjanit Shukri Buja, ishte dënuar me tri (3) vite burgim, në rastin “Stenta”, me dy (2) vite e gjashtë (6) muaj burgim ishte dënuar ish-Ministri i Shëndetësisë Ferid Agani, ndërsa me dy (2) vite ishte dënuar ish-Sekretari i kësaj ministrie Gani Shabani.

Në 44 aktakuzat e shënjestruara janë përfshirë 294 persona. Prej tyre 195 persona apo 66.3% të akuzuar i takojnë profilit të ulët, 60 persona apo 20.4% profilit të mesëm, ndërsa vetëm 39 persona apo 13.2% të akuzuar i takojnë profilit të lartë.

Prokurorët kanë dështuar të argumentojnë dhe të paraqesin kërkesa për konfiskim të pasurive nën dyshimin se janë përfituar përmes aktiviteteve kriminale në rastet e shënjestruara. Pothuajse në të gjitha rastet me aktgjykim dënues të formës së prerë, prokurorët kanë paraqitur kërkesa për

konfiskim të pasurisë apo mjeteve, e cila konfiskohet sipas ligjit në të gjitha rastet pavarësisht nëse do të ketë aktgjykim dënues apo lirues.

Problematikë tjetër që ka ndikuar në mos efikasitetin dhe zvarritjen e këtyre rasteve të shënjestruara ka qenë ndryshimi i shpeshtë qoftë i prokurorëve që kanë përfaqësuar aktakuzën, ashtu edhe me ndryshimet e kryetarëve të trupit gjykues, ndryshime të cilat kanë ndikuar në zvarritje dhe moszgjidhje të këtyre lëndëve. Vlen të theksohet rasti “Dëmi”, në të cilin deri tash janë ndryshuar tre kryetar të trupit që ka ndikuar që edhe pse janë mbajtur 19 seanca gjyqësore, ky rast tash do të gjykohet nga pika 0, ndërsa nga 19 dhjetori 2018, akoma nuk është arritur të mbahet asnjë seancë.

Edhe pse nuk ka ndodhur më herët, në gjysmën e dytë të vitit 2019, në dy prej rasteve të shënjestruara “Vizat” dhe “Veteranët”, në të cilat për mashtrim, konkretisht korrupsion, janë duke u akuzuar ish-udhëheqës të lartë të shtetit e ish-deputet, trupet gjyqësore, në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës e Kodin e Procedurës Penale, kanë obliguar mediat dhe organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë seancat gjyqësore që raportimi për personat e akuzuar dhe dëshmitarët të bëhet vetëm me initiale, kufizim ky i cili nuk ekziston sipas KPPRK-së.

IKD rekomandon përsëri Prokurorin e Shtetit dhe Koordinatorin për Shënjestrimin e rasteve që të zbatojnë me përpikëri kriteret e përcaktuara me PSV, lidhur me identifikimin dhe shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda, duke mos rritur numrin e lëndëve në kundërshtim me kriteret dhe duke mos anashkaluar rastet e krimeve të rënda, ku përfshihen profili i lartë dhe dëmet milionëshe.

Lëndët e shënjestruara të trajtohen si prioritet nga gjykatat dhe prokuroritë në mënyrë që të mos zvarritet procesi gjyqësor dhe procedurat gjyqësore në të gjitha shkallët dhe të njëjtat të përfundohen në afat të arsyeshëm kohor, duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Gjykatësit të zbatojnë obligimet ligjore ndaj prokurorëve, avokatëve dhe palëve tjera, të cilat nuk i arsyetojnë mungesat që ndikojnë në shtyrjen e rasteve të shënjestruara.

IKD po ashtu rekomandon që të hiqet ndalimi i raportimit të rasteve të shënjestruara të cilat në kundërshtim me ligjin pengojnë raportimin apo identifikimin vetëm me initiale nga seancat gjyqësore të këtyre rasteve.

II. Metodologjia

IKD, sikurse në raportin e parë të rasteve të shënjestruara, me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologjinë e monitorimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik të të gjitha rasteve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial si dhe metodologji të përzier të hulumtimit për ta pasqyruar realitetin mbi përzgjedhjen dhe procedimin e secilit rast të shënjestruar. Sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave edhe sa i përket këtij mekanizmi të shënjestrimit të rasteve dhe në raste të shpeshta kanë të dhëna të gabuara dhe të mangëta. Të dhënat e dy sistemeve nuk përputhen. IKD duke qenë organizata e vetme që ka monitoruar sistematikisht trajtimin e këtyre rasteve, gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet i bazon në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të shënjestruara me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe politikat e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Raporti përfshinë monitorimin e të gjitha rasteve të shënjestruara në shtatë Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit në Prishtinë si dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, përfshi edhe monitorimin e aspektit statistikor të sistemit prokurorial në lidhje me shënjestrimin e këtyre rasteve në fazën e hetimeve.

IKD përveç monitorimit të drejtpërdrejtë të këtyre rasteve në procedimin e tyre në gjyqësorin e Kosovës, vazhdimisht ka siguruar të dhënat statistikore nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Koordinatorin i KGJK-së Agim Maliqi, si dhe Koordinatorin i KPK-së Afrim Shefkiu nga shtatë gjykatat themelore, si dhe ka mbledhur të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat përkatëse.

Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhur në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e shënjestruara dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe atë gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të shënjestruara nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte, të cilat janë paraqitur përmes rasteve konkrete, duke i komentuar të gjitha specifikat e rasteve të shënjestruara për secilën prokurori dhe gjykatë si dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

Monitoruesit dhe hulumtuesit e IKD-së, prej nëntorit 2013 monitorojnë sistematikisht të gjitha rastet e korrupsionit, ndërsa që nga krijimi i mekanizmit për shënjestrimin e rasteve, ka pasur në fokus të vazhdueshëm monitorimin e secilit prej këtyre rasteve.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse të Këshillave, Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët e Prokurorive si dhe institucionet vendore e ndërkombëtare të përfshira në forma të ndryshme lidhur me rastet e shënjestruara, si lëndë reprezentative për procesin e liberalizimit të vizave. IKD gjatë gjithë procesit të monitorimit ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, intervista të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të krahasimit të rasteve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimit të thuktë të çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Ky raport është vazhdimësi e raportit të IKD-së të publikuar në qershor të vitit 2019 lidhur me trajtimin e rasteve të shënjestëruara nga sistemi i drejtësisë.¹

¹ Gashi L., Kadriu M. “Dështimet në rastet e shënjestruara.” IKD. Qershor 2019. (Shih linkun: <https://klics.org/wp-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

III. Veprimet e KGJK-së dhe KPK-së në trajtimin e rasteve të shënjestruara

KPK më 18 korrik 2014, kishte miratuar “*Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional*”².

Me anë të këtyre PSV-ve, institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë synonin që përmes koordinimit dhe bashkëpunimit reciprok të parandalonin, zbulonin, hetonin dhe gjykonin kryesit e veprave më të rënda penale. PSV-të përcaktojnë që institucionet që zbatojnë ligjin të udhëhequra nga Prokurori i Shtetit të bënë përzgjedhjen e këtyre rasteve sipas vlerësimit nëse veprat e dyshuara janë vepra të rënda dhe hetimi penal për këto raste kërkon përpjekje të përbashkët të dy apo më shumë institucioneve publike, e që qëllimi final të jetë sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes aktiviteteve kriminale.

Sipas PSV-së, me anë të anekseve, ishin përcaktuar veprimet në bazë të së cilave duhet të bëhet shënjestrimi i rasteve. Këto anekse të veçanta, nuk janë bërë publike nga KPK, edhe përkundër kërkesës së IKD-së të bërë në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike.

PSV-të kanë përcaktuar që në shënjestër të krimeve të rënda janë personat apo grupet e personave që janë të dyshuar për planifikimin e një apo më shumë veprave të rënda penale që kanë kryer vepra të tilla dhe që kanë qëllim përfitimin nga këto krime, duke i shkaktuar në këtë mënyrë dëme interesave publike dhe private.³

Në bazë të kësaj, KPK, kishte përcaktuar kritere të këtyre rasteve, të trajtuara si raste të rënda, duke përfshirë:

- Natyrën serioze të veprave të dyshuara;
- Rrezikun nga dëmi i shkaktuar nga veprat;
- Nivelin e organizimit të grupit kriminal;
- Vazhdimësinë e aktivitetit kriminal dhe aktiviteti i mëparshëm kriminal i kryerësve;
- Nevoja për koordinimin e veprimeve të institucioneve publike në parandalimin e veprave të dyshuara;
- Nevojat specifike për të drejtuar resurset e institucioneve publike për parandalimin e krimeve;
- Kërcënimet që rezultojnë nga aktiviteti kriminal;

²“*Procedurat Standarte të Veprimit për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional*”. Këshilli Prokurorial i Kosovës, Nr.819/2014. (Shih linkun <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Plane%20te%20punes/Nr.819.2014.Procedurat%20standarde%20te%20veprimit%20per%20perzgjedhjen%20e%20shenjest....pdf>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³Po aty.

- Prioritetet strategjike të institucioneve publike dhe angazhimet ndërkombëtare të Kosovës.

Të gjitha këto ishin si bazë në të cilat do të duhej të mbështeteshin organet e ndjekjes.

Pas më shumë se një viti prej se KPK kishte nxjerrë PSV-të, ishte KGJK, që me kërkesë të KPK-së, kishte mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme më 30 dhjetor 2015 dhe kishte nxjerrë një vendim me të cilin obligonte kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e çështjeve që të gjitha rastet që vijnë nga prokuroria dhe kanë shenjën “LV” [*Liberalizim i Vizave*], të trajtohen me prioritet absolut.⁴

KGJK, po ashtu kishte paraparë që kryetarët e gjykatave duhet të raportojnë në baza mujore për rastet që trajtohen në gjykatat përkatëse.

Pasi KPK më 18 korrik 2014 kishte miratuar PSV-të për trajtimin e këtyre rasteve, kishin filluar shënjestrimet e rasteve⁵, derisa rasti i fundit i shënjestëruar është rasti “Grantet”.

Por, pavarësisht kësaj, IKD në raportin e kaluar kishte gjetur se shënjestrimi i rasteve nuk është udhëhequr nga kriteret dhe qëllimi i vet PSV-ve, pasi Prokurori i Shtetit, ka shënjestruar raste, të cilat dalin jashtë qëllimit të përcaktuar në PSV, dhe që pothuajse në shumicën e rasteve mungon identifikimi dhe sekuestrimi i pasurisë, e në ato raste ku gjykata ka marrë vendime dënuese, mungon konfiskimi i pasurisë.⁶

a) Raportet e Komisionit Evropian për rastet e shënjestëruara

Komisioni Evropian (KE) më 19 janar 2012, kishte filluar dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën. Ky Komision pas rreth gjashtë muajsh, më 14 qershor 2012, ia kishte dërguar Qeverisë së Kosovës edhe një udhërrëfyes për liberalizimin e vizave. Aty ishin dhënë udhëzime, për hapat që duhet të ndërmerret Kosova për të përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave.

Më 8 shkurt 2013, KE publikoi raportin e parë lidhur me përparimin e Kosovës, pas udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave.⁷ Në këtë raport, në mënyrë të qartë thuhej se edhe pse

⁴ Vendimi Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 30 dhjetor 2015. (shih linkun <http://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/Vendimet%20e%20mbledhjes%20144.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵ Gashi L., Kadriu M.. Dështimet në rastet e shënjestëruara. IKD. Qershor 2019. f.12 (Shih linkun: <https://kliks.org/ep-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶ Gashi L., Kadriu M. “Dështimet në rastet e shënjestëruara.” IKD. Qershor 2019. F.12-16(Shih linkun: <https://kliks.org/wp-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷Shënim:Raporti i parë Komisionit Evropian për përparimin e Kosovës lidhur me kërkesat e Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave”. 08.02.2013 (Shih linkun www.meiks.net/repository/docs/20180816123231_firstreport_on_progress_on_kosovo_visa_liberalisation_en.pdf). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

ishte krijuar një bazë e mirë ligjore, “Kosova vazhdon të përballet me sfida të mëdha në parandalimin dhe luftimin në mënyrë efektive të krimit të organizuar dhe korrupsionit.”⁸

KE bazuar në gjetjet e tij i kishte rekomanduar institucioneve të drejtësisë së Kosovës që të parandalohet ndërhyrja politike në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimeve, që të ketë një rekrutim transparent në verifikimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të zbatohen veprimet disiplinore në të gjitha rastet e korrupsionit në gjyqësor dhe të zvogëlohet numri i lëndëve të pazgjidhura gjyqësore.⁹

Edhe në raportin e dytë, atë të 24 korrikut 2014, Komisioni Evropian ka theksuar se Kosova “ka pasur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, por ende duket të jetë aktuale mungesa e rezultateve të konkluduara të rasteve gjyqësore.”¹⁰ Në këtë raport, ishte theksuar se “sistemi i drejtësisë ka pasur një prioritet të dobët në shënjestrimin e rasteve të profilit të lartë për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.”¹¹

Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2016, kishte konstatuar se “Kosova ka forcuar kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar me themelimin e ekipeve multi-disiplinare hetimore, krijimin e mekanizmit përcjellës për nivelin e lartë të korrupsionit dhe rastet e krimit të organizuar si dhe forcimin e departamentit të krimeve të rënda të gjykatave themelore. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të lëndëve të hetuara dhe të ndjekura penalisht. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Vullnet më i fortë politik është i nevojshëm për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kosova është në fazë të hershme të luftimit të krimit të organizuar. Numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare mbetet i ulët”.

Kurse Raporti i Progresit për vitin 2019, konstaton gjendjen se “Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**.” Edhe në këtë raport përmendet se “progresi i Kosovës është i drejtuar vetëm në drejtim të reformave të rëndësishme legislative në fushën e sundimit të ligjit dhe në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë. Korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese.”

Sipas këtij raporti edhe “sa i përket luftimit të krimit të organizuar, Kosova është në një fazë të hershme dhe progresi i vetëm i arritur është përmes reformave të rëndësishme legislative në fushën e sundimit të ligjit, në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë dhe në ngrirjen paraprake të pasurisë. Megjithatë, pak progres është arritur në konfiskimin përfundimtar të pasurive dhe ende ka shumë pak hetime financiare dhe dënime përfundimtare.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ *Shënim*:Raporti i dytë Komisionit Evropian për përparimin e Kosovës lidhur me kërkesat e Udhërrefyesit për liberalizimin e vizave”, 24.07.2014. (Shih linkun www.mei-ks.net/repository/docs/kosovosecondvisareport.pdf) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹ Po aty.

Masat nevojiten për të siguruar në mënyrë rigoroze se nuk ka ndërhyrje politike në aktivitetet operative të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.”¹²

b) Shkelja e kriterëve të PSV-ve nga Prokurori i Shtetit në shënjestrimin e rasteve

IKD në raportin e kaluar mbi rastet e shënjestëruara kishte gjetur shkelje të kriterëve të PSV-ve nga Prokurori i Shtetit me rastin e shënjestërimit të rasteve. Shkeljet konsistojnë në shënjestërimin e rasteve të cilat nuk i plotësojnë kriteret e PSV-ve si dhe mos shënjestërimin e rasteve të cilat i plotësonin kriteret e PSV-ve¹³.

Por, krahas rasteve të trajtuara në raportin e kaluar në të cilat IKD kishte gjetur shkelje të kriterëve të PSV-ve, të njëjtat kriterë janë shkelur edhe në rastet e shënjestëruara gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019 ana e Prokurorit të Shtetit janë shënjestruar rastet si **“Mati”, “Ura e Gurit 1”, “Ura e Gurit 2” dhe “Qafa”**, në të cilat raste janë akuzuar 25 persona, të gjithë të akuzuar për vepra penale që lidhën me narkotikë, ndërsa vetëm në rastin **“Grantet”** dhe **“Prokurori 2”**, të akuzuarit ngarkohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare, mirëpo nuk është kërkuar që të konfiskohet pasuri e fituar me vepër penale të korrupsionit.


¹² *Shënim:* Raporti i Progresit për Kosovën”, 29.09.2019. (Shih linkun (http://mei-ks.net/repository/docs/alb_-20190529-kosovo-report.docx)). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³ Gashi L., Kadriu M.. Dështimet në rastet e shënjestëruara. IKD. Qershor 2019. F.12-16 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

IV. Efikasiteti dhe rezultatet në trajtimin e rasteve të shënjestruara

Për dallim nga të gjeturat e raportit të kaluar mbi efikasitetin dhe rezultatet e sistemit të drejtësisë në raportin e kaluar, në këtë raport nuk identifikohet asnjë risi tjetër, me ç'rast vazhdojmë problemet e njëjta. Dallimet e vetme janë statistikore, të cilat dallime, nuk janë të nivelit të atillë që do të ngrisin efikasitetin dhe rezultatet e sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të shënjestëruara.


Nga vitit 2015, prej kur ka filluar shënjestrimi i rasteve, e deri më 31 dhjetor 2019 rezultojnë se më së shumti raste ishin shënjestruar në vitin 2016, ku ishin ngritur gjithsej 13 aktakuza, derisa gjatë vitit 2019, janë ngritur gjashtë (6) aktakuza. Për më tepër shih grafikën në vijim:



Grafika 1 - Aktakuzat e rasteve të shënjestruara të ngritura sipas viteve.

Nga të gjitha rastet e shënjestruara, është vërejtur se shumica nga to kanë të bëjnë me vepra penale të “krimit të organizuar dhe korrupsionit”, por po ashtu edhe vepra të tjera si “mashttrim”, “kontrabandim me migrantë”, “shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikeve” dhe vepra të tjera penale karakteristike.

Në bazë të të dhënave të PSRK-së, nga 57 rastet e shënjestruara deri në muajin dhjetor të vitit 2019, përfshihen 443 persona, ndërsa 343 prej tyre janë akuzuar. Për vepra korruptive janë ngarkuar 194 persona, kurse 149 persona të tjerë janë akuzuar për veprat penale lidhur me krim të organizuar



Grafika 2 – Numri i përgjithshëm i rasteve të shënjestruara dhe numri i rasteve dhe personave të përfshirë në këto raste, të akuzuar për korrupsion dhe krim të organizuar.

Bazuar në gjetjet e IKD-së të nxjerra nga monitorimi sistematik i rasteve të shënjestruara, rezulton se prej 44 aktakuzave të ngritura në rastet e shënjestruara, PSRK-ja ka ngritur 29 aktakuza tri (3) aktakuza ka ngritur Prokuroria Themelore në Mitrovicë dhe ajo në Gjilan, nga dy (2) aktakuza kanë ngritur Prokuroria Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Prizren dhe një (1) e ka ngritur Prokuroria Themelore në Pejë. Në mesin e aktakuzave të ngritura, figuron edhe aktakuza voluminoze e njohur si “Stenta”, e cila është ngritur nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi. Ngritja e kësaj aktakuze nga ZKSH, ishte vlerësuar si e kundërligjshme nga IKD.¹⁴

Numrin më të madh të lëndëve të shënjestruara vazhdon ta ketë Gjkata Themelore në Prishtinë. Prej gjithsej 44 lëndëve të shënjestruara kjo gjykatë i ka 27 lëndë.¹⁵ Pas Prishtinës, vjen Gjkata Themelore në Prizren që ka trajtuar pesë (5) lëndë, Gjkata Themelore në Mitrovicë katër (4) lëndë, Gjkata Themelore në Gjilan tri (4) lëndë, dhe me nga dy (2) lëndë janë ngarkuar Gjkata Themelore në Gjakovë dhe Ferizaj. Ndërsa Gjkata Themelore në Pejë, është e vetmja gjykatë e cila nuk ka pasur në trajtim asnjë aktakuzë të rasteve të shënjestruara. Për më tepër shih tabelën në vijim:


¹⁴ Miftaraj E. dhe Musliu B. “‘Deti’ i korrupsionit në Kosovë: “Peshqit” e vegjël kapen, të mëdhenjtë lihen të lirë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, 28 mars 2017. (Shih linkun <https://kli-ks.org/deti-i-korrupsionit-ne-kosove-peshqit-e-vegjel-kapen-te-medhenjte-lihen-te-lire/>). (Qasur së fundi më 4 shkurt 2020).

¹⁵ Përgjigja për IKD-në e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, znj. Mirlinda Gashi. 10 maj 2019. Shënim: Në këtë përgjigje nuk përfshihen pesë (5) rastet e vitit 2019, të cilat janë duke u gjykuar nga Departamenti Special i kësaj gjykate.

Ngarkesa e Gjykatave Themelore me lëndët e shënjestruara							
Gjykata	Prishtinë	Prizren	Mitrovicë	Gjilan	Gjakovë	Ferizaj	Pejë
Numri i rasteve në punë	27	5	4	4	2	2	0


Tabela 1 - Trajtimi i rasteve sipas gjykatave kompetente.

Deri më tash prej të gjitha rasteve të shënjestruara, të cilat kanë filluar të gjykohen prej vitit 2015 e tutje, rezulton se vetëm 43 % apo 19 raste kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar, ndërsa 57 % apo 25 lëndë të tjera janë akoma në proces në shkallë të ndryshme gjyqësore.




Grafika 3 – Numri dhe përqindja e përgjithshme e lëndëve të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë dhe lëndëve që gjenden ende në procedura gjyqësore në shkallë të ndryshme.

Nga 25 rastet që janë në proces, 11 prej tyre janë duke u trajtuar në shkallë të parë, 9 raste kanë përfunduar në shkallë të parë ose janë në trajtim nga Gjykata e Apelit, ndërsa pesë (5) lëndë të tjera janë kthyer në rigjykim.



Grafika 4 - Faza procedurale për të gjitha rastet e aktakuzave të shënjestruara.

Edhe pse shënjestrimi i rasteve mendohej se do të ndikonte në zhvillimin e shpejtë dhe sipas afateve ligjore të procedurave gjyqësore, kjo gjë nuk ka ndodhur. Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se një numër i madh i rasteve janë akoma duke u trajtuar në shkallën e parë në sistemin gjyqësor, përkatësisht janë 25 raste ende në proces të shqyrtimit gjyqësorë në shkallë të parë apo në procedurën e ankimimit.



Grafika 5 – Numri dhe përqindja e lëndëve të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë dhe lëndëve të tjera që gjenden në ende në procedura gjyqësore në shkallë të ndryshme.

a) Shkeljet ligjore dhe të politikave të KGJK-së në rastet e shënjestruara

Përkundër obligimeve ligjore dhe politikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që rastet e shënjestruara të trajtohen me prioritet nga gjykatat, gjetjet e IKD-së dëshmojnë se në praktikë po vazhdon të ndodhë e kundërta.

IKD përmes monitorimit sistematik të të gjitha rasteve të shënjestruara, gjen se gjykatat vazhdojnë të mos respektojnë afatet ligjore e as politikat e KGJK-së që këto raste të trajtohen me prioritet. Në shumicën e rasteve të shënjestruara, gjykatësit në vazhdimësi shkelin afatet procedurale të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale.

IKD në vazhdim sjell disa prej rasteve më reprezentative, përmes të cilave dëshmohet mungesa e efikasitetit dhe seriozitetit të sistemit gjyqësor në procedimin e këtyre rasteve, ku disa prej këtyre rasteve edhe në raportin e kaluar ishin identifikuar si raste në të cilat sistemi i drejtësisë nuk ka treguar efikasitet dhe seriozitet¹⁶.

b) Shkeljet ligjore të vendimeve dhe politikave të KGJK-së nga vet KGJK

KGJK më 30 dhjetor kishte nxjerrë një vendim me të cilin obligonte kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e çështjeve që të gjitha rastet që vijnë nga prokuroria dhe kanë shenjën “LV” [Liberalizim i Vizave], të trajtohen me prioritet absolut.¹⁷

KGJK, po ashtu kishte paraparë që kryetarët e gjykatave duhet të raportojnë në baza mujore për rastet që trajtohen në gjykatat përkatëse.

Gjatë vitit 2019, asnjë nga kryetarët e gjykatave nuk ka raportuar në baza mujore para anëtarëve të KGJK-së lidhur me këto raste. Lidhur me faktin nëse për këtë pjesë Kryetarët e Gjykatave kanë raportuar me shkrim në baza mujore, KGJK nuk ka dhënë asnjëherë asnjë njoftim.

Rasti “Dëmi”

Në këtë rast, PSRK ka ngritur **aktakuzë** me **20 nëntor 2015**. Rasti **kishte filluar për** veprën penale të **krimit të organizuar** dhe **kishte përfunduar** vetëm për veprën penale të **shmangies nga tatimi**. **Shqyrtimi fillestar** është mbajtur në **qershor 2016**, në kundërshtim me KPP, përderisa **shqyrtimi gjyqësor** është ende **në procedurë** e sipër. Vetëm në këtë rast, **kryetari i trupit gjykues është ndryshuar katër herë**. Ky rast, pas ri-cilësimit të aktakuzës ka kaluar nga Departamenti për Krime të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë. **Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 1503 ditë.**

¹⁶ Gashi L., Kadriu M. “Dështimet në rastet e shënjestruara”. IKD. Qershor 2019. F.21 (Shih linkun: <https://kll-ks.org/wp-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷ Vendimi Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 30 dhjetor 2015. (shih linkun <http://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/decisions/Vendimet%20e%20mbledhjes%20144.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Rasti “Siguria”

Në këtë rast **aktakuza** është ngritur në **janar 2015**, kurse **aktgjykimi** është shpallur më **20 maj 2019**, apo **pas 1586 ditëve** nga koha kur është ngritur aktakuza, ndërsa deri më 31 dhjetor 2019 ky rast nuk ka marrë epilog edhe nga Gjykata e Apelit, kanë kaluar **1811 ditë**. Edhe përkundër faktit se me aktakuzë është pretenduar se i është shkaktuar dëm buxhetit të shtetit mbi 6 milionë euro, në shpalljen e aktgjykimit, gjykata ka vlerësuar se nuk është vërtetuar dëmi i pretenduar në aktakuzë dhe të gjithë të dyshuarit janë liruar nga akuza, përfshirë ish-Kryetarin e Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ish-Kryetarin e OSHP-së, Hysni Hoxha dhe ish-Drejtorin e KEK-ut, Arben Gjukaj.

Rasti “MSH 2”

Në këtë rast PSRK ka ngritur **aktakuzë** më **6 korrik 2015**, kundër ish-Sekretarit të MSH-së, Ilir Tolaj dhe shtatë (7) personave të tjerë, për vepra penale të korrupsionit. Në këtë rast, **gjykata e shkallës së parë** ka marrë **aktgjykim lirues** me **6 qershor 2018**, apo pas 2 vjetësh e 11 muajsh nga koha e ngritjes së aktakuzës, ndërsa rasti është duke u trajtuar akoma nga Gjykata e Apelit, që deri më 31 dhjetor behën **1640 ditë** nga ngritja e aktakuzës, mirëpo që nuk ka vendim të formës së prerë.

Rasti “HIB”

Një rast tjetër karakteristik i rasteve të shënjestruara është rasti **“HIB”**, aktakuza e të cilit ishte ngritur më 6 korrik 2015, që për veprën penale “Mashtrimi” dhe “Mashtrimi i blerësve”, ngarkonte drejtorin e “Hib Petrolit” Kujtim Bucaliu dhe kompaninë “Hib Petrol”, si person juridik. Për shkak të kthimit të këtij rasti në rigjykim, ky rast ishte gjykuar dy herë nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Përderisa me aktgjykimin e shpallur më 18 prill 2018, Bucaliu ishte dënuar me dënim unik prej katër (4) vjetësh burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej 15 mijë eurosh, ndërsa personi juridik “HIB Petrol”, ishte dënuar me dënim unik prej 30 mijë eurosh gjobë, si dhe ishte konfiskuar edhe autoboti-cisterna, e cila është rezultat i veprës penale.

Mirëpo pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer këtë rast në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 10 maj 2019, konkretisht gjykatësi Rustem Begolli, e kishte ndryshuar vendimin e tij të mëhershëm duke vendosur që në mungesë të provave ta lirojë nga akuzat për veprat penale të “mashtimit” dhe atë të “mashtimit të blerësve”, drejtorin gjeneral të “HIB Petrol”, Kujtim Bucaliu dhe kompaninë e tij, i cili vendim më 11 nëntor 2019, është vërtetuar edhe nga ana e Gjykatës së Apelit. Pra, që nga ngritja e aktakuzës në këtë rast e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë kanë kaluar gjithsej 1589 ditë.

V. Performanca e sistemit të drejtësisë në rastet e shënjestruara

Nga 44 rastet e aktakuzave të ngritura, të cilat janë shqyrtuar apo janë ende në proces në sistemin gjyqësor të Kosovës, rezulton se numri më i madh i rasteve të cilat kanë përfunduar me aktgjykime, shumica prej tyre kanë përfunduar me lirim të personave të akuzuar.

Në pjesën e më poshtme të raportit, janë elaboruar në detaje të gjitha rastet e trajtuara në kuadër të lëndëve të shënjestruara, të cilat nga IKD janë ndarë në disa kategori, përfshi: a) Rastet e përfunduara me aktgjykim përfundimtar; b) Rastet e kthyer në rigjykim; c) Rastet e përfunduara në shkallë të parë; si dhe d) Rastet në proces.

Nga 57 rastet e shënjestëruara, Prokuroria ka ngritur gjithsej 44 aktakuza, prej të cilave me aktgjykim përfundimtar kanë përfunduar 19 raste, në të cilat janë të përfshirë 58 persona. Nga këta 58 persona, aktakuzat kanë dështuar ndaj 40 personave, derisa vetëm 18 persona janë shpallur fajtorë. Ndaj këtyre 18 personave të cilat janë shpallur fajtorë, janë shqiptuar gjithsej 27 dënime, 14 prej të cilave janë dënime me gjobë derisa 13 janë dënime me burgim efektiv.

Nga 44 aktakuzat në rastet e shënjestëruara, pesë (5) prej tyre kanë përfunduar në shkallë të parë, por që më pas janë kthyer në rigjykim. Në këto pesë (5) raste janë të përfshirë 28 persona. Prej këtyre 28 personave, pesë (5) persona janë liruar nga akuza, për dy (2) persona është refuzuar aktakuza derisa 21 të tjerë janë shpallur fajtorë. Ndaj këtyre 21 personave, Gjykatat kanë shqiptuar 28 dënime, 18 prej të cilave me burgim efektiv, 8 (tetë) dënime me gjobë dhe dy (2) dënime me kusht.


Nga 44 aktakuzat në rastet e shënjestëruara, nëntë (9) raste kanë përfunduar vetëm në shkallë të parë. Në këto raste janë të përfshirë 81 persona, 24 prej të cilëve janë liruar nga akuza, ndaj një (1) personi është refuzuar aktakuza, ndaj gjashtë (6) persona personave është veçuar procedura, derisa 50 persona janë shpallur fajtorë. Ndaj këtyre 50 personave, Gjykatat kanë shqiptuar gjithsej 59 dënime, ku 25 prej tyre, janë dënime me kusht, 21 të tjera kanë qenë dënime me gjobë, ndërsa janë shqiptuar edhe 13 dënime me burgim efektiv.

Nga 44 aktakuzat në rastet e shënjestëruara, 11 raste janë në proces në shkallë të parë, në të cilat raste përfshihen 127 persona.

Në vazhdim IKD do të paraqet në formë tabelare, të dhënat e secilit rast të shënjestruara të trajtuar në të gjitha fazat e procedurës si dhe statusin aktual. Tabela do të pasqyrohet me fytyrën e secilit bartës të funksionit në prokurori dhe gjykatë, se si kanë vendosur ata për këto raste në të gjitha shkallët.

RASTET E PËRFUNDUARA ME AKTGJYKIM PËRFUNDIMTAR

Rasti	Prokurori	Gjyqtari Shkalla I	Vendimi Shkalla I	Gjyqtari Shkalla II	Vendimi Shkalla II	Gjyqtari Shkalla III	Vendimi Shkalla III
Ndërtimi 4 të akuzuar	 Genc Nixha	 Ajser Skenderi	1 REFUZIM 3 LIRIM	 Driton Muharremi	1 REFUZIM 3 LIRIM		PA KËRKESË
Klllokoti 1 1 i akuzuar	 Agron Uka	 Aziz Shaqiri	1 LIRIM	 Fillim Skoro	1 LIRIM		PA KËRKESË
Klllokoti 2 1 i akuzuar	 Afrim Shefkiu	 Afrim Shala	1 HUDHJE		PA ANKESË		
Autoriteti 4 të akuzuar	 Ali Rexha	 Valon Kurtaj  Arben Hoti	2 HUDHJE 2 LIRIM	 Fillim Skoro  Driton Muharremi	2 HUDHJE 2 LIRIM		PA KËRKESË
Apeli 4 të akuzuar	 Drita Hajdari	 Shasivar Hoti	3 LIRIM	 Driton Muharremi	3 LIRIM	 Nesrin Lushta	3 LIRIM SHKELJE E LIGJIT PENAL NË FAVOR TË TË AKUZUARVE
UP 3 të akuzuar	 Drita Hajdari	 Arben Hoti	2 BURGIM 1 BURGIM ME KUSHT	 Mejreme Memaj  Vaton Durguti	2 BURGIM 1 LIRIM	 Emine Mustafa  Agim Maliqi	2 BURGIM 1 LIRIM
OSHP 1 4 të akuzuar	 Admir Shala  Sylë Hoxha	 Arben Hoti	3 LIRIM 1 DËNIM ME GJOBË	 Xhevdet Abazi	3 LIRIM		PA KËRKESË
Qeraja 6 të akuzuar	 Njazi Rexha	 Beqir Halili	1 BURGIM 1 GJOBË 1 REFUZIM 3 LIRIM	 Have Halili	1 BURGIM 1 GJOBË 1 REFUZIM 3 LIRIM		PA KËRKESË
Avokatil 1 2 të akuzuar	 Agron Matjani	 Shaqir Zika	2 REFUZIM (TËRHEQJE)				
Avokatil 2 1 i akuzuar	 Agron Matjani	 Artan Sejrani	1 DËNIM ME GJOBË	 Abdullah Ahmeti	1 DËNIM ME GJOBË	 Nesrin Lushta	1 DËNIM ME GJOBË

Rasti	Prokurori	Gjyqtari Shkalla I	Vendimi Shkalla I	Gjyqtari Shkalla II	Vendimi Shkalla II	Gjyqtari Shkalla III	Vendimi Shkalla III
Suhareka 5 të akuzuar	 Sefer Morina	 Raima Elezi	5 REFUZIM (TËRHEQJE)				
Inspektori 1 i akuzuar	 Merita Bina Rugova	 Shpresa Hasaj-Hysenaj	1 DËNIM ME GJOBË	PA ANKESË			
Matrix-M 6 të akuzuar	 Abdurrahim Islami	 Artan Sejrani	2 BURGIM 4 LIRIM	 Driton Muharremi	2 BURGIM 4 LIRIM	PA KËRKESË	
Ndërrimi 4 të akuzuar	 Florije Shamolli	 Radosllav Markoviq	4 BURGIM	PA ANKESË			
HIB 1 i akuzuar	 Bashkim Zeqa	 Rrustem Begolli	1 LIRIM	 Ferit Osmani	1 LIRIM	PA KËRKESË	
Prokurori 3 të akuzuar	 Admir Shala	 Kreshnik Radoniqi	2 BURGIM 1 GJOBË	 Tonka Berishaj	2 BURGIM 1 GJOBË	 Valdete Daka	2 BURGIM 1 GJOBË
Kontrata 5 të akuzuar	 Faik Halili	 Vehbi Kashtanjeva	3 LIRIM 2 REFUZIM	 Abdullah Ahmeti	3 LIRIM 2 REFUZIM	PA KËRKESË	
Prokurori 2 1 i akuzuar	 Merita Bina Rugova	 Albina Shabani-Rama	1 PUSHIM				
Mati 2 të akuzuar	 Arben Kadriu	 Naser Maliqi	2 BURGIM		PA ANKESË	NË PROCES	

Rasti	Prokurori	Gjyqtari Shkalla I	Vendimi Shkalla I	Gjyqtari Shkalla II	Vendimi Shkalla II	Gjyqtari Shkalla III	Vendimi Shkalla III
-------	-----------	-----------------------	----------------------	------------------------	-----------------------	-------------------------	------------------------


RASTET E PËRFUNDUARA NË SHKALLË TË PARË



Siguria 7 të akuzuar	  	7 LIRIM	NË PROCES
Detyrimi 3 të akuzuar	 	3 BURGIM	NË PROCES
MSH 2 8 të akuzuar	  	6 LIRIM 2 BURGIM ME KUSHT	NË PROCES
Gjykatësi 3 të akuzuar	  	2 LIRIM 1 BURGIM	NË PROCES
FAN 8 të akuzuar	  	1 BURGIM 6 LIRIM 1 REFUZIM	NË PROCES
Gold 34 të akuzuar	 	11 GJOBË 23 BURGIM ME KUSHT	NË PROCES
Posta 3 të akuzuar	  	3 LIRIM	NË PROCES
Avokati 3 1 i akuzuar	 	1 BURGIM	NË PROCES
Kristal	 	7 BURGIM 1 GJOBË	NË PROCES

RASTET E KTHYERA NË RIGJYKIM

Shkurti 8 të akuzuar	 Haki Gecaj	 Zyhd Haziri	7 BURGIM 1 LIRIM	 Vaton Durguti	6 BURGIM 2 RIGJYKIM
KEDS 4 të akuzuar	 Hivzi Bajraktari	 Shasivar Hoti	2 REFUZIM 2 BURGIM MË KUSHT	 Driton Muharremi	1 LIRIM 1 RIGJYKIM
Stenta 1 2 të akuzuar	 Besim Kelmendi	 Florije Shamolli	 Shadije Gërguri	 Burim Ademi	2 RIGJYKIM
Mërgimtari	 Merita Bina Rugova	 Suzana Qerkini	3 BURGIM 1 DËNIM MË GJOBË	 Tonka Berishai	1 GJOBË 3 RIGJYKIM
Feronikeli 10 të akuzuar	 Agron Bajrami	 Beqir Kalludra	6 BURGIM 4 LIRIM	 Abdullah Ahmeti	10 RIGJYKIM

RASTET NË PROCES

Demi 9 të akuzuar	 Faik Halili  Atdhe Dema	 ELMAZ ZENUNI  VEHBI KASHTANJEVA  HAMDI IBRAHIMI  RRUSTEM BEGOLLI	NË PROCES				
Transportuesi 21 të akuzuar	 Abdurrahim Islami  Atdhe Dema  Beqir Halili	NË PROCES					
Qarku 46 të akuzuar	 Agron Bajrami  Burim Ademi  Bekim Veliqi	NË PROCES					
Sekseri 2 të akuzuar	 Fikrije Fejzullahu  Jehona Makolli Grantolli	 VESEL ISMAJLI  ADNAN ISUFI  FATIME DERMAKU	1 NË PROCES	 Driton Muharremi	1 HUDHJE	 Valdete Daka	1 HUDHJE SHKELJE E LIGJIT PENAL NË FAVOR TË AKUZUARIT
Shkolla 3 të akuzuar	 Faik Halili  Afrim Shefkiu  Xheladin Osmani	NË PROCES	NË PROCES				

Rasti	Prokurori	Gjyqtari Shkalla I	Vendimi Shkalla I	Gjyqtari Shkalla II	Vendimi Shkalla II	Gjyqtari Shkalla III	Vendimi Shkalla III
 Vizat 3 të akuzuar	 Afrim Shefkiu  Atdhe Dema	 Mustafë Tahiri  Vesel Ismajli	 NË PROCES				
 Veteranët 12 të akuzuar	 Enver Krasniqi  Valdet Gashi	 Nushe Mekaj	 NË PROCES				
 Qafa 9 të akuzuar	 Atdhe Dema	 Arben Hoti	 NË PROCES				
 Ura e gurit 1 10 të akuzuar	 Blerim Isufaj	 Valon Kurtaj	 NË PROCES				
 Ura e gurit 2 4 të akuzuar	 Blerim Isufaj	 Albina Shabani-Rama	 NË PROCES				
 Grantet 8 të akuzuar	 Habibe Salihi	 Arben Hoti	 NË PROCES				




Ngjyra e kuqe tregon dështimin e aktakuzave që përfshinë: hudhje, refuzim, lirim të akuzuarëve dhe rastet e përfunduara pa ankesa;



Ngjyra e gjelbër tregon dënimet e shqiptuara me burgim efektiv;



Ngjyra e portokalltë tregon dënimet e shqiptuara me gjobë dhe dënim me kusht;



Pa ngjyrë tregon rastet në procedurë Gjykatat Themelore dhe në Gjykatën e Apelit.

VI. Aktgjykimet përfundimtare në rastet e shënjestruara¹⁸


Nga 57 rastet e shënjestruara deri më 31 dhjetor 2019, janë 19 raste që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këto 19 raste, ku janë përfshirë 58 persona të akuzuar, gjykatat kanë shqiptuar dënime ndaj 18 personave apo 31% të tyre, ndërsa pa dënime nga gjykatat kanë kaluar 40 persona apo 69% të tyre. Në grupin e personave të cilët nuk kanë marrë dënime, bëjnë pjesë 25 persona të cilët janë liruar nga akuza, 11 persona ndaj të cilëve është refuzuar aktakuza, ndaj tre (3) personave është hudhur aktakuza derisa ndaj një (1) personi është pushuar procedura.

Deri më 31 dhjetor 2019, prej 18 personave të dënuar me aktgjykim përfundimtar, në total janë shqiptuar 27 dënime, 14 prej të cilave janë dënime me gjobë derisa 13 janë dënime me burgim efektiv.

Mos serioziteti i trajtimit të këtyre rasteve është vërejtur edhe gjatë gjithë vitit 2019, ku nga 30 raste sa janë trajtuar në këtë vit, është arritur që formën e prerë ta marrin vetëm gjashtë (6) raste, njeri nga të cilët kishte pushuar që në fillim të procedurës për shkak të vdekjes së të akuzuarit, ndërsa në një rast tjetër, të akuzuarit nuk kanë bërë fare ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë (*Rastet “Kontrata”, “Ndërtimi”, “Hib”, “UP”, dhe “Prokurori 2” dhe “Mati”*).

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara numri dhe lloji i aktgjykimeve të shpallura ndaj personave të gjykuar me aktgjykim të formës së prerë në rastet e shënjestruara.

¹⁸ Shënim: IKD në pjesën e më poshtme të këtij raporti, përkatësisht në Kapitullin XI – “Aneks IV: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë”, ka analizuar secilin rast të kësaj kategorie.



Grafiku 6 – Numri dhe lloji i aktgjykimit të shpallur ndaj personave të gjykuar me aktgjykim të formës së prerë në rastet e shënjestruara.

a) Politika e dënimeve në rastet e shënjestruara të përfunduara me aktgjykim përfundimtar

Në rastet e shënjestëruara të cilat kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar, ndaj 18 personave të dënuar janë shqiptuar gjithsej 27 dënime, ku 14 prej tyre janë dënime me gjobë, derisa 13 dënime të janë dënime me burgim efektiv.

Në këtë kategori të rasteve, janë shqiptuar 29 vite e 10 muaj burgim. Dënimi më i lartë i shqiptuar është 5 vite burgim në një rast, derisa dënimi më i ulët i shqiptuar është 6 muaj burgim efektiv, i shqiptuar në një (1) raste. Ndërsa, dënimi më i shpeshtë është dënimi me 2 vite e 4 muaj burgim, i shqiptuar në 4 raste.

	Lartësia e dënimit me burgim efektiv	Numri i dënimeve
	5 vite	Rasti Matrix M
	3 vite e 6 muaj	Rasti Matrix M
	3 vite	Rasti Prokurori
	3 vite	Rasti Mati
	2 vite e 6 muaj	Rasti Mati
	2 vite e 4 muaj	Rasti Ndërrimi
	2 vite e 4 muaj	Rasti Ndërrimi
	2 vite e 4 muaj	Rasti Ndërrimi
	2 vite e 4 muaj	Rasti Ndërrimi
	1 vit	Rasti Prokurori
	1 vit	Rasti UP
	1 vit	Rasti UP
	6 muaj burgim	Rasti Qeraja
Totali	29 vite e 10 muaj	13

Tabela 2 – Lartësia e dënimeve me burgim efektiv në rastet e përfunduara me aktgjykim përfundimtar.

Ndërsa, janë shqiptuar edhe 40,660.00 euro gjobë, në të cilat dënimi më i lartë me gjobë i shqiptuar në këto raste është 5260 euro, derisa dënimi më i ulët me gjobë është 1000 euro. Dënimi më i shpeshtë me gjobë në këto raste është 5000 dhe 1000 euro gjobë, i shqiptuar në nga 4 raste.

	Lartësia e dënimit me gjobë	Numri i dënimeve
	5260 euro	Rasti Inspektori
	5000 euro	Rasti Prokurori
	5000 euro	Rasti Matrix-M
	5000 euro	Rasti Mati
	5000 euro	Rasti Mati
	3000 euro	Rasti Prokurori
	2600 euro	Rasti OSHP
	2000 euro	Rasti Avokati II
	2000 euro	Rasti Matrix-M
	1800 euro	Rasti Qeraja
	1000 euro	Rasti Ndërrimi
	1000 euro	Rasti Ndërrimi
	1000 euro	Rasti Ndërrimi
	1000 euro	Rasti Ndërrimi
Totali	40,660.00	14


Tabela 3: Lartësia e dënimit me gjobë në rastet e përfunduara me aktgjykim përfundimtar.

IKD gjen se në të gjitha rastet e lartpërmendura, mungojnë konfiskimet e dobisë pasurore të fituar me vepra penale. Karakteristikë tjetër është fakti se nga 13 persona të dënuar me burgim efektiv janë vetëm tre (3) janë zyrtarë publikë, njëri (1) prej tyre ish-prokuror, një (1) ish-zyrtar komunal dhe një ish-zyrtar i UP-së.

VII. Aktgjykimet e shkallës së parë në rastet e shënjestruara të kthyer në rigjykim¹⁹

Në të gjitha rastet e shënjestruara të cilat po trajtohen nga gjykatat, pesë (5) prej këtyre rasteve janë kthyer në rigjykim. Në këto raste, instancat më të larta gjyqësore kanë gjetur shkelje të ligjit nga gjykata e instancës së parë dhe kanë vendosur t'i kthejnë në rigjykim.

Në këto raste janë të përfshirë 28 persona të akuzuar. Lidhur me ta në procesin e parë gjyqësor, shkalla e parë kishte shpallur fajtor 21 persona. 18 prej tyre i kishte dënuar me burgim efektiv²⁰, një (1) person është dënuar me gjobë, ndërsa dy (2) persona i kishte dënuar me burgim me kusht. Ndërsa, ndaj dy (2) personave ishte marrë aktgjykim refuzues dhe në mungesë të provave gjykatësit kanë liruar pesë (5) persona.²¹



Grafiku 7 – Numri dhe lloji i aktgjyimit të shpallur ndaj personave të gjykuar në shkallë të parë në rastet e kthyer në rigjykim.

¹⁹ Shënim: IKD në pjesën e më poshtme të këtij raporti, përkatësisht në Kapitullin XII – “Aneks II: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të kthyer në rigjykim”, ka analizuar secilin rast të kësaj kategorie.

²⁰ Shënim: Dy (2) persona te rasti “Mërgimtari” dhe pesë (5) persona te rasti “Shkurti”, janë dënuar me burgim efektiv dhe me gjobë.

²¹ Shënim: Te rasti “Keds”, në procesin e rigjyimit është duke u gjykuar vetëm një person, pasi një person është liruar nga Gjykata e Apelit, ndërsa ndaj dy të tjerëve është refuzuar akuza, për njërin është tërhequr prokurori, ndërsa i pandehuri tjetër ka ndërruar jetë, ndërsa në rastin “Mërgimtari”, procesi i rigjyimit është duke vazhduar vetëm ndaj tre të pandehurve, pasi dënimi i të pandehurit që ishte dënuar me gjobë, është vërtetuar dënimi e në rastin “Shkurti” janë vërtetuar dënimet ndaj gjashtë (6) personave, ndërsa është kthyer në rigjykim ndaj dy (2) personave.

I. Politika ndëshkimore në rastet e shënjestëruara të kthyer në rigjykim

Në rastet e kthyer në rigjykim, ka pasur një politikë ndëshkimore më të ashpër se sa në rastet e përfunduara me aktgjykim përfundimtar. Ky dallim në ashpërsi të dënimit shprehet si në dënimet me burgim efektiv, ashtu edhe në lartësinë e dënimeve me gjobë.

Nga 28 dënimet e shqiptuara në këto raste, 18 kanë qenë dënime me burgim efektiv, tetë (8) kanë qenë dënime me gjobë, derisa Gjykatat në këto raste kanë shqiptuar edhe dy (2) dënime me kusht.

Në këtë kategori të rasteve, janë shqiptuar 65 vite e 7 muaj burgim efektiv, në të cilat dënimi më i lartë me burgim efektiv ka qenë 11 vite, i shqiptuar në dy (2) raste, derisa dënimi më i ulët me burgim efektiv ka qenë 5 muaj, i shqiptuar në një (1) rast. Dënimi më i shpeshtë me burgim efektiv ka qenë dënimi me dy (2) vite burgim dhe gjashtë (6) muaj burgim efektiv, të shqiptuara në gjithsej 3 raste.

	Lartësia e dënimit me burgim efektiv	Numri i dënimeve
	11 vite	Rasti Shkurti
	11 vite	Rasti Shkurti
	8 vite	Rasti Shkurti
	5 vite e 6 muaj	Rasti Mërgimtari
	5 vite e 2 muaj	Rasti Mërgimtari
	4 vite	Rasti Shkurti
	4 vite	Rasti Shkurti
	3 vite	Rasti Feronikeli
	2 vite e 6 muaj	Rasti Feronikeli
	2 vite e 6 muaj	Rasti Stenta
	2 vite	Rasti Mërgimtari
	2 vite	Rasti Stenta
	2 vite	Rasti Shkurti
	1 vit	Rasti Shkurti
	6 muaj	Rasti Feronikeli
	6 muaj	Rasti Feronikeli
	6 muaj	Rasti Feronikeli
	5 muaj	Rasti Feronikeli
Totali	65 vite e 7 muaj	18

Tabela 4 – Lartësia e dënimeve me burgim efektiv në rastet e kthyer në rigjykim.

Ndërsa janë shqiptuar edhe 149.000 euro gjobë. Dënimi më i lartë me gjobë, njëherësh dënimi më i shpeshtë, ka qenë 50.000 euro, i shqiptuar në 2 (dy) raste, derisa dënimi më i ulët ka qenë 3.000 euro, i shqiptuar në një (1) rast.

	Lartësia e dënimit me gjobë	Numri i dënimeve
	50.000 euro	Rasti Shkurti
	50.000 euro	Rasti Shkurti
	20.000 euro	Rasti Shkurti
	10.000 euro	Rasti Shkurti
	7.000 euro	Rasti Mërgimtari
	5.000 euro	Rasti Shkurti
	4.000 euro	Rasti Mërgimtari
	3.000 euro	Rasti Mërgimtari
Totali	149.000 euro	8

Tabela 5 – Lartësia e dënimeve me gjobë në rastet e kthyer në rigjykim.

Ndërsa sa i përket dënimeve me kusht, në këtë kategori hynë dy (2) dënime, ku ndaj dy (2) të akuzuarve janë shqiptuar gjashtë (6) muaj burgim, i cili nuk do të ekzekutohej nëse brenda një periudhe prej dy (2) viteve, nuk kryejnë vepër tjetër penale.²²


	Lartësia e dënimit me burgim me kusht	Periudha verifikuese	Numri i dënimeve
	6 muaj burgim	2 vite	Rasti KEDS
	6 muaj burgim	2 vite	Rasti KEDS
Totali	1 vit	/	2

Tabela 6 – Lartësia e dënimeve me kusht në rastet e kthyer në rigjykim.

²² *Shënim* : Gjykata e Apelit, njërin nga këta persona e kishte liruar nga akuza, ndërsa për tjetrin e rastin e kishte kthyer në rigjykim.

VIII. Aktgjykimet e shkallës së parë në rastet e shënjestruara²³

Deri më 31 dhjetor 2019 të rastet në të cilat gjykimet kanë përfunduar vetëm në shkallën e parë, janë të përfshirë 81 persona. Gjykatat kanë shqiptuar aktgjykime dënuese ndaj 50 personave, prej tyre 13 janë dënuar me burgim efektiv, ndërsa shtatë (7) prej tyre përpos dënimit me burgim efektiv janë dënuar edhe me gjobë, ndërsa ndaj 25 personave janë shqiptuar dënime të kushtëzuara, dy (2) nga të cilët përpos dënimeve me kusht, janë dënuar edhe me gjobë, ndërsa 12 persona ishin dënuar vetëm me dënim me gjobë. Në mungesë të provave 24 persona janë liruar nga akuza, ndaj një (1) personi është shqiptuar aktgjykim refuzues, ndërsa për gjashtë (6) persona është veçuar procedura.



Grafiku 8 – Numri dhe lloji i aktgjykimit të shpallur pas përfundimit të procedurës në shkallë të parë në rastet e shënjestruara.

I. POLITIKA NDËSHKIMORE

Në rastet e shënjestëruara të cilat kanë përfunduar në shkallë të parë, ka një numër dominant të dënimeve me kusht në raport me dënimet me gjobë, dhe veçanërisht në raport me dënimet me burgim efektiv. Nga 59 dënimet e shqiptuara, 25 prej tyre janë dënime me burgim me kusht, 21 prej tyre kanë qenë dënime me gjobë, derisa 13 kanë qenë dënime me burgim efektiv.

Në këtë kategori, janë shqiptuar 33 vite e 4 muaj burgim efektiv. Tek dënimet me burgim efektiv, dënimi më i lartë ka qenë me 6 (gjashtë) vite burgim, i shqiptuar në një (1) rast, derisa

²³ Shënim: IKD në pjesën e më poshtme të këtij raporti, përkatësisht në Kapitullin XII – “ANEX III: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestëruara të përfunduara në shkallë të parë, të cilat gjenden në procedurë ankimore”, ka analizuar secilin rast të kësaj kategorie.

dënimi më i ulët ka qenë me 6 (gjashtë) muaj burgim efektiv, i shqiptuar në dy (2) raste. Dënimi më i shpeshtë ka qenë 2 vite e 5 muaj burgim efektiv, i shqiptuar në gjithsej 3 (tri) raste.

	Lartësia e dënimit me burgim efektiv	Numri i dënimeve
	6 vite	Rasti Detyrimi
	4 vite e 6 muaj	Rasti Detyrimi
	4 vite	Rasti Gjykatësi
	3 vite	Rasti Detyrimi
	3 vite	Rasti Kristal
	2 vite e 5 muaj	Rasti Kristal
	2 vite e 5 muaj	Rasti Kristal
	2 vite e 5 muaj	Rasti Kristal
	2 vite e 3 muaj	Rasti Kristal
	1 vit e 8 muaj	Rasti FAN
	8 muaj	Rasti Kristal
	6 muaj	Rasti Kristal
	6 muaj	Rasti Avokati 3
Totali	33 vite e 4 muaj	13

Tabela 7 – Lartësia e dënimeve me burgim efektiv në rastet e përfunduara në shkallë të parë.

Ndërsa, janë shqiptuar edhe 40,600.00 euro gjobë. Dënimi më i lartë, njëkohësisht edhe dënimi më i shpeshtë me gjobë ka qenë 3.000 euro, i shqiptuar në katër (4) raste, derisa dënimi i ulët me gjobë ka qenë 1.000 euro, i shqiptuar po ashtu në 4 (katër) raste. Ndërsa, dënimi me gjobë më i shpeshtë ka qenë 1.500 euro, i shqiptuar në gjithsej 5 raste.

	Lartësia e dënimit me gjobë	Numri i dënimeve
	3000 euro	Rasti Gold
	3000 euro	Rasti Gold
	3000 euro	Rasti Gold
	3000 euro	Rasti Avokati 3
	2800 euro	Rasti Gold
	2800 euro	Rasti Gold
	2500 euro	Rasti 1 Gold
	2000 euro	Rasti Gold
	2000 euro	Rasti Gold
	2000 euro	Rasti Gold
	1800 euro	Rasti Gold
	1500 euro	Rasti Kristal
	1500 euro	Rasti Kristal
	1500 euro	Rasti Kristal
	1500 euro	Rasti Kristal
	1500 euro	Rasti Kristal
	1200 euro	Rasti Gold
	1000 euro	Rasti MSH 2
	1000 euro	Rasti MSH 2
	1000 euro	Rasti Kristal
	1000 euro	Rasti Kristal
Totali	40,600.00	21

Tabela 8 – Lartësia e dënimeve me gjobë në rastet e përfunduara në shkallë të parë.

Ndërsa në këtë kategori, janë shqiptuar edhe 19 vite e nëntë (9) muaj burgim me kusht. Dënimet me kusht përbëjnë edhe numrin më të madh të dënimeve të kësaj kategorie, me gjithsej 25 dënime. 13 nga këto dënime janë dënime me një (1) vit burgim, i cili nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepra tjera penale brenda afatit dy (2) vjeçar. Ndërsa rasti më i rrallë, në dy (2) raste, janë shqiptuar dy (2) vite burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda një periudhë verifikuese pre tre (3) vitesh.


	Lartësia e dënimit me	Periudha	Numri i dënimeve
	burgim me kusht	verifikuese	
	2 vite burgim	3 vite	Rasti MSH 2
	2 vite burgim	3 vite	Rasti MSH 2
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	1 vit burgim	2 vite	Rasti Gold
	4 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	4 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	4 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
	3 muaj burgim	1 vit	Rasti Gold
Totali	19 vite e 9 muaj	/	25

Tabela 9 – Lartësia e dënimeve me kusht në rastet e përfunduara në shkallë të parë.

IX. Profili i personave të akuzuar në të gjitha rastet e shënjestruara²⁴

IKD ka analizuar edhe profilin e personave të cilët janë subjekt të procedurave gjyqësore në rastet e shënjestruara, të cilat gjenden për herë të parë në procedurë gjyqësore, rastet të cilat janë gjykuar në shkallë të parë dhe janë kthyer në rigjykim, rastet të cilat janë gjykuar në shkallë të parë dhe gjenden në procedurë ankimore, si dhe rastet e përfunduara me aktgjykim të formës së prerë. Nga të gjitha rastet rezulton se janë akuzuar 294 persona, prej të cilëve shumica absolute prej 195 persona i takojnë profilin të ulët, 60 persona i takojnë profilin të mesëm, ndërsa janë akuzuar vetëm 39 persona të profilin të lartë, që në përqindje i bie se nga të gjithë të akuzuarit, 66% i takojnë profilin të ulët, 21% i takojnë profilin të mesëm dhe vetëm 13% i takojnë profilin të lartë.

Në gjashtë (6) aktakuzat e ngritura në vitin 2019, në të cilat janë përfshirë 34 persona është akuzuar vetëm një person i profilin të lartë, ndërsa janë akuzuar nëntë (9) zyrtarë të profilin të mesëm dhe 24 të profilin të ulët. Për secilën prej kategorive, në vazhdim paraqitet profili i personave dhe vendimet e gjykatave ndaj këtyre profileve.



Grafika 9 – Profili i personave të akuzuar në rastet e shënjestruara.

²⁴ Përcaktimi i profileve të personave të akuzuar është bërë në dy mënyra. Profili i lartë është përcaktuar sipas udhëzuesit të KPK-së, të miratuar më 3 nëntor 2013, ndërsa profili i personave të mesëm dhe të ulët, është përcaktuar në bazë të standardit të hulumtimit të cilin e ka ndërtuar IKD ndër vite, varësisht prej pozitës në institucione, organizata apo të personave pa pozita publike.

a. Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar

Në rastet që kanë përfunduar me aktgjykime përfundimtare, nga 58 personat²⁵ e akuzuar, shtatë (7) persona i takojnë profilit të lartë për të cilat kanë dështuar aktakuzat për korrupsion pasi nuk është shqiptuar asnjë aktgjykim dënues. Katër (4) nga këta persona në mungesë të provave ishin liruar nga aktakuza (ish-kryetari i Apelit Salih Mekaj, ish-kryetari i Komunës së Klllokotit Sreqko Spasiq te rasti “Klllokoti I” “ ish-kryetari i OSHP-së Hysni Hoxha dhe ish-eksperti i OSHP-së Hysni Muhadri,), për një person prokurori kishte hequr dorë nga ndjekja penale (ish-kryetari i Dragashit Selim Jenuzi) ndërsa ndaj dy personave ishte hedhur aktakuza akoma pa filluar procesi gjyqësor (Ish-ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Ramë Buja dhe ish-kryetari i Klllokotit Sreqko Spasiq te rasti “Klllokoti II”).



Grafika 10 – Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar.

Prej 27 personave që i takojnë profilit të mesëm, rezulton se gjykatësit kanë shpallur aktgjykime dënuese ndaj shtatë (7) të akuzuarve, prej të cilëve katër (4) persona janë dënuar me burgim efektiv dhe tre (3) persona janë dënuar me gjobë, janë marr aktgjykime refuzuese ndaj nëntë (9) personave, është pushuar procedura për një prokuror për shkak të vdekjes së tij gjatë fazës së konfirmimit të aktakuzës, ndërsa kanë shpallur aktgjykime liruese ndaj dhjetë (10) të akuzuarve. Prej 24 personave që i takojnë profilit të ulët, rezulton se gjykatësit kanë shpallur aktgjykime dënuese ndaj 12 të akuzuarve, prej të cilëve 10 persona janë dënuar me burgim efektiv dhe dy (2) persona me dënim me gjobë, është marr aktgjykim refuzues ndaj një (1) personi, ndërsa kanë shpallur aktgjykime liruese ndaj 11 të akuzuarve.

²⁵ Shënim: Përpos 19 rasteve të përfunduara me aktgjykim përfundimtar, me aktgjykime përfundimtare ka përfunduar edhe procedura ndaj tre (3) të akuzuarve në rastin e kthyer në rigjykim “Keds” (2 refuzues dhe 1 lirues), e po ashtu edhe ndaj një (1) të akuzuari në rastin “Mërgimtar” (dënues) që po ashtu është në proces të rigjyimit ndaj tre (3) të akuzuarve të tjerë. Ndërsa në rastin “Sekseri”, që është në proces është hushur aktakuza ndaj një (1) të akuzuari.

b. Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë dhe janë kthyer në rigjykim

Nga 28 personat e akuzuar, ndaj të cilëve gjykatat kanë shqiptuar aktgjykime në shkallë të parë, por që janë kthyer në rigjykim, rezulton se personat e profilit të lartë janë ish-kryetari i Komunës së Lipjanit Shukri Buja, i cili ishte dënuar me tri (3) vite burgim nga gjykata e shkallës së parë, por Gjykata e Apelit e kishte prishur vendimin ndaj tij dhe të tjerëve dhe rasti është kthyer në rigjykim, e njëjtë është vepruar edhe për ish-ministrin e Shëndetësisë Ferid Agani dhe ish-sekretarin e kësaj ministrie Gani Shabani, që ishin dënuar me dënime me burgim, Agani me dy (2) vite e gjashtë (6) muaj, ndërsa Shabani me dy (2) vite burgim.



Grafika 10 – Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë dhe janë kthyer në rigjykim.

12 persona të akuzuar i takojnë profilit të mesëm, ndaj të cilëve gjykatat kanë shqiptuar aktgjykime në shkallë të parë, rezulton se pesë (5) prej tyre janë dënuar me nga gjashtë (6) muaj burgim efektiv dy (2) persona janë dënuar me kusht, ndaj dy (2) personave është refuzuar akuza, ndërsa pesë (5) personat tjerë janë liruar nga përgjegjësia penale. Në këtë grup të rasteve janë përfshirë edhe 13 persona që i takojnë profilit të ulët - kryesisht qytetarë. Ndaj tyre, gjykatësit kanë shqiptuar 11 aktgjykime dënuese, ku 10 të akuzuar janë dënuar me burgim, një (1) tjetër është dënuar me gjobë, ndërsa edhe dy (2) janë liruar nga akuza.

c. Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë

Deri më tash, gjykatat kanë shpallur aktgjykime ndaj 81 personave të akuzuar në rastet e shënjestruara, por të cilat lëndë ende janë aktive sepse gjenden në procedurë ankimore në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Prej këtij numri, rezulton se 16 persona të akuzuar i takojnë profilit të lartë nëntë (9) persona të akuzuar i takojnë edhe profilit të mesëm, ndërsa 56 persona i takojnë profilit të ulët. Nga 16 personat e gjykuar në shkallë të parë që i takojnë profilit të lartë, rezulton se nuk është shqiptuar asnjë aktgjykim dënues. Ndaj një përsosni është refuzuar akuza,

ndërsa numri më i madh i vendimeve për këtë profil të personave janë aktgjykimet liruese, të cilat janë shqiptuar ndaj 15 të akuzuarve.




Grafika 11 – Profili i personave të akuzuar në rastet që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë.

Prej nëntë (9) personave të akuzuar që i takojnë profilit të mesëm, rezulton se gjykatësit kanë shpallur aktgjykime dënuese me burgim efektiv prej gjashtë (6) muajsh dhe 3000 euro gjobë ndaj një avokati, ndërsa gjykatat kanë shpallur aktgjykime liruese ndaj tetë (8) të akuzuarve.

d. Profili i personave të akuzuar në rastet që gjenden në procedurë gjyqësore

Në rastet në proces gjyqësor për herë të parë, rezulton se janë të akuzuar 127 persona, prej të cilëve vetëm 13 të akuzuar i takojnë profilit të lartë (12 persona te rasti “Veteranet” Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari dhe një te rasti “Grantet”, Nenad Rikallo), 12 persona i takojnë profilit të mesëm, ndërsa numri më i madh apo 102 persona i takojnë profilit të ulët.



Grafika 12 – Profili i personave të akuzuar në rastet që gjenden në procedurë gjyqësore.

Këto raste janë ende në procedurë gjyqësore dhe sipas gjetjeve të IKD-së, të evidentuara në këtë raport, rezulton se gjykatësit, vazhdimisht shkelin afatet ligjore për trajtimin për e këtyre rasteve siç përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale.

Në këto raste deri më tash ndaj një (1) personi tashmë është pushuar procedura, pasi në rastin “Sekseri”, është hudhur aktakuza ndaj drejtorit të Drejtorisë për Krime Ekonomike në Prishtinë Emin Beqirit, i cili ka arritur të shpëtoi nga tri veprat penale për të cilat e ngarkonte prokuroria, përkatësisht për veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “pengimi i të provuarit” dhe “moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre”.

X. Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të shënjestruara

IKD edhe në raportin e dytë të saj të analizimit të rasteve të shënjestruara nuk ka parë progres të trajtimit të këtyre rasteve dhe ka listuar një numër të gjetjeve kryesore si rezultat i monitorimit sistematik hulumtimit dhe analizimit të këtyre rasteve. Gjetjet përfshijnë shkeljet e obligimeve ligjore dhe politikave të Këshillave në trajtimin e rasteve të shënjestruara deri tek keq menaxhimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial që kanë ndikuar në jo efikasitet dhe jo efektivitet në trajtimin e këtyre rasteve.

- Mekanizmi për shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda për liberalizimin e vizave edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar shkeljet e kriterëve të përcaktuara në Procedurat Standarde të Veprimit me rastin e shënjestrimin të rasteve. Gjatë vitit 2019, për dallim nga periudhat paraprake, nuk janë evidentuar raste të cilat i plotësojnë kriteret për shënjestërim por që nuk janë shënjestëruar, derisa janë evidentuar raste të kundërta, ku janë shënjestëruar raste të cilat nuk i plotësojnë kriteret e PSV-ve. Kjo pasi Prokurori i Shtetit, edhe në gashtë (6) aktakuzat e ngritura në vitin 2019, ka shkelur kriteret e PSV-ve, pasi nga 34 të akuzuarit ka akuzuar vetëm një (1) person të profilin të lartë, nëntë (9) të profilin të mesëm, ndërsa janë akuzuar 24 persona të profilin të ulët.
- Në mbi 90% të rasteve të shënjestruara gjykatësit shkelin afatet ligjore për trajtimin e rasteve sipas Kodit të Procedurës Penale.
- KGJK nuk mban llogaridhënës gjyqtarët lidhur me këto raste, me ç'rast shkel politikat dhe vendimet që vet i ka nxjerrë.
- Jo efikasitet në trajtimin e lëndëve. Nga viti 2015 deri në fund të muajit dhjetor 2019 Prokurori i Shtetit ka shënjestruar 57 raste, në të cilat janë përfshirë 372 persona. Nga 57 rastet e shënjestruara, Prokurori i Shtetit në 44 raste ka ngritur aktakuza, ndërsa tetë (8) raste janë në hetime, në katër (4) raste kanë pushuar hetimet, ndërsa në një (1) rast janë pezulluar hetimet. Prej 44 aktakuzave të shënjestruara vetëm 19 prej tyre apo 43% kanë përfunduar me aktgjykime të formës së prerë. Thënë më ndryshe, në parim, procesi i trajtimit të rasteve të shënjestëruara nuk ka arritur ende në gjysëm.
- Prokurori i Shtetit në 19 aktakuzat e gjykuara me aktgjykim përfundimtar, ku janë përfshirë 58 persona të akuzuar, ka dështuar të mbrojë aktakuzat ndaj 40 personave apo 69% të tyre, të cilët janë liruar nga gjykatat, ndërsa ka arritur të provojë aktakuzat ndaj 18 personave apo 31% të tyre, të cilët janë dënuar. Lidhur me dështimin e këtyre aktakuzave, sistemi prokurorial nuk ka mbajtur përgjegjësi asnjë prokuror.
- Prokurori i Shtetit në rastet në të cilat proceset gjyqësore kanë përfunduar vetëm në shkallën e parë, ku janë të përfshirë 81 persona ka arritur të provojë aktakuzat ndaj 50 personave apo 62% të tyre, ndërsa ka dështuar t'i provojë aktakuzat ndaj 25 personave apo 31%, ndërsa për gjashtë (6) persona, apo 7% është veçuar procedura. Politika e dënimeve në këto raste të përfunduara në shkallë të parë, rezulton se nuk është adekuate për të arritur qëllimin e dënimit. Prej 50 personave të dënuar në shkallë të parë, rezulton

se janë shqiptuar 59 dënime. Nga 59 dënimet e shqiptuara, 25 prej tyre janë dënime me burgim me kusht, 21 prej tyre kanë qenë dënime me gjobë, derisa 13 kanë qenë dënime me burgim efektiv.

- Në 43 aktakuzat e shënjestruara janë përfshirë 294 persona. Prej tyre 195 persona të akuzuar i takojnë profilin të ulët, 60 persona profilin të mesëm, ndërsa 39 persona i takojnë profilin të lartë.
- **Prej 44 aktakuzave të shënjestruara, 19 raste kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, ku përfshihen 58 persona të akuzuar.**
- IKD gjen se prej këtij totali të personave të akuzuar që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, 7 persona të akuzuar i kanë takuar profilin të lartë. Aktakuzat ndaj tyre kanë dështuar, pasi të gjithë janë liruar nga gjykatat. 27 persona i takojnë profilin të mesëm. Prej tyre, 4 të akuzuar janë dënuar me burgim efektiv, 3 janë dënuar me gjobë, për 9 persona janë refuzuar akuza, për 1 është hedhur aktakuza, ndërsa janë liruar 10 persona. Prej 58 personave të akuzuar që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, rezulton se 24 persona i takojnë profilin të ulët. Prej tyre, 10 të akuzuar janë dënuar me burgim efektiv, 2 janë dënuar me gjobë, për 1 është refuzuar akuza, ndërsa janë liruar 11 persona.
- **Prej 44 aktakuzave të shënjestruara, 5 raste kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë, por që janë kthyer në rigjykim, ku përfshihen 28 persona të akuzuar.**
- IKD gjen se prej këtij totali të personave të akuzuar, kanë qenë tre (3) zyrtar të profilin të lartë, njeri ishte dënuar më parë nga gjykata e shkallës së parë me tri (3) vite burgim, një (1) ishte dënuar me dy (2) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe një (1) me dy (2) vite burgim. Ndërsa rezulton se 12 persona i takojnë profilin të mesëm. Prej tyre, 5 të akuzuar janë dënuar me burgim, 2 me dënim me burgim me kusht, për dy (2) persona ishte refuzuar akuza, ndërsa pesë (5) persona ishin liruar nga akuzat. Prej 28 personave të akuzuar që kanë përfunduar në shkallë të parë që janë kthyer në rigjykim, rezulton se 13 persona i takojnë profilin të ulët. Prej tyre, 10 të akuzuar janë dënuar me burgim efektiv, një (1) ishte dënuar me gjobë, ndërsa dy (2) ishin liruar.
- **Prej 44 aktakuzave të shënjestruara, 9 raste kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë, por që gjenden ende në procedura ankimore, ku përfshihen 81 persona të akuzuar.**
- IKD gjen se prej këtij totali të personave të akuzuar, 16 persona të akuzuar i takojnë profilin të lartë por ndaj asnjërit nuk ka pasur aktgjykim dënues, për një (1) është refuzuar akuza ndërsa janë liruar 15 persona.
Prej 81 personave të akuzuar që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë, që ende gjenden në procedurë ankimore, rezulton se nëntë (9) persona i takojnë profilin të mesëm. Prej tyre, një (1) i akuzuar ishte dënuar me burgim efektiv, ndërsa janë liruar tetë (8) persona.

Prej 81 personave të akuzuar që kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë, që ende gjenden në procedurë ankimore, rezulton se 56 persona i takojnë profilin të ulët. Prej tyre, 12 të akuzuar janë dënuar me burgim efektiv, 25 janë dënuar me kusht, 12 janë dënuar me gjobë, një (1) person është liruar, e për gjashtë (6) persona është veçuar procedura.

- **Prej 44 aktakuzave të shënjestruara, 11 raste ende gjenden në procedurë gjyqësore për herë të parë në shkallë të parë, ku përfshihen 127 persona të akuzuar.**
- Prej tyre, 13 të akuzuar i takojnë profilin të lartë, 12 të akuzuar i takojnë profilin të mesëm, ndërsa 102 të akuzuar i takojnë profilin të ulët.
- Prokurorët kanë dështuar të argumentojnë dhe të paraqesin kërkesa për konfiskim të pasurive nën dyshimin se janë përfituar përmes aktiviteteve kriminale në rastet e shënjestruara.
- Mos respektimi i rekomandimeve të KGJK-së dhe KPK-së të nxjerra më 22 mars 2018 nga gjykatësit dhe prokurorët për trajtimin e lëndëve të shënjestruara.
- Mos respektimi i vendimeve dhe politikave të KGJK-së nga vetë KGJK
- Problematikë tjetër që ka ndikuar në mos efikasitetin dhe ekonomizimin e tyre rasteve të shënjestruara ka qenë ndryshimi i shpeshtë qoftë i prokurorëve që kanë përfaqësuar aktakuzën, ashtu edhe me ndryshimet e kryetarëve të trupit gjykues. Me dispozitat e KPPK-së është përcaktuar se në rastin kur gjatë shqyrtimit gjyqësor ndryshon kryetari i trupit gjykues ai rast duhet të fillojë rishtas dhe nëse gjatë trajtimit të këtyre lëndëve ndodhin situata të tilla, atëherë të njëjtat nuk mund të përfundohen në një afat të arsyeshëm kohor.
- Ndryshimi i vazhdueshëm i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në këto raste paraqet keq menaxhim të lëndëve, dhe mos reflektim përballë nevojës që rastet e shënjestruara të trajtohen me prioritet absolut.
- Shkelja e të drejtave të personave të akuzuar në procedurë penale, të cilët nuk gjykohen në kohë të arsyeshme.
- Vazhdojnë problemet në evidentimin e lëndëve të shënjestruara për liberalizim të vizave në evidencat zyrtare të sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial, përpos që dy këshillat (KGJK dhe KPK) nuk kanë të dhëna unike, ato edhe kanë mangësi në evidencat e tyre.
- Përderisa në përgjigjen e dhënë për IKD-në koordinatori i KGJK-së Agim Maliqi dhe zëdhënësja e Gjykatës Themelore në Prishtinë Mirlinda Gashi, nuk kanë dërguar të rastet e shënjestruara në të cilat janë ngritur aktakuza në vitin 2019, këto të dhëna janë dërguar nga zyra për informim e KPK-së.
- IKD, ka kërkuar informacione edhe nga të gjithë gjykatësit e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, mirëpo asnjëri nga ta nuk ka pasur informacione nëse kanë në trajtim raste të shënjestruara.
- Në rastet “Veteranët” dhe “Vizat”, trupe gjykuese në kundërshtim me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale kanë marrë vendime me të cilat janë ndaluar publikimet e

emrave të të akuzuarve (Te rasti Vizat) e po ashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve (Te rasti Veteranët)

ANEX I: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara që gjenden për herë të parë në gjykim

IKD si organizata e vetme në Republikën e Kosovës, e cila i monitoron sistematikisht rastet e shënjestruara, në vijim ka paraqitur gjetjet dhe vlerësimet për secilin rast veç e veç. Në këtë pjesë të raportit paraqiten rastet e shënjestruara, të cilat gjenden për herë të parë në proces gjyqësor, ku bëjnë pjesë 10 aktakuza të ngritura, përfshi rastet: 1) “Dëmi”, 2) “Transportuesi”, 3) “Qarku”, 4) “Sekseri”, 5) “Shkolla”, 6) “Vizat”, 7) “Veteranët”, 8) “Qafa”, 9) “Ura e Gurit 1”, 10) “Ura e Gurit 2” dhe 11) “Grantet”.

Trajtimi i rasteve të cilat janë duke u trajtuar nga gjykatat e shkallës së parë, është pasqyrimi më i qartë për hapat që janë ndërmarrë nga institucionet e drejtësisë për të përfunduar këto raste në hapa të shpejtë.

Kjo bazohet në faktin se në këto raste është përfshirë një rast, aktakuza e të cilit është ngritur gjatë vitit 2015 (“Dëmi”), një aktakuzë e vitit 2016 (“Transportuesi”), një aktakuza të vitit 2017 (“Qarku”), ndërsa janë në trajtim edhe katër (4) aktakuza të ngritura në vitin 2018 (“Sekseri”, “Shkolla”, “Vizat” dhe “Veteranët”) si dhe tri (3) aktakuza të ngritura në vitin 2019 (“Qafa”, “Ura e Gurit 1”, dhe “Ura e Gurit 2”)

Edhe pse te rasti “Dëmi” janë mbajtur shumë seanca gjyqësore, i njëjti akoma nuk ka arritur ende të marrë epilog përfundimtar. Në këtë rast, që nga ngritja e aktakuzës e deri tash janë ndryshuar dy prokurorë, ndërsa lënda i ishte dorëzuar katër gjykatësve të ndryshëm.

Ndërsa që nga 7 maj 2019 e deri më 31 dhjetor 2019, në rastin “Transportuesi”, nuk është mbajtur asnjë seancë.

Departamenti Special, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, që është funksionalizuar në korrikun e vitit 2019, ka në trajtim tri (3) rastet e aktakuzave të ngritura në vitin 2019 “Ura e Gurit 1”. “Ura e Gurit 2” “Qafa” dhe “Grantet”.

Përpos këtyre rasteve, edhe shumica e rasteve të tjera në këtë stad të procedurës, janë përcjellë me mbajtje të seancave jashtë afateve ligjore, zvarritje dhe shtyrje të shumta të seancave.

1. RASTI “DËMI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.5548/18.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Elmaz Zenuni, më pas Vehbi Kashtanjeva, më pas Hamdi Ibrahim, ndërsa aktualisht është Rustem Begolli.


Prokuror: Fillimisht ka qenë Faik Halili, më pas Atdhe Dema.

Veprat penale: “Krim i organizuar” Shmangia nga tatimi”; “Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin”.

Të pandehur: Blerim Sinani, Skender Sinanaj, Fatmir Sinani, Isa Dërguti, Samir Sinanaj, Sabit Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emini dhe Ramadan Sogojeva.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1503 DITË)



Ky proces fillimisht ishte zhvilluar në bazë të aktakuzës së përpiluar më 20 nëntor 2015, e cila ngarkonte të pandehurit Blerim Sinani, Skender Sinanaj, Fatmir Sinani, Isa Dërguti, Samir Sinanaj, Sabit Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emini për veprat penale “Krim të Organizuar” dhe Shmangie nga tatimi”. Sipas prokurorisë të njëjtë pretendohet se përmes bizneseve të tyre kanë lëshuar fatura fiktive (dokumente të rrejshme lidhur me tatimin) me qëllim që vetes dhe bizneseve të tjera t’iu mundësohet shmangia nga pagesa e tatimit duke i shkaktuar dëme në vlera të mëdha buxhetit të Kosovës.

Ata pretendohet se në periudhën kohore 2013-2014 përmes bizneseve të ndryshme, kishin lëshuar dokumente të rrejshme, duke iu mundësuar subjekteve apo bizneseve të caktuara shmangie nga tatimi, nga tarifat dhe kontributet e tjera.

Ndërkaq, më 25 prill të vitit 2018, prokurori Faik Halili, kishte bërë ndryshimin e aktakuzës, ku në cilësinë e të akuzuarit në këtë proces gjyqësor ishte shtuar edhe Ramadan Sogojeva.

Sipas PSRK-së, i akuzuari Sogojeva, në periudhën kohore 2013-2014, përmes bizneseve të tij, “Toni Group” dhe “Orli”, ka lëshuar dokumente të rrejshme, ku paraqitja e dokumentit të vërtetë është kërkuar me ligj, duke i dhënë fatura fiktive biznesit “Banana”, me pronarë të pandehurin Enver Hasanin dhe “OM” me pronar Mentor Emini në vlerë prej 227,047.40 euro. Sipas, aktit akuzues, iu ka mundësuar bizneseve në fjalë që të i shmangen pjesërisht apo tërësisht pagesës së tatimeve, tarifave apo kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj. E sipas aktakuzës, ka kryer në vazhdimësi veprën penale “dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin” nga neni 314, paragrafi i dytë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dispozitivi i dytë thotë se i akuzuari Sogojeva, në periudhën kohore prej vitit 2013-2014, me qëllim të shmangies pjesërisht apo tërësisht të pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohej me ligj, ka dhënë të dhëna të pa vërteta, nuk i ka përfshirë të dhënat lidhur me të ardhurat e bizneseve të tij “Toni Group” dhe “Orli”, pasurinë, gjendjen ekonomike apo faktet tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, ku ai sipas akuzës ka deklaruar një qarkullim më të vogël se sa qarkullimi real e më këtë thuhet se ka bërë shmangie nga tatimi në shumën prej 805,60 euro. Për këtë veprim, PSRK e ngarkon të njëjtin për kryerjen e veprës penale “shmangie nga tatimi”.

Në seancën e 25 prillit 2018, prokurori Faik Halili, kishte vendosur po ashtu që ta ndryshonte aktakuzën, me të cilën të akuzuarit nuk ndiqeshin me veprën penale të “krimit të organizuar”, por vetëm për veprat penale “dokumentet të rrejshme lidhur me tatimin” dhe “shmangie nga tatimi”.

Të akuzuarit e lartpërmendur, po ashtu akuzohen se në periudha të ndryshme nga 2010-2013, me qëllim të shmangies nga pagesa e tatimit, tarifave dhe kontributeve kishin dhënë të dhëna të pavërteta lidhur me të ardhurat e bizneseve të tyre “Adi”, “Lesa”, “Blera”, “Konto Ëeb”, “Skenda”, “Vali2”, “Eni-Deni” e shumë biznese të tjera, ku kishin deklaruar qarkullim real më të vogël për të bërë shmangie nga tatimi.

Në këtë proces gjyqësor i akuzuar ka qenë edhe Fatmir Sinani, por ndaj tij është veçuar procedura.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Rasti i njohur si “Dëmi”, ndryshe është rasti më reprezentativ për të treguar se edhe pse ky rast ka qenë i shënjestruar, trajtimi i tij në gjykatë është përcjellë me jo seriozitet e pengesa të ndryshme procedurale, mbi të gjitha për shkak se në këtë rast janë ndryshuar tre prokurorë dhe tre gjykatës.

Administrata Tatimore e Kosovës kishte iniciuar këtë rast me anë të kallëzimit penal të parashtruar më 30 prill të vitit 2014. Aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë më 28 maj të vitit 2014, ndërsa aktakuza më pas ishte ngritur më 20 nëntor të vitit 2015 nga prokurori Faik Halili.

Këtë aktakuzë fillimisht e kishte përfaqësuar prokurori Faik Halili, ndërsa në dy seanca kjo aktakuzë ishte përfaqësuar nga prokurorja Bukuriye Gjonbalaj, kurse aktualisht përfaqësohet nga prokurori i PSRK-së Atdhe Dema, pasi prokurori Halili kishte arritur moshën e pensionimit.

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo lëndë i ishte ndarë gjykatësit Elmaz Zenuni, që ishte transferuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, në Gjykatën Themelore në Prishtinë me qëllim që me disa gjykatës të tjerë, të trajtojnë disa lëndë të krimit të organizuar dhe korrupsionit me qëllim të përfundimit më të shpejtë të tyre. Zenuni kishte caktuar shqyrtimin fillestar tetë muaj pas ngritjes së aktakuzës, përkatësisht më 12 korrik të vitit 2016, duke shkelur afatin e paraparë ligjor, sipas të cilit kjo seancë duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.

Nën udhëheqjen e Zenunit ishin mbajtur 12 seanca, por ai para se të përfundojë ky rast kishte bërë kërkesë në KGJK, për t’u transferuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, e cila kërkesë i ishte aprovuar nga në mbledhjen e KGJK-së, të mbajtur më 27 prill 2017.²⁶

Pas largimit të gjykatësit Zenuni, disa nga të akuzuarit kishin ardhur në seancën e cila ishte caktuar më 18 maj 2017, mirëpo atë ditë kishin kuptuar se këtë lëndë nuk do ta gjykonte më gjykatësi Zenuni²⁷, ndërsa rasti “Dëmi”, me ndryshmin e trupit gjykues edhe pse ishte në fazën përfundimtare, ishte kthyer në pikën zero.

Pasi Zenuni ishte kthyer në gjykatën e Ferizajt, lënda i ishte caktuar gjykatësit Vehbi Kashtanjeva, por me kërkesë të mbrojtësve, Kashtanjeva ishte përjashtuar nga ky rast, pa e mbajtur asnjë seancë gjyqësore, pasi dy seanca kishin dështuar. Pastaj, ky rast kishte kaluar te gjykatësi Hamdi Ibrahim.

Në seancën e 25 prillit 2018, apo pas dy viteve e pesë muajsh, prokurori i PSRK-së Faik Halili, i cili kishte ngritur këtë aktakuzë, kishte vendosur që të heqë dorë nga vepra penale “krim i organizuar”, derisa tetë të akuzuarit, Blerim Sinani, Skender Sinanaj, Fatmir Sinani, Isa Dërguti, Samir Sinanaj, Sabit Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emiri, tash e tutje, do të ngarkoheshin me veprën penale të shmangies nga tatimi. Ri cilësimin juridik të veprës penale, prokurori Halili

²⁶ “Kryetarja Afërdita Bytyçi ankohet se ish-Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Hamdi Ibrahim nuk pranon lëndë në punë” Betimi për Drejtësi, 27 prill 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetarja-aferdita-bytyci-ankohet-se-ish-kryetari-i-gjykates-themelore-ne-prishtine-hamdi-ibrahimi-nuk-pranon-lende-ne-pune/>)

²⁷ “Gjyqtari kthehet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, të akuzuarit kthehen në shtëpi” Betimi për Drejtësi, 18 maj 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjyqtari-kthehet-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj-te-akuzuarit-kthehen-ne-shtepi/>)

kishte thënë se e ka bërë me arsyetimin se veprimet e të akuzuarve përmbushin elementet e veprës penale të shmangies nga tatimi, e jo edhe të krimit të organizuar.²⁸

Pasi gjykatësi Ibrahim i kishte caktuar shtatë seanca gjyqësore, tri nga të cilat ishin shtyrë, në seancën e 19 dhjetorit 2018, ai kishte vendosur që të aprovojë propozimin e mbrojtësve Behar Ejupi, Tahir Rrecaj dhe të tjerëve që kjo lëndë të kalojë në Departamentin e Përgjithshëm. Paraprakisht, lidhur me këtë propozim, prokurori Atdhe Dema, kishte thënë që PSRK-ja do të vazhdojë ta përfaqësojë këtë lëndë pa marrë parasysh se në cilin departament do të gjykohej. Sipas tij, një shkallë që vendos më rëndë mundet edhe më lehtë, andaj nuk do të heqin dorë nga ky përfaqësim, ndërsa nuk e ka kundërshtuar propozimin e mbrojtësve që kjo lëndë të kalojë në departament tjetër. Pas këtij deklarimi, gjykatësi Hamdi Ibrahim i kishte marrë aktvendim me të cilin Departamentin e Krimeve të Rënda e kishte shpallur jo kompetent për gjykim të këtij rasti. Ndërsa, kishte thënë se për të akuzuarin Fatmir Sinanaj, për të cilin ishte veçuar procedura do të marrë aktvendim më pas.²⁹

Tashmë ky rast i është ndarë gjykatësit Rrustem Begolli³⁰, në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili akoma nuk e ka caktuar seancën e parë gjyqësore.

Lidhur me ndryshimet e gjyqtarëve dhe zvarritjen e këtij rasti, IKD vazhdimisht ka kërkuar informata nga Gjykata Themelore në Prishtinë, por se kjo e fundit asnjëherë nuk ka dhënë sqarime.

Në rastin konkret, IKD gjenë se zvarritja më e madhe procedurale është bërë nga keq menaxhimi i këtij rasti, përkatësisht nga ndërrimi i gjyqtarëve në këtë rast. Në këtë drejtim, nisur nga fakti se këto lëndë janë me prioritet absolut, Gjykatat dhe veçanërisht Kryetarët e Gjykatave, duhet të reflektojnë drejt përballë nevojës për prioritizimin e këtyre rasteve, edhe në aspektin e menaxhimit të rasteve. Thënë më ndryshe, duke shfrytëzuar dispozitat ligjore dhe nënligjore, lëndët duhet të ndahen tek gjyqtarët që nuk rrezikojnë të largohen nga këto lëndë, para përfundimit të të njëjtave.

²⁸“Prokuroria heq dorë nga vepra penale “krim i organizuar”, shtatë të akuzuarit tani i ngarkon për “shmangie nga tatimi” Betimi për Drejtësi, 24 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-vepra-penale-krim-i-organizuar-shtate-te-akuzuarit-tani-i-ngarkon-per-shmangie-nga-tatimi/>)

²⁹“Rasti i shënjestruar për viza ndaj të akuzuarve për shmangie nga tatimi kalon në Departamentin e Përgjithshëm”, Betimi për Drejtësi, 19 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-shenjestruar-per-viza-ndaj-te-akuzuarve-per-shmangie-nga-tatimi-kalon-ne-departamentin-e-pergjithshem/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁰ Shënim: Lista më lëndët e shënjestruara për liberalizim të vizave të lëndët që gjykohen nga Gjykata Themelore në Prishtinë e dërguar nga ana e zëdhënëses Mirlinda Gashi-10.05.2019

Në anën tjetër, kjo duhet të ndodhë edhe me prokurorët e rastit. Fakti se ndryshimi prokurorit që përfaqëson akuzën parimisht nuk shkakton zvarritje procedurale, ky fakt ndikon në përfaqësimin efektiv të rasteve në Gjykatë. Andaj, prioriteti në menaxhimin e këtyre rasteve duhet të reflektohet edhe nga Prokurori i Shtetit.

Dëmi i pretenduar: Afër 800.000,00.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

2. RASTI “TRASPORTUESI”

Gjykata Themelore në Mitovicë

Numri i lëndës: P.nr.147/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Beqir Halili.


Prokuror: Fillimisht ka qenë Abdurrahim Islami, e më pas Atdhe Dema.

Të pandehur: Besim Zeqiri, Ismet Zeqiri, Agron Zymeri, Gentrit Zymeri, Canabeg Hyseni, Ali Muzliukaj, Liridon Hyseni, Ridvan Avdiu, Dugagjin Latifi, Besnik Istrefi, Azem Islami, Xhevat Spahija, Shkëlqim Jusaj, Selami Morina, Nexhat Mazrek, Demë Lokaj, Alban Nikqi, Fadil Qollaku, Albion Lokaj, Sabri Hasani, Burim Hasani.

Veprat penale: “Pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar”; “Kontrabandim i mallrave”; “Tregtia e ndaluar”; “Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore”; “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1127 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur më 30 nëntor 2016 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), Besim Zeqiri, Ismet Zeqiri, Agron Zymeri, Gentrit Zymeri, Sabri Hasani, Burim Hasani, Canabeg Hyseni, Ali Muzliukaj, Liridon Hyseni, Ridvan Avdiu, Dugagjin Latifi, Besnik Istrefi dhe Azem Islami, ngarkohen për kryerjen e veprave penale, “pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar” nga neni 283, “kontrabandim i mallrave”, “tregtia e ndaluar” dhe “shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore”.

Po ashtu, kjo aktakuzë ngarkon edhe të pandehurit Xhevat Spahija, Shkëlqim Jusaj, Selami Morina, Nexhat Mazrek, Demë Lokaj, Alban Nikqi, Fadil Qollaku dhe Albion Lokaj, për kryerjen e veprave penale, “pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar” nga neni 283, “kontrabandim i mallrave” nga neni 317, dhe “shmangie nga pagesa e tarifave të

detyrueshme doganore”, nga neni 318 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në vazhdim të aktakuzës, për veprën penale “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 të KPRK-së, secili veç e veç, akuzohen Agron dhe Gentrit Zymeri, Ismet Zeqiri, Canabeg Hyseni, Azem Islami, Fadil Qollaku, Demë Lokaj dhe Alban Nikqi.

Sipas aktakuzës, të pandehurit e lartpërmendur, në fillim të vitit 2012, kanë themeluar një grup kriminal me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore financiare, në atë mënyrë që përmes rrugëve anësore me kamionë, cisterna dhe mjete të tjera, në mënyrë të vazhdueshme dhe të kundërligjshme nga Serbia dhe Mitrovica e Veriut, kanë sjellë në mënyrë ilegale dhe në vazhdimësi mallrat e kontrabanduara si: derivate të naftës, vajra motorike etj.

Bazuar në aktakuzë, të pandehurit Besim dhe Ismet Zeqiri, në bashkëpunim me të gjithë pjesëtarët e grupit, nga data 11 qershor 2014 e deri më 10 dhjetor 2014, nga Serbia për në Kosovë, kanë bërë kontrabandimin e 52 ngarkesave me derivate të naftës (nga 12.000 litra), 2 ngarkesa me vaj hidrol (nga 10.000 litra) dhe 3 ngarkesa me nitrotretës (nga 7.000 litra), të cilat mallra të kontrabanduara ky grup kriminal më pas i ka shpërndarë nëpër qytete të ndryshme të Kosovës, në dyqane dhe depo të ndryshme, e gjitha kjo me qëllim që vetes dhe personit tjetër t’i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore, doganore apo tarifave të tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, duke bërë shmangien nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore që tejkalon shumë prej 30,000 eurosh.

Në këtë rast, kanë qenë të akuzuar edhe Besim Zeqiri dhe Ridvan Avdiu, mirëpo më 22 shkurt 2017 ndaj tyre ishte veçuar procedura, për shkak se ata gjendeshin me vendbanim jashtë Kosovës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktvendimi për fillim të hetimeve në këtë rast ishte iniciuar më 4 qershor të vitit 2014, e aktakuza ishte ngritur pas gati dy vitesh e gjysmë, më 30 nëntor 2016. Këtë aktakuzë e kishte përpiluar Prokurori Special, Abdurrahim Islami. Shqyrtimi fillestar ishte caktuar më 5 prill 2017, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur të mbahet për shkak të mungesës së të akuzuarit Agron Zymeri.³¹ Ky shqyrtim ishte mbajtur vetëm pas afër një viti, konkretisht më 11 tetor 2017, që është një tjetër shembull i cili tregon seriozitetin e sistemit të drejtësisë për procedimin e këtyre rasteve.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 23 shkurt 2018, kishte lëshuar urdhër arrest ndaj të akuzuarve Agron dhe Gentrit Zymeri për shkak të mungesës së tyre në këtë seancë. Kurse, gjykatësi Halili kishte bërë të ditur se as seancat e parapara të mbahen më 31 tetor e 1 nëntor nuk

³¹ “Shtyhet shqyrtimi fillestar ndaj 21 të akuzuarve për krim të organizuar” Betimi për Drejtësi. 5 tetor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shqyrtimi-fillestar-ndaj-21-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

do të mbaheshin.³² Ndryshe, seancat e parapara të mbaheshin me 4 prill, 13 prill, e 6 qershor 2018, si dhe 30 tetor 2018, kishin dështuar të mbaheshin për shkak të mungesës të të akuzuarve. E seanca e paraparë të mbahej më 27 shtator 2018, kishte dështuar për shkak se prokurori Abdurrahim Islami kishte arritur moshën e pensionimit dhe nuk mund ta përfaqësonte aktakuzën në rastin konkret.³³

Shtyrjet e seancave në këtë rast kanë vazhduar edhe në vitin 2019, pasi që në seancën e 8 marsit 2019, në gjykatë nuk u paraqitën të akuzuarit Ali Muzliukaj dhe Dugagjin Latifi, që ndikoi që ky rast edhe njëherë të dështojë, ndërsa kryetari i trupit gjykues, kërkoi nga Stacioni Policor në Mitrovicë, që të sigurohen adresat e këtyre dy të akuzuarve.³⁴

Në seancën e mbajtur më 7 maj 2019 është caktuar ekspertizë e re financiare, ndërsa për të akuzuarin Dugagjin Latifi është veçuar procedura, për të njëjtin do të zhvillohet procedurë tjetër dhe lënda do të marrë numër të ri. Ai nuk ishte paraqitur në këtë seancë dhe në raportin e Stacionit Policor të datës 6 maj 2019, thuhej se i akuzuari Latifi nuk gjendet në Kosovë dhe se sipas deklaratave të familjarëve të tij, ai ka rreth tre muaj që gjendet në Gjermani.³⁵ Pas seancës së 7 majit, nuk është mbajtur asnjë seancë në këtë rast, kurse seancat e radhës pritet të mbahen me 17 dhe 29 janar 2020.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Naftë, benzinë, vajra të llojeve të ndryshme, acid sulfurik, automjete, autocisterna, Cigare, aditivë të ndryshëm, sprej për makina, antifriz, ujë për dritare, ujë i distiluar, ujë i dejonizuar, ambalazh për vaj dhe auto pjesë të ndryshme.

³² “Për të dytën herë radhazi dështon gjykimi ndaj 19 të akuzuarve për krim të organizuar”, Betimi për Drejtësi. 30 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-dyten-here-radhazi-deshton-gjykimi-ndaj-19-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³³ “Prokurori special del në pension, dështon gjykimi ndaj të akuzuarve për krim të organizuar”, Betimi për Drejtësi, 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-del-ne-pension-deshton-gjykimi-ndaj-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁴ “Mungojnë dy të akuzuar, dështon gjykimi për krim të organizuar në rastin e shënjestruar për viza” Betimi për Drejtësi, 8 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-dy-te-akuzuar-deshton-gjykimi-per-krim-te-organizuar-ne-rastin-e-shenjestruar-per-viza/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁵ “Caktohet ekspertizë e re financiare në gjykimin ndaj 19 të akuzuarve për krim të organizuar, për njërin veçohet procedura” Betimi për Drejtësi, 7maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-ekspertize-e-re-financiare-ne-gjykimin-ndaj-19-te-akuzuarve-per-krim-te-organizuar-per-njerin-vecohet-procedura/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

3. RASTI “QARKU”

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: P.nr.129/2017.

Kryetar i Trupit Gjykses: Burim Ademi, më pas Bekim Veliqi


Prokuror: Agron Bajrami.

Të pandehur: Vladislav Trajković, Mensur Bekteshi, Ramadan Bajra, Argëtim Ismaili, Armend Smajli, Arben Smajli, Shkumbin Ismaili, Afrim Rustolli, Rinor Rustolli, Arben Rrsutolli, Liridon Borovci, Bahri Rexhepi, Nexhmendin Bajrami, Afrim Xhaqaj, Lulzim Kastrati, Nezir Zogaj, Blerim Avdylaj, Kujtim Avdylaj, Afrim Hoti, Dukagjin Kollçaku, Ruzhdi Kolica, Ardian Raci, Gazi Tarashaj, Ramush Salihu, Sali Salihu, Zekri Salihu, Shkelzen Salihu, Haki Isufi, Ismet Zeqiri, Alban Islami, Artan Kurpulaj, Florim Krasniqi, Ahmet Sylja, Radisav Mutavxhiq, Milan Stojanović, Besim Biberović, Reshat Kamberaj, Endrit Kllokoqi, Ramadan Mehmeti, Hasan Rexhbeqaj, Zenel Isufi dhe Xhemail Islami, Imri Bajrami, Nimon Zogaj, Mirko Iliq dhe Mursel Calaković.

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Shmangia nga tatimi”; “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”; “Tregtia e ndaluar”; “Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore” ;” Kontrabandimi i mallrave”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i parasë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 811 DITË)



Aktakuza në këtë rast ishte ngritur nga PSRK më 12 tetor të vitit 2017, sipas së cilës pretendohet që Argëtim Ismaili, Armend Smajli, Arben Smajli, Shkumbin Ismaili, Afrim Rustolli, Rinor Rustolli, Arben Rrsutolli, Liridon Borovci, Bahri Rexhepi, Nexhmendin Bajrami, Afrim Xhaqaj, Lulzim Kastrati, Nezir Zogaj, Blerim Avdylaj, Kujtim Avdylaj, Afrim Hoti, Dukagjin Kollçaku, Ruzhdi Kolica, Ardian Raci, Gazi Tarashaj, Ramush Salihu, Sali Salihu, Zekri Salihu,

Shkelzen Salihu, Haki Isufi, Ismet Zeqiri, Alban Islami, Artan Kurpulaj, Florim Krasniqi, Ahmet Sylaj, Radisav Mutavxhiq, Milan Stojanović, Besim Biberović, Vladislav Trajković, Mensur Bekteshi, Ramadan Bajra, Reshat Kamberaj, Endrit Klllokoqi, Ramadan Mehmeti, Hasan Rexhbeqaj, Zenel Isufi dhe Xhemal Islami, Imri Bajrami, Nimon Zogaj, Mirko Iliq dhe Mursel Calaković, kanë kryer veprat penale “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, “shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore”, “tregtia e ndaluar”, “falsifikimi i dokumenteve” “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “falsifikimi i parasë” dhe “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Sipas aktakuzës së PSRK-së, 42 të akuzuarit, gjatë periudhës kohore, janar 2015 e deri në mars të vitit 2016, me dashje dhe me dijeni, aktivisht kanë marrë pjesë në veprimtarinë kriminale të grupit duke vepruar si bashkim i strukturuar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie pasurore të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, ashtu që të njëjtit kanë arritur që në mënyrë shumë të sofistikuar të organizojnë tre skema të punës, konkretisht, import të kundërligjshëm përmes mos deklarimit apo deklarimit të pasaktë të mallrave të llojit “cigare” dhe kontrabandimit të tyre, kontrabandim të produkteve farmaceutike dhe stimulantëve seksual të llojit “kamagra” dhe “viagra”, po ashtu përmes shmangie nga tatimet e brendshme kanë realizuar të ardhura të konsiderueshme.

Për të akuzuarit, Imri Bajrami, Nimon Zogaj, Mirko Iliq dhe Mursel Calaković, gjykatësi Burim Ademi, ka veçuar procedurën, pas konstatimit se të njëjtit nuk gjenden në Kosovë, ndërkaq për të akuzuarin tjetër, Xhemal Islami, është veçuar procedura pasi ai e ka pranuar fajësinë për armëmbajtje pa leje. Bazuar në aktakuzë, të akuzuarit kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme në periudhën e përmendur më lartë, ashtu që janë shmangur nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore apo tarifave të tjera doganore që paguheshin me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave.

Gjithmonë sipas aktakuzës, veprimet e tyre kanë rezultuar me shmangie të përgjithshme doganore, gjithsej në shumën prej 1,666,824.07 euro dhe njëkohësisht duke iu shmangur obligimeve tatimore për mallrat e lartcekura dhe mos deklarimit të saktë të pasqyrave financiare, që rezultojnë në shumë prej 763,778.09 euro, e që rezultojnë me shmangie të përgjithshme doganore dhe tatimore gjithsej në shumën prej 2,430,620.16 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Parashtruesi i kallëzimit penal në këtë rast kishte qenë Dogana e Kosovës, e cila parashtrimin e kishte bërë më 25 shtator të vitit 2015. Aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë më 13 tetor të po të njëjtit vit, e më 12 tetor të vitit 2017, prokurori special Agron Bajrami kishte ngritur aktakuzë për këtë rast. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 23 janar të vitit 2018, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit Agron Bajrami, 42 të akuzuarit ishin deklaruar se nuk e ndiejnë

veten fajtorë për akuzat e prokurorisë se nga veprimet e tyre kanë bërë shmangie të përgjithshme doganore dhe tatimore, në shumën prej mbi dy milionë euro.³⁶

Pasi që të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë, gjykatësi Burim Ademi, kishte aprovuar propozimin e mbrojtësit së të akuzuarit Shkumbin Ismajli, avokatit Tahir Rrecaj, i cili nga gjykata ka kërkuar që të mos mbahet shqyrtimi i dytë, por t'u jepet afati prej 30 ditësh për kundërshtim të aktakuzës dhe provave. Në këtë seancë kishin munguar edhe katër të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Imri Bajrami, Nimon Zogaj, Mirko Iliq dhe Mursel Calaković, për të cilët gjykatësi Burim Ademi ka veçuar procedurën, pasi një propozim të tillë e ka bërë avokati Rrecaj, në emër të të gjithë mbrojtësve tjerë.

Në fillim të tetorit ishin paraparë të mbahen pesë seanca për këtë rast mirëpo të njëjtat ishin shtyrë³⁷. Më 20 nëntor 2018 kishte arritur të fillojë shqyrtimi gjyqësor, ku ishin dhënë vetëm fjalët hyrëse nga palët në procedurë³⁸, ndërsa dështimi për mbajtjen e seancës kishte vazhduar edhe në vitin 2019, kur ishte mungesa e njërit nga anëtarët e trupit gjykues arsye që të mos mbahet seanca e 14 janarit 2019³⁹. Pas kësaj, ishin arritur që të mbahen seancat e 15 janarit,⁴⁰ e po ashtu edhe ato të 1 e 4 marsit.^{41,42} dhe 30 prillit 2019. Ndërkaq, seanca e paraparë të mbahej me 5 qershor 2019, nuk ishte mbajtur për shkak të mungesës të akuzuarit, Blerim Avdylaj. Kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Burim Ademi, kishte bërë të ditur se gjykata ka pranuar një kërkesë nga avokati Skender Musa, i cili kishte kërkuar që seancat e 5 dhe 7 qershorit, të shtyhen për një datë tjetër, me arsyetimin se i mbrojturi i tij, ka të hospitalizuar bashkëshorten, e cila

³⁶ “Deklarohen të pafajshëm 42 të akuzuarit për keqpërdorim detyre dhe krim të organizuar, për katër të tjerë veçohet procedura”, Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-42-te-akuzuarit-per-keqperdorim-detyre-dhe-krim-te-organizuar-per-kater-te-tjere-vecohet-procedura/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁷ “Anulohen pesë seanca të parapara për këtë javë ndaj 42 të akuzuarve për keqpërdorim detyre dhe krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 1 tetor 2018(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/anulohen-pese-seanca-te-parapara-per-kete-jave-ndaj-42-te-akuzuarve-per-keqperdorim-detyre-dhe-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁸ “ Deklarohen të pafajshëm 41 të akuzuarit për keqpërdorim detyre dhe krim të organizuar, avokati dënohet 250 euro për vonesë në seancë”. Betimi për Drejtësi. 20 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-41-te-akuzuarit-per-keqperdorim-detyre-dhe-krim-te-organizuar-avokati-denohet-250-euro-per-vonese-ne-seance/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

³⁹ “Dështon gjykimi ndaj 41 të akuzuarve për keqpërdorim detyre dhe krim të organizuar” Betimi për Drejtësi. 14janar 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-gjykimi-ndaj-41-te-akuzuarve-per-keqperdorim-detyre-dhe-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁴⁰ “Dëshmitari thotë se në lokalin e tij ku u gjetën cigare pa banderola ishte i marrë me qira nga njëri i akuzuar”Betimi për Drejtësi. 15janar 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-ne-lokalin-e-tij-ku-u-gjeten-cigare-pa-banderola-ishte-i-marre-me-qira-nga-njeri-i-akuzuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁴¹ Dëshmitari thotë se me furgonin që ia kishte kërkuar njëri i akuzuar janë transportuar cigare me banderola të Maqedonisë”Betimi për Drejtësi. 1mars 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-me-furgonin-qe-ia-kishte-kerkuar-njeri-i-akuzuar-jane-transportuar-cigare-me-banderola-te-maqedonise/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁴² “Dëshmitari thotë se barnat e gjetura në pronën e tij kanë qenë të njërit nga të akuzuarit dhe sëe ka ditur se kanë qenë pa afat”Betimi për Drejtësi. 4mars 2019 (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-barnat-e-gjetura-ne-pronen-e-tij-kan-qene-te-njerit-nga-te-akuzuarit-dhe-se-ka-ditur-se-kan-qene-pa-afat/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

duhet t'i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjike, por siç tha ai, kësaj kërkesë nuk i ishte bashkëngjitur ndonjë dokument mbështetës.⁴³ Pasi që gjykatësi Ademi, është zgjedhur gjykatës i Departament Special, në Gjykatën e Apelit, ky rast i është trashëguar gjykatësit Bekim Veliqi. Ndërkaq, ende nuk është caktuar seanca e ardhshme për këtë çështje penale.

Dëmi i pretenduar: 2,430,620.16 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Para të falsifikuara, armë.

⁴³“ Dështon gjykimi ndaj 41 të akuzuarve për keqpërdorim detyre dhe krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 5 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-ndaj-41-te-akuzuarve-per-keqperdorim-detyre-dhe-krim-te-organizuar-2/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

4. RASTI “SEKSERI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.112/18.

Kryetari i Trupit gjykues: Fillimisht ka qenë Vesel Ismajli, më pas Adnan Isufi, së fundi Fatime Dermaku.


Prokurore: Fillimisht ka qenë Fikrije Fejzullahu, më pas Jehona Makolli - Grantolli

Të pandehur: Emin Beqiri dhe Rrahim Hashimi.

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”, “Moslajmërim i veprës penale”, “Pengim i të provuarit”, “Ushtrim i ndikimit”, “Mashtrimi”.

Faza e procedurës: Në proces,⁴⁴ është vërtetuar hudoja e aktakuzës ndaj Emin Beqirit.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 609 DITË)



PSRK më 3 maj 2018 përmes një njoftimi për media kishte njoftuar se kishte ngritur aktakuzë në gjykatë ndaj ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës, Emin Beqiri dhe biznesmenit Rrahim Hashimi, i njohur si “Sekseri”, pasi pretendonte se ata u kishin marrë 100 mijë euro drejtuesve të organizatës Qendra për Avokim dhe Diplomaci (QAD), për t’ua mbyllur një rast.⁴⁵

Prokuroria pretendonte se Emin Beqiri, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Krime Ekonomike në Prishtinë, gjatë muajit dhjetor 2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete dhe personin tjetër, përmes drejtorit të “City Group”, të akuzuarit Rrahim Hashimi, kishte kërkuar

⁴⁴Në listën e koordinatorit të KGJK-së Agim Maliqi, ky rast trajtohet si rast i formës së prerë me arsyetimin se aktakuza është hudoar nga Gjykata e Apelit për të dy të pandehurit 06.05.2019

⁴⁵“Ngritet aktakuzë ndaj ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri dhe biznesmenit Rrahim Hashimi”. Betimi për Drejtësi. 4 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-ndaj-ish-drejtorit-te-krimeve-ekonomike-ne-policine-e-kosoves-emin-beqiri-dhe-biznesmenit-rrahim-hashimi/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

100,000 euro nga të dëmtuarit Valmir Hajrullahu dhe Freskim Buqaj, për të cilët drejtoria kishte filluar një hetim në drejtim të veprës penale të mashtrimit. Beqiri, të akuzuarit Hashimi, sipas aktakuzës, i kishte dhënë informata që konsiderohen si fshehtësi zyrtare, ku pastaj ky i fundit iu kishte treguar të dëmtuarve se kontrolli-bastisja e lokaleve dhe shtëpive të tyre nuk do të bëhet sipas urdhërësës së gjykatës dhe i njëjti ishte përpjekur që t'i bind të dëmtuarit që t'i jepnin paratë e kërkuara me qëllim që procedura kundër tyre të mbyllet.

Mirëpo, gjithnjë sipas aktakuzës, i akuzuari Hashimi nuk kishte arritur t'i marrë paratë e kërkuara dhe ndaj të dëmtuarve Hajrullahu dhe Buqaj kishte filluar procedura, ndërsa pas kësaj prindërit e të dëmtuarve, Rexhet Hajrullahu dhe Qazim Buqaj, ia kishin dhënë të akuzuarit Hashimi 50,000 euro me qëllim që përmes të akuzuarit Beqiri t'ua mundësojë hapjen e lokaleve e pastaj t'i jepnin edhe 50,000 euro të tjera që të përmbyllej kjo procedurë. Kështu, në dhjetor 2016, Rexhep Hajrullahu ia kishte dhënë të akuzuarit Hashimi 16,000 euro, pastaj edhe 9,000 euro të tjera, ndërsa i dëmtuari Qazim Buqaj 25,000 euro.

Prokuroria, Beqirin e ngarkonte edhe me veprën penale “pengimi i të provuarit”, pasi i njëjti gjatë muajve janar-mars 2017, përkundër urdhërësës së gjykatës për ekzaminimin e aparatit telefonik “Iphone 6”, të të dëmtuarit Valmir Hajrullahu, nuk e kishte dërguar në laborator, ndërsa i dëmtuari e kishte vërejtur se bisedat dhe fotot e incizuara i ishin fshirë nga telefoni, e po ashtu, Beqiri akuzohej edhe për veprën penale “moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre”, pasi i njëjti edhe pse kishte pasur njohuri se i akuzuari Hashimi kishte marrë para në emër të tij, nuk e kishte lajmëruar veprën penale.

Ndërkaq, i akuzuari i dytë Rrahim Hashimi, akuzohet se gjatë muajit dhjetor 2016 nga familjarët e të dëmtuarve Hajrullahu dhe Buqaj kishte marrë shumën prej 50,000 eurosh dhe kishte kërkuar edhe 50,000 tjera, me qëllim që procedura ndaj tyre të përshpejtohet dhe pastaj edhe kishte ushtruar ndikim mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, duke bërë që i akuzuari Beqiri të veprojë në kundërshtim me ligjin. I njëjti akuzohet se gjatë viteve 2009-2017, kishte mashtruar shumë qytetarë, në atë mënyrë që përmes fakteve të rreme, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror kishte shfrytëzuar miqësinë me atasheun e Ambasadës së Hungarisë, Tamas Gergely, duke aplikuar për viza në emër të personave të ndryshëm, duke i paraqitur si punëtor të “City Group”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza e PSRK-së, e cila përmbante veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “pengimi i të provuarit”, “moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre”, “ushtrim i ndikimit” dhe “mashttrim”, për më pak se gjashtë muaj u përgjysmua pasi në fazën e kontrollit të aktakuzës ndaj Beqirit u pusha procedura për të gjitha pikat e aktakuzës, ndërsa ndaj Hashimit, mbeti që të gjykohej vetëm për veprën penale të “mashttrimit”.

Departamenti i Krimeve të Rënda, i Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte caktuar seancën fillestare më 16 maj 2018, pra në një afat rekord, vetëm 13 ditë pas ngritjes së aktakuzës së 2 majit 2018. Në atë seancë, dy të akuzuarit deklaruan se e ndejnë vetën të pafajshëm për akuzat e prokurorisë.⁴⁶ Pasi shkalla e parë e konfirmoi aktakuzën, lënda me ankesë u dërgua në Gjykatën e Apelit, e cila më 21 shtator kishte hudhur aktakuzën ndaj Beqirit, ndërsa e kishte kthyer në rivendosje vendimin me të cilin shkalla e parë kishte refuzuar kërkesën e tij për hudhjen e aktakuzës.⁴⁷ Në të njëjtën ditë kur Apeli kishte njoftuar për këtë vendim, kryetari i trupit gjykues, Vesel Ismajli, përsëri kishte konfirmuar aktakuzën ndaj Hashimit, i cili ngarkohej me veprat penale “Ushtrim i ndikimit” dhe “Mashtrimi”.

Mbrojtja e Hashimit, përsëri i ishte drejtuar instancës së dytë, duke kërkuar që si për Beqirin, të pushohet procedura edhe ndaj tij. Lidhur me kërkesat e tij, Gjykata e Apelit, më 18 tetor 2018, kishte marrë aktvendim me të cilin kishte aprovuar pjesërisht ankesën e Hashimit. Sipas këtij vendimi, ndaj Hashimit do të pushohej procedura penale për veprën penale të “Ushtrimit të ndikimit”, pasi nuk kishte dyshim të bazuar mirë se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale, ndërsa kishte konfirmuar akuzën me ç’rast ai ngarkohej për “mashtrim”.⁴⁸

Pasi gjyqtarit Ismajli, kjo aktakuzë i ishte kthyer për herë të dytë, por në fund me vetëm një vepër penale, ai konsideroi se kompetent tashmë është Departamenti i Përgjithshëm, e jo ai i Krimeve të Rënda. Ismaili, më 30 tetor 2018, përmes një akti përcjellës këtë lëndë e kishte dërguar në kompetencë në Departamentin e Përgjithshëm, të cilën do ta trajtonte gjyqtari Adnan Isufi. Sipas kësaj shkrese të gjykatësit Ismaili, një vendim i tillë është marrë pasi vepra penale e “mashtimit”, me të cilën ngarkohet Hashimi, dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 3 vjet.

Aktakuzën e ngritur nga PSRK-ja, do ta gjykojë Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa gjyqtari Isufi nuk e kishte caktuar shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se kjo lëndë ka shkuar në Gjykatën Supreme përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Me vendimin e Kolegji Penal të Gjykatës Supreme, të datës 1 prill 2019, ishte konstatuar se me vendimin e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, ka pasur shkelje në favor të ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri, me rastin e lirimit të tij nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe vepra të tjera penale. Përmes një komunikate për media, sipas kësaj gjykate, pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit ndaj dy vendimeve të shkallës së parë dhe të dytë që kishin liruar ish-drejtorin e

⁴⁶ “Ish-drejtori i Krimeve Ekonomike dhe biznesmeni deklarohen të pafajshëm për mbylljen e një rasti për 100 mijë euro”. Betimi për Drejtësi. 12 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-krimeve-ekonomike-dhe-biznesmeni-deklarohen-te-pafajshem-per-mbylljen-e-nje-rasti-per-100-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁴⁷ “Gjykata e Apelit konfirmon lirimin nga akuza për ish-drejtorin e Krimeve Ekonomike, Emin Beqiri”. Betimi për Drejtësi. 21 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-konfirmon-lirimin-nga-akuza-per-ish-drejtorin-e-krimeve-ekonomike-em-in-beqiri/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁴⁸ “Apeli e “zhdukë” korrupsionin nga rasti “sekseri”. Betimi për Drejtësi. 27 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-zhduke-korrupsionin-nga-rasti-sekseri/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri, ishin konstatuar shkelje në favor të të pandehurit.⁴⁹

Ndryshe, për këtë rast, të gjykatësi Isufi nuk ishte mbajtur asnjë seancë. Më pas, kjo lëndë i ka kaluar gjykatës Fatime Dermaku, e cila ka mbajtur seanca me 6 e 9 dhjetor.

Në seancën e 9 dhjetorit, në gjykatore janë dëgjuar dy dëshmitarë, ku njëri ka deklaruar se ndihet i mashtruar, ndërsa tjetri ka deklaruar të kundërtën.⁵⁰

Seanca e paraparë të mbahej më 18 dhjetor ka dështuar të mbahet për shkak të mungesës së akuzuarit Hashimi. Gjykatësja Fatime Dermaku ka deklaruar se ndaj të akuzuarit Hashimi, gjykata kishte lëshuar urdhëresë për sjellje nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan, mirëpo tha e i njëjti ishte në gjykim tjetër për çështje penale tjetër.

Dëmi i pretenduar: 100,000 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

⁴⁹“Supremja konstaton shkelje me rastin e lirimit të ish-drejtorit të Krimeve Ekonomike, Emin Beqiri” Betimi për Drejtësi. 17 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-me-rastin-e-lirimit-te-ish-drejtorit-te-krimeve-ekonomike-emin-beqiri/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁰ “I dëmtuari: Artan Nimani më garantoj për 2100 euro që ia dhashë Rrahim Hashimit për rregullimin e vizës”. Betimi për Drejtësi, 9 dhjetor (Shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/i-demtuari-artan-nimani-me-garantoi-per-2100-euro-qe-ia-dhashe-rrahim-hashimit-per-rregullimin-e-vizes/?fbclid=IëAR2GIRFëzadMz8mHzj1LHeKsISmYcuCBqgSO_fsy1R5QP4vtNaKVP6FyUOs)

5. RASTI “SHKOLLA”

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr.66/18.

Kryetar i Trupit Gjykses: Xheladin Osmani.

Prokuror: Fillimisht ka qenë Merita Bina-Rugova, e më pas Afrim Shefkriu.

Të pandehur: Flamur Hoxha, Besim Rexhaj, Veprim Rexhepi.

Veprat penale: “Shpërlarje parash”; “Mashttrim”; “Falsifikim i dokumenteve”; “Shmangie nga tatimi”.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 499 DITË)



Ky rast zhvillohet në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Speciale (PSRK), të datës 20 gusht 2018, me të cilën Flamur Hoxha dhe Besim Rexhaj, akuzohen se në periudhën 2016-2017, megjithëse e kanë ditur se të ardhurat burojnë nga aktivitete kriminale, kanë pranuar para nga qindra persona të dëmtuar, saktësisht 489 persona, me arsyetimin se do t'i punësojnë në Gjermani.

Sipas aktakuzës, Hoxha dhe Rexhaj, nga të dëmtuarit e njëjtë i kanë marrë nga 2500 - 3000 euro dhe fare nuk i kanë dërguar në Gjermani, duke fshehur fondet në fjalë e më pas të njëjtat fonde duke i transferuar tek persona të tjerë, kanë përvetësuar shumën prej 1,220,175.00 euro, nga të cilat kanë bërë shpërlarjen e parave në shumën prej 1,068,775.00 euro.

Me këtë, në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, kanë kryer veprën penale “shpërlarje parash”. Sipas aktakuzës, të njëjtit akuzohen edhe për veprën penale “mashttrim”, “falsifikim i dokumenteve” si dhe “shmangie nga tatimi”. Kurse, Veprim Rexhepi, akuzohet se në periudhën 2016-2017, me anë të falsifikimit, ka nënshkruar rreth 400 kontrata pune për në shtetin e Gjermanisë, pa qenë i autorizuar fare nga personat përgjegjës, në emër të të cilëve janë lëshuar këto kontrata.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ky rast kishte filluar me kallëzimin penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 29 gusht të vitit 2017. Data e nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve është 20 gusht 2018. Pas hetimeve, aktakuza ishte përpiluar nga ana e prokurorit Faik Halili, e në gjykatë e njëjta ishte ngritur më 20 gusht të vitit 2018. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 15 nëntor 2018, apo dy muaj pas ngritjes së aktit akuzues, ndërsa, shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 19 dhjetor të vitit 2018, ku më pas gjykata kishte marrë aktvendim me anë të së cilit kishte bërë aprovimin e aktit akuzues.

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar më 7 shkurt 2019, ndërsa kishte vazhduar edhe më 25 shkurt 2019, në të cilën seancë palët kishin shprehur gatishmërinë që të hynin në marrëveshje për pranimin e fajësisë⁵¹, por që kjo nuk ishte realizuar. Në seancat e mbajtura më 16⁵² dhe 17 prill 2019, janë dhënë dëshmitë e disa prej dëshmitarëve të rastit. Më pas, në këtë rast janë mbajtur seanca edhe më 5 gusht, 26 shtator, 1 tetor. Kurse, më 6 dhjetor ka filluar të deklarohet para trupit gjykues i akuzuari Flamur Hoxha. Mirëpo mbrojtësit e tij, avokatët Durim Nevzati dhe Ruzhdi Gashi, kishin kërkuar nga trupi gjykues që t’iu jepet kohë shtesë për t’u përgatitur për marrjen në pyetje dhe për të paraqitur mbrojtjen e klientit të tyre, duke kërkuar që të ndërpritet seanca.⁵³ Në seancën e 19 dhjetorit, i akuzuari Hoxha ka vazhduar paraqitjen e mbrojtjes së tij.⁵⁴ Ndërkaq, në seancën e 24 dhjetorit, para trupit gjykues, janë deklaruar dy të akuzuarit e tjerë, përderisa fjala përfundimtare në këtë rast pritet të paraqitet me 6 janar.⁵⁵

Dëmi i pretenduar: 1,220,175.00 euro dhe shpërlarje e parave në shumën prej 1,068,775.00 euro

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacione.

⁵¹ “Të akuzuarit për mashtrim me viza pune në Gjermani kërkojnë të hyjnë në negociim të marrëveshjes për pranim fajësie” Betimi për Drejtësi. 25 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-mashtrim-me-viza-pune-ne-gjermani-kerkojne-te-hyjne-ne-negocim-te-marreveshjes-per-pranim-fajesie/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵² “Gjykimi për mashtrim me viza pune gjermane, dëshmitarët thonë se klientët kanë paguar deri në 3000 euro” Betimi për Drejtësi. 16 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-mashtrim-me-viza-pune-gjermane-deshmitaret-thone-se-klientet-kane-paguar-deri-ne-3000-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵³ “Gjykimi për mashtrim me viza pune gjermane, njëri i akuzuar jep mbrojtjen e tij”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-mashtrim-me-viza-pune-gjermane-njeri-i-akuzuar-jep-mbrojtjen-e-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁴ “ Gjykimi për mashtrim me viza pune gjermane, vazhdon mbrojtjen e tij njëri nga të akuzuarit”. Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-mashtrim-me-viza-pune-gjermane-vazhdon-mbrojtjen-e-tij-njeri-nga-te-akuzuarit/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁵ “Gjykimi për mashtrim me viza pune, njëri i akuzuar thotë se klientëve u premtohet punësimi në Gjermani”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-mashtrim-me-viza-pune-njeri-i-akuzuar-thote-se-klienteve-u-premtohet-punesimi-ne-gjermani/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

6. RASTI “VIZAT”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.125/17.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Mustafë Tahiri, ndërsa më pas Vesel Ismajli

Prokuror: Fillimisht ka qenë Afrim Shefkiu, ndërsa më pas Atdhe Dema.

Të pandehur: Milaim Zeka, Ilir Krasniqi dhe Edmond Kërliu.

Veprat penale: “Mashttrim”; “Shmangie nga tatimi”; “Pastrim i parave”.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 491 DITË)



Prokuroria Speciale ka ngritur aktakuzë më 28 gusht 2018, me pretendimin se të pandehurit Ilir Krasniqi, Milaim Zeka dhe Edmond Kërliu kanë kryer disa vepra penale.

Ilir Krasniqi dhe Milaim Zeka akuzohen se prej vitit 2016 e deri në mars të vitit 2017 me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror më 2 qershor 2016, kishin krijuar biznesin “Ilir Krasniqi & Milaim Zeka OP”, si agjenci punësimi.

Sipas aktakuzës së përpiluar nga ana e prokurorit Afrim Shefkiu, të pandehurit thuhet se kishin paraqitur fakte të rreme kinse për punësimin e qytetarëve të Kosovës në Gjermani, përmes emisionit “Pa rrotlla” duke joshur qytetarët që të aplikojnë në zyrat tyre në lagjen “Pejton”, të Prishtinës. Tutje, pretendohet se në këtë rast ishte përfshirë edhe bashkëshortja e të pandehurit Ilir Krasniqi, Fexhrije Krasniqi, e cila ishte marrë me përgatitjen e dokumentacionit për punësim në Gjermani, në biznesin e saj për rregullimin e kopshteve.

Krasniqi dhe Zeka, akuzohen se kishin mashtruar 900 aplikues për viza pune, e që me qëllim iu kishin marrë shuma prej 500 deri në 3,050 euro, duke i ndarë proporcionalisht mes vete. Kurse, thuhet se pas fillimit të hetimeve, 354 personave i janë kthyer mjetet në vlerë prej 83,850 euro, kurse 546 personave të tjerë nuk i janë kthyer mjetet në vlerë prej 261,850.00 euro. Me këtë,

Krasniqi dhe Zeka akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “mashtrimi” nga neni 335 i KPRK-së.

Ndërsa, gjatë periudhës kohore prej 2 qershorit 2016 e deri më 31 dhjetor 2017, si bashkëpronarë të biznesit të lartpërmendur, me dashje direkte u janë shmangur obligimeve tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës me ç’rast akuzohen se kanë kryer veprën penale “shmangia nga tatimi”.

I pandehuri Ilir Krasniqi akuzohet po ashtu se me qëllim të fshehjes së burimeve të mjeteve financiare të fituara nga mashtrimi me viza pune dhe shmangies nga tatimi, më 19 nëntor 2016, kishte bërë transaksione të dyshimta. Me këtë ai akuzohet se ka kryer veprën penale “pastrimi i parave”. Ndërsa të pandehurit Zeka dhe Kërliu, akuzohen edhe për veprat penale “pastrim i parave”, “mashtrimi” dhe për veprën penale “shmangie nga tatimi”.

Kurse, i pandehuri Zeka akuzohet se si pronar i NSH Qendra Mediale “Mozaiku i Kosovës” me dashje direkte të shmangies së obligimit tatimor ndaj ATK-së kishte kryer veprën penale “shmangia nga tatimi”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK, më 28 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzën ndaj Milaim Zekës, Ilir Krasniqit dhe Edmond Kërliut dhe dy të pandehurve të tjerë, ndërsa më 26 shtator të vitit 2018, Milaim Zeka ishte arrestuar për shkak të dyshimeve se ai e kishte kërcënuar prokurorin special, Afrim Shefkriu që kishte ngritur aktakuzën e këtij rasti.

Zeka, dy ditë para arrestimit, në një emision televiziv kishte deklaruar se prokurorin Shefkriu, do ta ndjek me gjyq, me kanun, por edhe privatisht. “Ma përpara ia kisha falë nëse ma kish vra njërin prej fëmijëve në afekt sesa kështu me ia shkatërru njerëzve ëndrrat. Mua më kanë poshtëruar. Unë do ta ndjek këtë prokurorin tem me gjyq, me kanun e edhe privatisht. Nuk ia fali kurrë poshtërimin. Se njerëzit tash thonë për mua: Kqyre ky hajni i vizave”, kishte thënë deputeti Zeka. Më pas lidhur me këtë atij më 27 shtator 2018, i ishte caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh, e më 3 tetor këtë masë të sigurisë Gjykata e Apelit ia kishte zëvendësuar me një tjetër, me atë të arrestit shtëpiak.

E dy muaj pas ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, Afrim Shefkriu, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast më 29 tetor 2018, ku të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm. Paraprakisht, gjykatësi Tahiri, kishte njoftuar se më 26 tetor 2018, ka pranuar vendimin e 24 tetorit në të cilin mbrojtësi i Milaim Zekës, avokati Florent Latifaj kishte kërkuar përjashtimin e

prokurorit Afrim Shefkiu nga rasti. Në këtë seancë prezent kishte qenë prokurori Atdhe Dema, i cili tani përfaqëson aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.⁵⁶

Në seancën e 30 nëntorit, të akuzuarit kishin kundërshtuar aktakuzën. Mbrojtësit e të akuzuarve, kishin thënë se kërkesën për hudge të aktakuzës ia kanë dorëzuar gjykatës brenda afatit ligjor, por prokurori i rastit, Atdhe Dema, kishte thënë se ai vetëm kërkesën e të akuzuarit Ilir Krasniqi e kishte pranuar, por jo edhe të dy të akuzuarve tjerë Milaim Zeka e Edmond Kërliu. Më pas prokurori Dema, kishte deklaruar se meqenëse vetëm gjatë kësaj seance ka pranuar kundërshtimet për dy të akuzuarit në këtë rast, ai kishte thënë se nuk mund të jep përgjigje lidhur me këtë, duke kërkuar kohë për një gjë të tillë. Pasi që as mbrojtësit e të akuzuarve nuk e kanë kundërshtuar një propozim të tillë, kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Mustafë Tahiri, kishte aprovuar propozimin e prokurorit Dema dhe atij i kishte dhënë afat një javë për të dhënë përgjigje në kundërshtimet e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre.⁵⁷ Gjykata Themelore në Prishtinë, më pas, e ka konfirmuar aktakuzën, kurse ankesë për këtë aktvendim është parashtruar në Gjykatën e Apelit⁵⁸, e cila kishte vërtetuar më pas vendimin e shkallës së parë dhe në këtë mënyrë aktakuza kishte marrë formën e prerë.⁵⁹

Pas konfirmimit të aktakuzës, gjykatësi Mustafë Tahiri ka caktuar edhe seancën e shqyrtimit gjyqësor e cila ishte mbajtur më 27 mars 2019.⁶⁰

Në mbledhjen e KGJK-së të mbajtur më 5 prill 2019, ishte vendosur që gjykatësit Mustafë Tahiri, të mos i vazhdohet transferimi nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në këtë mënyrë rasti do të kthehet në pikën zero.⁶¹ Gjykatësi Tahiri, siç kishte thënë, për arsye personale dhe familjare, kishte kërkuar përfundimin e transferit edhe para se kjo lëndë të fillonte shqyrtimin gjyqësor, por në atë kohë, KGJK-ja kishte vendosur ta vazhdojë

⁵⁶ “Milaim Zeka dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për mashtrim, shmangie nga tatimi e pastrim parash”, Betimi për Drejtësi, 29 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/milaim-zeka-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-e-pastrim-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁷ “Deputeti Milaim Zeka dhe të tjerët kundërshtojnë aktakuzën që i ngarkon për mashtrim, shmangie nga tatimi e pastrim parash”, Betimi për Drejtësi, 30 nëntor 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-milaim-zeka-dhe-te-tjeret-kundershtojne-aktakuzen-qe-i-ngarkon-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-e-pastrim-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁸ “Konfirmohet aktakuza në rastin ku Milaim Zeka dhe të tjerët akuzohen për mashtrim, shmangie nga tatimi dhe pastrim parash”, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ne-rastin-ku-milaim-zeka-dhe-te-tjeret-akuzohen-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-dhe-pastrim-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁹ “Gjykata e Apelit konfirmon aktakuzën ndaj deputetit Milaim Zeka dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi, 11 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-konfirmon-aktakuzen-ndaj-deputetit-milaim-zeka-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁰ “Dëshmitari: Për vizë pune në Gjermani pagova mbi një mijë euro, Milaim Zeka më tha ta paraqes rastin në polici” Betimi për Drejtësi, 11 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-per-vize-pune-ne-gjermani-pagova-mbi-nje-mije-euro-milaim-zeka-me-tha-ta-paraqes-rastin-ne-polici/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶¹ “Gjykimi ndaj deputetit Milaim Zeka dhe dy të tjerëve kthehet në pikën zero” Betimi për Drejtësi, 5 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-deputetit-milaim-zeka-dhe-dy-te-tjereve-kthehet-ne-piken-zero/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

transferin e tij. Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj kishte thënë se në këtë rast është mbajtur vetëm një seancë dhe sipas tij, transferi mund të vazhdohet vetëm edhe një vit, ndërsa siç ka thënë ai kjo lëndë ka rreth 950 dëshmitarë dhe mund të zgjasë më shumë se një vit. Çoçaj kishte shtuar se bazuar në Ligjin e ri për KGJK-në, gjykatësi nuk mund të transferohet pa vullnetin e tij dhe kjo është edhe pengesë ligjore që Tahirit, t'i vazhdohet transferi.

Mirëpo, tre ditë më vonë, më 8 prill 2019 ishte mbajtur seanca tjetër e drejtuar nga gjykatësi Tahiri, në të cilën ishin dëgjuar katër të dëmtuar në cilësi të dëshmitarëve. Kjo pasi gjykatësi Tahiri kishte njoftuar se ai vendimin e KGJK-së për ndërprerje të transferit nuk e kishte pranuar akoma.⁶²

Pasi gjykatësi Tahiri, ishte transferuar sërish në Gjykatën Themelore në Ferizaj, kjo lëndë tanimë gjykohet nga Vesel Ismajli që ka cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, ndërkaq anëtare të trupit gjykues janë gjykatësja Nushe Kuka – Mekaj dhe Naime Krasniqi – Jashanica.

Seanca e paraparë të mbahej më 10 korrik 2019, kishte dështuar të mbahet si pasojë e mungesës së anëtares së trupit gjykues, gjykatëses Kuka- Mekaj.⁶³ Ndërkaq, edhe më 9 shtator 2019, kishte dështuar të mbahet ky gjykim për shkak se i akuzuari Ilir Krasniqi kishte thënë se ka probleme shëndetësore. Ai kishte thënë se dokumentet mjekësore nuk i ka me vete, por që ato do t'i dorëzojë gjykatës në seancën e radhës. Prokurori Atdhe Dema, nuk e kishte kundërshtuar kërkesën e të akuzuarit që kjo seancë të shtyhet për arsyt që Krasniqi i ka dhënë.⁶⁴

Në seancën e mbajtur më 24 tetor, kishte marrë vendim, me anë të së cilit, ka ndaluar mediat që t'i drejtohen me emër të akuzuarve. Ky vendim nga ana e trupit gjykues të udhëhequr nga gjykatësi Vesel Ismajli, ka ardhur pas kërkesës së të akuzuarit Zeka, i cili kishte deklaruar se mediat po incizojnë dhe xhirojnë seancën, e që sipas tij, askund në botë një gjë e tillë nuk lejohet. Ai kishte thënë deklaruar se është turp që të akuzuarit të dalin me emër dhe mbiemër në publik dhe që fëmijët e tyre t'i shohin ata në televizor, pa u shpallur ende vendimi se a janë fajtor apo jo.

Tutje, kishte kërkuar që gjykata të kufizojë qasjen e mediave dhe të mos i përmendet emri dhe të mos xhirohet seanca gjatë tërë kohës. E më pas, trupi gjykues pas një këshillimi kishte marrë

⁶²“Gjykimi ndaj Milaim Zekës dhe të tjerëve, katër të dëmtuarit thonë të jenë mashtruar nga kompania “Ilir Krasniqi Op” Betimi për Drejtësi, 8 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-milaim-zekes-dhe-te-tjereve-kater-te-demtuarit-thone-te-jene-mashtruar-nga-kompania-ilir-krasniqi-op/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶³ “Dështon gjykimi për mashtrim, shmangie nga tatimi dhe pastrim parash ndaj deputetit Milaim Zeka dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 10 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-dhe-pastrim-parash-ndaj-deputetit-milaim-zeka-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁴ “Shtyhet gjykimi për mashtrim, shmangie nga tatimi dhe pastrim parash ndaj ish-deputetit Milaim Zeka dhe të tjerëve” . Betimi për Drejtësi”. 9 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-dhe-pastrim-parash-ndaj-ish-deputetit-milaim-zeka-dhe-te-tjereve/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

vendim që mediave t’iu ndalohej e drejta që të akuzuarve t’iu përmenden emrat, duke iu drejtuar tani të akuzuarve vetëm me iniciale. Gjykimi më pas ishte zhvilluar, ku në seancë janë dëgjuar tre dëshmitarë për këtë rast.⁶⁵ Gjithashtu, gjatë kësaj seance, gjykata kishte refuzuar kërkesën e avokatit Kujtim Kërveshi, mbrojtës i të akuzuari Edmond Kërliu, që procedura ndaj tij të veçohet.

Kjo sepse, sipas gjykatësit Ismajli, Kërliu akuzohet së bashku me Zekën, andaj gjykimi do të mbahet si është mbajtur deri më tani pa veçim.⁶⁶ IKD vlerëson se kufizimi i tillë nga ana e trupit gjykues që raportimi të bëhet vetëm me iniciale, është kufizim inekzistent dhe i pabazuar në ligj. KPPRK përcakton se për rastet e përcaktuara me këtë kod, Gjykata mund ta mbyllë për publikun një pjesë ose tërë gjykimin. Por, në asnjë rast nuk përmendet se gjykata mund ta kufizojë raportimin vetëm në iniciale. Vendime të tilla të Gjykatave, janë negacion i transparencës publike të sistemit gjyqësor, si dhe janë të pabazuara në ligj. Për më tepër, vendime të tilla janë precedente negative të cilat rrezikojnë avancimin e bërë nga sistemi gjyqësor në kuptim të hapjes për monitorimin e seancave gjyqësore.

Ndryshe, në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2019, në gjykatore dëshminë e tyre e kanë dhënë pesë dëshmitarë, të cilët kanë deklaruar se kishin dhënë nga 1050 euro për t’u pajisur me viza në agjencinë e të akuzuari Ilir Krasniqit, por një gjë e tillë sipas tyre, nuk u ishte mundur.⁶⁷ Kurse, gjykimi ndaj të akuzuarve, ka vazhduar edhe më 10 dhjetor, ku është vazhduar me dëgjimin e tre dëshmitarëve të tjerë.⁶⁸ Ndërkaq, në seancën e mbajtur më 11 dhjetor, në gjykatore janë dëgjuar tre persona në cilësi të dëmtuarve.⁶⁹

Dëmi i pretenduar: Mbi 261,850.00 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacione.

⁶⁵ “Gjykata merr vendim që ish-deputetit dhe të tjerëve të mos u përmenden emrat në gjykimin për mashtrim me viza”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-merr-vendim-qe-ish-deputetit-dhe-te-tjereve-te-mos-u-permenden-emrat-ne-gjykimin-per-mashtrim-me-viza/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁶ “Gjykimi ndaj ish-deputetit dhe të tjerëve, dëshmitarët thonë se kishin dhënë mbi njëmijë euro, por s’ishin pajisur me viza pune”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-deputetit-dhe-te-tjereve-deshmitaret-thone-se-kishin-dhene-mbi-njemije-euro-por-sishin-pajisur-me-viza-pune/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁷ “Gjykimi për mashtrim me viza ndaj ish-deputetit dhe të tjerëve, dëshmitarët thonë se dhanë nga 1050 euro dhe nuk u pajisen me viza”. Betimi për Drejtësi. 9 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-mashtrim-me-viza-ndaj-ish-deputetit-dhe-te-tjereve-deshmitaret-thone-se-dhane-nga-1050-euro-dhe-nuk-u-pajisen-me-viza/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁸ “Gjykimi ndaj ish-deputetit dhe të tjerëve, dëshmitari: “E kom shi të lopën e vëcin për m’i bo 1050 euro për vizë, e në fund s’e mora” Betimi për Drejtësi. 10 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-deputetit-dhe-te-tjereve-deshmitari-e-kom-shite-lopen-e-vicin-per-mi-bo-1050-euro-per-vize-e-ne-fund-se-mora/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁶⁹ “Gjykimi ndaj ish-deputetit dhe të tjerëve, tre dëshmitarë thonë se kishin dhënë nga 1050 euro, por vizat s’i kishin marrë”. Betimi për Drejtësi. 11 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-deputetit-dhe-te-tjereve-tre-deshmitare-thone-se-kishin-dhene-nga-1050-euro-por-vizat-si-kishin-marre/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

7. RASTI “VETERANËT”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.230/18.

Kryetare e Trupit Gjykses: Nushe Kuka-Mekaj.


Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Prokuror: Fillimisht ka qenë Afrim Shefkiu, e më pas bashkarisht Enver Krasniqi dhe Valdet Gashi.

Të pandehur: Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari.

Faza e procedurës: Në proces.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 390 DITË)



Rasti i njohur si “Veteranët”, konsiderohet si rasti më i madh që është ndjekur nga prokuroria kosovare, kjo për shkak se siç pretendohet, ish-ushtarakët e UÇK-së anëtarë të komisionit për verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së, kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare, duke shtuar në lista të veteranëve 19,500 persona, të cilët sipas prokurorisë nuk është dashur ta gëzojnë këtë status.

Sipas aktakuzës, së ngritur më 7 dhjetor 2018, 12 personat e përfshirë akuzohen se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Sipas PSRK-së, nga provat e siguruar është vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të UÇK-së, buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar në shumë prej 88,769,217.04 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ky rast, akoma pa nisur mirë është përfshirë në një trajtim jo-serioz nga PSRK-ja. Këtë aktakuzë fillimisht e kishte përgatitur prokurori Elez Blakaj, por i njëjti në gusht të vitit 2018, kishte dhënë dorëheqje.⁷⁰

Në letrën e tij të dorëheqjes, Blakaj, kishte thënë se më 11 korrik 2018, kishte nënshkruar aktakuzën sipas të cilës 19,060 persona e gëzojnë statusin e veteranit në mënyrë të kundërligjshme dhe e kishte dorëzuar këtë aktakuzë te Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Reshat Millaku, por e njëjta nuk kishte shkuar në gjykatë.⁷¹

E Millaku, në një konferencë për media, më 20 gusht 2018, kishte thënë se njëra nga arsyet e mos dërgimit të aktakuzës ishte se në dispozitivin e aktakuzës së ngritur nga prokurori special i dorëhequr, Elez Blakaj, nuk i ka shkruar emrat dhe mbiemrat e 19,060 veteranëve, të cilët konsiderohen se janë të rrejshëm, edhe pse kishte pranuar se të gjitha provat janë përfshirë, por përmes fusnotave. Ai po ashtu kishte shtuar se nuk ishte bërë propozimi që këtyre veteranëve mashtroes, t’iu ndërpriten pagesat e pensioneve që marrin.⁷² Por, PSRK-ja, aktakuzën e veteranëve, përmes prokurorit Afrim Shefkriu, e kishte dorëzuar në gjykatë, më 14 shtator 2018, ku kishte rritur numrin e veteranëve të kundërligjshëm nga 19,060 në 20,238 persona.⁷³

Në kohën kur ishte dorëzuar kjo aktakuzë në gjykatë, në media kishin dalë edhe emrat e 20,238 personave, së bashku me të dhënat e tyre personale, çka kishte pasuar një debat të madh publik, pasi shumë persona dilnin me deklaratat se kanë qenë luftëtarë gjatë gjithë kohës së luftës por ishin të përfshirë në ato lista.

⁷⁰ “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurori Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/flet-elez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-per-veteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷¹ “Prokurori i dorëhequr Elez Blakaj në korrik e ka ngritur aktakuzën e profilit të lartë për veteranët, të cilës i prin Agim Çeku dhe përfundon me Xhavit Jasharin, aktakuza “fletë” në Prokurori Speciale”. Betimi për Drejtësi. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-dorehequr-elez-blakaj-ne-korrik-e-ka-ngritur-aktakuzen-e-profilin-te-larte-per-veteranet-te-ciles-i-prin-agim-cekun-dhe-perfundon-me-xhavit-jasharin-aktakuza-flene-ne-pr/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷² “Kryeprokurori Millaku nuk e argumenton mos dërgimin e aktakuzës në Gjykatë, thotë se është e mangët në dispozitiv edhe pse pranon se të gjitha provat janë përfshirë në aktakuzë, por përmes fusnotave (Video)”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-millaku-nuk-e-argumenton-mos-dergimin-e-aktakuzes-ne-gjykatë-thote-se-eshte-e-mangët-ne-dispozitiv-edhe-pse-pranon-se-te-gjitha-provat-jane-perfshire-ne-aktakuze-por-permes-fusnotave/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷³ “Dorëzohet në gjykatë aktakuza e prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj, për rastin e njohur si “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 14 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dorezohet-ne-gjykatë-aktakuza-e-prokurorit-te-dorehequr-elez-blakaj-per-rastin-e-njohur-si-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Edhe pse të akuzuarit, ishin në pritje të thirrjes së seancës fillestare, gjyqtarja Nushe Kuka-Mekaj, këtë aktakuzë e kishte kthyer në PSRK, për përmirësime dhe qartësime, pasi sipas saj, aktakuza nuk ishte përpiluar konform dispozitave të KPPK-së dhe se përshkrimi i gjendjes faktike të dispozitivit të aktakuzës ishte i paqartë. Gjyqtarja Kuka-Mekaj, i kishte dhënë PSRK-së 30 ditë afat për të bërë përmirësimet e kërkuara.⁷⁴

Edhe pse Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në deklaratimet e tij para mediave kishte thënë se aktakuza do të dorëzohet në gjykatë brenda afatit të përcaktuar nga gjykata,⁷⁵ një gjë e tillë nuk ndodhi, pasi PSRK-ja kërkoi nga GjTh në Prishtinë, zgjatjen e këtij afati edhe për 30 ditë të tjera, në mënyrë që të bëhen përmirësimet e kërkuara, propozim të cilin më 9 nëntor 2018, e aprovoi gjyqtarja Kuka-Mekaj.⁷⁶

Më 7 dhjetor 2018, PSRK-ja, përfundimisht këtë aktakuzë e kishte dorëzuar në gjykatë.⁷⁷

Seanca e shqyrtimit fillestar ishte caktuar të mbahet më 28 janar 2019, apo pas mbi 21 ditëve pas afatit ligjor të përcaktuar me KPPK, mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së Ministrit të Mbrojtjes Rustem Berisha, si dhe e dy të akuzuarve të tjerë, Faik Fazliu dhe Smajl Elezaj. Në këtë seancë, përveç prokurorit special Enver Krasniqi, i cili ishte caktuar për ta përfaqësuar këtë aktakuzë, i pranishëm në seancë ka qenë edhe prokurori tjetër special Valdet Gashi. Kjo seancë është shtyrë për 14 mars 2019.⁷⁸

Edhe në seancën e radhës nuk u paraqitën dy nga 12 të akuzuarit, Xhavit Jashari dhe Ahmet Daku për arsye të ndryshme nuk ishin në sallën e gjykimit dhe për këtë shkak, gjykatësja Nushe Kuka-Mekaj, i kishte pyetur palët nëse është e nevojshme të veçohet procedura, mirëpo për këtë propozim nuk ishte pajtuar as prokurori Krasniqi, i cili i kishte propozuar gjykatës që ndaj tyre të lëshohet urdhër arrest, e as mbrojtja e të akuzuarve të tjerë. Por pavarësisht se palët nuk kërkuan një gjë të tillë, ajo sipas detyrës zyrtare dhe duke marrë parasysh efikasitetin e procedurës vendosi që ndaj Jasharit dhe Dakut, të veçohet procedura.

⁷⁴ “Aktakuza e veteranëve i kthehet Prokurorisë Speciale për përmirësim dhe qartësim”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuza-e-veteraneve-i-kthehet-prokurorisë-speciale-për-përmirësim-dhe-qartësim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷⁵ “Kryeprokurori Lumezi thotë se brenda pak ditësh aktakuza e veteranëve do të ridërgohet në gjykatë”. Betimi për Drejtësi. 22 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-thote-se-brenda-pak-ditesh-aktakuza-e-veteraneve-do-te-ridergohet-ne-gjykate/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷⁶ “Gjykata i jep edhe 30 ditë afat Prokurorisë Speciale që të plotësojë aktakuzën në rastin “Veteranët””. Betimi për Drejtësi. 9 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-i-jep-edhe-30-dite-afat-prokurorisë-speciale-qe-te-plotesoje-aktakuzen-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷⁷ “Prokuroria Speciale e dorëzon në Gjykatë aktakuzën e plotësuar në rastin e “Veteranëve””. Betimi për Drejtësi. 7 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-e-dorezon-ne-gjykate-aktakuzen-e-plotesuare-ne-rastin-e-veteraneve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁷⁸ “Rasti “Veteranët”, mungesa e ministrit Rustem Berisha dhe dy të tjerëve shtyn seancën fillestare”. Betimi për Drejtësi. 28 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-mungesa-e-ministrit-rustem-berisha-dhe-dy-te-tjereve-shtyn-seancen-fillestare/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Pasi u plotësuan kushtet ligjore për mbajtjen e asaj seance, asnjëri nga të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë për veprën për të cilën ishin akuzuar⁷⁹, ndërsa mbrojtjes iu caktua data 15 prill 2019, si afat brenda së cilës mund të kërkohej hedhja e aktakuzës.

Në seancën fillestare, PSRK-ja paraqiti edhe kërkesën për ndaljen e përkohshme të pensioneve ndaj 19,500 veteranëve përfitues, të cilët konsiderohen si “të rrejshëm”, por kjo kërkesë më 26 mars 2019, u refuzua nga gjykatësja Kuka-Mekaj.⁸⁰

Në një pjesë të arsyetimit të këtij aktvendimi, ndër të tjerash thuhet se propozimi për masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së, si palë e tretë.

“Në rastin konkret, kur kemi parasysh se kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, të kërkesëpadisë, e cila është e karakterit urdhërues dhe qëllimi i saj është që të ruhet një gjendje ekzistuese, përkatësisht të mos dëmtohet edhe më tepër buxheti shtetëror i Republikës së Kosovës, nuk është drejtuar ndaj të pandehurve por ndaj Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Sociale, e cila e ka cilësinë e personit të tretë, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës së propozuar”, thuhet në aktvendimin të cilin e ka marr kryetarja e trupit gjykues, gjykatësja Nushe Kuka-Mekaj, që mban datën 26 mars 2019.

Ndërsa për dy të akuzuarit, për të cilët ishte veçuar procedura Xhavit Jashari dhe Ahmet Daku, gjykatësja Kuka-Mekaj, kishte caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më 1 prill 2019, në të cilin dy të akuzuarit kishin deklaruar se nuk e pranojnë fajësisë për akuzat që ngarkojnë mbi ta.⁸¹

Në qershor 2019, GjTh në Prishtinë përmes një komunikate për media kishte njoftuar konfirmimin e kësaj aktakuze. Pas konfirmimit të kësaj aktakuze nga shkalla e parë, edhe Gjykata e Apelit e kishte konfirmuar këtë aktakuzë duke lënë në fuqi aktvendimin e 19 qershorit 2019, të GjTh në Prishtinë.

⁷⁹ “Rasti “Veteranët”, Agim Çeku, Rrustem Berisha, Shkumbin Demalijaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm (Video)” Betimi për Drejtësi. 14mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-ceku-rrustem-berisha-shkumbin-demalijaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸⁰ “Gjykata refuzon kërkesën e Prokurorisë Speciale për pezullimin e pensioneve për 19.500 veteranë” Betimi për Drejtësi. 14mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-refuzon-kerkesen-e-prokurorise-speciale-per-pezuullimin-e-pensioneve-per-19-500-veterane/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸¹ “Rasti “Veteranët”, Ahmet Daku e Xhavit Jashari deklarohen të pafajshëm” Betimi për Drejtësi. 1 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-ahmet-daku-e-xhavit-jashari-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

“Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar dhe në mënyrë të drejtë ka dhënë arsye të mjaftueshme, se kundërshtimet janë të pabazuara dhe se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka prova të mjaftueshme, të pranueshme në aspektin procedural, për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, ndërsa tani nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të cilat mund të hedhet aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 250 par. 1 nën par. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Kodit të Procedurës Penale“, thuhet në komunikatën për media të Apelit.⁸²

Pas konfirmimit të aktakuzës, më 4 dhjetor 2019 ka filluar shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti, gjatë kësaj seance janë dhënë fjalët hyrëse. Kurse, më 5 dhe 6 dhjetor është filluar me dëgjimin e dëshmitarëve. Por, kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka-Mekaj, ka marrë vendim me të cilin ka ndaluar që të publikohen në media dëshmitë e dëshmitarëve e po ashtu që emrat e tyre të jepen vetëm me initiale derisa të përfundohet procedura e provave, duke lënë kështu publikun të painformuar për dëshmitë e dëshmitarëve të këtij procesi gjyqësorë.

Kuka-Mekaj, këtë vendim e ka arsyetuar mbi bazën se me publikimin e dëshmive të dëshmitarëve dëmtohet procesi gjyqësorë, pasi sipas saj humb rëndësia që të largohen dëshmitarët nga salla e gjykimit, derisa të merret në pyetje një dëshmitar tjetër. Mirëpo një formë e tillë e vendimit është aplikuar për herë të parë, pasi e njëjta situatë ndodh edhe në raste të tjera, por më parë nuk ka pasur vendime të ngjashme.^{83 84}

Edhe në seancën e mbajtur më 23 dhjetor, në gjykatore ka dhënë dëshminë e tij njëri nga dëshmitarët në këtë rast.⁸⁵ Gjatë kësaj seance, gjykata ka lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim për ish-kryetarin e Skenderajt, S.L, i cili mungoi në gjykim. Kryetarja e trupit gjykues, Nushe Kuka – Mekaj, kishte thënë se kishte prova se dëshmitari S.L, e kishte pranuar ftesën e gjykatës për të dëshmuar në këtë seancë, mirëpo i njëjti nuk e kishte arsyetuar mungesën e tij. Dëshmitari S.L, nuk i ishte përgjigjur ftesës së gjykatës as për seancat e 4, 5 dhe 6 dhjetorit, ndaj të cilit gjykata kishte lëshuar edhe më herët urdhëresë për sjellje me detyrim. Në seancën e së

⁸² “Rasti “Veteranët”, Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Agim Çekut, Rrustem Berishës e të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-konfirmon-aktakuzenndaj-agim-cekut-rrustem-berishes-e-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸³ “Rasti “Veteranët”, gjykata kundërligjshëm vendos që mediave t’u ndalohet publikimi i dëshmive të dëshmitarëve” Betimi për Drejtësi” 5 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-gjykata-kunderligjshem-vendos-qe-mediave-tu-ndalohet-publikimi-i-deshmive-te-deshmitareve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸⁴ “Dëgjohen edhe dy dëshmitarë në rastin “Veteranët”, por deklaratat e tyre sipas vendimit të gjykatës s’mund të bëhen publike” Betimi për Drejtësi” 6 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/degjohen-edhe-dy-deshmitare-ne-rastin-veteranet-por-deklaratat-e-tyre-sipas-vendimit-te-gjykates-smund-te-behen-publike/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸⁵ “Rasti “Veteranët”, nis seanca ndaj Agim Çekut, Rrustem Berishës dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 23 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-nis-seanca-ndaj-agim-cekut-rrustem-berishes-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

hënës ka munguar edhe dëshmitari S.B, ku sipas gjykatës Kuka-Mekaj atij i ishte dërguar ftesa përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, por sipas kërkesës së tij, ai do të sillej përmes policisë në seancën e 24 dhjetorit.⁸⁶ Gjatë seancës së mbajtur me 26 dhjetor, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar ish-kryetari i Komunës së Skenderaj, S.L dhe S.B.⁸⁷

Dëmi i pretenduar: 88,769,217.04 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

⁸⁶ “Lëshohet urdhër për sjellje me detyrim ndaj ish-kryetarit të Skenderajt, që është dëshmitar në rastin e “Veteranëve”. Betimi për Drejtësi. 23 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/leshohet-urdher-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-ish-kryetarit-te-skenderajt-qe-eshte-deshmitar-ne-rastin-e-veteraneve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸⁷ “Ish-kryetari i Skenderajt dëshmitar në gjykimin e rastit “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-skenderajt-deshmitar-ne-gjykimin-e-rastit-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

8. RASTI “QAFA”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.16/19

Kryetar i Trupit Gjykses: Arben Hoti


Prokuror: Atdhe Dema

Vepra penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “Shpërlarja e parasë”

Të pandehur: Bunjamir Jaha, Shpejtim Hamiti, Flamur Hamiti, Pajtim Hamiti, Bashkim Braha, Shkëlqim Ilazi, Arburim Ahmeti, Shkumbin Berisha, Ardonit Mustafa

Faza e procedurës: Në proces

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 215 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja, më 31 maj 2019, të akuzuarit Bunjamir Jaha, Shpejtim Hamiti, Flamur dhe Pajtim Hamiti, si dhe Bashkim Braha dhe Shkëlqim Ilazi nga 16 maji e deri me 7 tetor 2018, në Ferizaj, Kaçanik dhe fshatrat të këtyre komunave kishin transportuar dhe shitur substanca narkotike të llojit kokainë dhe kanabis.

Këta të akuzuar, sipas PSRK-së, sipas marrëveshjes paraprake duke i ndarë rolet ishin furnizuar nga Republika e Shqipërisë, pasi i akuzuari Bunjamir Jaha ishte ndaluar për kontroll në “Vërmicë”, dhe i është gjetur në automjetin e tij “Audi A4”, kokainë në sasi 549,44+0.0001 gram.

Ndërsa, në banesën në Ferizaj, të cilën të akuzuarit e kishin marrë me qira nga i akuzuari Shpejtim Hamiti, në të cilën e kishin shfrytëzuar për të ushtruar veprimtari kriminale, policia kishin sekuestruar kokainë në sasi prej 2+0.0001 gramë, si dhe substanca-preparati kanabis

(marihuanë), në sasi 5.54+0.0001 gramë si dhe peshore dhe aksesore tjerë të cilat iu kishin shërbyer për matjen, renditjen ndarjen dhe sistemimin e këtyre narkotikëve.

Për këto veprime, PSRK të akuzuarit po i ngarkon se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

I akuzuari Bashkim Braha, po akuzohet se nga data e pacaktuar e deri me 7 tetor 2018, në shtëpinë e tij në fshatin “Stogovë” në Komunën e Kaçanikut, në mënyrë të paautorizuar kishte mbajtur në posedim armën “Zastava M-57”, e kalibrit 7.62 mm. Me një karikatorë dhe 9 fishekë të kalibrit 7.62, një revole e kalibrit 6.32 mm me një karikatorë dhe 4 fishekë, 41 fishekë të kalibrit 7x64mm si dhe 6 fishekë të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12mm.

PSRK të akuzuarin Braha po e ngarkon me veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

I akuzuari Arburim Ahmeti po akuzohet se me 29 shtator 2018, në shtëpinë e tij në fshatin “Greme”, në Ferizaj, kishte pranuar nga i akuzuari Shpejtim Hamiti narkotikë në peshë 7.6 gram, të cilën e kishte vendosur në figurat e shahut, me qëllim që së bashku me tabelën e shahut ta dërgojë në qendrën korrektuese në Dubravë, tek Meriton Aliu i cili kishte qenë në vuajtje të dënimit.

Në aktakuzë thuhet se kjo sasi e fshehur në figura së bashku me tabelën e shahut, ishin sekuestruar në banesën e të akuzuarit Shpejtim Hamiti, ku pas ekzaminimit kishte rezultuar 5.54+0.0001 gramë substancë/preparat narkotik kanabis (marihuanë).

Edhe të akuzuarin Arburim Ahmeti, PSRK po e ngarkon me veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Sipas PSRK-së, i akuzuari Shpejtim Hamiti nga 18 tetor 2016, e deri me 29 qershor 2018, kishte bartur te xhirollogaria e të akuzuarit Ardonit Mustafa, 36,875.00 euro, për të cilat të ardhura nuk kishte prova se ishin nga një aktivitet i rregullt ekonomik.

Ai në marrëveshje me të akuzuarin Shkumbin Berisha kishte bartur të xhirollogaria e tij në Bankën Ekonomike 7,000 euro, për të cilat nuk kishte pasur prova të fitimit në mënyrë ligjore, pasuri e fituar nëpërmjet veprimtarisë së kundërligjshme të trafikimit me narkotikë dhe shndërrimin e një pjese të të ardhurave në automjete.

Kështu, sipas PSRK-së i akuzuari Shpejtim Hamiti përmes të akuzuarve të tjerë kishte përdorur të ardhurat nga aktivitete e dyshuara, ku nga veprimtaria e trafikimit të narkotikëve kishte përfituar 75.500 euro, si dhe kishte përfituar edhe dy BMË, ku njëra veturë ishte qenë e regjistruar në emër të të akuzuarit Shkumbin Berisha.

Sipas PSRK-së, i akuzuari Shkumbin Berisha kishte pranuar 7.000 euro nga i akuzuari Shpejtim Hamiti, para të cilat dyshohen se ishin fituar nga veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotikë të të akuzuarit Shpejtim Hamiti, automjetin BMË me vit prodhimi 2008 e kishte doganuar dhe regjistruar në emër të tij.

Shumën prej 36,875.00 euro nga i akuzuari Shpejtim Hamiti, sipas PSRK-së, e kishte pranuar edhe i akuzuari Ardonit Mustafa.

I akuzuari Bashkim Braha sipas aktakuzës, nga 12 shtatori 2016, kishte në pronësi automjetin “IMT 539”, me vit të prodhimit 2009, si dhe nga 12 shtatori 2017 kishte në përdorim automjetin “Audi A4”, vit i prodhimit 2008, e regjistruar në emër të motrës së tij, ku sipas prokurorisë kishte prova se të njëjtat ishin blerë nga veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotikë.

PSRK, të akuzuarit Shpejtim Hamiti, Shkumbin Berisha, Ardonit Mustafa dhe Bashkim Braha po i ngarkon me veprën penale “shpëlarje e parasë”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar më 8 tetor 2018 nga ana e Policisë së Kosovës. Kurse, aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e prokurorisë ishte iniciuar më 16 maj të po të njëjtit vit. Nga ana e prokurorit special Atdhe Dema aktakuza ishte përpiluar më 30 maj të vitit 2019, ndërkaq ishte ngritur në gjykatë një ditë më vonë. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 6 nëntor 2019 pranë Departamentit Special. Gjatë kësaj seance, zyrtari policor, Bunjamir Jaha, e kishte pranuar fajësinë se kishte poseduar dhe shpërndarë substanca narkotike nga Shqipëria për në Kosovë, ndërkaq gjykatësi i rastit, Arben Hoti, e kishte aprovuar këtë pranim të fajësisë.

Edhe i akuzuari Shpejtim Hamiti, kishte thënë se pranon fajësinë për pikën një të aktakuzës që e ngarkon atë me posedim dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve, ndërsa kishte thënë se për pikën katër të aktakuzës ku akuzohet për shpëlarje të parasë nuk e pranon fajësinë. Lidhur me pranimin e fajësisë për pikën e parë të aktakuzës, gjykata kishte marrë aktvendim me të cilin aprovoi këtë pranim të fajësisë. Fajtor për veprën penale të blerjes, posedimit dhe shitjes së narkotikëve dhe substancave tjera analoge, ishte deklaruar edhe i akuzuari Pajtim Hamiti, i cili kishte thënë se është i penduar dhe se nuk do të përsërisë më veprën penale për të cilën akuzohet. Pjesërisht fajësinë e kishte pranuar edhe i akuzuari tjetër Bashkim Braha, i cili kishte thënë se e pranon fajësinë për armëmbajtje pa leje dhe për shitje dhe posedim të paautorizuar të narkotikëve, mirëpo jo edhe për veprën penale “shpëlarje të parasë”.

Kurse, të akuzuarit Flamur Hamiti, Shkelqim Ilazi, Arburim Ahmeti, Shkumbin Berisha dhe Ardonit Mustafa nuk kishin pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohen.

Në fund, pasi që dy të akuzuarit Jaha dhe Hamiti, kishin pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkoheshin, gjykata kishte marrë vendim që të veçojë procedurën, e që aktgjykimi ndaj tyre të shpallet më 11 nëntor 2019, pasi që gjykata të shikojë edhe të kaluarën kriminale të këtyre të akuzuarve.

Ndërsa, për të akuzuarit që pranuan fajësinë pjesërisht dhe ata që nuk pranuan fajësinë, gjykimi ishte vendosur që të vazhdojë më 6 dhjetor 2019.

Gjykata, po ashtu kishte refuzuar kërkesat e pesë mbrojtësve të të akuzuarve të parë që të njëjtëve t’iu ndryshohet masa e paraburgimit.⁸⁸

Më 11 nëntor 2019, kjo gjykatë e kishte shpallur aktgjykimin, ku kishte dënua me tre vjet burg, zyrtarin policor, Bunjamir Jaha. Ndërsa, të akuzuarin tjetër Pajtim Hamiti, për të njëjtën vepër penale e kishte dënua me tre vjet e gjashtë muaj burgim.

Me rastin e shpalljes së këtij aktgjykimi, gjykatësi Hoti kishte thënë se dy të akuzuarve Jaha dhe Hamiti, do t’u llogaritet edhe koha e mbajtur në paraburgim, e cila masë u është ndërprerë sipas këtij aktgjykimi.

Gjykatësi Hoti, kishte deklaruar se të akuzuarve do t’u konfiskohet narkotiku, si dhe i ka obliguar ata që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën nga 200 euro, secili veç e veç.⁸⁹

Më 6 dhjetor, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë për të akuzuarit e tjerë, të cilët kishin kërkuar hudhjen e aktakuzës, kurse prokurori Dema kishte kërkuar vërtetimin e aktit akuzues.

Në këtë seancë, gjykatësi Arben Hoti, kishte aprovuar kërkesën për zëvendësimin e masës së paraburgimit, me atë të arrestit shtëpiak ndaj të akuzuarve Shpejtim Hamiti dhe Bashkim Braha, ndërsa kishte refuzuar që kjo masë t’i zëvendësohet të akuzuarit Flamur Hamiti.⁹⁰

Dëmi i pretenduar: 14,111.875 euro si dhe vetura që sipas prokurorisë janë përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

⁸⁸ “Polici pranon se kishte transportuar drogë nga Shqipëria në Kosovë, për të akuzuarit e tjerë vazhdon gjykimi”. Betimi për Drejtësi. 6 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/polici-pranon-se-kishte-transportuar-droge-nga-shqiperia-ne-kosove-per-te-akuzuarit-e-tjere-vazhdon-gjykimi/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁸⁹ “ Tre vjet burg për policin që pranoi se kishte transportuar drogë nga Shqipëria në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 11 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-vjet-burg-per-policin-qe-pranoi-se-kishte-transportuar-droge-nga-shqiperia-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁹⁰ “Të akuzuarit për shpëlarje parash, narkotikë dhe armëmbajtje pa leje kërkojnë hudhjen e aktakuzës, prokuroria kërkon vërtetimin e saj”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-shpelarje-parash-narkotike-dhe-armembahtje-pa-leje-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-prokuroria-kerkon-vertetimin-e-saj/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Prokuroria ka propozuar të konfiskohen kokainë në peshë të përgjithshme prej 551.33 gram + 0.0001 gram dhe kanabis (marihuanë) me peshë neto 5.54 gram + 0.0001, dy vetura “Audi” dhe dy vetura “BMË”, 75.000 euro, 13 telefona, para në monedha të letrës e të metalta në vlerë prej 3110 euro, dy peshore digjitale, revole e fishekë, para në monedha të letrës dhe të metalta në vlerë prej 836.05 euro dhe para të Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 170 denarë, si dhe një antiplumb.

9. RASTI “URA GURIT 1”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.39/2019

Kryetar i Trupit Gjykses: Valon Kurtaj


Prokuror: Blerim Isufaj

Vepra penale: “Krim i organizuar”, “ Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “Shmangia nga tatimi”

Të pandehur: Xhevahir Suma, Adam Nezaj, Gëzim Krasniqi, Jasir, Fuat dhe Furkan Bardi, Hajrullah Bushi e Daut Suma dhe dy të akuzuarit tjerë për shmangie nga tatimi, Burim Sejdiu dhe Qershon Islami

Faza e procedurës: Në proces

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 96 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur më 27 shtator 2019, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), nga 3 tetori 2018 e deri më 9 shkurt 2019, duke vepruar si grup i organizuar kriminal, i udhëhequr nga i akuzuari Xhevahir Suma, me qëllim të kryerjes së veprave penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge”, me role të ndara si anëtarë të grupit kriminal: i akuzuari Burim Sejdiu me detyrë që narkotikun e sjellë nga Republika e Shqipërisë ta sistemojë, dhe mbajë në shtëpinë e tij si dhe në mobilierinë “Niti”, në të cilën kishte për detyrë sistemimin e narkotikëve edhe Gëzim Krasniqi, i akuzuari Adam Nezaj, me detyrë që narkotikun ta sjell nga Shqipëria në Kosovë tek i akuzuari Sejdiu, i akuzuari Zylbehar Kalisi me detyrë që narkotikun ta sistemojë në shtëpinë e tij dhe të bashkudhëtojë me automjet që transporton narkotikët, ndërsa të akuzuarit Jasir, Fuat dhe Furkan Bardi, Daut Suma dhe Hajrullah Bushi si vozitës të automjeteve që transportonin narkotikët nga Republika e Kosovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, apo vëzhgohej rruga gjatë transportit me qëllim të shmangies së patrullave policore të këtyre dy vendeve.

Në aktakuzë thuhet se të akuzuarit të paktën katër herë transportuan apo tentuan të transportojnë sasi të madhe të narkotikut të llojit marihuanë në Republikën e Maqedonisë Veriore, ashtu që më 3 tetor 2018, tentuan të transportojnë 108 kg, duke kaluar ilegalisht kufirin dhe pasi u diktuan nga policia kufitare e RKS-së e hodhën nga automjeti narkotikun dhe pastaj hynë në territorin e Maqedonisë. Gjithnjë sipas aktakuzës, më 17 janar 2019, i akuzuari Nezaj ka transportuar marihuanë në sasi prej 75 kg nga Shqipëria për në shtëpinë e Sejdiut, ndërsa më 31 janar për në të njëjtin vend ka transportuar sasinë prej 150kg marihuanë.

Siç thuhet në aktakuzë më 19 janar 2019 dhe 8 shkurt 2019, të akuzuarit kishin transportuar gjithsej 250 kg marihuanë nga Kosova në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes vendkalimit kufitar në Han të Elezit dhe ua shitën personave të panjohur.

Sipas aktakuzës, më 8 shkurt 2019, pasi në shtëpinë e të akuzuarit Burim Sejdiu, në fshatin Papaz, ngarkuan 253 paketime marihuanë në peshë të përgjithshme prej 241,33 kg, me qëllim të dërgimit për shitje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por pasi u njoftuan nga i akuzuari Xhevahir Suma për patrullën e policisë në rrugë, e me kërkesë të akuzuarit Suma, të akuzuarit Jasir dhe Zilbehar, parkuan automjetin “Vë Sharan”, të ngarkuar me narkotik në parkingun e restorantit “Liburna” në Kaçanik për të vëzhguar kohë pas kohe anëtarët e grupit kriminal dhe marrë nga aty të nesërmen më 9 shkurt 2019, sasinë prej 223 paketimeve në peshë prej 209,202 kg duke e dërguar së pari në shtëpinë e të akuzuarit Sejdiu, në fshatin Papaz e prej aty në mobilierinë “Niti”, ku e fshehën në dy shtretër ku gjatë bastisjes u gjeten dhe sekuestruan nga ana e policisë ndërsa 30 paketimet me peshë të përgjithshme prej 21,131 kg, i fshehën në katër thasë që po ashtu u gjeten më 13 shkurt 2019, dhe u sekuestruan nga policia.

Me çka, në bashkëveprim Xhevahir Suma akuzohet se ka kryer veprën penale “Krim i organizuar”, nga neni 283 par 2 lidhur me par. 1 me nenin 281 par. 1, nën par 1.9 të nenit 273 par. 2 i KPK-së.

Ndërsa, të akuzuarit Burim Sejdiu, Adam Nezaj, Gëzim Krasniqi, Jasir Bardi, Fuad Bardi, Furkan Bardi, Daut Suma dhe Hajrullah Bushi, akuzohen se kanë kryer veprën penale “Krim i Organizuar” nga neni 283 paragrafi 1, lidhur me nenin 281 nënparagrafi, 1.9 lidhur me veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 dhe 1 të KPK-së.

Në dispozitivin e dytë të aktakuzës Burim Sejdiu, akuzohet për veprën penale “Shmangia nga tatimi”, nga neni 307 par. 1 të KPK-së, i cili me qëllim që ti shmangët pagesës së tatimeve apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, me paraqitjen e të dhënave të pa vërteta duke zhvilluar aktivitetin e tij biznesor në cilësinë e personit të autorizuar të biznesit “Burimi Trade” sh.p.k. në periudhën kohore 2014-2018, duke mos i përmbushur në tersi detyrimet ligjore për dokumentit e shitjeve siç kërkohet me legjislacionin tatimor nga rrjedh se ka bërë shmangie nga tatimi duke e dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës në shumën totale prej 5.945,30 euro.

Në dispozitivin e tretë të aktakuzës Qershon Islami akuzohet për veprën penale “shmangie nga tatimi”, nga neni 307 paragrafi 1 i KPK-së, i cili me qëllim që t’i shmanget pagesës së tatimeve apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, ku sipas aktakuzës, me paraqitjen e të dhënave të pavërteta, duke zhvilluar aktivitetin e tij biznesor në cilësinë e pronarit të “IQ Global” sh.p.k, në periudhën kohore 2014-2018, duke mos e përmbushur në tersi detyrimin ligjor ashtu që gjatë aktivitetit të tij është vërtetuar se të hyrat e deklaruarat i ka pasur më të vogla se transaksionet bankare të realizuara nga rrjedh se ka bërë shmangie nga tatimi duke e dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës, në shumën totale prej 4,783.01 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 3 tetor të vitit 2018, Policia e Kosovës ka iniciuar kallëzimin penal në këtë rast, përderisa aktvendimi për fillim të hetimeve është marrë me 1 nëntor të po të njëjtit vit. Aktakuza është ngritur nga e prokurorit special, Blerim Isufaj, me 27 shtator 2019.

Seanca fillestare në këtë rast është mbajtur me 17 tetor 2019, pranë Departamentit Special, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm.

Gjatë kësaj seance, mbrojtësi i të akuzuarit Xhevahir Suma, avokati Ymer Huruglica, i kishte propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij, paraburgimi t’i zëvendësohet me arrest shtëpiak.

Një propozim i tillë kishte marrë përkrahjen edhe të mbrojtësve të tjerë, të cilët i kishin propozuar gjykatës që të akuzuarve të tjerë t’u zëvendësohet paraburgimi me arrest shtëpiak, ose edhe caktimin e dorëzansë për disa nga të akuzuarit.

Ndërsa, prokurori Isufaj kishte kërkuar nga gjykata që të refuzohen propozimet e mbrojtësve për ndryshimin e masës së paraburgimit, me arsyetimin se ende ekzistojnë arsyet mbi të cilat është caktuar dhe vazhduar kjo masë.

“Sa i përket propozimit për masën e paraburgimit, PSRK-ja konsideron se ende ekzistojnë arsyet për të cilat është caktuar dhe vazhduar kjo masë, pasi që pesha e kësaj vepre penale është e rëndë, pasi që ata akuzohen për veprën penale krim i organizuar, përjashtimisht Qershon Islami, pastaj kemi faktin që të akuzuarit janë shtetas të shteteve të ndryshme”, kishte thënë prokurori.

Lidhur me këtë, gjykatësi Kurtaj, kishte marrë vendim që të refuzohen kërkesat për zëvendësimin e masës së paraburgimit ndaj të akuzuarve, duke lënë në fuqi këtë masë. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit Islami, avokati Berat Tmava i kishte propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të bëhet veçimi i procedurës dhe kjo çështje të kalojë në departamentin përkatës.

“Në këtë fazë të procedurës kërkoj nga ana e juaj, që sa i përket të mbrojturit tim Qershon Islami të veçohet procedura penale dhe kjo çështje të kalojë në departamentin përkatës sepse në rastin konkret kryerja e veprave penale që dyshohen 9 të akuzuarit e tjerë, nuk përputhet me kohë vend e po ashtu as me provat që gjenden në dosjet e lëndës dhe nuk ndërlidhen me njëra tjetrën. I

mbrojturi im dyshohet vetëm për veprën penale shmangie nga tatimi dhe për këtë vepër penale parashihet dënimi me gjobë apo burgim deri në 4 vjet”, kishte thënë avokati Tmava.

Sa i përket propozimit të avokatit Tmava, gjykatësi Kurtaj kishte thënë se do të merr vendim të veçantë, pas analizës që do t’i bëj shkresave të lëndës, ndërlidhjes së tyre mes vete, e parimit të ekonomizimit. Gjykatësi Kurtaj, pas deklarimit të të akuzuarve, i kishte njoftuar palët se brenda 30 ditësh ata mund të bëjnë kundërshtimin e provave dhe të paraqesin kërkesë për hedhje të kësaj aktakuze.⁹¹

Dëmi i pretenduar: 10.728,31

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

⁹¹“ Deklarohen të pafajshëm 10 të akuzuarit për krim të organizuar e shmangie nga tatimi”. Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-10-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-e-shmangie-nga-tatimi/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

10. RASTI “URA GURIT 2”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.45/19

Kryetar i Trupit Gjykses: Albina Shabani-Rama


Prokuror: Blerim Isufaj

Vepra penale: “ Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “ Mbjajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”

Të pandehur: Adam Nezaj, Islam Basha, Lavdërim Osmani, Vegim Esati

Faza e procedurës: Në proces

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 47 DITË)



Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, më 15 nëntor 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Adam Nezaj, Islam Basha, Lavdërim Osmani dhe Vegim Esati për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Sipas PSRK-së, të akuzuarit Adam Nezaj, Islam Basha dhe Lavdërim Osmani me qëllim që vetes t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, e duke vepruar në grup, më 23 qershor 2019, një natë para arrestimit janë takuar në Tiranë, ku janë dakorduar dhe kanë ndarë rolet, ku i akuzuari Nezaj kishte përgjegjësinë që drogën ta sjell nga Shqipëria në Kosovë, për ta sistemuar në pronën e të akuzuarit Mustafë Esati, pastaj të akuzuarit Islam Basha dhe Lavdërim Osmani që ta përgatisin terrenin, kanë shkuar në shtëpinë e të akuzuarit Mustafë Esati për të monitoruar vendin ku duhej dërguar narkotike, i pandehuri Vegim Esati, me detyrë për të vëzhguar lëvizjet eventuale të policisë.

Siç thuhet në aktakuzë, i akuzuari Adam Nezaj, më 24 qershor 2019, me veturën e tij “Citroen” ka hyrë në Kosovë dhe ka shkuar tek qendra tregtare “Viva Vresh” në Veternik, ku takohet me të

akuzuarin Lavdërim Osmani, të cilin aty e kishte dërguar i akuzuari Mustafë Esati, ku me veturën “Citroen”, kanë vazhduar për në shtëpinë e të akuzuarit Mustafë Esati, që gjendej në Lipjan, dhe me të arritur tek udhëkryqi i Lipjanit, takohen me të akuzuarit Islam Basha dhe Vegim Esati, me ç’rast futet me veturën e tij në brendësi të oborrit të shtëpisë së Mustafë Esatit, ku ishte e parkuar vetura “Pikap”, dhe nga vetura e Adam Nezajt zbrazin narkotikun për ta vendosur në veturën “Pikap”.

Gjithnjë sipas akuzës, vetura “Citroen” del nga aty dhe niset në drejtim të Lipjanit, kurse i pandehuri Mustafë Esati, me veturën e tij, shkon në një supermarket, i cili gjendej afër shtëpisë, ku blenë qese të plastikës dhe niset në drejtim të depos së tij, e ndalon veturën në hyrje të oborrit, derisa në këtë moment policia ka hyrë në këtë depo për të realizuar kontrollin dhe me të vërejtur policinë, i akuzuari Vegim Esati bërtet duke thënë “ikni, policia” dhe me rastin e kontrollit ka gjetur dhe sekuestruar 55 kg e 432 gramë substancë narkotike të llojit marihuanë.

Tutje, në aktakuzë thuhet se njëkohësisht në vendin e ngjarjes janë arrestuar të pandehurit Islam Basha, i cili në atë moment ka qenë në katin e dytë të shtëpisë hipur në dritaren e një dhome me qëllim të ikjes, Vegim Esati, Lavdërim Osmani, ndërsa pak më vonë në territorin e komunës së Gjakovës, është arrestuar edhe i akuzuari Adam Nezaj, kurse i akuzuari Mustafë Esati, ka arrit që të arratiset.

Me këto veprime, prokuroria i ngarkon të akuzuarit se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267 par.1 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu, sipas kësaj aktakuze, Vegim Esati akuzohet edhe se më parë është furnizuar dhe pa autorizim deri më 24 qershor 2019, ka mbajtur armë dhe atë një revole 9 mm, një karikator së bashku me 18 fishekë, i cili është gjetur dhe sekuestruar në depon e të pandehurit Mustafë Esati, që gjendet para autolarjes “Flloki”, te udhëkryqi i Lipjanit, me rastin e bastisjes që kishte ndërmarrë policia.

Me këto veprime, prokuroria e ngarkon të akuzuarin Vegim Esati se ka kryer veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në arsyetimin e aktit akuzues thuhet se me 11 shkurt 2019, Policia e Kosovës, DHTN në Ferizaj, pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ka ushtruar kallëzim penal për të pandehurit Burim Sejdiu, Gëzim Krasniqi, Xhevahir Suma, Daut Sumar, Jasir Bardi, Fuad Bardi, Hajrullah Bushi he Zilnbehar Kalisi, i cili gjendet në arrati. Me 10 shkurt 2019, është marrë aktvendimi për zgjerimin e hetimeve kundër të pandehurve Burim Sejdiu, Gëzim Krasniqi, Jasir Bardi, Fuad Bardi, Furkan Bardi, Hajrullah Bushi, mirëpo meqë në atë periudhë kohore akoma nuk dihej

identiteti i të akuzuarit Adam Nezaj si furnizuesi kryesor me narkotikë nga Republika e Shqipërisë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, thuhet se ka vijuar hetimi deri në arrestimin e tij që është realizuar me 24 qershor 2019, së bashku me tre të pandehurit tjerë.

Më 25 qershor 2019, Policia e Kosovës, DHTN në Ferizaj, thuhet se ka ushtruar kallëzimin penal për të pandehurit Adam Nezaj, Mustafë Esati, Lavdërim Osmani, Islam Basha e Vegim Esati, ndërsa me 25 qershor thuhet se është nxjerrë aktvendimi për zgjerim të hetimeve për të pandehurit Adam Nezaj, Vegim Esati, Islam Basha, Lavdërim Osmani dhe Mustafë Esati, ku ky i fundit gjendet në arrati.

Më 19 mars 2019, Prokuroria Themelore në Ferizaj, shkresat e të lëndës kundër të pandehurve i ka përcjellë në kompetencë të PSRK-së, ku kryeprokurori i PSRK-së, ka marrë aktvendim që kjo lëndë të merret në kompetencë.

Pasi janë zhvilluar hetimet thuhet se prokurori ka vlerësuar se përveç të pandehurit Adam Nezaj, asnjë tjetër nuk ka lidhje me grupin e parë.

Më 19 shtator 2019, thuhet se është bërë kërkesa pranë Departamentit Special, për veçimin e procedurës, ndërsa gjykatësi i procedurës paraprake ka aprovuar këtë kërkesë për veçim të procedurës, ashtu që ndaj Xhevahir Sumës, Burim Sejdiut, Gëzim Krasniqit, Adam Nezajt, Jasir, Fuad e Furkan Bardi, Hajrullah Bushi, Daut Suma dhe Zylbehar Kalisi, është ngritur aktakuzë .

Ndërsa, në këtë akt akuzues, përfshihen Adam Nezaj, Islam Basha, Lavdërim Osmani, Vegim Esati. Më 3 dhjetor 2019 është mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast, ku të akuzuarit kishin mohuar fajësinë.

Në këtë seancë, gjykatësja Shabani-Rama kishte marrë vendim që të refuzonte propozimet e mbrojtësve të të akuzuarve Vegim Esati, Lavdërim Osmani, Islam Bashi, avokatëve Skender Musa, Ahmet Tahiri dhe Arbër Shala, për zëvendësimin e masës së paraburgimit me atë të dorëzanisë. Sa i përket masës së paraburgimit, gjykatësja Shabani-Rama kishte thënë se mbetet në fuqi vendimi i 21 nëntorit 2019, për vazhdimin e kësaj mase.

Në fund, gjykatësja kishte njoftuar se seanca e radhës do të caktohet pasi që aktakuza të konfirmohet dhe të marrë formën e prerë.⁹²

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: PSRK ka propozuar që të konfiskohet dobia pasurore të cilën të pandehurit e kanë realizuar si rezultat i veprave penale të kryera, e cila pasuri është përshkruar në Urdhëresën Për Masë të Përkohshme për Sigurimin e Pasurisë të datës 15 gusht 2019.

⁹² “Deklarohen të pafajshëm katër të akuzuarit për shitblerjen e mbi 55 kg marihuanë”. Betimi për Drejtësi. 3 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-kater-te-akuzuarit-per-shitblerjen-e-mbi-55-kg-marihuane/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Njëkohësisht, ka propozuar që të lejohet shitja e aseteve të luajtshme të përfituara me aktivitet kriminal të përcaktuara në urdhëresën e lartcekur.

11. RASTI “GRANTET”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.74/19

Kryetar i Trupit Gjykses: Arben Hoti


Prokuror: Habibe Salihi

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Të pandehur: Nenad Rikalo, Kapllan Halimi, Shefki Zeqiri, Ekrem Gjoka, Shkelzen Morina, Leon Thaçi, Lindar Krasniqi, Albana Zeqiri

Faza e procedurës: Ende nuk ka filluar procesi gjyqësor.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KA KALUAR 1 DITË)



Aktakuza në këtë rast ende nuk është bërë publike. Mirëpo, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), më 30 dhjetor 2019, me anë të një komunikate për media ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë në kundër ish-ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie, Kapllan Halimi dhe gjashtë zyrtarëve tjerë, Shefki Zeqiri, Ekrem Gjoka, Shkelzen Morina, Leon Thaçi, Lindar Krasniqi, Albana Zeqiri për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas PSRK-së, Rikalo, Halimi dhe dy të akuzuarit tjerë, Shefki Zeqiri, dhe Ekrem Gjoka, në bashkëveprim gjatë vitit 2018, me qëllim që t’u mundësojnë përfitime në mënyrë të kundërligjshme disa kompanive, kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, si dhe me qëllim kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-098 për bujqësi dhe zhvillim rural, neni 5.1, neni 8, neni 13, paragrafi 1.2 , neni 4, neni 14.2, Ligji 03/L-098 për bujqësi dhe zhvillim rural, neni 8 dhe 9, Rregullores (QRK) nr. 37/2013, neni 7.1, paragrafi 1.1, Udhëzuesi dhe Doracaku për hartimin e konceptit të dokumenteve nga Zyra e Kryeministrit.

“I pandehuri Nenad Rikalo në cilësinë e Ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka tejkaluar kompetencat e tij, duke hartuar një “program të

veçantë”, pa buxhet të veçantë të ndarë për këtë projekt, ka vendosur mbi kriteret, ka përcaktuar regjionet për financim, shumën e grantit, duke i anashkaluar edhe procedurat e rregullta të hartimit të programit të veçantë, që ishte kompetencë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural në MBPZHR, duke mbivendosur në mes të masave me programin e rregullt. Po ashtu, më 26.03.2018 në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar vendimin për hartimin e politikave të reja për zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës rurale dhe ngritjes së konkurrencës në zonat rurale më pak të zhvilluara, me ç’rast edhe programin e dorëzon vetë, të përfunduar, (ndërsa komisionin e kishin formuar vetëm formalisht), thuhet në komunikatën e prokurorisë.

Tutje thuhet se Halimi, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka tejkaluar kompetencat e tij, duke nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme vendimin për t’iu mundësuar përfitim në mënyrë të kundërligjshme kompanive të ndryshme, ka emëruar grupin punues në përbërje prej 11 anëtarësh për përgatitjen e investimeve në infrastrukturë rurale, duke qenë në dijeni se ky grup nuk është kompetent dhe nuk ka njohuri për përpilimin e këtij programi, derisa ishte në dijeni se ky grup ishte vetëm formal, duke ditur se drafti është dorëzuar nga vetë ministri Nenad Rikalo.

“I pandehuri Shefki Zeqiri në cilësinë e personit zyrtar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit 2018, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme ka hartuar dhe aprovuar Udhëzimin Administrativ nr. 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë “Zonat rurale më pak të zhvilluara”, edhe pse e kishte ditur që ky program ishte hartuar në kundërshtim me Ligjin 04/L-090, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-098, për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Rregulloren (QRK) nr. 37/2013, duke i anashkaluar procedurat e rregullta të hartimit të programit të veçantë që është kompetencë e Departamentit të Politikave për Zhvillim Rural në MBPZHR.”, thuhet në njoftim.

“Ndërsa, i pandehuri Ekrem Gjoka, në cilësinë e personit zyrtar Ushtues i Detyrës së Kryeshefit të AZHB-së, në mënyrë të kundërligjshme ka marrë vendimin për formimin e grupit punues, i cili do të bënte kontrollin administrativ, vlerësimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve të masës së infrastrukturës rurale, në përbërje prej: Lindar Krasniqi, Shkelzen Morina, Albana Zeqiri, Leon Thaçi duke anashkaluar faktin se ky ekip duhej të formohet nga drejtori, të monitorohej nga drejtori dhe të raportonte te Drejtori i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve dhe Zhvillim Rural. Kështu që, i pandehuri Ekrem Gjoka, me qellim ka vepruar në atë mënyrë që t’u mundësonte përfitim kompanive të ndryshme, në mënyrë të kundërligjshme, ngase vetë ishte pjesë e grupit kur ministri ua kishte dorëzuar draftin e gatshëm, duke vepruar në këtë mënyrë, buxhetit të Republikës së Kosovës në bashkëveprim i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 4.000.000 euro.”, thuhet në komunikatën e PSRK-së.

Sipas Prokurorisë Speciale, me veprimet e lartpërmendura, të akuzuarit në bashkëveprim kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

“Po ashtu, Prokuroria Speciale, njofton se të pandehurit, Shkelzen Morina, Leon Thaçi, Lindar Krasniqi, Albana Zeqiri, më 14.08.2018, duke bashkëvepruar në cilësinë e personave zyrtarë pranë MBPZHR-së, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim që t’u mundësojë përfitime në mënyrë të kundërligjshme disa kompanive, të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ 09/2018, për zbatimin e programit te veçantë “Zonat rurale më pak të zhvilluara”, në bashkëveprim kanë kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së”, përfundon komunikata.⁹³

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në Departamentin Special, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ende nuk është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar për këtë rast, kjo seancë është caktuar për datën 12 mars.⁹⁴ Ky shqyrtim fillestar është caktuar 73 ditë pas ngritjes së aktakuzës, duke mos respektuar afatin e përcaktuar ligjor.

⁹³ “PSRK ngritë aktakuzë për keqpërdorim detyre ndaj ish-ministrit të MBPZHR-së, Nenad Rikalo”, Betimi për Drejtësi. 30 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-keqperdorim-detyre-ndaj-ish-ministrit-te-mbpzhr-se-nenad-rikalo/>)

⁹⁴ “Në mars fillon gjykimi për korrupsion ndaj ish-ministrit të Bujqësisë, Nenad Rikallo dhe zyrtarëve të tjerë” Betimi për Drejtësi. 25 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-mars-fillon-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-ministrit-te-bujqesise-nenad-rikallo-dhe-zyrtareve-te-tjere/>)

ANEX II: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të kthyer në rigjykim

Përpos rasteve të cilat akoma janë duke u trajtuar për herë të parë nga gjykata e shkallës së parë, në kuadër të rasteve të shënjestruara janë edhe pesë (5) raste, të cilat po trajtohen për herë të dytë nga Gjykatat Themelore, për arsye se Gjykata e Apelit, si instancë e dytë gjyqësore ka gjetur shkelje të ligjit dhe/apo të procedurave gjyqësore, rrjedhimisht pastaj i ka kthyer në rigjykim.

Katër rastet e kthyer në rigjykim janë: 1) “KEDS”; 2) “Ferronikeli”, 3) “Mërgimtari” 4) “Stenta” dhe 5) “Shkurti”.

Në rastin e njohur si “KEDS”, aktakuza ngarkonte tre persona dhe ishte ngritur më 6 tetor 2015 por pas 20 seancave të gjykimit të parë, ky rast duhet të trajtohet edhe njëherë nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Herën e dytë, rigjykimi do të zhvillohet vetëm ndaj një personi, pasi për dy persona ka përfunduar gjykimi, meqë ndaj njërit person Prokurori i Shtetit kishte hequr dorë nga aktakuza, ndërsa personi tjetër është liruar nga akuza.

Arsyeja e shkeljeve ligjore nga ana e gjykatave themelore, ka bërë që në procesin e rigjykimit të jetë edhe rasti “Mërgimtari”.

Sikurse rastet që janë në trajtim për herë të parë, edhe rastet “KEDS” është përcjellë me shkeljeve të afateve ligjore për një gjykim në kohë të arsyeshëm. Këtij rasti i është dashur mbi dy vjet që të merret një vendim nga shkalla e parë, por i njëjti rast do të trajtohet përsëri nga kjo instancë gjyqësore.

Ndërsa, rasti “Mërgimtari” epilogun nga shkalla e ka marrë shumë më shpejt, brenda më pak se një viti, nga aty e tutje këto raste janë përcjellë me hapa të ngadalshëm.

Te ky rast procesi i rigjykimit ishte paraparë të filloj më 28 tetor 2019, por e njëjta seancë nuk kishte mbajtur, ndërsa ishte arritur të mbahej më 25 nëntor 2019. Të dy këto raste tashmë janë akoma në proces të rigjykimit.

Në fund të vitit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte gjykuar rastin “Feronikeli”, ku kishte shpallur fajtor ish-kryetarin e komunës së Lipjanit, Shukri Buja i cili ishte dënuar me tri (3) vjet burgim. Njëkohësisht, aktgjykime dënuese ishte marrë edhe për pesë persona, ndërsa katër persona ishin liruar nga akuza. Këtë rast, Gjykata e Apelit, në vitin 2019, e ka kthyer në rigjykim. Sipas kësaj gjykate, shkalla e parë ka dështuar të vërtetojë dashjen e të akuzuarve të cilët ishin shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Sikur për këtë rast e po ashtu edhe për rastin “KEDS”, ende nuk janë caktuar seancat e para të procesit të rigjykimit.

Ndërsa, më 24 dhjetor, Gjykata e Apelit përmes një komunikate për media kishte bërë të ditur se ka kthyer në rigjykim rastin “Stenta”, ku ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani dhe ish-

sekretari i kësaj ministrie, Gani Shabani, sërish do të gjykohen lidhur me akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

E më 27 dhjetor 2019, përmes një komunikate për media, Gjykata e Apelit kishte njoftuar opinionin se ka vendosur për rastin “Shkurti”, duke vërtetuar dënimet ndaj gjashtë (6) të akuzuarve, ndërsa duke kthyer në rigjykim rastin ndaj një (1) të akuzuari që ishte dënuar dhe ndaj një (1) të akuzuari që ishte liruar, duke e lenë këtë rast akoma të papërfunduar me një aktgjykim përfundimtarë.

1.RASTI “KEDS”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.107/19.

Kryetar i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti.

Prokurori: Hivzi Bajraktari.

Të pandehur: Avni Alidemaj, Vjollca Ajvazi, Drita Hamiti dhe Blerim Sokoli.

Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashttrim i blerësve”.

Faza e procedurës: Rigjykim për të akuzuarën Vjollca Ajvazi.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1548 DITË)



Më 6 tetor 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzë kundër zyrtareve të Agjencisë së Metrologjisë Vjollca Ajvazi dhe Drita Hamiti, si dhe ndaj drejtorit ekzekutiv të rrjetit të KEDS-it Avni Alidemajt.

Me këtë aktakuzë prokuroria pretendon se gjatë intervalit kohor mars 2013 deri më 5 dhjetor 2014, të akuzuarit kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke u mundësuar kompanive “Kohler” dhe “KEDS” të përfitojnë dobi pasurore dhe të njëjtën kohë t’iu shkaktojnë dëm material konsumatorëve kosovarë. Sipas aktakuzës, dy zyrtaret Ajvazi dhe Hamiti, kanë shqyrtuar dokumentacionin për miratimin dhe lejimit e tipit të njehsorit elektrik digjital të prodhuesit “Kohler”, të tipit digjital “AEL. TF.04-1”.

Në këtë rast, pjesë e akuzës kishte qenë edhe Blerim Sokoli, ndaj të cilit ka pushuar procedura penale, pas i njëjti ka ndërruar jetë. Sokoli akuzohej se në cilësinë e drejtorit në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, kishte pranuar ta licencojë në mënyrë të kundërligjshme njehsorin elektrik “Kohler”, të prodhuar në Turqi.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar nga Policia e Kosovës më 15 maj të vitit 2015, ndërsa aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë më 29 prill 2015. Aktakuza ishte ngritur në gjykatë më 6 tetor të po të njëjtit vit. Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore në Prishtinë, seancën fillestare e kishte caktuar më 26 nëntor të vitit 2015 apo 51 ditë pas ngritjes të aktakuzës në gjykatë, ndërsa seanca e shqyrtimit të dytë ishte paraparë të mbahej më 9 mars të vitit 2016, apo dy muaj pas kohës kur kërkohet me dispozitat e KPPK-së, mirëpo e njëjta kishte dështuar të mbahet për shkak se i akuzuari Blerim Sokoli kishte ndërruar jetë. Atë ditë prokurori Hivzi Bajraktari, kishte kërkuar nga gjykata sigurimin e certifikatës së vdekjes nga shërbimi civil në Prizren që të zyrtarizohet vdekja e të ndjerit dhe të mundësohet procedimi i mëtejshëm i procesit gjyqësor.⁹⁵

Shqyrtimi i dytë, kishte arritur të mbahej më 29 mars 2016, ku mbrojtësit e Ajvazit e Hamitit kishin paraqitur kundërshtimet e tyre, ndërsa mbrojtja e Alidemajt kishte deklaruar se nuk kishin parashtruar kërkesë për hudhjen e aktakuzës, pasi që konsideronin se është krijuar një praktike gjyqësore, ku pretendimet e mbrojtjes janë vetëm akte formale⁹⁶. Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar më 12 tetor 2016, apo pothuajse 1 vit pas ngritjes së aktakuzës në këtë gjykatë.⁹⁷

Më 22 maj të vitit 2018, në fjalën përfundimtare, prokurori Hivzi Bajraktari kishte hequr dorë nga ndjekja penale për të akuzuarën Drita Hamiti, e një veprim të tillë ai kishte deklaruar se po e bënte për shkak të mungesës së provave⁹⁸.

Afërsisht tri vjet pas fillimit të kësaj procedure, më 28 maj të vitit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte shpallur aktgjykimin për këtë rast. Të akuzuarit Vjollca Ajvazi e Avni Alidemajt, kjo gjykatë i kishte shpallur fajtorë dhe i kishte dënuar me 6 muaj burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohej nëse brenda dy vitesh të akuzuarit nuk kryejnë vepër tjetër penale. Ndërsa, në mungesë provash ishin liruar për pikën e dytë të aktakuzës, me të cilin ngarkoheshin për

⁹⁵ “Shtyhet shqyrtimi dytësor në rastin e dallaveve me orën elektrike, vdes një i akuzuari”, Betimi për Drejtësi, 9 mars 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shqyrtimi-dytesor-ne-rastin-dallaveve-me-oret-elektrike-vdes-nje-i-akuzuari/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁹⁶ “Vazhdon shqyrtimi dytësor në rastin e dallaveve me orët elektrike”, Betimi për Drejtësi, 29 mars 2016, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-shqyrtimi-dytesor-ne-rastin-e-dallaveve-me-oret-elektrike/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁹⁷ Rasti i njehsorëve elektrik “Kohler”: Avokati Berisha e cilëson ndjekjen penale nga ana e prokurorisë si drejtësi selektive, Betimi për Drejtësi, 12 tetor 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-njehsorëve-elektrik-kohler-avokati-berisha-e-cileson-ndjekjen-penale-nga-ana-e-prokurorisë-si-drejtësi-selektive/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁹⁸ “Prokuroria heq dorë nga ndjekja penale për një të akuzuar në rastin “Kohler”, kërkon dënimin e dy të tjerëve, derisa mbrojtja kërkon lirimin e tyre”, Betimi për Drejtësi, 22 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-per-nje-te-akuzuar-ne-rastin-kohler-kerkon-denimin-e-dy-te-tjereve-derisa-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

veprën penale të mashtrimit. Në anën tjetër, për të akuzuarën Drita Hamiti, pas heqjes dorë nga ndjekja penale nga ana e prokurorit, kjo gjykatë kishte marrë aktgjykim refuzues.⁹⁹

Pas ankimimit të palëve në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë më 10 prill 2019, ka marrë vendim me anë të së cilit ka liruar të dënuarin nga shkalla e parë Avni Alidemajn, ndërsa për të akuzuarën tjetër Vjollca Ajvazi ka kthyer rastin në rigjykim dhe rivendosje.

Sipas instancës së dytë gjyqësore, sa i përket Avni Alidemajt, është thënë se nga shkresat e lëndës kjo gjykatë ka vlerësuar se asnjëra nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor nuk ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa sa i përket të akuzuarës Vjollca Ajvazi, në aktvendimin e Apelit është thënë se aktgjykimi i shkallës së parë juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashur të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.¹⁰⁰

Në këtë mënyrë tashmë ky rast në procesin e rigjyimit do të gjykohet vetëm për të akuzuarën Vjollca Ajvazi. Ndërkaq, ende nuk është caktuar seanca e parë pas kthimit në rigjykim për të njëjtën.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

⁹⁹Dënohen me burgim me kusht dy të akuzuarit për korrupsion në rastin e njehsorëve “Kohler” (Video), Betimi për Drejtësi, 28 maj 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-me-kusht-dy-te-akuzuarit-per-korrupsion-ne-rastin-e-njehsoreve-kohler/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁰⁰“Rasti “Kohler”, Apeli e liron njërin të akuzuar, kurse për të akuzuarën tjetër e kthen rastin në rigjykim” Betimi për Drejtësi, 25 prill 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-kohler-apeli-e-liron-njerin-te-akuzuar-kurse-per-te-akuzuaren-tjeter-e-kthen-rastin-ne-rigjykim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

2. RASTI “STENTA 1”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.369/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Shadije Gërguri.

Prokuror: Florije Salihu-Shamolli.

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Të pandehur: Ferid Agani dhe Gani Shabani.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1296 DITË)



Më 14 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, Sekretarit të Përgjithshëm të MSh-së, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfetit”, “dhënie e ryshfetit”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “shmangia nga tatimi”.

Në këtë çështje penale hetimet fillimisht janë zhvilluar ndaj 116 personave fizik dhe katër personave juridik. Pas hetimeve, për 56 persona fizik nuk ishin plotësuar kushtet ligjore që të përfshihen në këtë aktakuzë, andaj për të njëjtit edhe kishin pushuar hetimet. Karakteristikë e këtij rasti është ngritja e aktakuzës nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, gjetje kjo të cilën e ka ngritur IKD në raportet paraprake.¹⁰¹

Deri më tani, katër prokurorë janë ndërruar me lëndën “Stenta”. Tjetër karakteristikë e rastit është fakti se prokurori i shtetit që e ka përpiluar aktakuzën as nuk e përfaqëson dhe as nuk e

¹⁰¹ “Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit?”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2017. (Shih linkun <http://kli-ks.org/luftes-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

mbron atë. Aktakuza është dorëzuar në muajin qershor 2016, por leximi i saj nuk ishte bërë një kohë të gjatë, meqë prokuroria nuk i kishte dorëzuar provat për të gjithë të pandehurit në gjuhën që ata e kuptojnë. Kjo kishte rezultuar me 5 seanca të shtyra.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 19 maj 2017, si dhe më 25 maj 2017 për njërin nga të akuzuarit që kishte munguar në seancën e 19 majit. Kërkesat e mbrojtësve të të akuzuarve për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë më 31 korrik 2017, kurse, pas ankesave që mbrojtësit kishin ushtruar në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit, në tetor 2017 e kishte kthyer rastin në rivendosje.¹⁰²

Pas kthimit të rastit në rivendosje, më 26 shkurt 2018, kryetarja e trupit gjykues, Shadije Gërguri, për qëllim të efikasitetit të çështjes, e kishte veçuar procedurën në tri pjesë. Që nga ajo kohë, Ferid Agani dhe Gani Shabani gjykohen veçmas si një rast (STENTA 1). Gani Bajraktari dhe të akuzuarit tjerë, kryesisht mjekë, që bëjnë pjesë në dispozitivat III dhe IV të aktakuzës, janë duke u gjykuar veçmas (STENTA 2), kurse, Ali Hocaoglu dhe të akuzuarit tjerë që përfshihen nga dispozitivi katër deri në dispozitivin 10 të aktakuzës do të gjykohen veçmas (STENTA 3).¹⁰³

Asnjë nga të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 26 shkurt 2018, kurse, kërkesat e tyre për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave ishin refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin e Ferid Aganit dhe Gani Shabanit, si dhe në rastin tjetër Gani Bajraktari etj. aktakuza ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe këto raste tanimë janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, kurse për rastin Ali Hocaoglu etj., rasti është kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit pas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve. Në ndërkohë, për shkak se ka ndërruar jetë, ka pushuar procedura penale ndaj njërit nga të akuzuarit në këtë rast, Bedri Zaiti.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal në rastin “Stenta” është ngritur më 26 maj 2014, kurse aktvendimi për fillimin e hetimeve më 16 qershor 2014. Aktakuza është ngritur më 14 qershor 2016. Shqyrtimi fillestar në rastin “Stenta” është caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me katër muaj vonesë apo jashtë afatit të përcaktuar me KPPK. Karakteristikë për këtë rast është edhe seanca e shtyrë më 28 shkurt 2017pare, në të cilën gjyqtarja e rastit, Shadije Gërguri, kishte sqaruar se prokuroria me shpresë të veçantë ka njoftuar gjykatën se Afrim Bektashi kishte qenë i përfshirë në hetimet për

¹⁰² “Apeli e kthen në rivendosje rastin “Stenta”. Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-stenta/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁰³ “Pas veçimit të procedurës ndaj tyre, sërish deklarohen të pafajshëm ish-ministri dhe ish-sekretari Shabani”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-vecimit-te-procedures-ndaj-tyre-serish-deklarohen-te-pafajshem-ish-ministri-agani-dhe-ish-sekretari-shabani/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

këtë rast, por ndaj tij nuk ishin gjetur elemente të veprës penale dhe i njëjti nuk ishte pjesë e akuzës.¹⁰⁴

Mënyra e ngritjes së aktakuzës dhe tërheqja nga ndjekja penale ndaj Afrim Bekteshit, dëshmon jo-seriozitetin e prokurorisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Po ashtu, arsyetimi i prokurorisë për gabim teknik në ngritjen e aktakuzës, bie në kundërshtimin me obligimin ligjor që ka Prokurori i Shtetit sipas nenit 48 të KPPK-së, i cili përcakton se është detyrim i prokurorit që gjatë hetimit të veprave penale, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet, duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit.

Më 18 prill 2019, ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve, ku prokurorja Florije Salihu-Shamolli kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse mbrojtja lirimin e tyre¹⁰⁵, ndërsa më 24 prill, gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtorë të akuzuarit për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Agani është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim efektiv, ndërsa i akuzuari tjetër, Gani Shabani është dënuar me dy vjet burgim efektiv. Ata gjithashtu janë obliguar edhe t'i paguajnë shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 400 euro.¹⁰⁶

Në këtë rast të shënjestruar për liberalizim të vizave, nga ngritja e aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, kanë kaluar 1165 ditë.

Më 22 nëntor 2019, në Gjykatën e Apelit, është mbajtur seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit, në të cilën seancë të akuzuarit Ferid Agani dhe Gani Shabani, kanë kërkuar që shkalla e dytë t'i shpallë ata të pafajshëm ose që rasti ndaj tyre të kthehet në rigjykim. Në anën tjetër, prokuroria ka kërkuar që ndaj të njëjtëve të rritet dënimi i shqiptuar nga shkalla e parë.¹⁰⁷ Me 24 dhjetor, në një komunikatë për media, Apeli ka njoftuar se Departamenti Special i gjykatës së shkallës së dytë, i ka aprovuar ankesat e avokatëve mbrojtës të dy të akuzuarve kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas komunikatës, Gjykata e Apelit, pasi ka shqyrtuar më vëmendje aktgjykimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si dhe shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të

¹⁰⁴“Përfshihet gabimisht në aktakuzën e rastit “Stenta”, lirohet nga ndjekja penale Afrim Bekteshi”. Betimi për Drejtësi. 28 shkurt 2017. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/perfshihet-gabimisht-ne-aktakuzen-e-rastit-stenta-lirohet-nga-ndjekja-penale-afrim-bekteshi/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁰⁵“Stenta 1”, ish-ministri Agani dhe ish-sekretari Shabani kërkojnë të lirohen nga akuzat, prokuroria kërkon dënimin e tyre” Betimi për Drejtësi. 18prill 2019. (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/stenta-1-ish-ministri-agani-dhe-ish-sekretari-shabani-kerkojne-te-lirohen-nga-akuzat-prokuroria-kerkon-denimin-e-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁰⁶“Rasti “Stenta 1”, ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari Gani Shabani dënohen me mbi 4 vjet burg efektiv (Video)”Betimi për Drejtësi. 24prill 2019. (Shih linkun<https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ish-ministri-ferid-agani-dhe-ish-sekretari-gani-shabani-denohen-me-mbi-4-vjet-burg-efektiv/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁰⁷“Rasti “Stenta 1”, ish-ministri dhe ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë kërkojnë pafajësinë në Apel, prokuroria kërkon ashpërsimin e dënimeve” Betimi për Drejtësi” 22 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ish-ministri-dhe-ish-sekretari-i-ministrise-se-shendetesise-kerkojne-pafajesine-ne-apel-prokuroria-kerkon-ashpersimin-e-denimeve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar, mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, për çka duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.¹⁰⁸

Dëmi i pretenduar: 4,555,553.00 euro..

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹⁰⁸ “Apeli e kthen në rigjykim dhe rivendosje rastin ndaj ish-ministrit, Ferid Agani dhe ish-sekretarit, Gani Shabani” Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-dhe-rivendosje-rastin-ndaj-ish-ministrit-ferid-agani-dhe-ish-sekretarit-gani-shabani/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

3. RASTI “MËRGIMTARI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.48/19.

Kryetar i trupit gjykues: Suzana Çerkini.

Prokuror: Merita Bina-Rugova.

Të pandehur: Miftar Dobraj, Artan Kelmendi, Daniel Prenrecaj, Dren Mulla.

Veprat penale: “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Faza e procedurës: Në proces të rigjykitimit.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 695 DITË)



Sipas aktakuzës së PSRK-së, e cila është ngritur më 5 shkurt 2018, të akuzuarit Artan Kelmendi, Miftar Dobraj dhe Daniell Prenrecaj, duke vepruar si grup i organizuar kriminal, në krye me Albert Veliun kundër të cilit procedura penale është duke u zhvilluar në SHBA, kishin kryer vepra të rënda penale, të trafikimit me armë.

Sipas prokurorisë, gjatë muajit prill/maj 2017, në territorin e SHBA-ve, agjenti i policisë amerikane nga DEA (Drug Enforcement Administration), nën mbulim, kishte lidhur marrëveshje me Veliun për blerjen e 15 armëve automatike, kinse për narkobandat në Meksikë, më çmim prej 900 dollarë dhe për këtë ia kishte paguar shumën prej 13,500 dollarë.

Të akuzuarit Kelmendi dhe Veliu, më 18 qershor 2017, pas marrëveshjes paraprake me oficerin e Policisë së Kosovës, i cili ishte duke e zbatuar masën e fshehtë të blerjes së stimuluar në koordinim me policinë amerikane, ishin takuar në restorantin “Nora”, në Klinë, dhe të njëjtit ia

kishin dorëzuar oficerit policor 6 armë të gjata “AK 47” dhe një karikator të zbrazët për armë të gjata.

Ndërsa, më 27 qershor 2017, dyshohet se Kelmendi dhe Prenrecaj, në vendin e njëjtë, oficerit nën mbulim, ia kishin dorëzuar 8 pushka automatike “AK 47” me nga një karikator, një antitank të dorës me një projekttil 64 mm në të, si dhe 3 karikatorë të zbrazët. Ndërsa i akuzuari Dobraj e kishte mbikëqyrë nga restoranti dhe disa çaste me vonë të gjithë ishin arrestuar.

Prokuroria tre të akuzuarit, në bashkëkryerje me Albert Veliun, i ngarkon me veprën penale “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 285 par.1 i KPRK-së, lidhur me veprën penale “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, këmbimi ose shitja e pa autorizuar e armëve”.

Ndërkaq, i pandehuri Kelmendi, së bashku me të akuzuarin Dren Dulla akuzohet edhe me veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 15 maj të vitit 2017, Policia e Kosovës kishte paraqitur kallëzimin penal, me ç’rast më 22 maj të po të njëjtit vit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte filluar hetimet që kishin rezultuar me ngritje të aktakuzës më 6 shkurt të vitit 2018.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 4 prill të vitit 2018, apo 57 ditë pas ngritjes së aktakuzës duke mos respektuar afatin e paraparë ligjor prej 30 ditësh.

Gjatë këtij shqyrtimi, të akuzuarit Miftar Dobraj dhe Artan Kelmendi kishin kërkuar të arrijnë një marrëveshje për pranimin e fajësisë, duke kërkuar ri-cilësimin e veprës penale, sepse konsideronin se nuk ka elemente për “krim të organizuar”. Ndërsa, Dren Mulla, që prokuroria e ngarkonte vetëm me veprën penale të armëmbajtjes pa leje, e kishte pranuar fajësinë, me të cilin pranim ishte pajtuar edhe mbrojtësja e tij, avokatja Kosovare Kelmendi, e po ashtu edhe prokurorja Merita Binaj-Rugova, të cilin pranim më pas e kishte aprovuar gjykatësja Suzana Çerkini.¹⁰⁹ Ndërsa, në seancën e mbajtur më 20 prill ishte bërë e ditur se të pasuksesshme kishin rezultuar negociatat për pranimin e fajësisë mes PSRK – së dhe të akuzuarve të tjerë. E më pas gjykatësja Qerkini kishte njoftuar palët se brenda 30 ditësh kanë të drejtë të paraqesin kërkesat për hüdhe të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.¹¹⁰

¹⁰⁹“Dy nga tre të akuzuarit për krim të organizuar me armë në SHBA, kërkojnë të hyjnë në marrëveshje për pranimin e fajësisë”, Betimi për Drejtësi, 4 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-nga-tre-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-me-arme-ne-shba-kerkojne-te-hyjne-ne-marreveshje-per-pranimin-e-fajesise/>).

(Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹⁰“Të akuzuarit për krim të organizuar me armë në SHBA sëarrjnë marrëveshje për pranimin e fajësisë, mbesin në paraburgim” Betimi për Drejtësi, 20 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-me-arme-ne-shba-sarrijne-marreveshje-per-pranimin-e-fajesise-mbesin-ne-paraburgim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Ky gjykim kishte përfunduar më 20 korrik, pra tre muaj pas fillimit të procedurës në gjykatë, ku të akuzuarit ishin shpallur fajtorë. Trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësja Suzana Çerkini, kishte marrë vendim me të cilin tre të akuzuarit Dobraj, Kelmendi e Prendrecaj i kishte shpallur fajtorë për veprën penale “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, duke e kualifikuar si vepër në bashkëkryerje, e jo si krim të organizuar.

Miftar Dobraj ishte dënuar me 5 vjet e gjashtë muaj burgim dhe 7 mijë euro gjobë, Artan Kelmendi me dënim unik prej 5 vjet e dy muaj burgim, pasi përveç që ishte dënuar me 4 vjet e 6 muaj burgim për veprën penale të lartcekur, ai ishte dënuar edhe me 1 vit burgim për armëmbajtje pa leje.

Ndërkaq, Daniel Prenecaj ishte dënuar me dy vjet burgim dhe tre mijë euro gjobë. Fajtor ishte shpallur edhe i akuzuari për armëmbajtje pa leje Dren Mulla, i cili ishte dënuar me katërmijë euro gjobë. Po ashtu, gjykata, të akuzuarve iu kishte shqiptuar edhe dënim plotësues, duke iu konfiskuar mjetet me të cilat pretendohet se kishin kryer vepra penale, ashtu që Kelmendit dhe Mullës i ishin konfiskuar armët, Dobrajt i ishin konfiskuar 1,653 euro, ndërsa Prenecajt i ishte konfiskuar vetura “Audi A3”.¹¹¹

Palët të pakënaqura i ishin drejtuar Gjykatës së Apelit, e cila më 22 nëntor 2018, kishte mbajtur seancën e kolegjit¹¹², pas së cilës ishte vendosur që ky rast të kthehet edhe njëherë në rigjykim. Ndërsa, shkalla e dytë e ka refuzuar ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit për armëmbajtje pa leje, Dren Mulla, duke e vërtetuar kështu dënimin e shqiptuar ndaj tij.¹¹³ Pas kthimit të rastit në rigjykim, më 28 tetor 2019, nuk ishte arritur të mbahet seanca, ndërkaq ishin mbajtur seancat e 25 nëntor dhe 26 dhjetor 2019.

Dëmi i pretenduar: Nuk është e përcaktuar me aktakuzë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Armët, 1,653 euro dhe vetura “Audi A3”.

¹¹¹“Shpallen fajtorë katër të akuzuarit në rastin e shënjestruar për liberalizimin e vizave”, Betimi për Drejtësi, 20 korrik 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-fajto-re-kater-te-akuzuarit-ne-rastin-e-shenjestruar-per-liberalizimin-e-vizave/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹²Drejtesi, 22 nëntor 2018 (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-shqyrton-ankesat-e-paleve-ne-rastin-e-te-akuzuarve-per-trafikim-armesh-ne-shba/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹³“Kthehet në rigjykim rasti i shënjestruar për viza ndaj të akuzuarve për trafikim armësh në SHBA” Betimi për Drejtësi, 8mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-i-shenjestruar-per-viza-ndaj-te-akuzuarve-per-trafikim-armesh-ne-shba/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

4. RASTI “FERONIKELI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.206/19.

Kryetar i Trupit Gjykses: Beqir Kalludra.

Prokuror: Agron Bajrami.

Të pandehur: Shukri Buja; Nebih Zeqiri; Halit Gashi; Edmond Rexhepi; Hasim Vishesella; Fahri Retkoceri; Magbule Sadiku; Burim Kodra; Driton Avdiu; Bajram Rizani.

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Marrje Ryshfeti”; “Punimet ndërtimore të kundërligjshme”; “Dhënia e ryshfetit”; “Ushtrim ndikimi”.

Faza e procedurës: Rigjykim.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1052 DITË)



Policia e Kosovës më 18 shtator 2014 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj Shukri Bujës dhe të tjerëve, ndërsa aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë nga prokuroria më 21 tetor 2015. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) me 13 shkurt 2017, kishte ngritur aktakuzën me të cilën e ngarkonte ish-kryetarin e Lipjanit, Shukri Buja, Nebih Zeqirin – zyrtar për çështje pronësore në zyrën e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Halit Gashin – në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Lipjan dhe Magbule Sadikun – zyrtare në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Lipjan, se në kundërshtim me dispozitat ligjore, kanë ndërmarrë veprime për shpronësimin, eksproprijimin dhe më pas kanë tjetërsuar pronat shoqërore dhe komunale, në dobi të “New Co Ferronikel Complex L.L.C.”.

Fahri Retkoceri, akuzohet për veprat penale “punime ndërtimore të kundërligjshme” dhe “dhënie e ryshfetit”. I pandehuri Retkoceri akuzohet se ka filluar ndërtimin e një objekti kolektiv-

banesor, pa u pajisur me leje ndërtimi. I pandehuri Hasim Viseshella – në cilësinë e shefit të sektorit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Urbanizmit dhe Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Lipjanit dhe i pandehuri Edmond Rexhepi – Drejtor për Planifikim dhe Urbanizëm në komunën e Lipjanit, ngarkohen me veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “marrje e ryshfeti”, për faktin se kanë lëshuar leje ndërtimi për të pandehurin, Fahri Retkoceri.

Të akuzuarit, Driton Avdiu dhe Burim Kodra, akuzohen për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Prokuroria pretendon se dy të akuzuarit në cilësi të inspektorëve komunalë, me rastin e inspektimit në ndërtimin e objektit banesor nga i pandehuri, Fahri Retkoceri, nuk i kanë ndërmarrë masat për pezullim të punimeve. Ndërsa, i pandehuri Bajram Rizani – në cilësinë e drejtorit në Drejtorinë e Inspektionit në Komunën e Lipjanit, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare, duke qenë në dijeni se i pandehuri, Fahri Retkoceri, po ndërtonte objekt pa leje, nuk ka kërkuar nga vartësit e tij pezullimin e ndërtimit të objektit, me çka akuzohet për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 28 prill 2017, apo rreth një muaj e gjysmë pas afatit 30 ditor të përcaktuar në KPPK për mbajtjen e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës.¹¹⁴ Kurse, shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 31 Maj 2017, brenda afateve të përcaktuara në KPPK.¹¹⁵

Që nga ajo kohë e deri në shpalljen e aktgjyqimit, për këtë rast, janë mbajtur edhe shtatë seanca gjyqësore, kurse për arsye të ndryshme pesë të tjera ishin shtyrë. Verдикtin e saj final, gjykata e kishte dhënë me 5 nëntor 2018, ku Shukri Buja, është dënuar me tre vjet burgim efektiv, pasi është shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje. Për keqpërdorim të pozitës zyrtare, fajtorë janë shpallur edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Nebih Zeqiri, i cili është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim, Halit Gashi, Edmond Rexhepi dhe Bajram Rizani me nga gjashtë muaj burgim secili, kurse Hasim Viseshella është shpallur fajtor për marrje ryshfeti dhe është dënuar me pesë muaj burgim. Të akuzuarve Gashi, Rexhepi, Rizani dhe Viseshella, dënimet me burg mund t’iu zëvendësohen me dënime me gjobë. Ndërsa, janë liruar nga akuza, Magbule Sadiku, Burim Kodra si dhe Driton Avdiu, kurse ndaj biznesmenit Fahri Retkoceri, aktgjykim lirues është marrë për veprën penale “punimet ndërtimore të kundërligjshme”, ndërsa aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit, është marrë

¹¹⁴“Deklarohet i pafajshëm ish-Kryetari i Lipjanit dhe zyrtarët tjerë të kësaj komune”. Betimi për Drejtësi. 28 prill 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-ish-kryetari-i-lipjanit-dhe-zyrtaret-tjere-te-kesaj-komune/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹⁵ “Shukri Buja kërkon të hidhet poshtë aktakuza ndaj tij” Betimi për Drejtësi. 28 prill 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-buja-kerkon-te-hidhet-poshte-aktakuza-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

për veprën penale të dhënies së ryshfetit.¹¹⁶ Ajo çka vlen të theksohet në këtë rast është fakti se neglizhenca që është bërë në trajtimin e tij, ka bërë që disa vepra penale për të cilat akuzoheshin Shukri Buja si dhe Fahri Retkoceri të parashkruhen. Këtë rast, Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim. Sipas kësaj gjykate, shkalla e parë ka dështuar të vërtetojë dashjen e të akuzuarve të cilët ishin shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.¹¹⁷ Pas kthimit në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë ende nuk ka caktuar seancë të shqyrtimit gjyqësor.

Dëmi i pretenduar: Mbi 6 milionë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹¹⁶“*Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja dënohet me tre vjet burgim për korrupsion*”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-lipjanit-shukri-buja-denohet-me-tre-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹⁷ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e Shukri Bujës, i dënuar me tre vjet burg për korrupsion”, Betimi për Drejtësi. 23 gusht 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-shukri-bujes-i-denuar-me-tre-vjet-burg-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

5. RASTI “SHKURTI”

Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: PKR.nr.99/18.

Kryetar i Trupit Gjykses: Zyhdi Haziri.

Prokuror: Haki Gecaj.

Të pandehur: Afrim Luma, Ramadan Hyseni, Fehmi Gashi, Fatos Ahmeti, Gëzim Abazi, Fatmir Statovci, Zeqir Berisha, Lutfi Nebiu.

Veprat penale: “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”; “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale”, “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 629 DITË)



Sipas aktakuzës së PSRK-së, të ngritur më datë 12 prill 2018, pretendohet se të pandehurit Afrim Luma, Ramadan Hyseni, Fehmi Gashi, Fatos Ahmeti në periudhën kohore nga fillimi i muajit shkurt 2017 deri më datë 30 prill 2017, me dashje kanë marrë pjesë në veprimtari kriminale të grupit të organizuar, në të cilin kanë marrë pjesë edhe i pandehuri Amir Sherifi që gjendet në arrati dhe shtetasi nga Shqipëria, personi me emrin Artur, të cilët me qëllim të vetit t’i sjellin përfitim pasuror, janë marrë me blerjen, transportin dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të llojit marihuanë.

Sipas aktakuzës, narkotikun e blerë nga shtetasit e Shqipërisë të cilët e kanë sjellë deri në brendësi të Kosovës afër Landovicës, pjesëtarët e grupit Afrim Luma, Amir Sherifi, Ramadan Hyseni, Fehmi Gashi dhe Fatos Ahmeti e kanë shpërndarë-fshehur fillimisht në fshatin Bibaj, Krushë e Madhe, në fshatin Sojevë dhe fshatin Cërnillë. Sipas aktit akuzues, këtë sasi të

narkotikëve e cila ishte në thasë, të pandehurit e kanë paketuar dhe fshehur në tavolina dhe dërrasa të përgatitura më qëllim që pastaj ta transportojnë për shitje në shtetet e Evropës Perëndimore dhe në Turqi, përmes Maqedonisë.

Gjithnjë sipas aktakuzës, Policia e Kosovës pas aplikimit të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, ka rënë në gjurmë të vendeve ku fshehen narkotikët dhe me rastin e bastisjes së shtëpive dhe objekteve përcjellëse, në shtëpinë-lokalin e të pandehurit Fehmi Gashi në fshatin Krushë e Madhe, më datë 25 prill 2017, kanë gjetur 184.39 kg narkotikë të llojit marihuanë, të fshehura në 10 tavolina të mëdha dhe katër tavolina të vogla. Po aty, thuhet se me rastin e bastisjes së shtëpisë së tani të pandehurit Ramadan Hyseni në fshatin Bibaj, Komuna e Ferizajt, më datë 26 prill 2017 janë gjetur 128 kg narkotikë të llojit marihuanë, të fshehura në 64 pako të dërrasave. Pastaj, më dt. 25 prill 2017 në fshatin Cernillë në shtëpinë e vëllait të të pandehurit Fatmir Statovci, në dy tavolina në të cilat pas hapjes së tyre janë gjetur 12 kg e 667.9 gram narkotikë të llojit marihuanë, të cilat i kishte dërguar i pandehuri Fatos Ahmeti. Ndërsa, më datë 30 prill 2017, me rastin e bastisjes së shtëpisë së kushëririt të tani të pandehurit Lutfi Nebihu në fshatin Sojevë, Komuna e Ferizajt, janë gjetur 500 kg narkotikë të llojit marihuanë të vendosura në 20 tavolina, me ç'rast në të gjitha vendet është sekuestruar më shumë se 824 kg e 706 gram narkotikë e llojit marihuanë.

Në dispozitivin numër II të aktakuzës, thuhet se Gëzim Abazi në intervalin kohor prej 7 shkurt 2017 deri 30 prill 2017, në Ferizaj, me dashje i kishte ndihmuar pjesëtarët e grupit të organizuar kriminal, duke i vënë në dispozicion këtyre të fundit mjete për kryerjen e veprës penale, ashtu që me kërkesë të Afrim Lumës dhe Amir Sherifit, Abazi ka dërguar për rregullim pajisjen për “Mbështjellje të ëmbëlsirave” tek Faton Krasniqi.

Sipas dispozitivit II të kësaj aktakuze, thuhet se pasi nuk ka mund ta rregullojë pajisjen, të njëjtën, e ka dërguar më pas tek Agim Berisha, duke kërkuar prej tij që t’ia rregullojë atë, e cila shërben për “Paketimin e duhanit”, që në fakt përdorej për paketim të narkotikëve. Pastaj, me kërkesë të pjesëtarëve të grupit kishte shkuar dy herë radhazi në fshatin Begracë, në fabrikën e pronarit Arsim Luzha ku prodhohen qese dhe kishte porositur qese me dimensione të posaçme 60x17 cm, “të cilat duhet të mbajnë 2-3 kg”, duke shfrytëzuar makinën në pronësi të Amir Sherifit, e që i akuzuari Gëzim Abazi e kishte regjistruar në emrin e tij. Kjo makinë thuhej se ka shërbyer për takime me Afrim Lumën dhe Amir Sherifin, si dhe shkuarjen në fabrikë për porosi të qeseve dhe marrjen e tyre tek mjeshtri për rregullimin e pajisjes për paketimin e narkotikut.

Ndryshe, Fatmir Statovci, Zeqir Berisha dhe Lutfi Nebihu, sipas aktakuzës, me dashje i kanë ndihmuar pjesëtarëve të grupit kriminal në fshehjen e mjeteve të veprës së kryer penale, ashtu që në shtëpinë e vëllait të tij, Fatmir Statovci ka fshehur dy tavolina në të cilat gjendeshin të fshehura 12 kg e 667.9 gram marihuanë; në shtëpinë e pabanuar të vëllait të tij, Zeqir Berisha ka fshehur 10-12 thasë marihuanë, disa tavolina dhe traj të drurit, dhe në ahur (stallë) të kushëririt të tij, Lutfi Nebihu ka fshehur 20 tavolina në të cilat janë fshehur rreth 500 kg marihuanë.

Andaj, sipas prokurorisë, të akuzuarit Afrim Luma, Ramadan Hyseni, Fehmi Gashi dhe Fatos Ahmeti, kanë kryer veprën penale “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar” nga neni 283, si dhe veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kurse, i akuzuari Gëzim Abazi ka kryer veprën penale “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar” në ndihmë nga neni 283 dhe “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ndërsa, Fatmir Statovci, Zeqir Berisha dhe Lutfi Nebihu, akuzohen se kanë kryer veprën penale “dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale” nga neni 388 paragrafi 2 nën paragrafi 2.8 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me shkresën nën shenjë PP/I.nr.67/2017, të datës 27 prill 2017, në çështjen penale kundër të pandehurve Afrim Luma, Ramadan Hyseni, Fehmi Ahmeti, Gëzim Abazi, Fatmir Statovci, ka marrë aktvendim për fillim të hetimeve më 29 prill 2017. Më pas kjo prokurori ka marrë aktvendim për zgjerim të hetimeve edhe ndaj Zeqir Berishës, kurse më 1 maj 2017, hetimet ishin zgjeruar edhe ndaj të pandehurve Amir Sherifi dhe Lutfi Nebiu.

Kjo prokurori aktakuzën e kishte ngritur më 12 prill të vitit 2018, derisa me anë të saj kishte kërkuar edhe konfiskim të veturave të të pandehurve Afrim Luma, Gëzim Abazi dhe Fatos Ahmeti të përfshira në urdhrin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të lëshuar nga gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Gjithashtu, ishte propozuar që të bëhet edhe konfiskimi i të gjitha tavolinave dhe dërrasave të cilat janë shfrytëzuar për fshehjen e substancës narkotike si dhe mjetet e punës: vegla për paketim, shkuma, shtrëngues me bulon, skele, dorëza të punës dhe peshore digjitale që janë përdorur në kryerjen e veprës penale nga të pandehurit e të cilat gjenden nën mbikëqyrjen e Njesisë së Hetimeve të DHTN në Ferizaj.

Ndërsa, shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 5 qershor 2018, pothuajse dy muaj pas ngritjes së aktakuzës. Gjatë kësaj seance, i akuzuari Zeqir Berisha, kishte pranuar fajësinë. Ndërkaq, në seancën e mbajtur më 6 qershor 2019, të akuzuarit kanë paraqitur mbrojtjen e tyre, ku tre nga të akuzuarit, Afrim Luma, Ramadan Hyseni e Gëzim Abazi kishin pranuar fajësinë.

Në seancën e mbajtur më 25 qershor, fjalët përfundimtare i kishin dhënë prokurori special Haki Gecaj, i akuzuari Afrim Luma me avokaten e tij Teuta Qaushi, i akuzuari Ramadan Hyseni me avokaten e tij Lirie Kovani, i akuzuari Fehmi Gashi me avokatin e tij Hazer Susuri, i akuzuari Fatos Ahmeti me avokatin e tij Avni Ibrahimini dhe i akuzuari Gëzim Abazi me avokatin e tij Shefqet Xhelili.

Kurse, në seancën e mbajtur më 11 korrik, fjalët përfundimtare janë dhënë nga i akuzuari Fatmir Statovci me avokatin e tij Enver Halili, i akuzuari Lutfi Nebiu me avokatin e tij Shemsedin Piraj dhe i akuzuari tjetër Zeqir Berisha. Shpallja e aktgjykimit nga ana e kryetarit Zyhdi Haziri është bërë me 16 korrik.

Të akuzuarit Afrim Luma dhe Ramadan Hyseni, janë dënuar me dënim me burgim efektiv prej 11 vitesh secilit, si dhe dënim me gjobë ku secili duhet të paguajë shumën prej 50 mijë eurosh. Fehmi Gashi është dënuar me 8 vite burgim efektiv dhe 20 mijë euro gjobë. Fatos Ahmeti është dënuar me 4 vite burgim dhe 10 mijë euro gjobë, kurse Gëzim Abazi është dënuar me 4 vite burgim dhe 5 mijë euro gjobë. Me dy vit burgim është dënuar Fatmir Statovci, me një vit burgim është dënuar i akuzuari Zeqir Berisha, kurse Lutfi Nebiu është liruar nga akuza. Ndaj tyre, gjithashtu është shpallur edhe dënimi plotësues, konfiskimi i narkotikut, veturës, dërrasave dhe veglave të punës, si dhe janë detyruar të paguajnë edhe për paushallin gjyqësor, ku secili prej të dënuarve do të paguaj nga 200 euro.

Ndryshe më 24 tetor ishte paraparë shqyrtimi i ankesave ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, në rastin e shënjestruar për liberalizim të vizave, ku Zeqir Berisha, Fatmir Statovci, Gëzim Abazi, Fehmi Gashi, Ramadan Hyseni, Afrim Luma dhe Fatos Ahmeti në korrik të këtij viti, i kishte shpallur fajtorë për vepra penale që lidhen me krim të organizuar.

Por, kjo seancë ishte shtyrë pasi që i dënuari Afrim Luma, pas referimit të lëndës nga gjykatësi referues, Vaton Durguti, kishte revokuar autorizimin e tij ndaj avokates Teuta Qaushi, kjo me arsyetimin se e njëjta e kishte mashtruar.

Kurse, më 12 dhjetor, është mbajtur seanca e kolegjit të Apelit, ku PSRK ka kërkuar dënimin e të liruarit nga shkalla e parë, Lutfi Nebiu. Në anën tjetër, mbrojtësit e të akuzuarve kishin kërkuar zbutjen e dënimeve.

Gjykata e Apelit, përmes një komunikate për media, kishte bërë të ditur se ka vërtetuar dënimet në këtë rast të shënjestruar për liberalizim të vizave për gjashtë nga të akuzuarit, ndërkaq ka kthyer në rigjykim rastin sa u përket të akuzuarve Gëzim Abazi dhe Lutfi Nebiut.

Tutje, kjo gjykatë ka bërë të ditur se është konfiskuar automjeti “ BMX X5”, të cilin e ka përdorur i akuzuari Afrim Luma për kryerje të veprës penale.

Si dhe kolegji i Apelit ka aprovuar pjesëshëm edhe ankesat e mbrojtësve të pandehurve Afrim Luma, Ramadan Hyseni, Fehmi Gashi dhe Fatos Ahmeti, ashtu që iu është zbutur dënimi me gjobë.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Tre vetura, 825 kg narkotikë të llojit marihuanë, tavolina, dërrasa, vegla për paketim, shkuna, shtrëngues me buton, skele, dorëzave të punës, peshore digjitale.

ANEX III: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të përfunduara në shkallë të parë, të cilat gjenden në procedurë ankimore

Në kuadër të këtyre rasteve të shënjestëruara hyjnë edhe dhjetë (10) raste të tjera të cilat janë gjykuar vetëm nga shkalla e parë dhe aktualisht ose janë në proces në Gjykatën e Apelit ose nuk ka përfunduar përpilimi i aktgjykimeve ende.

Në këto raste bëjnë pjesë 1) “Siguria”, 2) “MSH 2”, 3) “FAN”, 4) “Detyrimi”, 5) “Gold”, 6) “Posta”, 7) “Kristal”, 8) Avokati III”, dhe 9) “Gjykatësi”.

Nga këto nëntë (9) raste të shënjestëruara të cilat deri më tash kanë arritur të përfundohen në shkallë të parë, shtatë (7) nga to po presin të marrin vendimin e Gjykatës së Apelit, ndërsa të rasti “Avokati III” dhe “Gjykatësi” akoma nuk është përpiluar aktgjykimi.

Në këtë grup bën pjesë edhe rasti “Siguria”, lidhur me të cilin Gjykata Themelore në Prishtinë, pas 34 seancave gjyqësore, më 20 maj 2019, ka shpallur aktgjykimin me të cilën në mungesë të provave u liruan nga akuzat ish-kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku dhe gjashtë persona të tjerë.

Edhe pse, më 16 janar 2015 pas dyshimeve për dallavare me një tender të sigurimit fizik të objekteve të KEK-ut mbi gjashtë milion euro, ishte ngritur aktakuzë ndaj shtatë personave, shpallja e aktgjykimit në shkallë të parë ishte bërë vetëm pas 1586 ditësh. Ky rast fillimisht është trajtuar nga gjykatës të misionit të EULEX-it, por vendimi i shkallës së parë me të cilin u liruan të gjithë të akuzuarit u shqiptua pas më shumë se katër viteve gjykim.

Për rastin “Posta”, aktakuza ishte ngritur në gusht të vitit 2018, kurse gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin lirues ndaj të akuzuarve e ka shpallur pas 14 muajsh.

Rasti “Kristal” edhe pse pas afër dy vjetësh të procesit gjyqësor, më 12 shkurt 2018 ishte shpallur aktgjykim dënues ndaj 10 personave, këtë vendim e kishte hedhur poshtë Gjykata e Apelit më 6 shtator 2018, pasi kishte gjetur shkelje nga gjykata e shkallës së parë. E pas rastit të kthimit në rigjykim, në maj të vitit 2019, gjykata e shkallës së parë i kishte dhënë epilog këtij rasti.

Kurse, pas rigjykimit, më 24 dhjetor ka përfunduar në shkallë të parë edhe rasti “Gjykatësi”, në të cilin akuzohej ish-gjykatësja Safete Tolaj me dy persona të tjerë.

Në pritje të vendimit të Apelit, pas ankesave të parashtruara në këtë gjykatë, janë rastet “MSH II”, “Gold”, “Siguria”, “Fan”, “Detyrimi” dhe “Kristal”.

1. RASTI “SIGURIA”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.18/15.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ky rast është gjykuar nga gjyqtari e EULEX-it Vladimir Mikula, por më pas ka kaluar te gjyqtari vendor Beqir Kalludra.

Prokuror: Fillimisht ky rast është gjykuar nga prokurori i EULEX-it Paul Flynn, por më pas ka kaluar te prokurorja Florie Salihu-Shamolli.

Të pandehur: Sami Lushtaku, Esat Tahiri, Milazim Lushtaku, Driton Pruthi, Arben Gjukaj, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku.

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “Shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizim”, “Mashttrim”, “Lidhja e kontratës së dëmshme”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1811 DITË)



Më 2 shtator 2012, ishte ngritur kallëzim penal kundër kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtaku. Më 5 tetor 2012, prokurori i EULEX-it kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimit, kurse më 16 janar 2015 kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Sami Lushtakut, Esat Tahirit, Milazim Lushtakut, Driton Pruthit, Arben Gjukajt, Hysni Hoxhës dhe Azem Durakut për veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit” dhe “mashttrim”.

Ata akuzohen në lidhje me tenderin milionësh për sigurimin fizik të objekteve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Sami Lushtaku akuzohet për veprën penale “shtytje për

keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”, Arben Gjukaj e Hysni Hoxha për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku për veprat penale “mashtrimi” dhe “falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje”, Driton Pruthi për veprat penale “keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit” dhe “lidhja e kontratës së dëmshme”, si dhe Azem Duraku për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza në rastin kundër Sami Lushtakut dhe të tjerëve ishte ngritur me 16 janar 2015. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar dhe mbajtur në kohë rekord, vetëm pas katër ditëve nga ngritja e aktakuzës, respektivisht më 20 janar 2015 dhe shqyrtimi i dytë me 11 shkurt 2015. Përderisa, shqyrtimi i parë dhe i dytë ishin caktuar dhe mbajtur brenda afateve ligjore të përcaktuara me KPPK, mbajtja e shqyrtimit kryesor në këtë rast ishte shtyrë për më shumë se një vit, duke u mbajtur tek më 24 shkurt 2016.

Kjo lëndë ka kaluar nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, tek gjyqtari vendor Beqir Kalludra, po ashtu edhe nga prokurori Paul Flynn te prokurorja Florie Salihu-Shamolli.

Nga 24 shkurti i vitit 2016, kur ishte mbajtur seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor, e deri më tash janë caktuar 20 seanca gjyqësore, dhjetë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin. Më 2 nëntor 2018, ky gjykim kishte dështuar të mbahej për shkak se kryetari i trupit gjykues Beqir Kalludra, duhej të merrte pjesë në një trajnim të etikës.¹¹⁸ Kurse, seanca e paraparë për datën 14 dhjetor 2018 kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të akuzuarit Sami Lushtaku, për të cilin gjykatësi Kalludra kishte thënë se do të lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim.¹¹⁹

Ndërsa, për shkak të mungesës së mbrojtësve të të akuzuarve kishte dështuar të mbahej seanca e paraparë për 9 janar. Kjo për arsye se Oda e Avokatëve të Kosovës kishte hyrë në bojkot të përgjithshëm deri në tërheqjen e urdhëresës dhe rekomandimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që kishte të bëjë me kufizimin e avokatëve dhe palëve të tjera në objektet e gjykatave pa ftesë ose pa leje të kryetarit të gjykatës përkatëse.¹²⁰ Seanca e paraparë të mbahej më 23 prill 2019, në të cilën synohej të jepej fjala përfundimtare, kishte dështuar të mbahej për shkak se prokurorja e rastit, Florije Shamolli, nuk ishte e gatshme të jep fjalën përfundimtare pasi sipas saj në PSRK,

¹¹⁸ “Gjykatësi në trajnim, shtyhet gjykimi për rastin e njohur “KEK II” Betimi për Drejtësi, 2 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-ne-trajnim-shtyhet-gjykimi-ne-rastin-e-njohur-kek-ii/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹¹⁹ “Rasti “KEK 2”, mungon Sami Lushtaku, gjykatësi thotë se ndaj tij do të lëshohet urdhëresë për sjellje” Betimi për Drejtësi, 14 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-kek-2-mungon-sami-lushtaku-gjykatesi-thote-se-ndaj-tij-do-te-leshohet-urdherese-per-sjellje/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²⁰ “Avokatët bojkotojnë punën në gjykatë, dështon gjykimi ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi, 9 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokatet-bojkotojne-punen-ne-gjykate-deshton-gjykimi-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

kanë qenë të angazhuar me rastin e kthimit jashtëzakonshëm të disa qytetarëve të Kosovës nga Siria.¹²¹

Seanca e fundit që ishte mbajtur në këtë rast është ajo e 3 majit 2019, ku prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, kurse, mbrojtësit e të akuzuarve, kishin kërkuar lirimin e tyre nga akuza. Gjithashtu, mbrojtësi i të akuzuarit Esat Tahiri, kishte deklaruar se për njërin nga veprat penale që akuzohet i mbrojturi i tij, e që është “falsifikim i dokumentit” është arritur parashkrimi, andaj ai i kishte propozuar gjykatës që për atë vepër të shqiptojë aktgjykim refuzues.¹²²

Pas 34 seancave gjyqësore, prej të cilave 20 ishin mbajtur dhe 14 ishin shtyrë, është caktuar që shpallja e aktgjykimit të mbahet më 20 maj 2019, duke mos respektuar afatin e përcaktuar me ligj, sipas të cilit shpallja e aktgjykimit duhet të bëhet tre ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Më 20 maj, gjykatësi Beqir Kalludra, vendosi që ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë të lirohen nga akuzat që rëndonin mbi ta. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Kalludra, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale më të cilat ngarkohen. Kurse, ndaj Esat Tahirit dhe Milazim Lushtakut, u shpall aktgjykim refuzues për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, me arsyetimin se është arritur parashkrimi absolut. Të njëjtit u liruan sa i përket veprës penale të mashtrimit, kurse Tahiri edhe për shtytje për keqpërdorim të detyrës zyrtare.¹²³

Gjykatësi Kalludra, në shpalljen e aktgjykimit ishte deklaruar edhe për dëmin në këtë rast, që sipas tij është diskutuar edhe në media. Ai kishte vlerësuar se nuk mund të qëndrojë një aktakuzë e cila nuk ka përcaktuar në mënyrë të saktë vlerën e dëmit, që i është shkaktuar buxhetit të shtetit. “Është fol edhe në media për dëmin, nëse e keni aktakuzën para vete faqja 5 pika 5 , shuma 6 milion e 182 mijë, e njëjta faqe pika 3 është 100 mijë. Te pika tjetër është 50.000 mijë. Ju lutem shumë, kjo nuk duhet me ndodh. 6 milion është vlere e tenderit, dëmi duhet te ishte diferenca mes kompanive. Nuk mund të qëndroj një aktakuzë e tillë diku 100 mijë diku 6 milion”, kishte thënë gjykatësi në arsyetimin e tij pas shpalljes së aktgjykimit.

¹²¹ “Shtyhet dhënia e fjalës përfundimtare në gjykimin ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve për tenderin milionësh në KEK” Betimi për Drejtësi, 23 prill 2019 (Shih linkun - <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-dhenia-e-fjalës-përfundimtare-ne-gjykimin-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve-per-tenderin-milionesh-ne-kek/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²² “Përfundon gjykimi për tenderin milionësh në KEK, prokuroria kërkon dënimin e Sami Lushtakut dhe të tjerëve, mbrojtja e quan “aktakuzë të poshtër” Betimi për Drejtësi, 3 maj 2019 (Shih linkun - <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-gjykimi-per-tenderin-milionesh-ne-kek-prokuroria-kerkon-denimin-e-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve-mbrojtja-e-quan-aktakuze-te-poshter/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²³ “Sami Lushtaku dhe të tjerët lirohen nga akuzat në rastin e njohur KEK 2” Betimi për Drejtësi, 20 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-ne-rastin-e-njohur-kek-2/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit dhe nuk ka akoma vendim gjyqësorë.

Dëmi i pretenduar: 6,182,609.76 euro.

Sekuestrimi dhe konfiskimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

2. RASTI “GJYKATËSI”

Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: PKR.nr.154/17, numri i lëndës pas kthimit të rastit në rigjykim - PKR.nr.39/19

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Agim Maliqi, e më pas Ibrahim Idrizi.

Prokuror: Fillimisht ka qenë Valbona Dish-Haxhosaj, e më pas Rasim Maloku.

Të pandehur: Safete Tolaj, Fisnik Tolaj, Granit Shehaj.

Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Asgjësimi apo fshehja e materialit arkivor”; “Falsifikim i dokumentit zyrtar”; “Ushtrim i ndikimit” “Mashttrim”; “Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve”; “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 814 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Pejë më 9 tetor 2017, Safete Tolaj, akuzohej se në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Deçan, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin, përkatësisht për djalin e saj, të pandehurin Fisnik Tolaj, ka keqpërdorur autoritetin e saj zyrtar.

Sipas aktit akuzues, pasi që e pandehura më 2 janar 2017, e kishte caktuar paraburgimin për një të pandehur, Fisnik dhe Granit Shehaj takohen dhe ky i fundit duke shfrytëzuar detyrën zyrtare tejkalon kompetencat e tij dhe i jep shumën prej 1,900 euro të pandehurit Fisnik, për të ndikuar tek e pandehura, e cila më pas më 10 janar 2017, masën e paraburgimit e zëvendëson me masën e dorëzanisë.

Tutje, në aktakuzë thuhej se e pandehura Safete Tolaj, deri më 13 janar 2017 ka fshehur materialet arkivore të Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Deçan, ashtu që në shtëpinë e të njëjtës janë gjetur dosje origjinale të kësaj gjykate, e të cilat e kishin vendin në arkivin e gjykatës.

Gjithnjë, sipas aktakuzës, e pandehura deri më 13 janar 2017, në gjykatën e lartcekur i kishte mundësuar të pandehurit Fisnik Tolaj, përpilimin e dokumenteve dhe shkresave zyrtare ashtu që ky i fundit duke shfrytëzuar pozitën e të pandehurës dhe me dijeninë e saj, përdor vulën dhe shkresat zyrtare në të cilat fut përmbajtje të rreme.

Kjo aktakuzë më pas ishte ndryshuar e plotësuar nga ana e prokurorit Rasim Maloku.

Sipas aktakuzës së ndryshuar, Fisnik Tolaj lidhur me dispozitivin e parë, që ka të bëjë me rastin e Agron Kelmendit dhe Agron Ahmetgjekajt, në çështjen juridiko – civile C.nr.74/12, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë pasuror për vete, kishte kërkuar nga Agron e Berat Kelmendi shumë prej 20,000 euro me qëllim që të ushtronte ndikim mbi vendimmarrjen e gjyqtarës Safete Tolaj, e më pastaj ishin pajtuar që të shkëmbenin një truall në sipërfaqe prej 3.70 m² në emër të Agron Ahmetgjekajt, si dhe shumë prej 2,000 euro, akuzohej për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit”, nga neni 431 par.1 të KPRK-së, për dallim nga aktakuza e parë ku i njëjti për këto veprime akuzohej se kishte kryer veprën penale “mashttrim”, nga neni 355 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Ndërsa, është tërhequr pika ku ai akuzohej për veprën penale “mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të autorizuar të armëve” nga neni 374 par. 1 të KPK-së. Kurse, pikat e akuzës lidhur me kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve zyrtare”, nga neni 398 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së kishin mbetur të pandryshuara.

Lidhur me pikat e akuzës ndaj ish-gjykatëses Safete Tolaj, ku ajo akuzohej për tre vepra penale, si “keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, “asgjësim apo fshehje e materialit arkivor”, nga neni 416 të KPK-së. Tolaj akuzohej edhe për “falsifikim i dokumentit zyrtar”, nga neni 434 par.1 të KPK-së, e përshkruar në pikën tre të dispozitivit të aktakuzës fillestare të datës 9 tetor 2017, por për këtë vepër prokuroria kishte hequr dorë nga ndjekja penale sepse sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se e pandehura ka kryer këtë vepër penale.

Kurse, për të akuzuarin e tretë, zyrtarin Granit Shehaj, vepra ishte ri cilësuar dhe ai nuk ngarkohej më për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, por për kryerje të veprës penale “ushtrim i ndikimit në ndihmë”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Prokuroria Themelore në Pejë, kishte ngritur aktakuzë ndaj Safete Tolaj, Fisnik Tolaj e Granit Shehaj, më 9 tetor 2017. Këtë aktakuzë e kishte përpiluar prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj. Pas akuzave për korrupsion, gjykatësja në fjalë kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë dhe dorëheqjen e saj e kishte miratuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor të këtij 2017.¹²⁴ KGJK-ja, ndërkaq e kishte suspenduar Tolajn, nga pozita e gjykatëses mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore të Pejës, dega në Deçan, më 23 janar 2017.

Më 23 nëntor të vitit 2017 ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast ku të pandehurit nuk kishin pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkoheshin.¹²⁵ Më 26 janar 2018, Gjykata Themelore në Ferizaj, përkatësisht gjykatësi Agim Maliqi, e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e mbrojtjes për hudhjen e aktakuzës, kundërshtimin e provave dhe kërkesën për veçimin e procedurës ndaj ish-gjykatëses Safete Tolaj.¹²⁶ Kurse, më 12 mars të vitit 2018 edhe gjykata e shkallës së dytë kishte bërë konfirmimin e aktakuzës.

Kjo gjykatë, duke refuzuar ankesën për hudhje të aktakuzës, të parashtruar nga ana e mbrojtësit të Safete Tolajt, avokatit Kujtim Kërveshi, kishte vendosur që ta vërtetojë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me konfirmimin e aktakuzës. Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kishte filluar më 25 prill 2018, ku për ta gjykuar këtë rast ishte zgjedhur gjykatësi Ibrahim Idrizi, meqë gjykatësi paraprak Agim Maliqi, ishte emëruar gjyqtar në Gjykatën Supreme.¹²⁷

Prokurori Rasim Maloku, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2018, kishte bërë ndryshimin dhe plotësimin e aktakuzës. Prokurori Maloku, në këtë seancë ka thënë se ka vlerësuar që ka ndryshim të gjendjes faktike dhe për këtë ka bërë një ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës. Në aktakuzën e ndryshuar nga prokurori Maloku thuhej se ai tërhiqet nga ndjekja penale kundër të pandehurit Fisnik Tolaj, vetëm për veprën penale “mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të autorizuar të armëve”, e përshkruar në pikën pesë të aktakuzës sepse sipas tij, në shqyrtimin gjyqësor nuk është provuar se i pandehuri ka kryer atë vepër penale.

¹²⁴ “Jep dorëheqje gjykatësja e akuzuar për korrupsion, Safete Tolaj” Betimi për Drejtësi. 16 nëntor 2017(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/jep-doreheqje-gjykatesja-e-akuzuar-per-korrupsion-safete-tolaj/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²⁵ “Deklarohen të pafajshëm ish-gjykatësja e Deçanit, Safete Tolaj dhe dy të tjerët”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2017(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-ish-gjykatesja-e-decanit-safete-tolaj-dhe-dy-te-tjeret/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²⁶ “Konfirmohet aktakuza ndaj ish-gjykatëses Safete Tolaj dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 janar 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-ish-gjykateses-safete-tolaj-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²⁷ “Gjykata e Apelit konfirmon aktakuzën ndaj ish-gjykatëses, Safete Tolaj”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-konfirmon-aktakuzen-ndaj-ish-gjykateses-safete-tolaj/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Tutje, sipas aktakuzës se ndryshuar ndaj, ish-gjykatëses Safete Tolaj, ishte tërhequr pika tre e dispozitivit, ku ajo akuzohej për “falsifikim i dokumentit zyrtar”, me arsyetimin e njëjtë se sipas prokurorit Maloku, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se e pandehura ka kryer atë vepër penale. Mirëpo, prokurori i rastit Rasim Maloku, njëkohësisht kishte propozuar që konform nenit 96 paragrafi 1 dhe 97 paragrafi 2 të KPRK-së, nga Blerina Vishaj, bashkëshortja e të pandehurit Fisnik Tolaj të konfiskohet në mënyrë të përhershme banesa me sipërfaqe prej 57.42 m², në kompleksin banesor-afarist “Urban Living”, në lagjen “Mat 1”, në Prishtinë, e cila sipas tij, ishte dobi pasurore e fituar nga veprat penale të të pandehurit Fisnik Tolaj. Ndërsa për të akuzuarin e tretë, Granit Shehaj, vepra ishte ri cilësuar në veprën penale “ushtrim i ndikimit në ndihmë”.¹²⁸

Në këtë rast, gjykatësi Ibrahim Idrizi, ka respektuar në shumicën e rasteve kërkesën e KGJK-së, që rastet e shënjestruara të mos shtyhen më shumë se dhjetë ditë dhe pas 15 seancave të mbajtura në pjesën e parë të vitit 2018, një në muajin prill, gjashtë në muajin maj, gjashtë në muajin qershor dhe dy në muajin korrik, më 13 korrik 2018, ish-gjykatësja e Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Deçan, Safete Tolaj, ishte liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare.¹²⁹

Ajo ishte shpallur e pafajshme në të gjitha pikat e akuzës me të cilat ngarkohej. Kurse, djali i saj, Fisnik Tolaj, ishte dënuar me dënim unik prej katër vjet e gjashtë muaj burgim, pasi është shpallur fajtor për dy vepra penale “ushtrim i ndikimit” dhe “falsifikim i dokumentit”. Për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, ai ishte dënuar me tre vjet burgim, kurse për falsifikim të dokumenteve është dënuar me dy vjet burgim, por ndaj tij, më pas është shqiptuar dënimi unik prej katër vjet e gjysmë burgim. Fisnik Tolaj, sipas aktgjyqimit, do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga 13 janari 2017 deri më 07 korrik të atij viti. I pafajshëm ishte shpallur edhe zyrtari policor, Granit Shehaj, i cili ngarkohej me veprën penale për ndihmë në ushtrimin e ndikimit.

Pasi lënda, është dërguar në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë më 31 janar 2019, ka mbajtur seancën e kolegjit¹³⁰, ndërsa pas më pak se një muaji, kjo gjykatë, me arsyetimin se kishte gjetur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, këtë rast e kishte kthyer në rigjykim.¹³¹

¹²⁸ “Prokurori ndryshon dhe plotëson aktakuzën në rastin e ish-gjykatëses Safete Tolaj, shtyhet fjala përfundimtare”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-ndryshon-dhe-ploteson-aktakuzen-ne-rastin-e-ish-gjykateses-safete-tolaj-shtyhet-fjala-perfundimtare/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹²⁹ “Ish-gjykatësja, Safete Tolaj, lirohet nga të gjitha pikat e aktakuzës, djali i saj dënohet me katër vjet e gjysmë burgim (Video)”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-gjykatesja-safete-tolaj-lirohet-nga-te-gjitha-pikat-e-aktakuzes-djali-i-saj-denohet-me-kater-vjet-e-gjysme-burgim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³⁰ “Prokuroria kërkon rigjykim për ish-gjykatësen Safete Tolaj dhe rritje të dënimit për djalin e saj, mbrojtja kundërshton”. Betimi për Drejtësi. 31 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-rigjykim-per-ish-gjykatesen-safete-tolaj-dhe-rritje-te-denimit-per-djalin-e-saj-mbrojtja-kundershton/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³¹ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e ish-gjyqtarës Safete Tolaj, djalit të saj dhe zyrtarit policor”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-gjyqtarës-safete-tolaj-djalit-te-saj-dhe-zyrtarit-policor/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Më 20 shtator, kishte dështuar të mbahet seanca e parë pas kthimit në rigjykim të lëndës. Shkak për mos mbajtjen e kësaj seance kishte qenë mungesa e mbrojtësit të të akuzuarit Fisnik Tolaj, , avokatit Gëzim Kollçaku.¹³² Ndërkaq, në seancën e mbajtur më 16 tetor, gjykatësja Safete Tolaj, si dhe zyrtari policor, Granit Shehaj, i, sërish janë deklaruar të pafajshëm. Kurse, i akuzuari Fisnik Tolaj, djali i ish-gjykatëses Tolaj, ka pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale për të cilat është dënuar në aktgjykimin e parë, kurse është deklaruar i pafajshëm vetëm për veprën penale “ushtrimi i ndikimit”. Tutje, gjatë kësaj seance janë paraqitur fjalët hyrëse nga ana e palëve në procedurë.¹³³ Në këtë rast, seanca janë mbajtur edhe më 23 tetor e 2 dhjetor. Ndërsa, në seancën e mbajtur më 3 dhjetor, tre të akuzuarit kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore për tu mbrojtur në heshtje.¹³⁴

Më 23 dhjetor janë dhënë fjalët përfundimtare nga ana e palëve në procedurë. Gjatë kësaj seance, prokurori Rasim Maloku, kishte thënë se pas administrimit të provave materiale është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Ai i kishte propozuar gjykatës që të bëhet konfiskimi i banesës që ishte blerë në emër të bashkëshortes së të akuzuarit Tolaj, si dhe konfiskimin e 630 eurove të gjetura gjatë bastisjes, me arsyetimin se të njëjtat janë fituar në mënyrë të kundërligjshme. Këto propozime, i kishte kundërshtuar mbrojtësi i të akuzuarit Tolaj, avokati Gzim Kollçaku.

Ai i ka kërkuar gjykatës që lidhur me veprat për të cilat akuzohet i mbrojturi i tij, dhe të cilat i ka pranuar, t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, dhe atë, pranimin e fajësisë që në shqyrtimin e parë, pendesën e tij dhe premtimin që nuk do të kryej asnjëherë vepra penale të tjera, faktin që është mbajtës i vetëm i familjes, si dhe gatishmërinë e tij për të bërë kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarve. Ndërsa, për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, të cilën i akuzuari Tolaj ka mohuar ta ketë kryer, avokati Kollçaku i kishte kërkuar gjykatës që të bie aktgjykim lirues.

Në fjalën përfundimtare, i akuzuari Tolaj kishte kërkuar falje publike dhe ka shprehur keqardhje ndaj familjes dhe nënës së tij, duke thënë se me veprimet e tij, e njëjta është ballafaquar me këtë gjendje. Mbrojtësi i të akuzuarit Tolaj, avokati Kujtim Kërveshi, në fjalën përfundimtare kishte deklaruar se në mungesë të provave dhe dëshmime, ndaj klientes së tij duhet të shpallet aktgjykim lirues. Ndërsa, e akuzuara Tolaj kishte thënë se nuk ndihet fajtores dhe se nuk është

¹³² “Dështon të nis rigjykimi ndaj ish-gjykatëses Safete Tolaj, djalit të saj dhe zyrtarit policor”, Betimi për Drejtësi, 20 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-te-nis-rigjykimi-ndaj-ish-gjykat-eses-safete-tolaj-djalit-te-saj-dhe-zyrtarit-policor/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³³ “Pas kthimit në rigjykim, ish-gjykatësja Safete Tolaj dhe zyrtari policor sërish deklarohen të pafajshëm, djali i saj nuk e pranon fajësinë vetëm për njërin nga veprat për të cilat akuzohet”, Betimi për Drejtësi, 16 tetor 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykimi-ish-gjykat-esja-safete-tolaj-dhe-zyrtari-policor-serish-deklarohen-te-pafajshem-djali-i-saj-nuk-e-pranon-fajesine-vetem-per-njeren-nga-veprat-per-te-cilat-akuzohet/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³⁴ “Pas kthimit të rastit në rigjykim, ish-gjykatësja Safete Tolaj, djali i saj dhe zyrtari policor mbrohen në heshtje”, Betimi për Drejtësi, 3 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-te-rastit-ne-rigjykimi-ish-gjykat-esja-safete-tolaj-djali-i-saj-dhe-zyrtari-policor-mbrohen-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

përgjegjëse për rastet në fjalë. Po ashtu, në mungesë të provave, mbrojtësi i të akuzuarit Shehaj, avokati Fitim Malokaj, i kishte kërkuar gjykatës që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza.¹³⁵

Më 24 dhjetor, njëjtë si në gjykimin e parë, ish-gjykatësja Safete Tolaj, për herë të dytë është liruar nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe asgjësim apo fshehje të materialit arkivor. I pafajshëm është shpallur edhe zyrtari policor, Granit Shehaj, i cili akuzohet për veprën penale “ushtrim i ndikimit në ndihmë”. Ndërsa, djali i ish-gjykatëses Tolaj, Fisnik Tolaj, i akuzuar për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “ushtrim i ndikimit”, është dënua me dënim unik prej katër vjetësh burgim.

Për veprën penale të ushtrimit të ndikimit në vazhdimësi, të akuzuarin Tolaj e ka dënua me tre vjet burgim, ndërsa për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve në vazhdimësi, e ka dënua me një vit e gjashtë muaj burgim. Më pas, të akuzuarit Tolaj i është shqiptuar dënimi unik prej katër vjetësh burgim. Në këtë dënim, gjykatësi Idrizi tha se do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, nga 13 janar 2017, deri më 7 korrik 2017.

Kurse, ai është liruar për pikën e aktakuzës ku thuhet se në mes të datave 2 dhe 9 janar 2017, kishte kërkuar përfitim pasuror për vete ndaj atëherë të pandehurve Sh.H dhe B.H, ku përmes zyrtarit policor, tani të akuzuarit Granit Shehaj, ia kishin kërkuar vëllait të të pandehurve shumë prej 2000 euro, në mënyrë që atëherë gjykatësja Tolaj t'ua zëvendësonte masën e paraburgimit me atë të arrestit shtëpiak. Ai është obliguar të paguajë shumë prej 400 euro në emër të shpenzimeve të procedurës, si dhe 50 euro në emër të fondit të viktimave të krimit. Po ashtu, ai është obliguar që të dëmtuarit Kelmendi t'ia paguajë shumë prej 2000 euro, kurse të dëmtuarit Bajraktari, shumë prej 2500 euro.

Ndërsa, i dëmtuari Mehaj është udhëzuar në kontest civil, për kërkesë pasurore-juridike. Lidhur me propozimin e prokurorit të rastit, Rasim Maloku, që të bëhet konfiskimi i banesës që ishte blerë në emër të bashkëshortes së të akuzuarit Tolaj, si dhe konfiskimin e 630 eurove të gjetura gjatë bastisjes, me arsyetimin se të njëjtat janë fituar në mënyrë të kundërligjshme, gjykatësi Idrizi më anë të aktgjykimit ka aprovuar propozimin e konfiskimit të përhershëm të të hollave, ndërsa ka refuzuar propozimin për konfiskimin e banesës.¹³⁶

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Banesa me sipërfaqe prej 57.42 m², në kompleksin banesor-afarist “Urban Living”, në lagjen “Mat 1”, në Prishtinë, por kjo është refuzuar nga trupi gjykues. Kurse, është aprovuar konfiskimi i të hollave në vlerë prej 630 euro.

¹³⁵ “Përfundon rigjykimi ndaj ish-gjykatëses Safete Tolaj, djalit të saj dhe zyrtarit policor”. Betimi për Drejtësi. 23 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-rigjykimi-ndaj-ish-gjykateses-safete-tolaj-djalit-te-saj-dhe-zyrtarit-policor/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³⁶ “Ish-gjykatësja Safete Tolaj sërish shpallet e pafajshme, djali i saj dënohet me katër vjet burgim” Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-gjykatesja-safete-tolaj-serish-shpallet-e-pafajshme-djali-i-saj-denohet-me-kater-vjet-burgim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

3. RASTI “DETYRIMI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.458/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Arben Hoti.

Prokuror: Merita Bina-Rugova.

Të pandehur: Arben Bashota, Osman Bajrami, Sylejman Bajrami.

Veprat penale: “Pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar”; “Detyrim”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS DERI MË 31 DHJETOR 2019 KANË KALUAR 1241 DITË)



Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), me 8 gusht 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj Arben Bashotës, si dhe Osman dhe Sylejman Bajramit, për shkak të veprës penale të krimit të organizuar lidhur me veprën penale “detyrim”.

Sipas aktakuzës së PSRK-së, tre të akuzuarit së bashku me të ndjerin Ruzhdi Shaqiri, dhe me disa persona të tjerë të pa identifikuar, duke vepruar si grup kriminal, në krye me të akuzuarin Bashota, gjatë periudhës kohore shumë vjeçare kishin kryer krime të rënda me qëllim të përfitimit financiar.

Në aktakuzë thuhet se të njëjtit që nga viti 2004 kishin bërë presione të vazhdueshme në të dëmtuarit Murat Tërnavë, Hysen Shahini dhe Ismet Osmani, që ta lirojnë pronën kontestuese në sipërfaqe prej mbi 10 hektarësh, e cila gjendet në Fushë-Kosovë, rrugës për në Prishtinë, të cilën pronë e kishte marrë në shfrytëzim i dëmtuari Tërnavë për 10 vjet nga KBI Ndërmarrja Shoqërore “Bujqësia”. Në këtë pronë, të dëmtuarit kishin ndërtuar objekte në vlerë prej më shumë se 5 milionë euro.

I akuzuari Bashota po pretendohet se kishte siguruar aktgjykimin e falsifikuar të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të datës 21 shkurt 1997, sipas të cilit, kjo ngastër kadastrale i kthehej në pronësi personit Marko Mitroviq, si dhe një tjetër aktgjykim po ashtu të falsifikuar, me të cilin kinse Mitroviq, e kishte autorizuar atë që në emër të tij të ndërmarrë veprime juridike.

Pas kësaj, Bashota me këto dokumente false kishte kërkuar regjistrimin e ndryshimeve pronësore në kadastrë, duke vënë në lajthim drejtorin për Kadastrë dhe Gjeodezi, i cili me 10 mars 2004, kishte marrë aktvendim që kjo ngastër kadastrale të kalojë në emër të personit Marko Mitroviq.

Në aktakuzë thuhet se të akuzuarit me përpjekje për të përvetësuar këtë pronë, kishin siguruar 6 kontrata të falsifikuara, sipas të cilave Marko Mitroviq pronën ia kishte shitur personave: Xhavit dhe Shemsije Bashota, Smajl Mehmeti, Xhyle Maraj, Viloleta Ahmeti dhe Myzafer Maliqi. Duke përdorur këto dokumente, të akuzuarit kishin insistuar tek të dëmtuarit që ta lirojnë pronën, duke u paraqitur se toka ishte e tyre dhe që nga viti 2007, kishin filluar të përdornin edhe kërcënime serioze për t'i detyruar të dëmtuarit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre.

Gjithashtu, në këtë rast ka qenë i akuzuar edhe Ruzhdi Shaqiri, por ai ishte vrarë në gusht të vitit 2014, në Skënderaj, për të cilin rast Gani Geci, më 3 qershor të vitit të kaluar, ishte dënuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim, por që në tetor të vitit të kaluar ky rast ishte kthyer në rigjykim.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Si rrjedhojë e një kallëzimi penal të Policisë së Kosovës të 15 janarit 2015, PSRK-ja pas 11 ditëve kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve, ndaj Arben Bashotës dhe të tjerëve. Prokurorja e PSRK-së Merita Binaj-Rugova, pas gati dy vitesh hetime, më 8 gusht 2016, për veprat penale: “Pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar” dhe “Detyrim”, kishte ngritur aktakuzë ndaj Arben Bashotës, Ruzhdi Shaqirit dhe vëllezërve Osman dhe Sylejman Bajrami.

Pas arritjes së aktakuzës në gjykatë, shqyrtimi fillestar ishte caktuar pas dy muajsh, konkretisht më 14 tetor 2016, apo një muaj pas afatit të paraparë ligjor, ndërsa shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 21 nëntor 2016, duke respektuar afatin e përcaktuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pasi aktakuza ishte konfirmuar, seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ishte mbajtur më 25 prill 2017, apo pas pesë muajsh nga koha kur ishte mbajtur shqyrtimi i dytë. Në këtë rast, më pas, gjatë vitit 2017 ishin mbajtur edhe shtatë seanca të tjera, konkretisht më 6 qershor, 20 korrik, 28 shtator¹³⁷, 18 tetor, 9 nëntor dhe 21 nëntor, që i bie se në 12 muaj të vitit 2017, janë mbajtur vetëm tetë seanca të shqyrtimit gjyqësor.

¹³⁷“I dëmtuari thotë se për lirimin e pronës u kërcënuan e shantazhuan nga të akuzuarit për krim të organizuar” Betimi për Drejtësi, 28 shtator 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-demtuari-thote-se-per-lirimin-e->

Gjykatësi Hoti, seancën e parë për vitin 2018, e kishte gjykuar më 8 shkurt 2018¹³⁸, për të vazhduar më 7 mars, 18 maj dhe 14 qershor.

Kur në fillim të muajit korrik, punëtorët e administratës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial ishin futur në grevë, duke kërkuar paga më të larta, përfaqësuesit e grevisteve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 5 korrik, ishin pajtuar me kryetaren e kësaj gjykate Afërdita Bytyçi, që ata të jenë të pranishëm në gjykimet e rasteve të shënjestruara. Atë ditë ishte caktuar edhe seanca ndaj Bashotës dhe të tjerëve, por pasi ishte vendosur që të veprohet në këtë mënyrë, palët ishin larguar nga gjykata dhe në këtë formë kishte dështuar mbajtja e kësaj seance.¹³⁹

Pas dështimit të seancës së 5 korrikut, gjatë atij muaji, gjykatësi Hoti, brenda korrikut kishte caktuar edhe dy seanca të tjera, çka nuk kishte ndodhur më herët. Njëra ishte mbajtur më 13 korrik, ndërsa seanca e 18 korrikut kishte dështuar për shkak se aty munguan tre dëshmitarë të thirrur nga gjykata.¹⁴⁰

Udhëtimet zyrtare fillimisht të prokurores Merita Binaj-Rugova¹⁴¹ dhe më pas kryetarit të trupit gjykues Arben Hoti¹⁴², bënë që të dështojnë dy seancat e fundit për vitin 2018 – ajo e 10 shtatorit dhe ajo e 10 tetorit 2018.

Pas disa seancave të dështuara të vitit 2018, edhe viti 2019 filloi me shtyrje të seancës, këtë herë seanca u shty për shkak se të akuzuarit Arben Bashota, i ishte ndryshuar mbrojtësja e caktuar sipas detyrës zyrtare. Avokatja Luljeta Jashari, kishte kërkuar shtyrje të seancës, me arsyetimin

[prones-u-kercenuan-e-shantazhuan-nga-te-akuzuarit-per-krim-te-organizuar-i-kercenuan-e-shantazhuan-qe-ta-lirrojne-pronen/](#)). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³⁸ “Dëshmitarët thonë se pas kërcënimit nënshkruan kontrata të reja për qiramarrjen në Fushë Kosovë” Betimi për Drejtësi, 8 shkurt 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-thone-se-pas-kercenimit-nenshkruan-kontrata-te-reja-per-qiramarrjen-ne-fushe-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹³⁹ “Greva vazhdon, por mundësohet mbajtja e seancave në rastet e shënjestruara për liberalizimin e vizave (Video)” Betimi për Drejtësi, 5 korrik 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/greva-vazhdon-por-mundesohet-mbajtja-e-seancave-ne-rastet-e-shenjestruara-per-liberalizimin-e-vizave/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴⁰ “Mungojnë dëshmitarët, shtyhet gjykimi për krim të organizuar i shënjestruar për liberalizim të vizave” Betimi për Drejtësi, 18 korrik (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-deshmitaret-shtyhet-gjykimi-per-krim-te-organizuar-i-shenjestruar-per-liberalizim-te-vizave/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴¹ “Prokurorja në udhëtim jashtë vendit, shtyhet gjykimi për krim të organizuar, detyrim dhe falsifikim të dokumenteve” Betimi për Drejtësi, 10 shtatorit 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-ne-udhetim-jashte-vendit-shtyhet-gjykimi-per-krim-te-organizuar-detyrim-dhe-falsifikim-te-dokumente/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴² “Gjykatësi në udhëtim zyrtar, shtyhet gjykimi për krim të organizuar, detyrim dhe falsifikim të dokumenteve” Betimi për Drejtësi, 10 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-ne-udhetim-jashte-vendit-shtyhet-gjykimi-per-krim-te-organizuar-detyrim-dhe-falsifikim-te-dokumente/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

se i duhet kohë për të përgatitur lëndën, ndërsa seanca e radhës është caktuar për 20 shkurt 2019.¹⁴³

Në seancën e mbajtur më 20 mars 2019, të gjithë të akuzuarit ishin mbrojtur në heshtje¹⁴⁴, ndërsa më 30 prill, ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Më 6 maj 2019, kryetari i trupit gjykues Arben Hoti kishte shpallur aktgjykimin me të cilin të gjithë të akuzuarit ishin shpallur fajtorë.¹⁴⁵

Kështu, për veprën penale të detyrimit, lidhur me veprën penale të bashkimit kriminal, i akuzuari Arben Bashota, është dënuar me gjashtë vite burgim dhe të njëjtit i është caktuar menjëherë masa e paraburgimit. Osman Bajrami është dënuar me katër vjet e gjashtë muaj burgim, kurse Sylejman Bajrami është dënuar me tre vjet burgim, të cilëve gjithashtu do t'u llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Me shpalljen e aktgjykimit, është bërë e ditur se të akuzuarit Bashota i janë konfiskuar veturat “Chevrolet” dhe “BMW”. Nga i akuzuari Osman Bajrami është konfiskuar vetura “Audi A4”, derisa Sylejman Bajrami i është konfiskuar shuma prej 10 mijë eurove.

Sipas, gjykatësit Arben Hoti, për të gjitha këto, gjykata ka konsideruar dhe vërtetuar se janë dobi pasurore të përfituara me vepër penale. Ai kishte deklaruar se trupi gjykues e ka ri kualifikuar veprën penale të krimit të organizuar, duke i ngarkuar të akuzuarit vetëm me veprën penale “detyrimi”, lidhur me veprën penale “bashkimi kriminal”.¹⁴⁶

Ndërkaq, më 12 dhjetor, një kolegji i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit, ka shqyrtuar ankesat e ushtruara nga ana e PSRK-së, si dhe mbrojtësve të akuzuarve, Arben Bashota, Osman Bajrami dhe Sylejman Bajrami.

E pakënaqur me aktgjykimin e Themelores, PSRK-ja është ankuar në Apel, të cilës i ka propozuar që rastin ta kthen në rigjykim. Sipas PSRK-së, edhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë të buta dhe jo në harmoni me udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme. Të akuzuarit përmes mbrojtësve të tyre, janë ankuar në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar që të lirohen nga akuzat apo të rigjykohen. Derisa, fillimisht ankesat e avokatëve mbrojtës pretendonin se në aktgjykimin e shkallës së parë ka pasur edhe shkelje esenciale të

¹⁴³“Avokatja e papërgatitur për seancë, shtyhet gjykimi në rastin e shënjestruar për liberalizim të vizave” Betimi për Drejtësi, 22 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokatja-e-papergatitur-per-seance-shtyhet-gjykimi-ne-rastin-e-shenjestruar-per-liberalizim-te-vizave/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴⁴“Gjykimi për krim të organizuar, Arben Bashota dhe të tjerët mbrohen në heshtje” Betimi për Drejtësi, 20 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krim-te-organizuar-arben-bashota-dhe-te-tjeret-mbrohen-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴⁵“Arben Bashota dhe dy të tjerët dënohen me mbi 13 vjet burg për dallaveret me pronën në Fushë Kosovë” Betimi për Drejtësi, 6 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arben-bashota-dhe-te-tjeret-denohen-me-mbi-13-vjet-burg-per-dallaveret-me-pronen-ne-fushe-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁴⁶ Po aty

dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, të njëjtit gjatë seancës së kolegjit të Apelit hoqën dorë nga këto dy baza ankimore.¹⁴⁷

Dëmi i pretenduar: Nuk është përcaktuar në aktakuzë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Veturat “Chevrolet”, “BMË”, “Audi A4” dhe dhjetëmijë (10,000) euro .

¹⁴⁷ “Apeli shqyrton ankesat e palëve në rastin e të dënuarve për dallaveret me pronën në Fushë Kosovë”. Betimi për Drejtësi, 12 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-shqyrton-ankesat-e-paleve-ne-rastin-e-te-denuarve-per-dallaveret-me-pronen-ne-fushe-kosove/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

4. RASTI “MSH 2”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.382/15.

Kryetari i Trupit Gjykses: Valbona Musliu-Selimaj.

Prokuror: Fillimisht ka qenë Admir Shala, e më pas Florije Salihu-Shamolli.

Të pandehur: Ilir Tolaj, Bekim Fusha, Zenel Kuqi, Valentina Haxhija-Pacolli, Remzije Thaçi, Florije Tahiri. Kanë qenë të përfshirë edhe Arion Lleshi dhe Shpend Agani, por të njëjtit kanë arritur marrëveshje për pranim të fajësisë.

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashtrimi”, Përdorimi i paautorizuar i firmës, i markës apo i modelit të huaj”, “shmangia nga tatimi në bashkëkryerje”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1640 DITË)



PSRK më 23 prill 2013, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Ilir Tolajt, ish Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të tjerëve. Më 6 korrik 2015, PSRK kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ilir Tolajt, Bekim Fushës, Zenel Kuqit, Valentina Haxhijajt, Remzije Thaçit dhe Florije Tahirit për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas PSRK, Ilir Tolaj si Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Bekim Fusha si ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit Farmaceutik në MSH dhe Zenel Kuqi si menaxher i Prokurimit në MSH, gjatë periudhës kohore 23 maj 2011 deri më 31 dhjetor 2011, në bashkëveprim i kanë sjellë përfitime kompanisë “KMI” SHPK Drenas, me pronar Arian Lleshin dhe Shpend Aganin, në vlerë prej 400 mijë eurosh. Valentina Haxhijaj, Remzije Thaçi dhe Florije Tahiri akuzohen se si anëtare të Komisionit për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të kontratës, i kanë mundësuar kompanisë “KMI” të bëjë manipulim me sasinë e barërave. Me këtë, në vazhdimësi, ato akuzohen se kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Zenel Kuqi akuzohet se si menaxher i prokurimit, gjatë periudhës ndërmjet 23 majit 2011 dhe 31 dhjetorit 2011 i ka tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë materiale nga

kompania “ACG” dhe “Standart”, për aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral i aneksit të Emergjencës ekzistuese në QKUK”. Kompania “Alb Architect” në aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral dhe adaptimi i katit përdhësë në Klinikën Interne, në repartin e ri për dializë në QKUK”, si dhe kompania “Life Farm” për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me infuzione”, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës, në vlerën totale prej 277,307.97 eurove.

Në aktakuzën e njëjtë ishin të përfshirë edhe dy biznesmenët Arion Lleshi dhe Shpend Agani, mirëpo të dy kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë. Si rrjedhojë, gjykata i kishte shpallur fajtor dy biznesmenët, duke i dënuar me nga dy vjet burgim me kusht dhe me nga 1,000 euro gjobë. Sipas aktgjykimit të GjTh në Prishtinë, të njëjtit, po ashtu obligohen që t’i kthejnë shtetit dëmin e shkaktuar prej 400 mijë eurove.

Sipas prokurorisë, Lleshi dhe Agani akuzoheshin se kanë bërë paraqitje të rreme apo kanë fshehur fakte, gjë kjo e cila ka rezultuar në dëmtimin e buxhetit të MSH-së, si dhe të njëjtit i janë shmangur pagimit të tatimeve dhe kontributeve të tjera për punëtorë, të përcaktuara me ligj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Ilir Tolajt dhe të tjerëve ishte caktuar në GjTh në Prishtinë me vonesë prej katër muajsh, respektivisht ishte caktuar më 8 dhjetor 2015. Kjo seancë ishte shtyrë dhe ishte mbajtur vetëm më 20 janar 2016. Shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 26 shkurt 2016. Edhe shqyrtimi kryesor në këtë rast është caktuar me vonesa, respektivisht mbi gjashtë muaj pas shqyrtimit të dytë. Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ishte caktuar më 9 shtator 2016, por e njëjta ishte shtyrë për 15 shtator 2016. Deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në këtë rast janë caktuar 25 seanca gjyqësore, pesë nga të cilat kishin dështuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 6 qershor të vitit 2018, kishte shpallur aktgjykimin, sipas të cilit Tolaj dhe pesë të tjerët ishin shpallur të pafajshëm, pasi sipas kryetares së trupit gjykues Valbona Musliu-Selimaj, nuk ishte provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale më të cilat ngarkoheshin.¹⁴⁸

Pasi të akuzuarit e tjerë Arion Lleshi dhe Shpend Agani kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë, ata gjykata i kishte shpallur fajtor, duke i dënuar me nga dy vjet burg me kusht dhe me nga 1,000 euro gjobë. Sipas aktgjykimit të GjTh në Prishtinë, të njëjtit po ashtu obligohen që t’i kthejnë shtetit dëmin e shkaktuar prej 400 mijë eurove.

¹⁴⁸“Ilir Tolaj dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për korrupsion në rastin e asgjësimit të barnave pa afat (Video)”Betimi për Drejtësi. 6 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ilir-tolaj-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-korrupsion-ne-rastin-e-asgjesimit-te-barnave-pa-afat/>. (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Më 17 tetor 2019, në seancën e mbajtur në Gjykatën e Apelit, PSRK ka kërkuar që ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ilir Tolaj dhe pesë zyrtarë të tjerë të kësaj ministrie, të gjykohen sërish për akuzat për korrupsion, në rastin e asgjësimit të barnave pa afat.

Por, si të panevojshëm rigjykimin e klientëve të tyre, e kanë parë mbrojtësit e të akuzuarve, të cilët, Gjykatës së Apelit i kanë propozuar që të refuzojë ankesën e PSRK-së dhe të vërtetojë aktgjykimin lirues që e kishte marrë gjykata e shkallës së parë.¹⁴⁹

Dëmi i pretenduar: 476.307.97 euro.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Nuk ka kërkesë për konfiskim.

¹⁴⁹ “Prokuroria kërkon rigjykim për Ilir Tolajn dhe të tjerët, mbrojtësit kërkojnë që të vërtetohet pafajësia e tyre”. Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-rigjykim-per-ilir-tolajn-dhe-te-tjeret-mbrojtesit-kerkojne-qe-te-vertetohet-pafajesia-e-tyre/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

5. RASTI “FAN”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.734/15.

Kryetar i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti.

Prokurore: Fikrije Fejzullahu.

Të pandehur: Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku.

Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “mashtrimi”, “shmangie nga tatimi”, “legalizim i përmbajtës së rreme”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 MAJ 2019, KANË KALUAR 1470 DITË)



Rasti kundër Naser Osmanit kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 28 prill 2014. PSRK më 30 prill 2014, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse kjo Prokurori më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë kundër deputetit Naser Osmani si nënkryetari i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabanit si drejtor i bordit të AKP – së, pastaj kundër Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, të gjithë zyrtarë në AKP si dhe kundër biznesmenit Agim Deshishku.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si Drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Lluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Agron Kamberi si kryesues të Njesisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtar të AKP-së: Lisa Brodey, Mohammed Omran dhe Hubert

Warsmann, i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000.00 euro.

Ata akuzohen se kanë shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar dëm Ndërmarrjes Shoqërore “FAN” e përfaqësuar nga AKP-ja si dhe buxhetit të shtetit, lidhur me çështjen e Ndërmarrjes së Re “FAN-Podujevë”. Kjo e fundit, ishte privatizuar në valën e 7-të të shitjes nga AKM-ja, ku ishte blerë me çmim prej 2,310,000.00 euro nga blerësi, i akuzuari Agim Deshishku, sipas kontratës së nënshkruar me zotimet e fituara të bëjë investime në vlerë prej 2,800,000.00 euro dhe të punësojë 236 punëtorë përgjatë periudhës dy vjeçare.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është caktuar më 17 mars 2016. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë për 4 prill 2016. Në seancën e 4 prillit 2016, përderisa prokurori special Admir Shala ka lexuar aktakuzën, Naser Osmani dhe Bahri Shabani, pjesë e bordit të drejtorëve të AKP-së, nuk ishin deklaruar lidhur me fajësinë, me arsyetimin se prezent duhet të jenë të gjithë anëtarët e bordit.¹⁵⁰ Shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti ishte caktuar më 10 prill 2017, pra pas më shumë se një viti, por e njëjta ishte shtyrë për dy herë më radhë, ndërsa u arrit të mbahet vetëm më 12 korrik 2017. Më 29 janar 2019, ishte paraparë të bëhej shpallja e aktgjykimit për këtë rast, mirëpo gjykatësi Shashivar Hoti kishte bërë të ditur se në kohën që trupi gjykues ka pasur në dispozicion nuk ka arritur të bëjë shqyrtimin e të gjitha shkresave të lëndës dhe shpallja është shtyrë për 8 shkurt 2019.¹⁵¹

Pas 27 seancave gjyqësore, shtatë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin dhe gati 3 vjet pas ngritjes së aktakuzës, më 8 shkurt 2019, deputeti Naser Osmani dhe të akuzuarit tjerë Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka dhe Naim Avdiu ishin shpallur të pafajshëm për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

I pafajshëm për legalizim të përmbajtës së rreme në vazhdimësi, ishte shpallur edhe i akuzuari Agim Deshishku. Mirëpo, Deshishku ishte gjetur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë për veprën penale të mashtrimit në vazhdimësi, për çka ishte dënuar me 1 vit burgim. Kurse, për veprën penale të shmangies nga tatimi, Deshishku ishte dënuar me 1 vit burgim dhe 10 mijë euro gjobë. Ndaj tij ishte shqiptuar dënim unik prej 1 viti e 8 muajsh burgim, ku do t'i llogaritej edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Gjithashtu, sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Shashivar Hoti, i akuzuari Agim Deshishku obligohej që dëmin prej 53,807.46 euro t'ia

¹⁵⁰ “Fillon gjykimi, Naser Osmani dhe të tjerët në rastin e AKP-së deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 4 prill 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/fillon-gjykimi-naser-osmani-dhe-te-tjeret-ne-rastin-e-akp-se-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁵¹ “Shtyhet shpallja e aktgjykimit ndaj deputetit Naser Osmani dhe të tjerëve për privatizimin e fabrikës “FAN” Betimi për Drejtësi 29 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shpallja-e-aktgjykimit-ndaj-deputetit-naser-osmani-dhe-te-tjereve-per-privatizimin-e-fabrikes-fan/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

kompensojë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), si dhe të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në vlerë prej 300 euro. Ndërkaq, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ishte udhëzuar në kontest civil. Sipas aktgjyqimit, ishte refuzuar edhe kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e ndërmarrjes “FAN”.¹⁵²

Ndryshe, ndaj Agron Kamberit, në fillim ishte pushuar procedura, pasi ndaj tij prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale. Gjykata e Apelit më 30 dhjetor 2019, kishte mbajtur seancën e kolegjit, në të cilën seancë prokuroria kishte kërkuar që ky rast të kthehet në rigjykim.¹⁵³

Dëmi i pretenduar: Mbi 5 milionë euro.

Sekuestrimi dhe konfiskimi: Është refuzuar kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e ndërmarrjes “FAN”

¹⁵² “Deputeti Naser Osmani dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për keqpërdorim pozite, dënohet Agim Deshishku” , Betimi për Drejtësi, 2 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-naser-osmani-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-keqpërdorim-pozite-dënohet-agim-deshishku/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁵³ Prokuroria kërkon që ish-deputeti Naser Osmani dhe të tjerët të rigjykohen për rastin “FAN” Betimi për Drejtësi, 30 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-qe-ish-deputeti-naser-osmani-dhe-te-tjeret-te-rigjykohen-per-rastin-fan/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

6. RASTI “GOLD”

Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: P.nr137/18.

Kryetar i Trupit Gjykses: Shabi Idrizi.

Prokuror: Valdet Avdiu

Të pandehur: Visar Ibraj, Gani Ibraj, Bujar Ibraj, Shefqet Lajqi, Naser Balkan, Ibrahim Balkan, Taulant Lajqi, Haki Ibraj, Izet Balkan, Shenoll Ballkan, Recep Balkan, Ardit Ibraj, Sabedin Sharku, Marsel Seba, Kristina Seba, Agron Osmani, Xhemajl Bajrami, Behar Pruthi, Enver Tertini, Ilaz Ilazi, Ridvan Halimi, Arian Hasani, Edmond Zhaveli, Fuad Llausha, Abduraman Bakiq, Hilmi Jupolli, Hizir Cini, Ozan Shporta, Qemal Foki, Naser Kamberi, Taulant Tamiku, Durim Sulejmani, Bastri Ismajli dhe Orhan Kasemi.

Vepra penale: “Kontrabandim i mallrave”; “Tregti e ndaluar”; “Shmangia nga tatimi”; “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 695 DITË)



Prokuroria Themelore në Ferizaj më 5 shkurt 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj 34 personave, nga të cilët Visar Ibraj, Gani Ibraj, Bujar Ibraj, Shefqet Lajqi, Naser Balkan, Ibrahim Balkan, Taulant Lajqi, Haki Ibraj, Izet Balkan, Shenoll Ballkan, Recep Balkan, Ardit Ibraj, akuzohen se nga fillimi i muajit janar e deri më 8 shtator 2016, në bashkëkryerje duke kaluar vijën kufitare kanë shmangur kontrollin doganor në pikën kufitare Hani i Elezit, ku kanë bartur nga Turqia për në Kosovë, fshehurazi mallrat të llojit ari dhe argjend, me autobusët e kompanisë “Alper”, ku në shumë të përgjithshme kanë shmangur tarifë doganore prej 243,275.39 euro.

Në aktakuzë thuhet se të akuzuarit me qëllim që të fshehin apo t'i shmangen tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, nuk i kanë përfshirë të dhënat lidhur me të ardhurat e tyre, pasurinë, si dhe pa autorizim kanë zhvilluar tregti të ndaluar.

Gjithashtu, sipas aktakuzës, duke vepruar në bashkëkryerje kanë organizuar rrjetin e shitësve, duke shitur dhe shpërndarë ari dhe argjend, i cili ishte sjellë fshehurazi nga Turqia në Kosovë.

Me këtë, ata ngarkohen për kryerjen e veprave penale “kontrabandim i mallrave”, nga neni 317, “tregti e ndaluar”, nga neni 305, dhe “shmangia nga tatimi” nga neni 313 par. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërsa të akuzuarit Sabedin Sharku, Marsel Seba, Kristina Seba, Agron Osmani, Xhemajl Bajrami, Behar Pruthi, Enver Tertini, Ilaz Ilazi, Ridvan Halimi, Arian Hasani, Edmond Zhaveli, Fuad Llausha, Abduraman Bakiq, Hilmi Jupolli, Hizir Cini, Ozan Shporta, Qemal Foki, Naser Kamberi, Taulant Tamiku, Durim Sulejmani, Bastri Ismajli dhe Orhan Kasemi, akuzohen të kenë kryer veprën penale “blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale” nga neni 345 par. 1 lidhur me par. 3 të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Pranë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Divizioni Kundër Krimit të Organizuar në Policinë e Kosovës, kishte paraqitur kallëzim penal më 5 shkurt 2016. Aktvendimi për fillim të hetimeve ishte marrë më 22 shkurt 2016, më pas hetimet ishin zgjeruar më 22 shkurt, 6 shtator 2016 dhe 3 maj 2017, ndërsa aktakuzën në gjykatë e kishte ngritur më 5 shkurt të vitit 2018.

Fillimisht, ky rast ka qenë i ngritur nga Prokuroria Speciale pasi të akuzuarit dyshoheshin se kanë vepruar si grup kriminal, por më pastaj dyshimet ekzistonin vetëm për veprat “kontrabandë e mallit”, “tregti e ndaluar”, “shmangia nga tatimi”, si dhe “blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur nëntë muaj pas ngritjes së aktakuzës, duke mos u përfillur afati ligjor i paraparë prej 30 ditësh. Pasi të akuzuarit nuk e kishin pranuar fajësinë dhe ishte konfirmuar aktakuza, gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte arritur të mbaheshin tetë seanca, ndërsa fjala përfundimtare është dhënë më 27 dhjetor 2018, ku avokatët kishin kërkuar plotësimin e ekspertizës financiare të punuar nga eksperti Vehbi Imeri, i cili ishte i caktuar me kërkesën e vet avokatëve të 34 të akuzuarve, mirëpo një kërkesë e tillë ishte refuzuar.

Pas 10 muajve proces gjyqësor, më 31 dhjetor 2018, me anë të aktgjykimit të shpallur nga kryetari i trupit gjykues Shabi Idrizi, të pandehurit Visar Ibraj, Gani Ibraj, Bujar Ibraj, Shefqet Lajqi, Naser Balkan, Ibrahim Balkan, Taulant Lajqi, Haki Ibraj, Izet Balkan, Shenoll Ballkan, Recep Balkan, Ardit Ibraj, ishin shpallur fajtor për shkak të veprës penale “kontrabandë me mallra” të kryer në bashkëkryerje.

Të akuzuarit Sadedin Sharku, Marsel Seba, Kristjan Seba, Agron Osmani, Xhemajl Bajrami Behar Pruthi, Enver Tertini, Ilaz Ilazi, Ridvan Halimi, Arian Hasani, Edmond Zhaveli, Fuad Llausha, Abdurahman Bakiq, Hilmi Jupolli, Hizir Cini, Ozan Shporta, Qemal Foki, Naser Kamberi, Taulant Tamniku, Durim Sylejmani, Bastri Ismajli dhe Orhan Kasemi, ishin shpallur fajtor për shkak të veprës penale “blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”.

Visar Ibraj, ishte dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 180ditëve, i cili dënim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3,000 eurove. Gani Ibraj i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 ditëve, i cili dënim i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 2,500 eurove. Bujar Ibraj është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, i cili dënim është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë dymijetëqind euro . Shefqet Lajqi është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 150 ditëve, i cili dënim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2,000 eurove. Pastaj, Naser Ballkanit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2,800 eurove. Kurse, Ibrahim Ballkan, dënimi burgimi në kohëzgjatje prej 180 ditëve, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3,000 eurove.

Taulant Lajqi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej njëmijetëqind euro. Haki Ibraj, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej njëmijedyqind euro. Izet Ballkan, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej dymijë euro. Shenoll, Ballkan, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë ditëve, i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej tremijë euro. Recep Ballkan, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej dymijë euro. Ardit Ibraj, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Gjithashtu, të njëjtit obligohen t’ia kompensojnë të dëmtuarës dëmin në vlerë prej 243,275.39 euro.

Sadedin Sharku , dënim burgimi në kohëzgjatje prej një vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Marsel Seba, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Kristina Seba, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Agron Osmani, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Xhemajl Bajrami, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Behar Pruthi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindnjëzet ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Enver Terten, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Ilaz Ilazi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Ridvan Halimi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Arian Hasani, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Edmond Zhavelli, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Fuad Llausha, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Abduraman Bakiqi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Hilmi Jupolli, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Hizir Cini, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Ozan Shporta, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Qemal Foki, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Naser Kamberi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Taulant Tamniku, dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Durim Sulejmani, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të

ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Bastri Ismajli, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Orhan Kasemi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Të pandehurit Visar Ibraj, Gani Ibraj, Bujar Ibraj, Shefqet Lajqi, Naser Balkan, Ibrahim Balkan, Taulant Lajqi, Haki Ibraj, Izet Balkan, Shenoll Ballkan, Recep Balkan dhe Ardit Ibraj janë liruar nga akuza për veprat penale “shmangia nga tatimi” dhe veprën penale “tregti e ndaluar”.

Sipas aktgjykimit të shkallës së parë, sasia e sekuestruar e arit prej 28,439.97 gram që rezulton me shmangie të përgjithshme doganore në shumën prej 228,404.923 euro dhe sasia e argjendit prej 47,526.91 gram ose në shumën prej 14,871.16 euro, si dhe autobusi i kompanisë "Alper" do të mbeten të konfiskuara në arkën shtetërore. Ky rast akoma nuk ka arritur në Gjykatën e Apelit.¹⁵⁴ Kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit.

Dëmi i pretenduar: 541.603.58 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: 28,439.97 gram ari, 47,526.91 gram argjend dhe autobusi i kompanisë “Alper”.

¹⁵⁴ Nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, z.Arber Jashari, për IKD-në, e datës 25.04.2019

7. RASTI “KRISTAL”

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr.76/18.

Kryetar i Trupit Gjykses: Xheladin Osmani.

Prokuror: Merita Bina- Rugova.

Të pandehur: Tunë Kqira, Gjon Kqira, Ekrem Leci, Hill Kaqinari, Kastriot Kqira, Gjeksion Kqira, Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj dhe Zyrafete Hukolli, Ragip Fazlija dhe Sejdë Kaqorraj, Marjan Kqira, Zef Oroshi.

Veprat penale: “Krim i organizuar”, “Shpëlarje e parave”, “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”, “Fajde”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizura të armëve”, “Detyrimi”.

Faza e procedurës: E përfunduar në shkallë të parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 1325 DITË)



Më 18 maj 2016, PSRK, ka ngritur aktakuzën e cila i ngarkon ta akuzuarit Tunë Kqira, Gjon Kqira, Ekrem Leci, Hill Kaqinari, Kastriot Kqira, Gjeksion Kqira, Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj dhe Zyrafete Hukolli, Ragip Fazlija dhe Sejdë Kaqorraj me veprat penale të “krimit të organizuar”, “fajde”, “detyrim”, “shpëlarje e parave”, “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” dhe “armëmbajtje pa leje”.

Sipas aktakuzës, këta persona duke vepruar në grup kanë shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarve, duke u dhënë atyre shuma të mëdha parash e duke kërkuar nga të njëjtët kthimin e borxhit me kamatë disproporcionale.

Aktakuza përshkruan se si Pal Gruda nga Prizreni është detyruar të paguajë kamatë ditore deri në 500 euro dhe mujore deri në (3,000) tremijë euro. Grudës, një borxh prej 20 mijë euro i ishte

shndërruar me anë të kamatës jo-proporcionale deri në afro 1 milion euro. I zënë ngushtë nga presioni i këtij grupi për të paguar “borxhin”, familja Gruda ka paraqitur rastin në polici.

Tunë Kqira, sipas aktakuzës, ka qenë në krye të grupit kriminal duke i udhëhequr punët e paligjshme të kryera nga ta. Në këtë rast penal ishin sekuestruar disa prona të familjes Kqira, për të cilat, organi i akuzës, pretendon se janë fituar në mënyrë të kundërligjshme, e cila pasuri e sekuestruar vlerësohet të jetë disa miliona euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal në këtë rast nga ana e Policisë së Kosovës ishte paraqitur më 12 janar të vitit 2015, e pas 4 muajsh, më 29 maj të vitit 2015 nga PSRK ishte nxjerrë aktvendimi për fillim të hetimeve. Këto hetime, epilogun e kishin pasur më 18 maj të vitit 2016 me ngritjen e aktakuzës nga ana e PSRK-së.

Gjykata Themelore në Prizren, tre muaj pas ngritjes së aktit akuzues, ka mbajtur seancën fillestare në këtë rast duke mos përfillur afatin e paraparë ligjor prej 30 ditësh. Përkatesisht, seanca e shqyrtimit fillestar ishte mbajtur më 23 gusht të vitit 2016. Kurse, shqyrtimi i dytë më 9 shtator të po të njëjtit vit.

Gjykata Themelore në Prizren, më 12 shkurt të vitit 2018, i kishte shpallur fajtorë të akuzuarit për organizimin e skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, Tunë Kqira, Gjon Kqira, Ekrem Leci dhe Hill Kaqinari. Gjithashtu, fajtorë ishin shpallur edhe të akuzuarit Kastriot Kqira, Gjekson Kqira, Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj dhe Zyrafete Hukolli për veprën penale të fajdesë dhe detyrimit. Kurse, të akuzuarit Ragip Fazlija dhe Sejdë Kaqorraj ishin liruar nga akuzat me të cilat ngarkoheshin, si dhe të gjithë të akuzuarit janë liruar nga akuza e krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave.¹⁵⁵

Tunë Kqira ishte dënuar me dy vjet e tre muaj burgim, të cilin nuk do të duhej ta mbajë, sepse përkon me kohën të cilën ai ka kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Ndërsa, të akuzuarit Gjon Kqira, Benson Buza dhe Besfort Omaj ishin dënuar me nga dy vjet e pesë muaj burgim, brenda të cilit do të llogaritet edhe koha e kaluar nga ta në paraburgim dhe arrest shtëpiak, nga maji 2015, deri në tetor 2017. Të akuzuarit Zyrafete Hukolli, Ekrem Leci dhe Hill Kaqinari, ishin dënuar me nga gjashtë muaj burgim, por i njëjti dënim me kërkesë të mbrojtjes është zëvendësuar me dënim me gjobë në vlerë prej 2,500 euro. Për veprën penale të fajdesë, ishin dënuar Gjekson Kqira, me tetë muaj burgim dhe Gëzim Kqira, me pesë muaj burgim, ku këtij të fundit, dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në vlerë prej dymijë eurove. Marjan Kqira dhe të akuzuarit e tjerë për armëmbajtje pa leje janë dënuar me nga 1,500 euro gjobë.

¹⁵⁵“Dënohen të akuzuarit për fajde dhe detyrim, lirohet nga sekuestrimi pasuria milionëshe e tyre”Betimi për Drejtësi, 12 shkurt 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-te-akuzuarit-per-fajde-dhe-detyrim-lirohet-nga-sekuestrimi-pasuria-milioneshe-e-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Edhe pse PSRK kishte kërkuar konfiskim të parave, pronave, veturave, objekteve të banimit dhe biznesit në një vlerë të përgjithshme prej mbi 1 milion euro, gjykata e shkallës së parë kishte anuluar të gjitha urdhëresat për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të lëshuara nga gjykata në këtë rast penal. Këtë e kishte bërë me arsyetimin se organi i akuzës nuk ka arritur të provojë se pasuria e sekuestruar është fituar me veprë penale.

E pakënaqur me aktgjykimin e Themelores, PSRK-ja kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit me propozim që kjo e fundit rastin ta kthejë në rigjykim. Këtë rast, Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim.¹⁵⁶ Dhe aktualisht ky rast është duke u trajtuar përsëri nga Gjykata Themelore në Prizren.

Pas rigjykimit, më 24 maj 2019, Gjykata Themelore në Prizren, ka shpallur aktgjykimin për këtë çështje penale.

Tunë Kqira është liruar nga vepra penale e krimit të organizuar lidhur me veprën penale “detyrim”, si dhe lidhur me veprën penale “fajdeja”, të akuzuarin Gjon Kqira dhe Marjan Kqira janë liruar për kryerjen e veprës penale “krim i organizuar” lidhur me veprën penale “detyrimi”, e për krim të organizuar lidhur për veprën penale “fajdeja”, Bashkë me ta, janë liruar edhe Kastriot Kqira, Benson Buza, Gjekson Kqira dhe Gëzim Kqira për krim të organizuar.

Tunë, Kastriot, Marjan, Gjon Kqira e Benson Buza janë liruar nga akuza edhe për shpërlarje të parave. Ndaj tyre, gjykata e shkallës së parë, ka shpallur edhe aktgjykim dënues.

Tunë Kqira për veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” është dënuar me 2 vite e tre muaj burgim, ku do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim e arrest shtëpiak prej datës 28 maj 2015 deri më 29 gusht 2017. Ndërkaq, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve”, ai është dënuar me gjobë në vlerë prej 1500 euro.

I akuzuari Kastriot Kqira, për veprën penale “detyrimi” lidhur me veprën penale “fajdeja” është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 vitesh, ku do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 28 maj 2015 deri më 11 tetor 2017. I njëjti për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve”, ai është dënuar me gjobë në vlerë prej 1500 euro.

Gjon Kqira për veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” është dënuar me 2 vite e 5 muaj burgim, ku do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim e arrest shtëpiak prej datës 28 maj 2015 deri më 11 tetor 2017. Edhe ai për veprën penale “mbajtja në

¹⁵⁶“Apeli e kthen në rigjykim rastin ndaj Tunë Kqirës dhe të tjerëve që akuzohen për fajde”, Betimi për Drejtësi, 12 tetor 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-ndaj-tune-kqires-dhe-te-tjereve-qe-akuzohen-per-fajde>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve”, është dënuar me gjobë në vlerë prej 1500 euro.

Marjan Kqira, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve” është dënuar me gjobë në vlerë prej 1500 euro. Benson Buza për veprën penale “detyrimi” lidhur me veprën penale “fajdeja” është dënuar me burgim është dënuar me 2 vite e 5 muaj burgim, ku do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim e arrest shtëpiak prej 28 maj 2015 deri më 3 tetor 2017. Për veprën penale “detyrimi”, i akuzuari Besfort Omaj është dënuar në kohëzgjatje prej 2 vite e pesë muaj, ku do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 28 maj 2015 deri më 30 qershor 2017.

I akuzuari Gjeksion Kqira, për veprën penale “fajdeja”, është dënuar me gjobë prej 1000 euro dhe burgim në kohëzgjatje prej tetë muajsh, ku do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 28 maj 2015, deri më 26 janar 2016. Sipas aktgjykimit, ai është i obliguar që dënimin e shqiptuar me gjobë ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Kurse, nëse nuk mundet apo dëshiron të paguajë dënimin me gjobë, sipas aktgjykimit, gjykata për çdo 20 euro nga shuma e dënimit do t’i caktojë një ditë burgim.

Gëzim Kqira, është dënuar për fajde në burgim prej 6 muajsh e 1000 euro gjobë, edhe atij i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 11 tetor 2015 deri më 9 shkurt 2016. Me kërkesë të mbrojtësit e pëlqim të tij, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej 3000 euro, të cilin është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari Gëzim Kqira, nuk mundet apo dëshiron të paguajë shumën prej 4000 euro, sipas aktgjykimit, gjykata për çdo 20 euro nga shuma e dënimit do t’i caktojë një ditë burgim.

Të akuzuarve i është shqiptuar edhe dënim plotësues, me anë të së cilit Tunë Kqirës i është konfiskuar pistoleta e markës “Zuraki -M906”, së bashku me 64 fishekë, pastaj 22 fishekë të vendosur mbi mbishkrimin “Fioschi”, një qese e lëkurës me 12 fishekë të kalibrave të ndryshëm dhe një karikator i zbrazët të pistoletës dhe kallëp krahui i pistoletës.

Kastriot Kqirës, i është konfiskuar pistoleta e tipit “TT”, me një karikator me 8 fishekë dhe spreji “Pthetherspray protect plus” dhe Gjon Kqirës pistoleta e tipit “Zastava” me kalibër 62 mm, me dy karikatorë dhe 15 fishekë. Të akuzuarit Marjan Kqira i është konfiskuar pistoleta e tipit “TT”, me kalibër 7.62 mm me dy karikatorë, njëri i mbushur me 8 e tjetri me 7 fishekë, si dhe 61 fishekë të kalibrit 7.64mm.

Të akuzuarit Benson Buza, i është konfiskuar spreji CS- Gaz paranisand, boksi i hekurit, 2 kutia plastika me pajisje për pastrimin e pistoletave me dy jelekë antiplumb të tipit “ABA”, një point black, pistoleta me gaz, një karikator dhe dy fishekë, si dhe një shkop i madh druri.

Të dëmtuarit, Pal Gruda, Zef Gruda, Fadil Gashi, Blerimi Qono, Matilda Nushi, Besnik Nushi, Fadil Gashi, Shemsedin Berisha, Mehmedin Ahmetaj, Nrec Qollaku, Kapllan Gashi dhe Avdi Zekaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridik – civil. Të akuzuarit janë obliguar të paguajnë paushallin gjyqësor secili me nga dy mijë euro në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe janë obliguar që të paguajnë secili nga 50 euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.


Edhe me këtë aktgjykim ishte refuzuar kërkesa e PSRK-së për konfiskim të pronave, parave, objekteve të banimit, veturave. Kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit. Në këtë çështje penale të përfshirë kanë qenë edhe Ragip Fazlija, Ekrem Leci, Hill Kaqinari, Sejdë Kaqoraj dhe Zef Oroshim, për veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.

Meqenëse, i akuzuari Zef Oroshi, nuk ka marrë pjesë në disa shqyrtime gjyqësore, ndaj të njëjtit është lëshuar fletë arrest i Policisë së Kosovës, i njëjti ka qenë i pakapshëm nga policia, e në shqyrtimin gjyqësor të datës 28 mars 2017, është marrë vendim që ndaj të njëjtit të veçohet procedura penale. Për të akuzuarën Zyrafete Hakolli, e akuzuar për fajde e mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, gjithashtu është veçuar procedura, meqenëse e njëjta në disa shqyrtime nuk ka marrë pjesë.

Ndërkaq, procedura është vendosur të veçohet edhe të akuzuarit Ragip Fazlija, Ekrem Leci, Hill Kaqinari e Sejdë Kaqorraj, të akuzuar për veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.

Dëmi i pretenduar: Nuk është përcaktuar me aktakuzë

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Para, prona, objekte banimi dhe biznesi, vetura, në një vlerë të përgjithshme mbi 1 milion euro.

8. RASTI “AVOKATI III”**Gjykata Themelore në Prishtinë****Numri i lëndës** PKR.125/17.**Kryetar i Trupit Gjykses:** Valbona Musliu-Selimaj.**Prokuror:** Sylë Hoxha.**I pandehur:** Haxhi Çekaj.**Vepra penale:** “Mashtrimi”.**Faza e procedurës:** Aktgjykim i shkallës së parë**(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 995 DITË)**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë më 11 prill 2017 me të cilën Haxhi Çekajn, e akuzon se në cilësinë e avokatit të të akuzuarit Nimon Berisha, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër e mashtron të dëmtuarën Mirjeta Imerin dhe atë në vazhdimësi, duke filluar nga 6 janari 2015, e deri më datën e ndalimit dhe arrestimit të tij më 15.02.2017.

Prokuroria pretendon se Çekaj, nga e dëmtuara Mirjeta Imeri kishte marrë para për mbrojtjen e Nimon Berishës, babait të të dëmtuarës, në emër të mbrojtjes së tij dhe në emër të ekspertizave - marrjes së një ekspertize nga Turqia dhe atë në një shumë të përgjithshme prej 43,000.00 euro, si dhe shumën tjetër të cilën Çekaj, thuhet se e ka marrë nga e dëmtuara në emër të trupit gjykses të Gjykatës Themelore në Pejë në shumë prej 40,000.00 euro. Kjo shumë është konfiskuar nga ana e zyrtarëve me rastin e arrestimit të të pandehurit, ndërsa dëmi i shkaktuar të dëmtuarës tejkalon shumën 50,000.00 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e PSRK – së ishte marrë më 6 mars 2017, ndërsa aktakuza ishte përpiluar më 11 prill të po këtij viti nga Prokurori Special, Sylë Hoxha. Kjo aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë ishte ngritur një ditë më pas, më 12 prill. Në këtë rast kishte pasur tentativë për të hyrë në marrëveshje të pranimi të fajësisë. Sipas prokurorit Hoxha, pas disa përpjekjeve nuk kishin arritur të dakordoheshin për një marrëveshje të pranueshme nga të dy palët, duke shtuar se pas disa takimeve me mbrojtësin e të akuzuarit Çekaj,

avokatin Besnik Berisha nuk kishin arritur të gjejnë një mes për negociim të marrëveshjes për pranim të fajësisë. Në këtë rast janë mbajtur 11 seanca gjyqësore, ndërsa kanë dështuar të mbahen 7 të tjera. Ky rast ende është në procedurë gjyqësore në shkallë të parë. Seanca e 25 marsit 2019, kishte dështuar për shkak të mungesës së kryetares së trupit gjykues Valbona Musliu-Selimaj.¹⁵⁷

Në seancën e mbajtur më 25 prill 2019, mbrojtja e të akuzuarit kishte hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarit Nimon Berisha, të cilin e kishte propozuar vetë. Pasi që dëshmitari i ftuar nuk ishte dëgjuar, prokurori i PSRK-së Sylë Hoxha, kishte propozuar që dëshmitë e gjykatësit Kreshnik Radoniqi, gjykatëses Lumnije Muhaxheri, si dhe dëshmia e Nimon Berishës të lexohen, e të njëjtit të mos ftohen për të dhënë dëshmi. Këtë propozim, e kishte aprovuar trupi gjykues i përbërë nga gjykatësit Valbona Musliu-Selimaj, Vesel Ismajli dhe Naime Krasniqi-Jashanica.

Mbrojtja e të akuzuarit kishte propozuar që të dëgjohen edhe dëshmitarë tjerë, mirëpo trupi gjykues gjatë kësaj seance ka aprovuar vetëm kërkesën për dëgjimin e avokatit Jashar Lokaj.¹⁵⁸ Pikërisht, për shkak të mungesës të dëshmitarit Lokaj, kishte dështuar të mbahet seanca e 5 korrikut të vitit 2019.¹⁵⁹ Kurse, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2019, gjykata kishte vendosur që dëshmitari Nazmi Selmanaj, të ftohet përsëri për t'u dëgjuar në këtë. Dëshmitari Selmanaj, kishte dhënë dëshminë e tij edhe në seancën e mbajtur më 21 janar 2019, si i propozuar nga prokuroria. Pavarësisht kësaj, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte vendosur që të njëjtin ta ftojë përsëri për të dëshmuar në këtë rast, duke miratuar propozimin e avokatit Besnik Berisha.¹⁶⁰

Seanca e planifikuar të mbahej më 7 shtator 2019, kishte dështuar të mbahet si pasojë e mungesës të akuzuarit.¹⁶¹ Kurse, me seancën e mbajtur më 22 tetor 2019, Çekaj, i akuzuar duke dhënë mbrojtjen e tij ka deklaruar se asnjëherë nuk kishte kërkuar prej të dëmtuarës, Mirjeta Imeri, shumë prej 40 mijë euro për të blerë trupin gjykues në një rast ku ai kishte qenë

¹⁵⁷ “Gjykatësja në pushim mjekësor, shtyhet gjykimi ndaj avokatit që akuzohet për mashtrim” Betimi për Drejtësi. 25 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesja-ne-pushim-mjekesor-shtyhet-gjykimi-ndaj-avokatit-qe-akuzohet-per-mashtrim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁵⁸ “Mbrojtja e avokatit të akuzuar për mashtrim heq dorë nga dëgjimi i dëshmitarit që e kishte propozuar vetë” Betimi për Drejtësi. 25 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-avokatit-te-akuzuar-per-mashtrim-heq-dore-nga-degjimi-i-deshmitarit-qe-e-kishte-propozuar-vete/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁵⁹ “Mungon dëshmitari, dështon gjykimi në rastin e shënjestruar për viza ndaj avokatit që akuzohet për mashtrim”, Betimi për Drejtësi, 5 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-deshmitari-desh-ton-gjykimi-ne-rastin-e-shenjestruar-per-viza-ndaj-avokatit-qe-akuzohet-per-mashtrim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶⁰ “Gjykimi ndaj avokatit të akuzuar për mashtrim, ftohet dëshmitari që është dëgjuar më parë”. Betimi për Drejtësi. 10 shtator 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-avokatit-te-akuzuar-per-mashtrim-ftohet-deshmitari-qe-eshte-degjuar-me-pare/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶¹ “Dështon seanca ndaj avokatit që akuzohet për mashtrim”. Betimi për Drejtësi, 7 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-seanca-ndaj-avokatit-qe-akuzohet-per-mashtrim/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

mbrojtës.¹⁶² Më 25 nëntor 2019, pas dy viteve gjykim, ka përfunduar procesi gjyqësor ndaj avokatit Haxhi Çekaj. Gjatë kësaj seance është dhënë fjala përfundimtare nga ana e prokurorit Sylë Hoxha, mbrojtësit të Çekajt, avokatit Besnik Berisha si dhe nga pala e dëmtuar, Mirjeta Imeri. Prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarit, ndërkaq mbrojtja lirimin nga akuza.¹⁶³

Më 2 dhjetor 2019, gjykata e shkallës së parë, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësja Valbona Musliu-Selimaj, i akuzuari Çekaj është dënuar me 6 muaj burgim, si dhe me 3000 euro gjobë. Në bazë të këtij aktgjykimi, dënimi me burg ndaj Çekajt, me pajtimin e tij mund t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në vlerë prej 5000 euro, ndërsa i akuzuari është i obliguar të paguajë edhe 300 euro në emër të shpenzimeve procedurale. Gjykatësja Musliu-Selimaj kishte njoftuar se i akuzuari do të paguajë edhe shumën prej 50 euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave.

Ndaj Çekajt është shpallur edhe dënimi plotësues që është ndalimi i ushtrimit të profesionit të avokatit në kohëzgjatje prej një viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në shpallje të aktgjykimit, trupi gjykues ka njoftuar se kanë bërë edhe rikualifikimin e veprës penale “mashtrimi”, nga paragrafi 1, në paragrafin 2, i cili thotë se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej 10 mijë euro apo më shumë, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet”.

Pala e dëmtuar, Mirjeta Imeri për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil, pasi që sipas gjykatës Musliu-Selimaj nuk ishte përcaktuar saktë dëmi i shkaktuar në këtë rast.¹⁶⁴

Dëmi i pretenduar: Mbi 50,000.00 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Mbi 50,000.00 euro.

¹⁶² “Avokati i akuzuar për mashttrim mohon se kishte kërkuar 40 mijë euro nga e dëmtuara për t'i dhënë dikujt rryshfet”. Betimi për Drejtësi. 22 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-akuzuar-per-mashttrim-mohon-se-kishte-kerkuar-40-mije-euro-nga-e-demtuaara-per-ti-dhene-dikujt-ryshfet/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶³ “PSRK-ja kërkon dënimin e avokatit të akuzuar për mashttrim, mbrojtja thotë se e dëmtuara është më së pakti e mashtruar”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ja-kerkon-denimin-e-avokatit-te-akuzuar-per-mashttrim-mbrojtja-thote-se-e-demtuaara-eshte-me-se-pakti-e-mashtruar/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶⁴ “Shpallet fajtor avokati që akuzohej se gjatë ushtrimit të detyrës kishte mashtruar klientin e tij”, Betimi për Drejtësi. 2 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-fajtor-avokati-qe-akuzohej-se-gjate-ushtrimit-te-detyres-kishte-mashtruar-klientin-e-tij/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

9. RASTI “POSTA”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.202/18.

Kryetar i Trupit Gjykes: Lutfi Shala.

Prokuror: Florije Salihu-Shamolli.

Të pandehur: Agron Mustafa; Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj.

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”.

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 502 DITË)



Më 22 dhjetor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, pas disa publikimeve në media kishte dorëzuar lëndën PPN.nr.236/16, me të cilën kishte kërkuar nga Prokuroria Speciale ta trajtojë çështjen e kontestit në mes të PTK-së dhe “Z-mobile”, në procedurën e arbitrazhit, kontest të cilin, e kishte humbur PTK-ja, duke u detyruar që Z-mobile-it, t’ia përmbushë detyrimin në vlerë prej 32,856,407.28 euro.

Pasi PSRK-ja, kishte filluar hetimet, e njëjta, më 17 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Drejtorit të PTK-së Agron Mustafa, ish-Drejtorit të PTK-së Ejup Qerimi dhe Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të PTK-së Rexhë Gjonbalaj, duke i ngarkuar ata për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” nga neni 422 i KPRK-së.

Sipas aktakuzës, nga 19 shkurti 2015 kur Agron Mustafa ishte zgjedhur në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të PTK-së e deri më 24 maj 2017, edhe pse nuk kishte qenë kompetent në kontestin në mes të PTK-së dhe tani të dëmtuarës DARDAFON.net (Z-Mobile), kishte lidhur marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit. Me këtë veprim, sipas prokurorisë, janë shkaktuar

vonesa në liferimin e Sim-kartelave, nuk e kishte furnizuar me bllokun e numeracionit dhe nuk i kishte dhënë shërbimet 3G dhe 4G të dëmtuarës. Edhe pse për këtë kontratë, për veprën penale “lidhja e kontratave të dëmshme”, me aktgjykim të formës së prerë në qershor 2011, ishin liruar pesë persona, e po ashtu, edhe pse autoriteti rregullativ i komunikimeve elektrike dhe postare, tani të dëmtuarës Z-Mobile ia kishte lejuar përdorimin e numeracionit jo-geografik 045, i njëjti këto vendime nuk i kishte zbatuar.

Në këtë mënyrë, siç pretendon prokuroria, përkundër përpjekjeve të të dëmtuarës për zgjidhje të kësaj marrëveshje dhe për eliminimin e arbitrazhit të mundshëm, Mustafa nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me këtë. Gjithnjë sipas aktakuzës, Mustafa, në procedurën e arbitrazhit kishte angazhuar kompaninë “Studioligji”, për të përfaqësuar kompaninë në arbitrazh, në të cilën procedurë, gjykata ndërkombëtare e Arbitrazhit kishte marrë vendim në dobi të së dëmtuarës. Në bazë të këtyre veprimeve të Mustafës, prokuroria po pretendon, se PTK-ja ka qenë e detyruar që t’i paguajë të dëmtuarës Z-Mobile shumën prej 32,856,407.28 euro, pa llogaritur shpenzimet tjera të procedurës së arbitrazhit, në vlerë prej mbi 500,000 euro dhe 65,000 funta angleze.

Lidhur me këtë kontest në mes PTK-së dhe Z-Mobile, në gjykatat vendore ashtu edhe në atë të arbitrazhit, pas të cilave procedura gjyqësore, PTK-ja ishte dëmtuar miliona euro, përpos Mustafës, për periudhën 2012-2014, është duke u akuzuar edhe Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-së, Ejup Qerimi, dhe kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të PTK-së, Rexhë Gjonbalaj. Sipas prokurorisë, të njëjtit kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare, në dëm të të dëmtuarës Z-Mobile, e po ashtu i kanë shkaktuar dëm edhe PTK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza ndaj Mustafës, Qerimit dhe Gjonbalajt, kishte arritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në të njëjtën ditë në të cilën edhe ishte ngritur, më 17 gusht 2018 dhe i ishte ndarë gjyqtarit Lutfi Shala.

Shala, kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 27 shtator 2018 apo 10 ditë pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh nga momenti kur aktakuza kishte arritur në gjykatë, në të cilin shqyrtim tre të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.¹⁶⁵

Në shqyrtimin e dytë i cili ishte caktuar më 7 nëntor 2018, brenda afatit ligjor nga shqyrtimi fillestar, të akuzuarit kërkuan që kjo aktakuzë të hudhet.¹⁶⁶ Ndërsa, më 7 dhjetor 2018, gjykatësi i rastit Lutfi Shala kishte nxjerrë aktvendim me anë të së cilit kishte hudhur poshtë aktakuzën për shkak se sipas tij nuk ishte vërtetuar që të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën

¹⁶⁵ “Agron Mustafa dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për rastin e “Z-Mobile””. Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-rastin-e-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶⁶ “Agron Mustafa dhe dy të tjerët kërkojnë hudhjen e aktakuzës për rastin “Z-Mobile” . Betimi për Drejtësi. 7 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-dy-te-tjeret-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-per-rastin-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

ngarkoheshin. Edhe pse Prokuroria Speciale kishte pretenduar se tre të akuzuarit i kanë shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës rreth 30,000,000 euro dëm, sipas gjykatës, prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer vepër penale.¹⁶⁷

Pas ankesës së Prokurorisë Speciale ndaj aktvendimit për hushje të aktakuzës, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të aprovojë ankesën e PSRK-së dhe në këtë mënyrë kishte konfirmuar aktakuzën ndaj tre të pandehurve.¹⁶⁸

Pas konfirmimit të aktakuzës, gjykatësi Shala e ka mbajtur vetëm një seancë të shqyrtimit gjyqësor e cila është mbajtur më 21 mars 2019, kur kishte dhënë dëshminë Blerim Devolli, i cili në këtë proces gjyqësor është në cilësi të të dëmtuarit.¹⁶⁹

Ndryshe, seanca e paraparë të mbahej me 16 maj 2019 është anuluar, për arsye se i akuzuari Ejup Qerimi, me anë të një parashprese e kishte informuar gjykatën se për shkaqe shëndetësore gjendet jashtë vendit. Po ashtu, gjykatësi Shala, kishte njoftuar se edhe prokurori special Naim Abazi kishte njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantonte në seancën e kësaj date, për shkak se më herët ishte caktuar në gjykimin e rastit “Toka”, ku të akuzuar për krim të organizuar dhe për vepra të tjera penale janë Azem Sylja dhe 17 persona të tjerë. Mirëpo, aktakuzën e rastit “Toka”, në seancën e 16 majit e ka përfaqësuar prokurorja Habibe Salihi.¹⁷⁰

Në seancën e radhës të mbajtur me 10 qershor 2019, eksperti i telekomunikacionit Ismet Haliti e kishte cilësuar si krim të përmasave të mëdha kontratën që Telekom i Kosovës kishte arritur me kompaninë “Dardafon.net”, lidhur me ndarjen e numrave për Z-Mobile. Ai po ashtu kishte thënë se me një kontratë të tillë është dëmtuar rëndë interesi publik.¹¹⁶ Në po të njëjtën seancë dëshminë e tij edhe kishte dhënë edhe udhëheqësi i Departamentit Ligjor në Telekomin e Kosovës, Sabahudin Ramaxhiku, i cili kishte deklaruar se gjetjet që kishte bërë departamenti i tij, para nënshkrimit të kontratës me Dardafon.net, nuk ishin respektuar nga ana e Bordi të PTK-së.¹⁷¹

¹⁶⁷ “Hudhet poshtë aktakuza ndaj Agron Mustafës dhe të tjerëve në rastin e “Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-agron-mustafes-dhe-te-tjereve-ne-rastin-e-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶⁸ “Apeli vendos që Agron Mustafa dhe ish-drejtesit tjerë të Telekomit të Kosovës të gjykohen për rastin “Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 4 shkurt 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-agron-mustafa-dhe-ish-drejtesit-tjere-te-telekomit-te-kosoves-te-gjykohen-per-rastin-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁶⁹ “Blerim Devolli thotë se takimet me udhëheqësit e Telekomit ishin të “ftohta” dhe sa për tu njoftuar” Betimi për Drejtësi. 21 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/blerim-devolli-thote-se-takimet-me-udheheqesit-e-telekomit-ishin-te-ftohta-dhe-sa-per-tu-njoftuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁰ “Anulohet seanca ndaj Agron Mustafës dhe dy të tjerëve për rastin e Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 21 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/anulohet-seanca-ndaj-agron-mustafes-dhe-dy-te-tjereve-per-rastin-e-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷¹ “Rasti “Z-Mobile”, udhëheqësi i Departamentit Ligjor në Telekom thotë se gjetjet e tyre nuk ishin respektuar

Seanca e radhës ishte mbajtur me 8 korrik 2019, në të cilën seancë kishte deklaruar ish ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të PTK-së, Mehdi Latifaj, i cili kishte thënë se kontrata e lidhur mes PTK dhe Z-Mobile kishte pasur mangësi juridike.¹⁷² Në seancën të mbajtur me 22 gusht 2019, ish-menaxheri i sigurimit të të hyrave në njësinë “Vala”, Arben Shabani kishte deklaruar se në kontratën e lidhur me Z-Mobile nuk ishin paraparë shërbimet 3G dhe 4G.¹⁷³

Në seancën e mbajtur më 10 tetor 2019, drejtuesit e kompanisë Dardanfon.net, përkatësisht Z-Mobile, Blerim Devolli dhe Milot Gjokolli e kishin njoftuar Gjykatën Themelore në Prishtinë, se ata nuk e ndiejnë veten të dëmtuar dhe nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale, në rastin e ish-drejtuesve të Telekomit të Kosovës. Gjatë kësaj seance, këshilltari ligjor në Darafon.net, Valon Basha ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, si dhe ishin administruar provat e propozuara në aktakuzë, si dhe ishin propozuar prova të reja nga ana e mbrojtjes.¹⁷⁴

Gjatë seancës së 11 tetorit, Agron Mustafa kishte shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për tu mbrojtur në heshtje, ndërkaq Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj kishin mohuar akuzën.¹⁷⁵

Më 18 tetor 2019, gjatë dhënies së fjalës përfundimtare, tre ish-drejtuesit e Postës dhe Telekomit të Kosovës, tash Telekom i Kosovës, Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj, kishin kërkuar që të shpallen të pafajshëm lidhur me akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.¹⁷⁶

Në anën tjetër, prokurori Naim Abazi, kishte kërkuar dënimin e tyre, e kishte thënë se nga kontrata me Z-Mobile janë dëmtuar xhepat e qytetarëve.¹⁷⁷

nga Bordi”. Betimi për Drejtësi. 10 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-z-mobileudheheqesi-i-departamentit-ligjor-ne-telekom-thote-se-gjetjet-e-tyre-nuk-ishin-respektuar-nga-bordi/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷² “Ish-ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të PTK-së thotë se marrëveshja me Z-Mobile kishte mangësi juridike”. Betimi për Drejtësi. 8 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ushtruesi-i-detyres-sekryeshefit-ekzekutiv-te-ptk-se-thote-se-marreveshja-me-z-mobile-kishte-mangesi-juridike/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷³ “Zyrtari i Telekomit thotë se në kontratën me Z-Mobile nuk ishin paraparë shërbimet 3G dhe 4G”. Betimi për Drejtësi. 22 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtari-i-telekomit-thote-se-ne-kontraten-mez-mobile-nuk-ishin-parapare-sherbimet-3g-dhe-4g/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁴ “Gjykimi ndaj ish-drejtuesve të Telekomit të Kosovës, Z-Mobile thotë se nuk e ndien veten të dëmtuar”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-ish-drejtuesve-te-telekomit-te-kosoves-z-mobile-thote-se-nuk-e-ndien-veten-te-demtuar/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁵ “Gjykimi për kontratën me Z-Mobile, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj mohojnë akuzën, Agron Mustafa mbrohet në heshtje” Betimi për Drejtësi. 11 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-kontraten-me-z-mobile-ejup-qerimi-dhe-rexhe-gjonbalaj-mohojne-akuzen-agron-mustafa-mbrohet-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁶ “Ish-drejtuesit e Telekomit kërkojnë të lirohen nga akuza për korrupsion në rastin e kontratës me Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtuesit-e-telekomit-kerkojne-te-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion-ne-rastin-e-kontrates-me-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁷ “Prokurori kërkon dënimin e ish-drejtuesve të Telekomit, thotë se nga kontrata me Z-Mobile u dëmtuan xhepat e qytetarëve” Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-kerkon-denimin-e-ish-drejtuesve-te-telekomit-thote-se-nga-kontrata-me-z-mobile-u-demtuan-xhepat-e-qytetareve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 21 tetor, ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve. Sipas kryetarit të trupit gjykues gjykatësit Lutfi Shala, ky trup gjykues nuk ka gjetur se të akuzuarit kanë kryer veprën penale. Ai kishte thënë se pas dëgjimit të dy të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe provave materiale, nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorisë Speciale.¹⁷⁸

“Pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të nenit 361 par. I dhe 2 të KPPRK-së, ky trup gjykues nuk gjeti se të akuzuarit të kenë kryer veprën penale për të cilën i ngarkon akuza”, thuhet në një pjesë të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Gjykatësi Shala, me arsyetimin e tij kishte vlerësuar se trupi gjykues i drejtuar nga ai, ka gjetur se janë të pabazuara të gjitha provat me të cilat prokuroria pretendon me aktakuzën e saj se tre të akuzuarit në periudhën kohore prej shkurt 2012, e deri në shkurt të vitit 2015, nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, me qëllim që t’i shkaktojnë dëm të dëmtuarës “Z-Mobile”, duke mos zbatuar kontratën me numër 01-156/09, të datës 16 janar 2009.

Sipas Shalës, gjykata ka gjetur se të gjitha provat e propozuara nga PSRK-ja, si dëshmitar, e po ashtu edhe provat tjera materiale vetëm kanë konstatuar ekzistimin e një marrëdhënieje kontraktuale juridiko-civile dhe asgjë më shumë.

Tutje, edhe pse gjykata kishte vlerësuar se nga kjo kontratë e lidhur në mes palëve ka mundur t’i shkaktohet dëm PTK-së, me asnjë provë thuhet se nuk është vërtetuar se për këto dëme janë fajtorë të akuzuarit, pasi kanë munguar elementet e dashjes dhe përfitimit.

“Trupi gjykues ka vlerësuar se në rastin konkret, mund të jetë shkakuar dëm lidhur me mos zbatimin e kontratës, mirëpo assesit nuk është vërtetuar se dëm është shkakuar me dashjen e të pandehurve. Kjo së paku nuk është arrit të vërtetohet me provat që ka prezantuar prokuroria si organ i ndjekjes që obligohet që ti provojë para gjykatës pretendimet e prezantuara ne aktakuzë”, është thënë në arsyetimin e gjykatës.¹⁷⁹

Dëmi i pretenduar: Rreth 30,000,000 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹⁷⁸ “Tre ish-drejtuesit e Telekomit të Kosovës lirohen nga akuzat lidhur me kontratën me Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-ish-drejtuesit-e-telekomit-te-kosoves-lirohen-nga-akuzat-lidhur-me-kontraten-me-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁷⁹ “Arsyetimi i gjykatës për lirimin e tre ish-drejtuesve të Telekomit nga akuzat lidhur me kontratën me Z-Mobile” Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-gjykates-per-lirimin-e-tre-ish-drejtuesve-te-telekomit-nga-akuzat-lidhur-me-kontraten-me-z-mobile/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

ANEX IV: Analizë e detajuar e rasteve të shënjestruara të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë¹⁸⁰

Nga të gjeturat e IKD-së rezulton se nga 38 raste gjithsej, është arritur që vetëm 19 prej tyre të marrin një vendim përfundimtar ku bëjnë pjesë rastet: 1)“OSHP 1”, 2)“Avokati II” 3)“Prokurori”, 4)“Klllokoti I”, 5)“Kontrata”, 6)“Suhareka”, 7)“Matrix-M”, 8)“Avokati I”, 9)“Apeli” 10)“Qeraja”, 11)“Ndërtimi”, 12)“Klllokoti II”, 13)“Autoriteti”, 14)“Inspektori”,15) “Ndërimi”, 16)“HIB” 17)“UP”, 18) “Prokurori 2” dhe 19) “Mati”.

IKD, ka vërejtur se përpos rastit “**Prokurori**”, në të cilin ish-prokurorja Vahide Badivuku, për shkak të kryerjes së veprës penale “marrja e ryshfetit”, ishte dënuar me tre vjet burg dhe 5.000 euro gjobë, e po ashtu iu ndalua edhe ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për tre vjet, pas përfundimit të dënimit me burgim. Kurse, te aktgjykimet e tjera dënuese, kryesisht janë gjykuar persona të profilit të ulët.

Rasti “**Apeli**”, është një rast që në fillimin e saj kishte tronditur opinionin publik, për shkak se për vepra penale që ndërlidhen me korrupsion dyshohej kryetari i Gjykatës së Apelit Salih Mekaj, mirëpo aktakuza e prokurores speciale Drita Hajdari, në fund kishte mbetur e pambështetur në prova dhe me aktgjykim përfundimtar Mekaj dhe tre të akuzuarit e tjerë ishin liruar nga të gjitha akuzat që i ngarkonin ata.

Në këtë grup të rasteve, janë akuzuar edhe dy ish-kryetarë të komunave, lidhur me vepra penale korruptive për kohën kur ata kishin ushtruar funksionin e kryetarit të komunave, por asnjëra nga aktakuzat kundër këtyre personave që trajtohen si profil i lartë, nuk janë finalizuar me aktgjykime dënuese.

Ish-kryetari i Klllokotit, Sreqko Spasiq, është akuzuar në dy raste që njihen si “Klllokoti I” dhe “Klllokoti II”. Te rasti “**Klllokoti II**”, Spasiq ishte akuzuar për veprën penale “konflikt i interesit”, por këtë aktakuzë gjykata e shkallës së parë e kishte hudhur pas seancës fillestare. Ndërsa, te rasti “**Klllokoti I**”, ai përveç veprës penale “konflikt i interesit”, akuzohej edhe për veprën penale “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”, por gjykata nuk kishte vërtetuar pretendimet e prokurorisë dhe në këtë mënyrë ai ishte liruar nga aktakuza.

Ish-kryetari i komunës së Dragashit Salim Jenuzi ishte akuzuar për “keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar” dhe ishte dënuar njëherë nga Gjykata Themelore në Prizren, por pasi rasti ishte kthyer në rigjykim, Prokurori i Shtetit, kishte vendosur që të tërhiqej nga ndjekja penale, me

¹⁸⁰ Këto raste janë trajtuar në mënyrë të detajuar në raportin e kaluar të IKD-së mbi trajtimin e rasteve të shënjestëruara nga sistemi i drejtësisë. Me qëllim të shmangies nga përsëritja, në këtë pjesë këto raste do të trajtohen vetëm shkurtimisht. Shih për më tepër Gashi L. dhe Kadriu M. “*Dështimet në rastet e shënjestëruara*”- Qershor 2019. F-40-79 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/deshtimet-ne-rastet-e-shenjesteruara/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shkurt 2020).

arsyetimin se ka arritur afati i parashkrimit dhe rrjedhimisht Gjykata Themelore në Prizren, kishte shqiptuar aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit Jenuzi.

Njësoj, aktgjykime refuzuese ishin dhënë edhe te rastet “Avokati I” dhe “Suhareka”. Te rasti “**Suhareka**”, pas 10 seancave gjyqësore, prokurori Safer Morina në seancën në të cilën ishte paraparë të jepej fjala përfundimtare kishte vendosur të heqë dorë nga aktakuza, pasi kishte vlerësuar se nuk ishin vërtetuar pretendimet e aktakuzës.

Te rasti “**Avokati I**”, Afrim Radoniqi në cilësinë e avokatit publik të Gjakovës dhe Xhevat Rraci në cilësinë e drejtorit pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër e Pronë të komunës së Gjakovës, pretendohet se i kishin shkaktuar dëm Komunës së Gjakovës, pasi një pronë të saj ia kishin lënë në shfrytëzim një personi pas obligimit të kompensimit. Mirëpo në këtë rast, edhe pse aktakuza ndaj Radoniqit dhe Rracit, ishte ngritur më 6 prill 2016, prokurori Agron Matjani, vetëm pas gjashtë muajsh kishte vendosur që të tërhiqet nga ndjekja penale, me arsyetimin se të njëjtit nuk kanë kryer vepër penale.

Rastit “**OSHP 1**”, nga ngritja e aktakuzës i janë dashur 1540 ditë deri sa ta merrte formën e prerë, ndërsa rasti që kishte marrë formën e prerë më së shpejti nga të gjitha rastet e shënjestruara është rasti “**Killokoti II**” – për 152 ditë.

Në këtë grup të rasteve bënë pjesë rasti i njohur si “**UP**”, në të cilin ka qenë i akuzuar edhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës Enver Hasani, i cili është dënuar nga shkalla e parë, por më pas Gjykata e Apelit, e kishte liruar atë nga akuza. Ky rast edhe pse kishte përfunduar nga shkalla e parë më 18 tetor të vitit 2017, i njëjti është dashur që të trajtohet dy herë nga ana e Gjykatës së Apelit. Kjo pasi fillimisht kjo gjykatë, e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, por më pas Gjykata Supreme e kishte kthyer rastin në rivendosje vetëm për dy të bashkakuzuarit e Hasanit, për të cilët Gjykata e Apelit, më 16 prill 2019, kishte vendosur. Kjo gjykatë, sërish ua kishte ashpërsuar dënimet, dy të akuzuarve për mashtrim në detyrë, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi, të cilëve ua ka shqiptuar nga një vit burg efektiv.

Me përballje të gjatë para gjykatës është përballur edhe rasti i njohur si “**HIB**”, aktakuza e të cilit rast ishte ngritur në fundin e vitit 2015. Kjo pasi ky rast është gjykuar dy herë nga shkalla e parë, pasi njëherë ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit.

Ky rast i trajtuar në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, për dy herë më radhë ka prodhuar dy aktgjykime krejtësisht të ndryshëm. Përderisa gjykatësi Rustem Begolli më 18 maj 2018 kishte shpallur fajtor Kujtim Bucaliun, si person përgjegjës të kompanisë “HIB Petrol” duke e dënuar me katër vjet burgim, e po ashtu kishte dënuar edhe kompaninë “HIB Petrol”, herën e dytë, pas kthimit në rigjykim të këtij rasti, aktgjykimi ishte krejtësisht tjetër. Pas rigjykimit, më 10 maj 2019, gjykatësi Begolli, kishte vlerësuar se në mungesë të provave Bucaliu dhe kompania “HIB Petrol”, shpallen të pafajshëm. Vendim të cilin, gjykata e shkallës së dytë e kishte vërtetuar më 11 nëntor 2019.

Ndërsa rasti “**Prokurori 2**”, ku i akuzuar ishte ish-prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë Agron Matjani, është pushuar për shkak të vdekjes së tij në rrethana të panjohura deri më tani.

Kurse, rasti “**Mati**” ka marrë epilog në shkallë të parë për 56 ditë, ku me 19 korrik 2019, aktgjykime dënuese janë shpallur për dy të akuzuarit.

1. Rasti OSHP 1

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.679/14.

Kryetar i Trupit Gjykses: Arben Hoti.

Prokuror: Fillimisht Admir Shala, e më pas Sylë Hoxha.

Të pandehur: Hysni Hoxha, Hysni Muhadri, Arsim Robelli, Veton Fetahu.

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Falsifikim i dokumenteve”, “Mashttrim”; “Deklarim i rremë nën betim”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR KANË KALUAR 1540 DITË)



PSRK më 4 dhjetor 2014, kishte ngritur aktakuzë e cila e ngarkonte Hysni Hoxhën dhe Hysni Muhadrin, për kryerje të veprës penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, në bashkëkryerje. Në këtë rast Hoxha pretendonte se kishte keqpërdorur detyrën në cilësi të kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe njëherësh edhe në cilësi të kryetarit të Panelit Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa Muhadri këtë e kishte bërë duke ushtruar funksionin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

I akuzuari Veton Fetahu kishte bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohet dhe ishte dënua me dënim me gjobë në vlerë prej 2600 euro. Kurse, më 27 nëntor të vitit 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte shpallur aktgjykimin me të cilin Hysni Hoxha, ishte liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Bashkë me Hoxhën, nga akuza ishte liruar edhe eksperti shqyrtues i OSHP-së, Hysni Muhadri, derisa gjithashtu nga akuza

për falsifikim të dokumenteve ishte liruar edhe i akuzuari i tretë në këtë rast, kontabilisti i jashtëm i kompanisë “Conex”, Arsim Robelli. Sipas gjykatës, nuk ishte provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale me të cilën akuzoheshin.¹⁸¹ Në prill të vitit 2018, Gjykata e Apelit, kishte njoftuar se kjo gjykatë e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e PSRK-së ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi sipas kësaj gjykate, nuk ishin gjetur shkeljet e pretenduara nga ana e PSRK-së.¹⁸²

Dëmi i pretenduar: 1,799,759.54 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹⁸¹ “Lirohet nga akuza për keqpërdorim detyre ish-kreu i OSHP-së, Hysni Hoxha (Video)”. Betimi për Drejtësi. 27 nëntor 2017, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre-ish-kreu-i-oshp-se-hysni-hoxha/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁸² “Apeli vërteton pafajësinë e ish-kreut të OSHP-së, Hysni Hoxha dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-ish-kreut-te-oshp-se-hysni-hoxha-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

2. RASTI “AVOKATI II”

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: Për këtë rast është bërë bashkimi i lëndës PKR.nr.179/15

Kryetar i Trupit Gjykses: Artan Sejrani.

Prokuror: Agron Matjani.

I pandehur: Afrim Radoniqi.

Veprat penale: “Falsifikim i dokumentit zyrtar”; “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”; “Konflikt interesit”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR KANË KALUAR 466 DITË)



Aktakuza ndaj Afrim Radoniqit, ishte ngritur më 12 qershor të vitit 2015 nga Prokuroria Themelore në Gjakovë. Ai akuzohej se më 17 prill 2009 si person zyrtar – avokat publik i Kuvendit Komunal të Gjakovës me qëllim të përfitimit pasuror, i ka shkaktuar dëm Komunës së Gjakovës duke nënshkruar marrëveshjen për kompensim, me të cilën familjes Kastrati, ua ka dhënë ngastrën e Komunës së Gjakovës me sipërfaqe prej 0.16.74 hektar, në emër të kompensimit të pronës së eksproprijuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës. Po ashtu, Radoniqi ngarkohej edhe me veprën penale të “konflikti i interesit” dhe “falsifikimi i dokumentit zyrtar”.

Më 18 korrik të vitit 2016 ishte bërë shpallja e aktgjykimit në këtë rast. Në mungesë të provave gjykata e kishte liruar Radoniqin nga akuza për veprën penale “keqpërdorimi i detyrës zyrtare”, dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”, ndërsa për veprën penale “konflikt i interesit” Radoniqi ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënim me gjobë në vlerë prej 3000 eurosh. Ky aktgjykim më 20 shtator 2016 ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, por shkalla e dytë kishte vendosur që gjobën ta zvogëloi në dënim prej 2.000 eurove, e cila tashmë është bërë i formës së

prerë, pasi vendimin e Gjykatës së Apelit të 20 shtatorit 2016, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e cila më 5 dhjetor 2016, e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmerisë së Afrim Radoniqit.

Dëmi i pretenduar: Pronë me sipërfaqe prej 0.16.74 hektar.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur kërkesë në aktakuzë.

3. RASTI “PROKURORI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.652/15.

Kryetar i trupit gjykues: Kreshnik Radoniqi.

Prokuror: Admir Shala.

Të pandehur: Vahide Badivuku, Idriz Kelmendi, Isak Smakolli.

Veprat penale: “Marrje ryshfeti”, “Dhënie ryshfeti”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR KANË KALUAR 912 DITË)



Prokuroria Speciale e Kosovës, kishte ngritur aktakuzë ndaj tre të pandehurve më 17 nëntor të vitit 2015. Sipas aktakuzës së ngritur nga prokurori special Admir Shala, Vahide Badivuku, akuzohej se ka kryer veprën penale “marrje e ryshfetit” dhe “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”, pasi pretendonte se në mënyrë të tërthortë ka kërkuar dhe pranuar dhuratë për vete, në mënyrë që të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke respektuar afatin e caktuar ligjor, kishte mbajtur shqyrtimin fillestar, nëntë ditë pasi aktakuza kishte arritur në gjykatë, konkretisht më 26 nëntor 2015, ndërsa afati ishte respektuar edhe për seancën e shqyrtimit të dytë, e cila ishte mbajtur më 29 dhjetor të po të njëjtit vit.

Pasi ishte konfirmuar aktakuza, më 9 shkurt 2016 ishte caktuar edhe seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor, por që nuk ishte mbajtur, ndërsa seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ishte mbajtur më 10 shkurt 2016 dhe kishte vazhduar edhe me 11 shkurt 2016. Edhe në muajin mars ishin mbajtur katër seanca të tjera gjyqësore, konkretisht më 1,7,8 dhe pastaj më 31 mars, kur edhe ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Pas shtatë seancave gjyqësore, më 5 prill të vitit 2016, kryesuesi i trupit gjykues, gjykatësi Kreshnik Radoniqi, kishte bërë shpalljen e aktgjykimit sipas të cilit ish-prokurorja Vahide Badivuku ishte dënuar me tre (3) vjet burgim efektiv dhe 5.000 euro gjobë, e po ashtu iu ndalua edhe ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për tre vjet, pas përfundimit të dënimit me burgim, për veprën penale marrje e ryshfetit, për shkak të kryerjes së veprës penale të marrjes së ryshfetit.¹⁸³

Nga të bashkakuzuarit e Badivukut, Idriz Kelmendi ishte dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, ndërsa Isak Smakolli ishte dënuar me gjobë prej tre mijë eurove.

Dënimi ndaj të akuzuarve ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, mirëpo ndaj këtij vendimi, mbrojtja e Badivukut kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila kishte aprovuar atë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe rastin e kishte kthyer në rivendosje në shkallën e dytë.

Gjykata e Apelit edhe për herë të dytë, më 14 qershor 2017, përmes një komunikate për media, kishte njoftuar se i ka refuzuar si të pa bazuar ankesat e Prokurorisë Speciale dhe avokatit mbrojtës, duke ia vërtetuar të akuzuarës Vahide Badivuku, dënimin e shqiptuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 5 prill 2016.¹⁸⁴

Badivuku, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë i ishte drejtuar edhe njëherë Supremes, e cila përsëri e kishte aprovuar atë duke e kthyer lëndën edhe njëherë në rivendosje në Gjykatën e Apelit,¹⁸⁵ e cila gjykatë më 16 maj 2018, për herë të tretë, kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin, ish-prokurorja Vahide Badivuku, ishte shpallur fajtores për marrje ryshfeti dhe ishte dënuar me tre vjet burgim. Kolegji gjyqësor i Gjykatës së Apelit, po ashtu i ka ri cilësuar veprimet e dy të akuzuarve tjerë të këtij rasti Idriz Kelmendi dhe Isak Smakolli nga “ushtrim ndikimi “ në “dhënie ryshfeti”. I pari është dënuar me një vjet burgim, ndërsa të dytit i është vërtetuar dënimi me gjobë prej tre mijë eurosh. Kështu, Apeli kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), e cila kishte kërkuar dënime më të

¹⁸³ “Vahide Badivuku dënohet me tre vjet burg dhe tre vjet ndalim i ushtrimit të profesionit”, Betimi për Drejtësi, 5 prill 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vahide-badivuku-denohet-me-tre-vjet-burg-dhe-tre-vjet-ndalim-i-ushtrimit-te-profesionit/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁸⁴ “Apeli sërish vërteton dënimin ndaj ish-prokurores, Vahide Badivuku” Betimi për Drejtësi 14 qershor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-serish-verteton-denimin-ndaj-ish-prokurores-vahide-badivuku/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁸⁵ “Gjykata Supreme e kthen në rivendosje rastin e ish-prokurores, Vahide Badivuku”, Betimi për Drejtësi 11 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-e-ish-prokurores-vahide-badivuku/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

ashpra për të akuzuarit, si dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve të cilët kishin kërkuar lirimin nga akuza apo kthimin e rastit në rigjykim.¹⁸⁶

Dëmi i pretenduar: 17 mijë eurot e humbura, pasi ato para ishin të destinuara për tu përdorur për simulimin e veprës penale.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka kërkesë për konfiskim.

¹⁸⁶ “Apeli sërish vërteton dënimin ndaj ish-prokurores së akuzuar për korrupsion, Vahide Badivuku” Betimi për Drejtësi 16 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-serish-verteton-denimin-ndaj-ish-prokurores-se-akuzuar-per-korrupsion-vahide-badivuku/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

4. RASTI “KLLOKOTI 1”

Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: PKR.nr.193/15.

Kryetar i Trupit Gjykues: Aziz Shaqiri.

Prokuror: Agron Uka.

I pandehur: Sreqko Spasiq.

Veprat penale: “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”; “Konflikt interesi”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË



KALUAR 975 DITË)

Sipas aktakuzës së përpiluar më 2 dhjetor të vitit 2015, Sreqko Spasiq duke vepruar si kryetar i Komunës së Klllokotit, më 6 janar 2014, kishte keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar, në atë mënyrë që nuk ka përfillur procedurat e përcaktuara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, duke emëruar Hasan Rushitin si zëvendëskryetar, i cili kishte marrë katër muaj pagë për këtë funksion, duke i kanë shkaktuar kështu dëm buxhetit komunal në vlerë prej 3200 euro.

Aktakuza përfshinte edhe veprën penale “konflikt interesi” nga neni 424 i KPRK-së, ku i akuzuari thuhej se kishte keqpërdorë pozitën zyrtare në atë mënyrë që edhe pas paralajmërimit nga Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) si person i autorizuar në PTU “Aqua Sana” nuk ka ndërmarrë veprime për t’iu shmangur konfliktit të interesit.

Gjykatësi i këtij rasti, Aziz Shaqiri kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 28 janar të vitit 2016, apo 52 ditë pas afatit të paraparë me Kodin e Procedurës Penale. Pas 12 seancave të caktuara, pesë nga të cilat ishin shtyrë, më 19 dhjetor të vitit 2017, Gjykata Themelore në Gjiilan, më 29 dhjetor 2017 kishte liruar nga akuza Spasiqin. Kryetari i trupit gjykues, Aziz Shaqiri, kishte deklaruar se nga provat e paraqitura dhe dëshmitë e dëshmitarëve nuk është vërtetuar

përgjegjësia penale për të akuzuarin Spasiq, në të gjitha pikat e aktakuzës.¹⁸⁷ Gjykata e Apelit, më 3 gusht 2018 e kishte vërtetuar këtë aktgjykim duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e prokurorit.

Dëmi i pretenduar: 90,200.00 euro, edhe pse në aktakuzë dhe në aktgjykim është llogaritur gabimisht dëmi, duke u konsideruar se është vetëm 70,200 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

¹⁸⁷ “Lirohet nga akuzat për keqpërdorim detyre dhe konflikt të interesit ish-kryetari i Klllokotit” , Betimi për Drejtësi, 29 dhjetor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuzat-per-keqperdorim-detyre-dhe-konflikt-te-interesit-ish-kryetari-i-klllokotit/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

5. RASTI “KONTRATA”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.220/17.

Kryetar i Trupit Gjykses: Vehbi Kashtanjeva.

Prokuror: Faik Halili.

Të pandehur: Xhavit Dakaj, Milot Vokshi, Xhemajl Buzuku, Fehmi Zylfiu dhe Bukuriye Borovci

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”; “Cenim të barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.¹⁸⁸

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 1154 DITË)



Më 29 dhjetor të vitit 2015, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj Xhevat Dakaj, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për kryerjen e veprës penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” në bashkëkryerje me Milot Vokshin, sekretar i përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës duke i tejkaluar kështu kompetencat e tyre ku më 12 dhjetor 2014 me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore , për vete apo persona tjerë në mënyrë të kundërligjshme lidhin marrëveshje të mirëkuptimit mes institucionit ku punojnë, përkatësisht mes MASHT-it dhe Gjykatës Kushtetuese me qëllim të shfrytëzimit të kontratës publike kornizë, nga ana e MASHT-it.

¹⁸⁸Në tabelë janë evidentuar të dhënat e shqyrtimit kryesor, numri i seancave dhe data e aktgjykimit vetëm në procesin e rigjyimit.

Më 30 dhjetor 2016, Dakaj dhe Vokshi, ishin shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për veprat për të cilat ngarkoheshin, me atë aktgjykim Dakaj ishte dënuar me dhjetë muaj burgim efektiv, ndërsa Vokshi me gjashtë muaj.

Ndërkaq, ndaj zyrtarit të prokurimit, Xhemajl Buzuku gjykata kishte shpallur aktgjykim lirues për shkak të mungesës së provave.

E pas kthimit të rastit në rigjykim, trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësi Vehbi Kashtanjeva, kishte caktuar 12 seanca gjyqësore, dy nga të cilat ishin shtyrë.

Trupi gjykues më 29 nëntor 2018, të pandehurit i kishte liruar nga akuza. Sipas gjykatës, një vendim i tillë ishte marrë pasi nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkoheshin. Gjykatësi Kashtanjeva kishte thënë se “Rasti është kthyer në rigjykim dhe në bazë të aktgjykimit të Apelit janë dhënë udhëzime të shqyrtohet se a ka pasur dëm buxheti i Kosovës. Me këtë rast ne gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kemi mundur të konstatojmë se në rastin konkret ka pasur ndonjë dëm. Dihet se çdo operator ekonomik kur kryen ndonjë shërbim e ka fitimin. Nuk kemi mundur të konstatojmë se dy të akuzuarit kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme”.¹⁸⁹

Pasi kjo lëndë është trajtuar në Gjykatën e Apelit, e njëjta më 25 shkurt të vitit 2019, ka marrë vendim me të cilin ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë, duke bërë kështu këtë vendim të formës së prerë.¹⁹⁰

Dëmi i pretenduar: 31,612.60 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

¹⁸⁹ “Pas rigjykimit, shpallen të pafajshëm ish-sekretari i Gjykatës Kushtetuese dhe ish-sekretari i MASHT-it (Video)”, Betimi për Drejtësi, 29 nëntor 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-shpallen-te-pafajshem-ish-sekretari-i-gjykatës-kushtetuese-dhe-ish-sekretari-i-masht-it/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁹⁰ Nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit Arber Jashari , për IKD-në, e datës 15.10.2019.

6. RASTI “SUHAREKA”

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr. 27/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Raima Elezi.

Prokuror: Sefer Morina.

Të pandehur: Muharrem Elshani, Hafir Maliqaj, Kurtesh Fondaj, Berat Kabashi, Rraif Fetiu.

Vepra penale: “Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 308 DITË)



Prokuroria Themelore në Prizren, me anë të aktakuzës së ngritur më 15 shkurt 2016, të akuzuarin Muharrem Elshani e akuzonte se duke qenë drejtor i klubit futbolistik “Ballkani” në Suharekë, ka përvetësuar një pjesë të stadiumit prej 16 ari, për nevoja të objektit të tij afarist banesor “Gradina”, ndërsa Kurtesh Fondajn e akuzonte se duke qenë drejtor i urbanizmit në Komunën e Suharekës, ka aprovuar kushtet e ndërtimit duke e ndryshuar pëlqimin urbanistik të vitit 2009, duke ia mundësuar ndërtimin e parkingut për objektin afarist banesor “Gradina”.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ishin mbajtur 10 seanca gjyqësore, mirëpo në fund të shqyrtimit gjyqësor, më 19 dhjetor 2016, në të seancën në të cilën ishte paraparë të jepej fjala përfundimtare, prokurori, prokurori Sefer Morina kishte hequr nga aktakuza me arsye se gjatë administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarëve dhe të akuzuarve, nuk janë vërtetuar

pretendimet e aktakuzës, ndërsa sipas tij, ishin vërtetuar se të gjithë zyrtarët komunal kanë vepruar sipas detyrave dhe autorizimeve të tyre.¹⁹¹

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

¹⁹¹ “Prokurori heq dorë nga akuza ndaj zyrtarëve të Komunës së Suharekës”. Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-akuza-ndaj-zyrtareve-te-komunes-se-suharekes/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

7. RASTI “MATRIX-M”

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: PKR.nr.83/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Ajser Skenderi.

Prokuror: Abdurrahim Islami.

Të pandehur: Selim Kastrati, Milena Krstiq, Bajram Morina, Hamëz Limaj, Gëzim Mallaku dhe Artur Rexha.

Vepra penale: “Krim i organizuar”, “trafikim me njerëz” dhe “mundësim ose detyrim në prostitucion”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 584 DITË)



Ky rast zhvillohej në bazë të aktakuzës së PSRK-së, e cila i ngarkonte të akuzuarit Selim Kastrati, Milena Krstiq, Bajram Morina, Hamëz Limaj, Gëzim Mallaku dhe Artur Rexha me veprat penale “krim i organizuar”, “trafikim me njerëz” dhe veprën penale të “mundësimi ose detyrimi në prostitucion”.

Aktakuza përfshinte edhe banakierin e lokalit “Matrix-M”, Gëzim Mallakun, i cili akuzohej se ka qenë ndërmjetësues në mes femrave dhe klientëve, duke u marrë atyre përqindjet e shërbimeve dhe duke e informuar Selim Kastratin për numrin e klientëve dhe pagesat e bëra nga ta.

Në këtë grup kriminal, sipas aktakuzës, bënte pjesë edhe Artur Rexha nga Tirana, i cili akuzohej se në marrëveshje me Selim Kastratin dhe Bajram Morinën, ka sjellë femra nga Shqipëria për të punuar në lokal.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ngritja e aktakuzës në këtë rast ishte bërë më 7 mars të vitit 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 19 prill të vitit 2016. Pas konfirmimit të aktakuzës në këtë rast ishin mbajtur edhe 10 seanca gjyqësore, ndërsa më 29 maj 2017, Gjykata Themelore në Prizren kishte shpallur aktgjykimin me të cilin nga gjashtë të akuzuarit, për veprën penale të trafikimit me njerëz ishin gjetur fajtor vetëm Selim Kastrati dhe Milena Krstiq.

Kastrati ishte dënuar me pesë vjet burgim efektiv dhe pesë mijë euro gjobë, ndërsa e akuzuara, Krstiq ishte dënuar me tri vjet e gjashtë muaj burgim efektiv dhe me 2000 euro gjobë.

Të akuzuarit e tjerë, Bajram Morina, Hamëz Limaj, Gëzim Mallaku dhe Artur Rexha ishin liruar nga të gjitha akuzat me të cilat ngarkoheshin.

Dëmi i pretenduar: Nuk është përcaktuar në aktakuzë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

8. RASTI “AVOKATI 1”

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës PKR.nr.47/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Shaqir Zika.

Prokuror: Agron Majtani.

Të pandehur: Afrim Radoniqi dhe Xhevat Rraci.

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 197 DITË)



Bazuar në aktakuzën e ngritur më 7 prill 2016, dyshohej se me 17 shtator 2012, Afrim Radoniqi në cilësinë e avokatit publik të Gjakovës dhe Xhevat Rraci në cilësinë e drejtorit pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër e Pronë të komunës së Gjakovës, i kishin shkaktuar dëm kësaj komune. Prokuroria Themelore në Gjakovë pretendonte se ata këtë e kanë bërë në atë mënyrë që kanë arritur marrëveshje për kompensim me pronarin e mëparshëm të një prone Pren Ibishaj nga fshati Brekoc, Komuna e Gjakovës, të cilit i njihet e drejta në shfrytëzimin e përhershëm të ngastrës kadastrale me numër 4452, me sipërfaqe prej 345 metra katrorë, pa obligim të kompensimit në emër të shfrytëzimit dhe rregullimit të tokës ndërtimore.

Pas ngritjes së aktakuzës, seanca fillestare ishte mbajtur më 30 maj të vitit 2016 apo 23 ditë nga koha e paraparë me KPPK, në atë seancë të akuzuarit Afrim Radoniqi dhe Xhevat Rraci ishin deklaruar të pafajshëm, duke shtuar se nuk mund të kenë përgjegjësi penale, pasi të njëjtit nuk i kishin kaluar kompetencat e tyre zyrtare.

Mirëpo, menjëherë pas shqyrtimit të dytë, prokurori Agron Majtani me anë të parashtresës së dorëzuar në gjykatë më 6 tetor 2016 kishte tërhequr aktakuzën.

Në arsyetimin e tij, gjykatësi i rastit Shaqir Zika, kishte theksuar se prokurori i shtetit më 6 tetor 2016 ka njoftuar për tërheqjen e tij nga aktakuza në fjalë. Sipas tij, kjo ishte bërë me arsyetimin

se pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, është arritur në përfundim se të pandehurit Radoniqi dhe Raci nuk kanë përfituar përfitim të kundërligjshëm për vete, e as për personat e tjerë, e madje, të njëjtit nuk i kanë shkaktuar as dëm Komunës së Gjakovës.

Dëmi i pretenduar: Prona me sipërfaqe prej 345 metra katrorë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

9. RASTI “APELI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.338/16.

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti.

Prokurore: Drita Hajdari.

Të pandehur: Salih Mekaj; Vlora Gorani; Mentor Seferaj; Ali Seferaj.

Vepra penale: “Ushtrim i ndikimit”; “Shtytje në kryerjen e veprës penale ushtrim i ndikimit” dhe “Dhënia e ryshfetit”.

Faza procedurale: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 905 DITË)



Më 31 maj 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe anëtarit të KGJK-së, Salih Mekaj, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Po ashtu, e pandehura Vlora Gorani, akuzohet se me dashje ka shtyrë të pandehurin Salih Mekaj të kryejë veprën penale, me qëllim që përmes tij ta shpejtojë caktimin e shqyrtimit gjyqësor dhe pastaj edhe ri-cilësimin juridik të veprave penale për të pandehurin Mentor Seferaj dhe një tjetër të pandehur në një tjetër rast penal, e në këtë mënyrë të arrijë lirimin e këtyre dy personave nga paraburgimi.

Ky proces gjyqësor, ishte mbajtur larg syve të publikut për shkak të vendimit të gjykatës për ta mbyllur atë për median dhe publikun.

Ndërsa, gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor, prokurorja Drita Hajdari, kishte rikualifikuar veprën penale ndaj Mekajt, nga “keqpërdorimi i pozitës zyrtare”, në “ushtrim i ndikimit”. Gjykata, më 28 maj 2018, shpalli aktgjykimin me të cilin i liroi të akuzuarit nga të gjitha akuzat.¹⁹² Me këtë aktgjykim e akuzuara Vlora Goraniu lirua për veprën penale “shtytje në kryerjen e veprës penale të ushtrimit të ndikimit”, ndërsa për veprën penale “dhënie e ryshfetit”, përveç Gorani, ishin liruar edhe të akuzuarit Mentor Seferaj dhe Ali Seferaj.

Aktgjykimin e shkallës së parë, e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 22 nëntor 2018, i kishte liruar përfundimisht nga akuzat Mekajn dhe të tjerët.¹⁹³ E pakënaqur me vendimet e shkallës së parë dhe të dytë, prokuroria me pretendimet se gjyqësori nuk ka vepruar drejt kur ka liruar Mekajn dhe të tjerët, me mjet të jashtëzakonshëm për mbrojtje të ligjshmërisë i është drejtuar edhe Gjykatës Supreme, por edhe kjo gjykatë ka vërtetuar vendimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore, duke konstatuar se ka pasur shkelje të ligjit në favor të të pandehurve.¹⁹⁴

Dëmi i pretenduar: Nuk ka kërkesë të përcaktuar në aktakuzë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: 15,000 euro (me vendimin e shkallës së parë, këto mjete i janë kthyer të akuzuarës Vlora Gorani).

¹⁹² “Ish-kryetari i Apelit, Salih Mekaj lirohet nga të gjitha akuzat (Video)”. Betimi për Drejtësi. 28 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-apelit-salih-mekaj-lirohet-nga-te-gjitha-akuzat/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁹³ “Gjykata e Apelit vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të saj, Salih Mekaj dhe tre të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-saj-salih-mekaj-dhe-tre-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁹⁴ “Edhe Supremja konfirmon pafajësinë e Mekajt”. Koha.net. 22 janar 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/140997/edhe-supremja-konfirmon-pafajesine-e-mekajt/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

10. RASTI “QERAJA”

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: P.nr.77/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Beqir Halili.

Prokuror: Njazi Rexha.

I/E pandehur: Halim Gecaj, Lulzim Kadriu, Hetem Sejdijs, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani. Në aktakuzë ka qenë i përfshirë edhe Feriz Zeqiri, por ndaj tij ka pushuar procedura penale, pasi që i njëjti ka ndërruar jetë.

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 638 DITË)



Prokuroria Themelore e Mitrovicës më 7 korrik 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj Halim Gecajt, Lulzim Kadriut, Hetem Sejdijs, Valentina Jasharit, Nuradin Hasanit dhe Feriz Zeqirit, duke i ngarkuar ata me veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor në këtë rast më 23 tetor të vitit 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dy zyrtarët e Komunës së Skenderajt, Halim Gecajn dhe Lulzim Kadriun, i kishte shpallur fajtorë për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe ndaj tyre kishte shqiptuar dënim me nga gjashtë muaj burgim, kurse, nga akuza ishin liruar tre të pandehurit e tjerë, Hetem Sejdijs, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani. Ndërsa, sipas gjykatësit Beqir Halili, të akuzuarit Hetem Sejdijs, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani janë shpallur të pafajshëm, sepse sipas tij, nuk

ishte konstatuar se ka pasur dashje gjatë kryerjes së detyrave në komisionin për hapjen e ofertave, në lidhje me dhënien e pronave komunale në shfrytëzim.¹⁹⁵

Të pakënaqur me aktgjykimin e shpallur nga gjykata e shkallës së parë në Mitrovicë, Halim Gecaj e Lulzim Kadriu, si dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë kishin parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Mirëpo, kjo gjykatë më 6 prill të vitit 2018, i kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Gecaj e Kadriu si dhe atë të prokurorisë, ndërsa kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dëmi i pretenduar: Nuk është përcaktuar me aktakuzë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹⁹⁵ “Dy zyrtarë të Komunës së Skenderajt dënohen me burg, tre të tjerë lirohen nga akuza (Video)”, Betimi për Drejtësi, 23 tetor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-zyrtare-te-komunes-se-skenderajt-denohen-me-burg-tre-te-tjere-lirohen-nga-akuza/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

11. RASTI “NDËRTIMI”

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: PKR.nr.10/18

Kryetare e Trupit Gjykses: Ajser Skenderi.


Prokuror: Genc Nixha.

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Uzurpim i pronës së paluajtshme”.

Të pandehur: Salim Jenuzi; Nexhat Selaj; Bean Haxhihasani dhe Vetim Hasani.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.¹⁹⁶

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 947 DITË)



Prokuroria Themelore në Prizren, më 10 gusht 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër Kryetarit të Komunës së Dragashit, Selim Jenuzi, Drejtorit komunal të Urbanizmit, Bean Haxhihasani, inspektorit të kësaj komune, Vetim Hasani dhe biznesmenit Nexhat Selaj, për veprën penale të “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Uzurpim i pronës së paluajtshme”.

Salim Jenuzi, akuzohej se si Kryetar i Dragashit, në periudhën 2009-2016, ia ka mundur Nexhat Selajt, përvetësimin e pronës komunale, të cilën ky e kishte uzurpuar paraprakisht. Bean Haxhihasani, akuzohej se në cilësinë e drejtorit të urbanizmit në Komunën e Dragashit, ka lëshuar një vendim me të cilin i është lejuar Nexhat Selajt, që të ndërtojë objektin afarist në pronë komunale, ndërsa Vetim Hasani, akuzohet se në cilësinë e inspektorit të ndërtimit në Komunën e Dragashit, nuk ka vepruar për ta ndërprerë ndërtimin e objektit afarist të Nexhat Selajt, me material të përhershëm.

Në këtë rast, Gjykata Themelore në Prizren, më 21 nëntor 2017, kishte shpallur aktgjykimin në këtë rast, e ku Salim Jenuzi, ishte dënuar me një vit burgim me kusht, pasi ishte shpallur fajtor për keqpërdorim të detyrës zyrtare, por që dënimi me burgim nuk do të ekzekutohej, nëse Jenuzi

¹⁹⁶ Shënim: Në tabelë janë evidentuar të dhënat e shqyrtimit kryesor, numri i seancave dhe data e aktgjykimit vetëm në procesin e rigjyimit.

brenda periudhës prej dy vjetësh, nuk kryen vepër të re penale. Kurse, edhe Nexhat Selaj, ishte dënues me gjashtë muaj burgim, për uzurpim të pronës së paluajtshme, i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse ai brenda dy vjetësh nuk kryen vepër të re penale.

Ndërsa, të akuzuarit Bean Haxhihasani dhe Vetim Hasani, ishin liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, me arsyetimin se nuk është vërtetuar gjendja faktike sipas aktakuzës.¹⁹⁷

Pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në shkurt të vitit 2018, e kishte kthyer në rigjykim rastin vetëm sa i përket të akuzuarve Jenuzi dhe Selaj, kurse, për të akuzuarit Bean Haxhihasani dhe Vetim Hasani e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.¹⁹⁸

Në seancën që ishte mbajtur më 5 tetor 2018, prokurori Genc Nixha kishte vendosur që të tërhiqej nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit Jenuzi, me arsyetimin se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale,¹⁹⁹ që ndikoi që përfundimisht, më 9 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prizren, të shpallte aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, Salim Jenuzi, i cili akuzohej për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”, kurse në mungesë të provave kishte liruar nga akuza për “uzurpim të pronës së paluajtshme” të akuzuarin Nexhat Selaj.²⁰⁰

Pas këtij vendimi të Gjykatës Themelore në Prizren, Prokuroria Themelore në Prizren kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar që instanca e dytë gjyqësore të shqiptojë aktgjykim dënues ndaj tij ose që çështjen ta kthejë edhe një herë në rigjykim.²⁰¹ Mirëpo, më 4 mars 2019, gjykata e shkallës së dytë kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore në Prizren.²⁰²

Dëmi i pretenduar: Nuk ka kërkesë të përcaktuar në aktakuzë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

¹⁹⁷ “Dënohet me kusht kryetari i Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi (Video)”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-kryetari-i-komunes-se-dragashit-salim-jenuzi/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁹⁸ “Apeli kthen në rigjykim rastin kundër ish-kryetarit të Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-kunder-ish-kryetarit-te-komunes-se-dragashit-salim-jenuzi/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

¹⁹⁹ “Arrihet parashkrimi absolut, prokuroria heq dorë nga ndjekja penale ndaj ish-kryetarit të Dragashit” Betimi për Drejtësi. 5 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arrihet-parashkrimi-absolut-prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²⁰⁰ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, shpallet i pafajshëm i akuzuari për uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-uzurpim-prone/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²⁰¹ “Prokuroria kërkon dënim ose rigjykim për të bashkakuzuarin e ish-kryetarit të Dragashit, që ishte liruar nga shkalla e parë” Betimi për Drejtësi. 5 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denim-ose-rigjykim-per-te-bashkakuzuarin-e-ish-kryetarit-te-dragashit-qe-ishte-liruar-nga-shkalla-e-pare/>) . (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²⁰² Nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, z.Arber Jashari , për IKD-në, e datës 15.10.2019.

12. RASTI “KLLOKOTI 2”

Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: PKR.nr.174/2015

Kryetar i Trupit Gjykses: Afrim Shala.

Prokuror: Afrim Shefkiu.

I pandehur: Sreqko Spasiq.

Vepra penale: “Konflikt interesi”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 152 DITË)

Sipas aktakuzës të ngritur më 21 tetor 2015 nga Prokuroria Themelore në Gjiilan pretendohej se Sreqko Spasiq në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Klllokotit kishte kryer veprën penale “konflikt interesi”.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 13 janar të vitit 2016, ku ishte kërkuar hudhja e aktakuzës dhe ishte bërë kundërshtimi i provave nga mbrojtja, ndërsa nga prokuroria ishte kërkuar refuzimi i një kërkesë të tillë. Pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, në po të njëjtën datë, më 13 janar 2016 gjykatësi Afrim Shala, me arsyetimin se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, kishte hudhur aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj Spasiqit.²⁰³

Por, më 27 janar të vitit 2016, Gjykata e Apelit kishte aprovuar ankesën e prokurorisë ndaj aktvendimit për hudhje të aktakuzës dhe e kishte kthyer çështjen në rivendosje. Megjithatë,

²⁰³ Nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, z.Sabit Shkodra, për IKD-në, e datës 06.02.2019.

shkalla e parë përsëri më 12 shkurt 2016, kishte hedhur poshtë aktakuzën e prokurorisë dhe ky vendim ishte bërë i plotfuqishëm më 21 mars të vitit 2013.²⁰⁴

Dëmi i pretenduar: Nuk ka kërkesë të përcaktuar në aktakuzë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

²⁰⁴ Nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, z.Sabit Shkodra, për IKD-në, e datës 17.05.2019.

13. RASTI “AUTORITETI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.656/16.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Valon Kurtaj, e më pas Arben Hoti.

Prokurore: Fillimisht ka qenë Ali Rexha, e më pas Fikrije Fejzullahu.

Të pandehur: Ramë Buja, Xhavit Dakaj, Xhemajl Buzuku, Afrim Demiri.

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashttrim”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 704 DITË)



Më 7 nëntor të vitit 2016, PSRK kishte ngritur aktakuzë me të cilën e akuzonte ministrin Ramë Buja se në cilësi të Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Xhavit Dakaj si sekretar i Përgjithshëm në MASHT pretendohet se kishin lidhur marrëveshje të kundërligjshme me operatorin ekonomik “Alb – Architect”, pronar i të cilës është i akuzuari, Afrim Demiri. Ndërsa Xhemajl Buzuku, akuzohet se në cilësinë e drejtorit të prokurimit në MASHT, me qëllim të përfitimit për vete apo për të tjerët, më 15 maj 2009, kishte lidhur kontratë për 24 muaj me mundësi vazhdimi edhe për 12 muaj, me operatorin ekonomik “Alb-Architect” për projektin “Mbikëqyrja Profesionale e Objekteve Kapitale të Ndërtuara nga MASHT”.

Pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, gjykata më 28 prill 2017, ka hedhur poshtë aktakuzën ndaj ish-ministrit, Ramë Buja dhe ish-sekretarit, Xhavit Dakaj, me arsyetimin se PSRK-ja, nuk ka mundur me asnjë provë të vetme të vë në pah faktin e tejkalimit të kompetencave zyrtare apo keqpërdorimit të pozitës, nga të akuzuarit Buja dhe Dakaj, ndërsa aktakuza ishte konfirmuar për

dy të akuzuarit e tjerë Xhemajl Buzuku dhe Afrim Demiri.²⁰⁵ Ky vendim më pas ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.²⁰⁶

Ndërsa, më 2 maj të vitit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, i kishte liruar nga akuza të akuzuarit Buzuku e Demiri.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka kërkesë të përcaktuar në aktakuzë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka pasur asnjë kërkesë në aktakuzë.

²⁰⁵ “Prokurori Special nuk është në dijeni për hedhjen e aktakuzës ndaj ish-ministrit, Ramë Buja” Betimi për Drejtës, 16 maj 2017 (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-nuk-eshte-ne-dijeni-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-rame-buja/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²⁰⁶ “Apeli vërteton vendimin për hedhjen e aktakuzës ndaj ish-ministrit Buja”, Betimi për Drejtës, 5 qershor 2017 (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-vendimin-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-buja/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

14. RASTI “INSPEKTORI”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.24/17.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Valon Kurtaj e më pas Shpresa Hasaj-Hyseni.

Prokuror: Merita Bina-Rugova.

I pandehur: Muhamet Binaku.

Vepra penale: “Marrje ryshfeti”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 471 DITË)



Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e ngritur më 23 janar 2017, pretendonte se Muhamet Binaku, në pozitën e Kryeinspektorit të Regjionit të Prishtinës, pranë Inspektoratit të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka kërkuar 10,000 euro nga dëshmitari Liridon Zogiani, kontabilist në kompaninë “All Zone”.

Më 8 maj të vitit 2018, i akuzuari Binaku kishte vendosur që ta pranojë fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë dhe ishte dënuar me gjashtë muaj burgim, si dhe dy mijë euro gjobë. Dënimi me burgim në këtë rast, me pëlqimin e të pandehurit, është konvertuar në dënim me gjobë.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

15. RASTI “NDËRRIMI”

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: P.nr.42/2018.

Kryetar i Trupit Gjykses: Radosllav Markoviq.


Prokuror: Florije Shamolli.

Të pandehur: Milan Aliksijeviç, Mladen Mijatoviç, Makfir Spahiu dhe Stanisha Radishiç.

Veprat penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.²⁰⁷

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 119 DITË)



Sipas aktakuzës së PSRK-së, e cila ishte ngritur më 27 prill 2018, të akuzuarit Milan Aliksijeviç, Mladen Mijatoviç, Makfir Spahiu dhe Stanisha Radishiç, fillimisht janë ngarkuar për kryerjen e veprave penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” dhe “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, mirëpo, pas arritjes së marrëveshjes në mes tyre dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ishte vendosur që të pranohet fajësia nga të akuzuarit dhe të ndryshohet aktakuza në atë mënyrë, që të akuzuarit në fjalë të ngarkohen vetëm me veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 23 gusht 2018, apo pas afër katër muaj pas afatit të paraparë më KPPK. Në atë seancë të akuzuarit kishin arritur marrëveshje për praninë të fajësisë, marrëveshje që ishte pranuar nga ana gjykatësit Radosllav Markoviq. Atë ditë u bë edhe shpallja e aktgjykimit, sipas të cilit, të akuzuarit ishin dënuar me nga dy vjet e katër muaj

²⁰⁷ Ky rast në listën e koordinatorit të KGJK-së të dërguar për IKD-në më 6 maj 2019, nuk figuron në listën e rasteve të formës së prerë por nga përgjigja elektronike e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit Arber Jashari për IKD-në, e datës 26.04.2019, është thënë se kjo lëndë nuk është trajtuar nga Gjykata e Apelit.

burgim efektiv dhe 1,000 euro gjobë, për kryerjen e veprës penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka dëm të përcaktuar me aktakuzë.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Narkotiku në peshë prej 11 kg e 422.855 gramë dhe vetura e markës “Peugeot 307”.

16. RASTI “HIB”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.385/15.

Kryetar i trupit gjykues: Rustem Begolli.

Prokuror: Fillimisht ka qenë Atdhe Dema, e më pas Bashkim Zeqa.

Të pandehur: Kujtim Bucaliu, “HIB Petrol”.

Veprat penale: “Mashttrim”; “Mashttrim i blerësve”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.²⁰⁸

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR KANË KALUAR KANË KALUAR 1590)



Sipas aktakuzës së përpiluar më 6 korrik të vitit 2015, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Kujtim Bucaliu dhe “HIB Petrol SH.P.K.” ngarkohen me veprat penale “mashtrimi” dhe “mashtrimi i blerësve”.

Sipas prokurorisë, në intervalin kohor nga 8 shkurt 2012 e deri më 30 janar 2014, “HIB Petrol SH.P.K.” dhe e dëmtuara–Komuna e Prishtinës kishin nënshkruar kontratë për furnizimin me naftë të 44 institucioneve edukativo-arsimore brenda territorit të Komunës së Prishtinës për ngrohje dhe gjenerator. Personi përgjegjës i personit juridik “HIB Petrol SH.P.K.”, Kujtim Bucaliu, me vetëdije kishte mashtuar Komunën e Prishtinës me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të fondeve publike për vete. Të njëjtat kishin siguruar vajra gazore për ngrohje nga burime të paidentifikuara, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve përmes fletëpagesave lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e naftës.

Me këtë aktakuzë në cilësinë e personit juridik akuzohet edhe “HIB Petrol SH.P.K.”, pasi që pretendohet se duke vepruar sipas kontratës me Komunën e Prishtinës e kishte mashtuar të njëjtën duke vepruar në dëm të pasurisë së saj, duke i ofruar naftën e cila nuk përkonte me

²⁰⁸Në tabelë janë evidentuar të dhënat e shqyrtimit kryesor, numri i seancave dhe data e aktgjykimit vetëm në procesin e rigjykit.

kriteret dhe cilësitë e karburanteve të lëngëta të naftës të parapara me neni 7 të udhëzimit administrativ, si dhe duke tejkaluar prezencën prej 10,0mg/kg të sulfurit në naftë, madje edhe duke e tejkaluar vlerën e lejuar deri në 80 herë më shumë, për t'i shkaktuar rrjedhimisht dëm në shkallë të madhe të dëmtuarës Komunës së Prishtinës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Komuna e Prishtinës, më 27 maj të vitit 2014, kishte ushtruar kallëzim penal kundër “HIB Petrol SH.P.K” dhe personit përgjegjës të personit juridik për veprat penale “mashtrimi” dhe “mashtrimi i blerësve”, “legalizim i përmbajtjes së rreme” dhe “mbajtja e paligjshme e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme”. Më pas, më 3 tetor 2014, Prokuroria Themelore në Prishtinë, kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër Kujtim Bucaliut si person përgjegjës i personit juridik “HIB Petrol SH.P.K.” për shkak të veprës penale “mashtrim i blerësve”.

Pas analizimit e vlerësimit të të gjitha provave, informacioneve dhe shkresave të siguruar gjatë hetimeve, prokuroria kishte zgjeruar hetimet më 2 qershor 2015 edhe për veprën penale “mashtrim” kundër Kujtim Bucaliut, si person përgjegjës i personit juridik “HIB Petrol SH.P.K.”.

Aktakuza ndaj Bucaliut dhe “HIB Petrol SH.P.K.” ishte ngritur më 6 korrik 2015, ndërsa shqyrtimi fillestar nga Departamenti i Krimeve të Rënda në këtë rast ishte mbajtur më 2 dhjetor të vitit 2015. Pastaj, 6 ditë pas shqyrtimit fillestar, gjykatësi Florent Latifaj, këtë lëndë me akt përcjellës e kishte deleguar në Departamentin e Përgjithshëm me arsyetimin se kjo lëndë binte në kompetencë të këtij departamenti.²⁰⁹

Kjo lëndë më pas ishte trajtuar nga gjyqtari Rustem Begolli, i cili shqyrtimin e dytë e kishte mbajtur më 14 shkurt të vitit 2017, apo një vit e gjysmë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Epilogun në shkallë të parë ky gjykim e kishte pasur më 18 maj të vitit 2018, kur edhe ishte bërë shpallja e aktgjyqimit. Kujtim Bucaliu ishte dënuar me dënim unik prej katër vjetësh burgim, pasi ishte shpallur fajtor për veprat penale “mashtrimi” dhe “mashtrimi i blerësve”. Ai ishte dënuar edhe me gjobë në shumë prej 15 mijë eurosh. Për veprën penale të mashtimit, Bucaliu ishte dënuar me tre vjet burgim si dhe me 15 mijë euro gjobë, ndërsa për atë të mashtimit të blerësve, ishte dënuar me një vit e katër muaj burgim. Pas kësaj, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte shqiptuar dënimin unik prej katër vjetësh burgim, si dhe 15 mijë euro gjobë.

²⁰⁹ Akti përcjellës i gjykatësit z.Florent Latifaj, i datës 8 dhjetor 2015 i siguruar nga IKD në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kurse, personi juridik “HIB Petrol”, për veprën penale të mashtrimit ishte dënuar me dënim unik prej 30 mijë eurosh gjobë. “HIB Petrol”, me përfaqësuesin Shkelzen Hetaj, për “mashttrim” ishte dënuar me 25 mijë euro gjobë, kurse për atë të mashtrimit të blerësve ishte dënuar me tetë mijë euro gjobë. Pas kësaj, gjykata kishte shqiptuar dënimin unik në shumë prej 30 mijë eurosh. HIB Petrolit i ishte konfiskuar edhe autoboti cisterna, e cila është rezultat i veprës penale. Ndërkaq, Komuna e Prishtinës ishte udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.²¹⁰

Pas ankesave të mbrojtjes, këtë rast, Gjkata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim. Pas kthimit në rigjykim, në seancën e mbajtur më 13 nëntor 2018, gjykatësi Begolli, kishte kërkuar nga prokuroria të bëhet plotësimi i aktakuzës.²¹¹ Ndërkaq, në këtë proces të rigjykimit përpos seancës së 5 shkurtit 2019, e cila ishte shtyrë për shkak mungesës së mbrojtësit së të akuzuarit Bucaliu²¹², gjykatësi Rustem Begolli, ka arritur të mbajë katër seanca të tjera, konkretisht me 15 shkurt, si dhe 4, 18 dhe 28 mars 2019.

Më 8 maj 2019, kishte mbaruar përfunduar rigjykimi, ku ishte dhënë fjala përfundimtare, ndërkaq, dy ditë më vonë, më 10 maj, Gjkata Themelore në Prishtinë, konkretisht gjykatësi Rustem Begolli, e kishte ndryshuar vendimin e tij të mëhershëm duke vendosur që ta lirojë nga akuzat për veprat penale të “mashttrimit” dhe atë të “mashttrimit të blerësve”, drejtorin gjeneral të “HIB Petrol”, Kujtim Bucaliu dhe kompaninë e tij.²¹³ Sipas gjykatësit Begolli, pas analizimit të provave veç e veç dhe në tërësinë e tyre, gjykata kishte arritur në përfundimin se nuk është tejkaluar dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari dhe kompania e tij kanë kryer veprat penale që u ngarkoheshin. Gjkata e Begolli ka obliguar Agjencinë për Administrimin e Sendeve të Sekuestruara, që kompanisë “HIB Petrol” t’i kthehet autoboti cisterna e sekuestruar, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ndërkaq Komuna e Prishtinës, si palë e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Më pas, Gjkata e Apelit e ka liruar përfundimisht nga akuzat për mashttrim, kompaninë “HIB Petrol” dhe drejtorin e saj, Kujtim Bucaliu, të akuzuar për veprën penale të mashtrimit.

²¹⁰ “Dënohen me burgim dhe me gjobë “HIB Petrol” dhe pronari Kujtim Bucaliu, për furnizimin me naftë jociësore në Prishtinë”, Betimi për Drejtësi, 18 maj 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-dhe-me-gjobe-hib-petrol-dhe-pronari-kujtim-bucaliu-per-furnizimin-me-nafte-jocilesore-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹¹ “Gjkata kërkon plotësimin e aktakuzës në rigjykimin e rastit “HIB Petrol”, prokuroria e mbrojtja e kundërshtojnë”, Betimi për Drejtësi, 13 nëntor 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjkata-kerkon-plotesimin-e-aktakuzes-ne-rigjykimin-e-rastit-hib-petrol-prokuroria-e-mbrojtja-e-kundershtojne/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹² “Shtyhet seanca e rigjykimit ndaj “HIB Petrol” rreth furnizimit me naftë për shkollat e Prishtinës” Betimi për Drejtësi, 5 shkurt 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-e-rigjykimit-ndaj-hib-petrol-rreth-furnizimit-me-nafte-per-shkollat-e-prishtines/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹³ “Pas rigjykimit, drejtori i “HIB Petrol” lirohet nga akuzat për furnizim me naftë jociësore në shkollat e Prishtinës” Betimi për Drejtësi, 10 maj 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-drejtori-i-hib-petrol-lirohet-nga-akuzat-per-furnizim-me-nafte-jocilesore-ne-shkollat-e-prishtines/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Apeli ka refuzuar ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke lënë kështu në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë, e cila gjithashtu e kishte liruar ata nga akuza.²¹⁴

Dëmi i pretenduar: Nuk ka dëm të përcaktuar me aktakuzë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi: Autoboti – cisterna e kompanisë “HIB Petrol”.

²¹⁴ “Apeli përfundimisht liron nga akuzat për furnizim me naftë jocilësore në Prishtinë kompaninë “HIB Petrol” dhe drejtorin e saj”, 13 nëntor 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-perfundimisht-liron-nga-akuzat-per-furnizim-me-nafte-jocilesore-ne-prishtine-kompanine-hib-petrol-dhe-drejtorin-e-saj/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

17. RASTI “UP”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.432/15.

Kryetar i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Afërdita Bytyçi, e më pas Arben Hoti.

Prokurore: Drita Hajdari.

Të pandehur: Enver Hasani; Hakif Velu; Albert Rakipi.

Vepra penale: “Mashttrim në detyrë”.

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË AKTGJYKIMIN PËRFUNDIMTAR, KANË KALUAR 1356 DITË)



Më 31 korrik të vitit 2015, prokurorja e PSRK-së Drita Hajdari, kishte përpiluar dhe ngritur aktakuzën në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Sipas PSRK-së, Enver Hasani në cilësinë e rektorit të UP-së, Haki Velu në cilësi të shefit të Zyrës së Prokurimit në UP dhe Albert Rakipi në cilësi të drejtorit të Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN) me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për këtë institut, kishin falsifikuar kontratën origjinale lidhur me përkthimin e disa librave nga gjuha angleze në atë shqipe.

Sipas aktakuzës, të njëjtit kishin hartuar edhe një kontratë të re, duke shfrytëzuar numrin e njëjtë të protokollit nga kontrata origjinale. Sipas kontratës origjinale, vlera e saj kishte qenë 500.000 euro, përkatësisht çmimi i pagesës për njësi 1000 fjalë 12.65 euro e stipuluar me nenin 17, ndërsa në kontratën e re sipas prokurorisë, kjo pjesë është ndryshuar në 1,000 karaktere për 12.65 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 25 korrik të vitit 2012, Policia e Kosovës kishte parashtruar kallëzim penal ndaj Hakif Velut e Albert Rakipit lidhur me keqpërdorimet në Universitetin e Prishtinës. Aktvendimin për fillim të hetimeve, Prokuroria Themelore në Prishtinë e kishte marrë më 9 janar të vitit 2014. Kjo lëndë ishte hetuar nga një ekip i prokurorëve të EULEX-it dhe të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. EULEX-i më 12 gusht 2014 këtë lëndë e kishte transferuar në Prokurorinë Themelore në

Prishtinë. Ndërsa, kjo prokurori, më 21 nëntor 2014, ia kishte transferuar lëndën PSRK-së. Prokurorja Drita Hajdari, më pas, më 14 prill 2015, kishte nxjerrë vendim për zgjerim të hetimeve, duke përfshirë në cilësinë e rektorit të UP-së edhe Enver Hasanin.

Gjatë asaj kohe, zhvillohej gara për Kryeprokuror të Shtetit, ku Gjykata Kushtetuese në krye me Enver Hasanin, kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, në të cilin ishte zgjedhur kandidati Aleksandër Lumezi. Aso kohe, një pjesë e anëtarëve të KPK – së kishin zhvilluar “luftë” publike me Gjykatën Kushtetuese për procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit. Dhe posa Gjykata Kushtetuese kishte hapur rrugë për dekretimin e Kryeprokurorit Lumezi, ndaj Enver Hasanit, në të njëjtën ditë, më 14 prill 2015, PSRK – ja kishte nxjerrë dy vendime për fillimin e hetimeve kundër tij. Njëri lidhej me rastin kur kishte qenë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa tjetri për kohën sa kishte qenë Rektor i UP – së.

Në këtë të fundit, aktakuza kundër Enver Hasanit dhe dy të tjerëve ishte ngritur më 31 korrik 2015 për vepra penale të korrupsionit. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur 118 ditë pas ngritjes së aktakuzës, më 27 nëntor 2015. Ndërsa, shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 11 janar të vitit 2016.

Shqyrtimi kryesor ishte hapur më 9 mars të vitit 2016²¹⁵, kurse më 8 prill të po këtij viti, mbrojtja e Hasanit kishte bërë të ditur se ky i fundit do të mbrohet në heshtje.²¹⁶ Epilogun, ky rast, në shkallë të parë e kishte arritur më 18 tetor të vitit 2017 me shpallje të aktgjykimit dënues nga ana e trupit gjykues. Enver Hasani ishte dënuar me 1 vit burgim me kusht, por dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohej nëse ai në periudhën dy vjeçare nuk do të kryente vepër tjetër penale. Kurse, Hakif Veliu e Albert Rakipi, ishin dënuar me nga gjashtë muaj burgim efektiv. Por, sipas aktgjykimit, ndaj tyre dënimi me burgim, mund të zëvendësohej me gjobë në shumë prej 10 mijë eurosh. Me këtë aktgjykim, gjykata i kishte obliguar që t’ia kompensojnë UP-së shumën prej 70,131.27 euro.²¹⁷

Më 2 maj të vitit 2018, Gjykata e Apelit kishte shqyrtuar ankesat në këtë rast. Apeli nuk kishte mbajtur seancë publike pasi që në rastin konkret nuk bëhej fjalë për aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.²¹⁸

²¹⁵ “Hapet shqyrtimi kryesor për akuzat për keqpërdorime në Up nga Enver Hasani”, Betimi për Drejtësi, 9 mars 2016, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hapet-shqyrtimi-kryesor-per-keqpërdorimet-e-pretenduar-ne-up/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹⁶ “Enver Hasani do të mbrohet në heshtje”, Betimi për Drejtësi, 8 prill 2016, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-do-te-mbrohet-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹⁷ “Enver Hasani dënohet me burgim me kusht dhe obligohet tëia kthejë UP-së mbi 70 mijë euro (Video)”, Betimi për Drejtësi, 18 tetor 2017, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-dënohet-me-burgim-me-kusht-dhe-obligohet-tia-ktheje-up-se-mbi-70-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²¹⁸ “Apeli shqyrton ankesat e palëve në rastin e ish-rektorit të UP-së, Enver Hasani”, Betimi për Drejtësi, 2 maj 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-shqyrton-ankesat-e-paleve-ne-rastin-e-ish-rektorit-te-up-se-enver-hasani/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Gjykata e Apelit, më pas e kishte liruar nga akuzat për mashtrim në detyrë, ish-rektorin e Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani. Sipas vendimit të instancës së dytë, PSRK-ja nuk e kishte provuar fajësinë e Hasanit. Kurse, Apeli e kishte aprovuar ankesën e Prokurorisë, lidhur me dy të akuzuarit e tjerë të këtij rasti, Haki Velu dhe Albert Rakipi. Për këta të fundit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ishte ndryshuar vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që kjo gjykatë këta të akuzuar për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor i kishte gjykuar secilin me nga 1 vit burgim efektiv.²¹⁹

Përfundimisht pafajësinë e Hasanit lidhur me këtë rast e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme. Kjo gjykatë kishte refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilën e kishte ushtruar Prokurori i Shtetit, megjithatë e kishte kthyer në rivendosje në Gjykatën e Apelit vendimin ndaj Hakif Velut dhe Albert Rakipit, duke e anuluar vendimin e Apelit.²²⁰

Pasi Gjykata Supreme kishte konstatuar se ndaj Hakif Velut dhe Albert Rakipit, shkalla e dytë kishte shkelur të drejtat për një gjykim të drejtë, meqë të njëjtit nuk ishin ftuar për seancën e Apelit të mbajtur më 2 maj 2018 dhe si pasojë të njëjtit nuk kishin pasur mundësi të paraqesin argumentet e tyre lidhur me këtë çështje juridike-penale. Seanca e kolegjit të Apelit, ishte mbajtur më 16 prill, 2019. Më pas, Gjykata e Apelit sërish ua ka ashpërsuar dënimet, dy të akuzuarve për mashtrim në detyrë, Hakif Velu dhe Albert Rakipi, të cilëve ua ka shqiptuar nga një vit burg efektiv, ndërsa të njëjtit ishin liruar nga obligimi që t'ia kompensojnë UP-së shumën prej 70,131.27 euro, pasi UP-ja për kompensimin e këtij dëmi është udhëzuar në kontest civil.²²¹

Pas këtij vendimi të Gjykatës së Apelit, të pandehurit Velu dhe Rakipi përsëri i janë drejtuar Gjykatës Supreme me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila kërkesë me 30 shtator 2019 është refuzuar nga Gjykata Supreme si e pabazuar.

Dëmi i pretenduar: 70,131.27 euro.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

²¹⁹“Apeli e liron nga akuzat për korrupsion ish-rektorin e UP-së, Enver Hasani”, Betimi për Drejtësi, 15 maj 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-nga-akuzat-per-korrupsion-ish-rektorin-e-up-se-enver-hasani/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²²⁰“Supremja vërteton pafajësinë e Hasanit sa ishte rektor, ky thotë se Prokurori e ndoqi pa të drejtë”, Koha.net. 2 nëntor 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/video/126629/supremja-verteton-pafajesine-e-hasanit-sa-ishte-rektor-ky-thote-se-prokurori-e-ndoqi-pa-te-drejte/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

²²¹“Kontrata e UP-së, Apeli sërish i gjykon me burg efektiv dy të akuzuarit, Hakif Velu dhe Albert Rakipi”, Betimi për Drejtësi, 29 maj 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kontrata-e-up-se-apeli-serish-i-gjykon-me-burg-efektiv-dy-te-akuzuarit-hakif-velu-dhe-albert-rakipi/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

18. RASTI “PROKURORI 2”

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.42/19

Kryetar i Trupit Gjykses: Albina Shabani - Rama


Prokuror: Merita Bina - Rugova

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Të pandehur: Agron Matjani

Faza e procedurës: Është pushuar procedura për shkak të vdekjes së të akuzuarit.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI NË PUSHIMIN E PROCEDURËS, KANË KALUAR 30 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur me 5 nëntor 2019, nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori Agron Matjani, tani më i suspenduar, në cilësinë e personit zyrtar – Prokuror i Shtetit në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me dashje kishte keqpërdorur pozitën dhe detyrat e prokurorit.

Sipas prokurorisë, Matjani me rastin e ngritjes së aktakuzës në disa raste penale, në mënyrë drastike e kishte zbutur kualifikimin penal të veprës, në kundërshtim me ligjin, ashtu që për kryesit e veprave kishte siguruar dënime shumëfish më të lehta se sa e parasheh ligji për veprat penale të cilat i kishin kryer.

Në aktakuzë thuhet se në një rast penal kundër kryesve Qëndrim Shala dhe Veton Gjoshi të cilët më të shtëna zjarri nga pushka automatike dhe nga revolja i kishin privuar nga jeta tre persona të cilët kishin qenë të ulur në një kafiteri të Gjakovës, përderisa me vendim hetimin e kishte zhvilluar një prokuror tjetër në drejtim të veprës penale “vrasje e rëndë”, nga neni 179 të KPRK-së, për të cilën veprë parashihet dënim jo më pak se 10 vite burgim ose burgim të përjetshëm, i akuzuari Matjani me 31 janar 2018, kryesit e veprës i ka akuzuar për “vrasje”, nga neni 178 e cila dënohet jo më pak se 5 vite burgim, edhe përkundër vrasjes së tre personave, hakmarrjes së paskrupullt dhe duke vënë në rrezik jetën e personave të tjerë.

Ndërsa, sipas PSRK-së në një rast tjetër penal kundër kryesit Luan Haxhishabani, hetimi ishte zhvilluar në drejtim të veprës penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 dhe veprës penale “marrja e ryshfetit”, nga neni 428 i KPRK-së, por i akuzuari Matjani me 12 dhjetor 2017, aktakuzën e kishte ngritur vetëm në drejtim të veprës penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, e dënueshme deri në 5 vite burim, edhe pse i akuzuari në këtë rast në cilësinë e ekzaminerit në Qendrën e Patent-shoferevë në Gjakovë, prej kandidatit kishte kërkuar dhe marrë të holla në shumë prej 300-500 euro.

Sipas PSRK-së, i akuzuari Matjani në aktakuzë nuk kishte përfshirë edhe veprën penale “marrja e ryshfetit”, edhe pse në veprimet e të akuzuarit ishin plotësuar elementet e kësaj vepre penale.

Me këto veprime, sipas PSRK-së ish-prokurori Matjani për kryesit e veprave kishte siguruar dobi jo-materiale- dënime shumëfish më të lehta se sa e parasheh ligji për veprat penale të cila i kishin kryer.

PSRK-ja të akuzuarin Matjani po e ngarkonte me veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në këtë rast, aktvendimi për fillim të hetimeve ishte iniciuar më 10 janar 2019, ndërkaq aktakuza ishte ngritur me 5 nëntor. Shqyrtimi fillestar ishte caktuar brenda afatit ligjor. Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 22 nëntor 2019, ish-prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Agron Matjani ishte deklaruar i pafajshëm për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

I njëjti kishte kërkuar që t’i caktohet një avokat sipas detyrës zyrtare, pasi sipas tij, për shkak të problemeve shëndetësore nuk ishte në gjendje të përfaqësojë veten, sepse siç kishte thënë ai, është i papunë që një vit. Lidhur me kërkesën e të akuzuarit Matjani, prokurorja speciale Bina – Rugova kishte deklaruar se mbrojtja nuk ishte e obligueshme, megjithatë do ta lë në dorë të gjykatës të vendosë.

Gjykatësja Albina Shabani-Rama e ka njoftuar të akuzuarin se lidhur me kërkesën e tij për caktimin e një mbrojtësi do të vendosë jashtë seancës. E njëjta gjithashtu e kishte njoftuar Matjanin se brenda afatit prej 30 ditësh, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.²²²

Ndryshe, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në maj të këtij viti, kishte marrë vendim që t’i propozohet Presidentit të vendit, Hashim Thaçi, shkarkimi i prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Agron Matjani.

²²² “Ish-prokurori Agron Matjani deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 22 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-prokurori-agron-matjani-deklarohet-i-pafajshem-per-keqpërdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

“Këshilli ka marrë vendim për t’i propozuar Presidentit të vendit shkarkimin nga detyra të prokurorit Agron Matjani për shkak të mosrespektimit të rëndë të detyrave zyrtare, vendim ky, i cili ka ardhur pas zhvillimit të procedurave disiplinore nga komisioni përkatës”, thuhej në njoftimin e KPK-së.

Më 5 dhjetor 2019, ishte raportuar se Matjani ka ndërruar jetë dhe në këtë formë është pushuar procedura penale ndaj tij.²²³

‘Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Konfiskimi dhe sekuestrimi: Nuk ka informacion.

²²³ “Policia/ Ish-prokurori i Krimeve të Rënda gjendet i vdekur në banesën e tij në Prizren”, Sinjali. 5 dhjetor 2019. <https://sinjali.com/ish-prokurori-i-krimeve-te-renda-gjendet-i-vdekur-ne-banesen-e-tij-ne-prizren/>. (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

19. RASTI “MATI”

Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: PKR.nr.76/2019.

Kryetar i Trupit Gjykses: Naser Maliqi


Prokuror: Arben Kadriu

Të pandehur: Fiçri Thaqi, Luigj Mehmeti

Veprat penale: “Posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar.

(NGA NGRITJA E AKTAKUZËS E DERI MË 31 DHJETOR 2019, KANË KALUAR 221 DITË)



Sipas aktakuzës së ngritur më 25 maj 2019, më 24 janar të po të njëjtit vit, rreth orës 16:00, në magjistralen Prishtinë – Gjiilan, saktësisht në fshatin Ponesh, pa autorizim, kanë transportuar me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes substancë narkotike të llojit “marihuanë”, e cila me ligj është shpallur si substancë e rrezikshme.

Këtë thuhet se e kanë bërë në atë mënyrë që i pandehuri Thaqi, pas një marrëveshje paraprake e kishte marrë nga një person i panjohur në Prizren substancën narkotike “marihuanë”, në peshë prej 52.37 kg, me automjetin e markës “Mercedes”, e të cilën substancë në bazë të marrëveshjes është dashur ta transportojë deri te i pandehuri Luigj Mehmeti nga Gjiilani, i cili e ka pritur në parkingun e Qendrës Tregtare “ETC”, në Gjiilan. Por, nga Policia e Kosovës është ndaluar i pandehuri Thaqi në fshatin Ponesh dhe në bagazhin e veturës i gjendet dhe sekuestrohet substanca narkotike e lartcekur. Po ashtu thuhet se derisa ishte në pritje të substancës arrestohet edhe i pandehuri Mehmeti dhe te i njëjti gjenden të hollat në shumë prej 2000 euro, aq sa ka qenë marrëveshja e të pandehurit Fiçri me të pandehurit Mehmeti për kompensim.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Gjilan, më 19 korrik 2019, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj dy të akuzuarve.

Sipas këtij aktgjykimi, Fiçri Thaqi, i cili ka pranuar fajësinë, është dënuar me gjobë prej 5000 euro dhe dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vitesh, ku në këtë dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26 janar 2019 e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Luigj Mehmeti është dënuar me 5000 euro gjobë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh e gjashtë muajsh, ku do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 26 janar 2019.

Dy të akuzuarve u është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Me anë të këtij aktgjykimi është bërë edhe konfiskimi i substancës narkotike të llojit “marihuanë” në peshë prej 52.37 kg, e cila do të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, si dhe të hollat prej 2000 euro, të cilat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës. Është konfiskuar edhe automjeti i markës “Mercedes” dhe një telefon i llojit “Samsung” dhe “Iphone”.

Dëmi i pretenduar: Nuk ka informacion.

Sekuestrimi dhe konfiskimi: Janë konfiskuar substanca narkotike e llojit “marihuanë” në peshë prej 52.37 kg, e të hollat prej 2000 euro, automjeti i markës “Mercedes” dhe një telefon i llojit “Samsung” dhe “Iphone”.

ANEX V: Veprimet e institucioneve të drejtësisë pas 1 janarit 2020

Sipas të dhënave të Prokurorit të Shtetit, të datës 3 mars 2020, janë shënjestruar 61 raste me gjithsej 459 persona, sipas të cilave 48 prej tyre janë me aktakuza, ndërkaq, 32 raste për të cilat janë ngritur aktakuza i përkasin natyrës korruptive ku janë të përfshirë 229 persona të ndryshëm të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Sipas tyre, nga 61 rastet e përgjithshme, 16 raste janë me aktakuza që i përkasin natyrës së krimit të organizuar, ku janë të përfshirë 155 persona, prej tyre 14 raste kanë vendim të formës së prerë, 17 raste janë vendosur në shkallë të parë, 17 raste i kemi me shqyrtim gjyqësor, 8 raste janë në fazën e hetimeve ku janë të përfshirë 99 persona, për 4 raste kanë pushuar hetimet ku kanë qenë të përfshirë 11 persona, si dhe 1 rast me pezullim të hetimeve ku është i përfshirë 1 person.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Gjykata e Apelit, ka vendosur për rastet “MSH2”, “Fan” dhe “Detyrimi”.

Përmes një njoftimi të 5 shkurtit 2020, kjo gjykatë kishte njoftuar se e kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë të rastit “MSH2”, ku të akuzuarit ishin liruar nga akuza.

Apeli, kishte aprovuar pjesërisht ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në rastin e ish-sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj, duke e dënuar këtë të fundit me tre vjet burg efektiv për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Po ashtu, për keqpërdorim të pozitës zyrtare, Apeli e ka dënuar me dy vjet e katër muaj burgim edhe të akuzuarin Bekim Fusha, ndërsa me dy vjet e tetë muaj burgim e ka dënuar të akuzuarin Zenel Kuqi.

Gjithashtu, shkalla e dytë i ka dënuar me nga gjashtë muaj burgim me kusht, në një periudhë verifikimi prej një vjetësh, edhe të akuzuarit tjerë për keqpërdorim të pozitës zyrtare në këtë rast, Valentina Haxhijaj, Florije Tahiri dhe Remzije Thaqin.

Gjykata e Apelit, po ashtu më 24 shkurt 2020, kishte njoftuar se për shkak të shkeljeve ligjore kishte kthyer në rigjykim rastin e njohur si “Dëmi”, ku për akuza për “detyrim” akuzoheshin Arben Bashota dhe vëllezërit Osman dhe Sylejman Bajrami.

Arben Bashota ishte dënuar me 6 vjet burgim, Osman Bajrami ishte dënuar me 4 vjet e 6 muaj burgim, kurse Sylejman Bajrami ishte dënuar me 3 vjet burgim.

Me vendimin e shkallës së parë po ashtu të akuzuarit Bashota, i ishin konfiskuar veturat “Chevrolet” dhe “BMË”, kurse nga të akuzuarit Osman Bajrami ishte konfiskuar vetura “Audi A4”, derisa Sylejman Bajrami i ishte konfiskuar shuma prej 10 mijë euro.

Ndërsa, Gjykata e Apelit, me njoftimin e 4 marsit 2020, kishte njoftuar se kishte kthyer në rigjykim edhe rastin e njohur si “Fan”, në të cilin akuzoheshin Naser Osmani dhe pesë të akuzuarve të tjerë.

Kurse, biznesmenit Agim Deshishku, i cili ishte dënuar nga shkalla e parë për mashtrim në vazhdimësi dhe shmangie nga tatimi, Apeli ia ka vërtetuar dënimin prej një vit e tetë muaj burgim dhe 10.000 euro gjobë dhe është detyruar që ATK-së, si palë e dëmtuar t’i kompensoj dëmin në shumë prej 53.807.46 euro.

XI. Rekomandimet

- Prokurori i Shtetit dhe Koordinatori për Shënjestrimin e rasteve të zbatojnë me përpikëri kriteret e përcaktuara me PSV, lidhur me identifikimin dhe shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda.
- Prokurori i Shtetit dhe Koordinatori për Shënjestrimin e rasteve, të shënjestrohen rastet që i plotësojnë kriteret sipas PSV-ve, ku mundësitë për konfiskim të pasurive janë shumë të mëdha.
- Lëndët e shënjestruara të trajtohen si prioritet nga gjykatat themelore dhe Gjykata e Apelit dhe prokuroritë, në mënyrë që të mos zvarritet procesi gjyqësor dhe procedurat gjyqësore në të gjitha shkallët dhe të njëjtat të përfundohen në afat të arsyeshëm kohor, duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.
- Kryetarët e gjykatave, me rastin e ngarkimit me lëndë, t'i njoftojnë gjyqtarët e caktuar se i është caktuar një lëndë e shënjestruar.
- KGJK dhe kryetarët e gjykatave të marrin hapa me të cilët duhet të ndalohet praktika e kufizimit të raportimit nga seancat gjyqësore publike të rasteve të shënjestruara.
- KGJK të respektojë politikat dhe vendimet që vetë i ka nxjerrë, në atë mënyrë që të ftojë Kryetarët e Gjykatave për të raportuar na baza mujore lidhur me rastet e shënjestruara.
- KGJK dhe KPK të harmonizojnë bazat e të dhënave të tyre në mënyrë që këto institucione të kenë të dhëna unike dhe të informohet publiku në baza mujore për progresin dhe sfidat në trajtimin e këtyre lëndëve.
- Kryetarët e gjykatave të sigurohen që një gjykatës mos të ngarkohet me më shumë se dy lëndë të shënjestruara, meqenëse qëllimi i shënjestrimit të rasteve është rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në trajtimin e tyre.
- Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët brenda kompetencave të tyre të kujdesen për menaxhimin e mirë të rasteve, në mënyrë që në një rast mos të ketë ndërrime të shpeshta të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërrime këto të cilat ndikojnë në efikasitetin e trajtimit të rastit dhe efektivitetin e përfaqësimit të aktakuzës.
- Kryetarët e gjykatave dhe Kryeprokurorët e prokurorive të udhëzojnë gjykatësit e prokurorët që të jenë të informuar se cilat lëndë janë të shënjestruara.
- Gjykatat të publikojnë në faqet e tyre aktgjykimet e formës së prerë si dhe datën dhe orën se kur do të mbahen seancat për rastet e shënjestruara për liberalizim të vizave.
- Gjykatësit të zbatojnë obligimet ligjore ndaj prokurorëve, avokatëve dhe palëve tjera, të cilat nuk i arsyetojnë mungesat që ndikojnë në shtyrjen e rasteve të shënjestruara.